



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar i auditimit të ushtruar në Drejtorinë Rajonale
Tatimore Shkodër**

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI

“AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”

TIRANË, SHKURT 2023

PËRMBAJTJA:

NR.	TITULLI	FAQE
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-10
I.1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-3
I.2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-6
I.3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	6-10
II	HYRJA	10-14
II.1	Titulli, marrësi	10-10
II.2	Objektivat dhe qëllimi	10-11
II.3	Identifikimi i çështjes	11-11
II.4	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	11-11
II.5	Përgjegjësitë e audituesve	11-12
II.6	Kriteret e vlerësimit	12-13
II.7	Standardet e auditimit	13-13
II.8	Metodat e auditimit	13-13
II.9	Dokumentimi i auditimit	13-14
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	14-138
III.1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	14-14
III.2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	14-138
III.2.1	Mbi zbatimin e rekomandimeve.	14-18
III.2.2	Mbi programimin e të ardhurave tatimore, realizimin e tyre, ndarë sipas strukturës së të ardhurave tatimore për periudhën objekt auditimi.	18-20
III.2.3	Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.	21-110
III.2.3.1	Mbi auditimin e veprimtarisë së Sektorit të Kontrollit Tatimor në Vend.	21-67
III.2.3.2	Mbi auditimin e veprimtarisë së Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.	68-110
III.2.4	Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, të veprimtarisë së Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara.	110-123
III.2.5	Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, të veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve.	123-128
III.2.6	Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.	128-130
III.2.7	Mbi përgatitjen e Pasqyrave Financiare dhe raportimin financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.	130-135
III.2.8	Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në ekzekutimin e buxhetit vjetor, për periudhën nën auditim.	135-138
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	138-156

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 814/1, datë 09.09.2022, ndryshuar me shkresën nr. 814/2, datë 24.10.2022 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër. Në përfundim të auditimit, hartoi Projekt Raportin e Auditimit, bazuar në Letrat e punës, Akt Konstatimet, vërejtjet e bëra nga subjekti “Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër”, etj., sipas drejtimeve të auditimit të përcaktuara në Programin e Auditimit. Projekt Raporti i Auditimit u dërgua në subjekt me shkresën nr. 814/4, datë 30.12.2022, njohja e të cilit është konfirmuar nga subjekti i audituar, me shkresën përcjellëse nr. 3313/49, datë 10.01.2023, protokolluar në KLSH me nr.814/5, datë 13.01.2023. Mbi këtë bazë është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit.

I.2. Përmbledhje e gjetjeve kryesore:

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në RPA	Rëndësia	Rekomandimi
1	Janë evidentuar diferenca të konsiderueshme në qarkullimin e të ardhurave të deklaruar në kasat fiskale me të ardhurat e deklaruar në deklaratat e TFTH-së dhe TVSH-së; në qarkullimin e deklaruar në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e Tatimit mbi Fitimit, të klasifikuara si të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit për periudhën objekt auditimi, të cilat sipas përlllogaritjeve paraprake rezultojnë në shumën 754,281,903 lekë.	Pika III.2.3.2 Faqe 68-110	E lartë	-Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për diferencat e pajustificuara, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në zërat e Tatimit mbi Fitimin, Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH-së, të përlllogaritura paraprakisht në shumën 596,120,224 lekë, nga e cila penalitete në shumën 107,096,251 lekë, si rezultat i diferencave me kasën për 1198 raste; dhe si rezultat i diferencave mes të ardhurave të TF dhe TVSH në shumën 158,161,678 lekë, nga e cila penalitete në shumën 28,414,608 lekë, për 94 raste, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse si dhe kryerjen e propozimeve përkatëse Sektorit të Kontrollit Operacional në DRT Shkodër për kontrollet e thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

				- Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër në bashkëpunim me DPT-në në cilësinë e institucionit epror përgjegjës, t'i drejtohen AKSHI-t me shkresë zyrtare për problematikat e hasura gjatë kryerjes së detyrave funksionale të punonjësve tilla si: normalizimin e situatës së funksionimit të sistemit informatik tatimor dhe rikthimin e dokumentacionit dhe informacionit të fshirë në postën elektronike zyrtare të institucionit; përmirësimin e problematikave të lidhura me inkorporimin e sistemit të ri fiskal CPCM, zgjidhjen e mangësive dhe mospërputhjeve me sistemin e vjetër ku nevojitet mundësimi i aksesit në sistemin e vjetër të kasave Nexus për të kryer verifikime; shqyrtimin e mundësisë për hapjen e akseseve për ti eksportuar ne excel apo për të aksesuar raportet e shkarkuara nga ana e IT-së çdo muaj për kasat/pajisjetfiskale/sigurimet/deklaratat e TVSH-ve apo te TTHF, TF; pasqyrimin e vlerave të pajisjeve fiskale të çregjistruara nga AKSHI, problemeve të regjistrimit të importeve në sistemin selfcare; dublikime, etj; në mënyrë që DRT Shkodër nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të kryejë verifikimet përkatëse për diferencat e konstatuara nga grupi i auditimit.
2	Janë evidentuar diferenca të konsiderueshme në vlerën e importeve dhe eksporteve të deklaruar në tatime dhe të deklaruar në doganë, të klasifikuara si të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit, për periudhën objekt auditimi, të cilat sipas përlllogaritjeve	Pika III.2.3.2 Faqe 68-110		- Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për diferencat e pajustifikuara, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në zërat e Tatimit mbi Fitimin dhe TVSH-së, të përlllogaritura paraprakisht

	paraprake rezultojnë në shumën 355,266,336 lekë.			në shumën 107,473,939 lekë, nga e cila penalitete në shumën 33,468,787 lekë, në importet për 334 raste dhe 247,792,397 lekë, nga e cila penalitete në shumën 44,517,257 lekë, në eksporte për 210 raste duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse. - Strukturat respektive të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit të kryejnë propozimet përkatëse Sektorit të Kontrollit Operacional në DRT Shkodër për kontrollet e thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.
3	Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, ka rezultuar se në disa raste nuk ishin analizuar në përputhje me Ligjin nr. 9920/2008, kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, kërkesat e Programit të Kontrollit, mbi verifikimin e pasqyrave financiare të subjekteve tatimpagues dhe deklarimet e tatimpaguesve, gjë e cila ka sjellë ri karakterizimin e situatës, si dhe evidentimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit në shumën 86,409,676 lekë.	Pika III.2.3.1 Faqe 21-67	E lartë	Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht në vlerën prej 86,409,676 lekë, nga e cila penalitetet në shumën 22,125,629 lekë.

4	- Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të kontrollit, nga 30 dosje kontrollit tatimor të audituara, në 15 prej tyre, nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur procedurat e kontrollit , mbi analizimin e situatës financiare dhe deklarimeve të subjektit, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, kërkesat e programeve të kontrollit, si dhe Ligjin nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, me ndryshime.	Pika III.2.3.1 Faqe 21-67	E lartë	Drejtori i Drejtorisë Tatimore Shkodër, në cilësinë e Titullarit, duhet të nxjerrë përgjegjësitë si dhe të marrë masa të menjëhershme, për forcimin e kontrolleve të cilësisë, mbi kontrollet e ushtruara nga inspektorët e kontrollit tatimor në vend, nga ana e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit Tatimor në Vend dhe Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.
---	--	------------------------------	---------	---

I.3. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

I.3.1. Konkluzion i përgjithshëm:

Në përfundim të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë bazuar në ISSAI/IFPP 200-299 dhe 400-499 parimet themelore të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë dhe ISSAI/IFPP 2000-2899 dhe 4000-4899, standardet e auditimit financiar dhe të të përputhshmërisë, të ushtruar në DRT Shkodër, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2020 deri në 30.06.2022, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 814/1, datë 09.09.2022, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin se, përsa i përket përputhshmërisë së çështjeve të audituara, subjekti i audituar “Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër” me përjashtim rasteve të cilësuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të cilat i përkasin kontrollit tatimor në vend dhe kontrollit tatimor nga zyra, përgjithësisht ka vepruar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore, të cilat kanë shërbyer si kritere vlerësimi, ndërsa përsa i përket auditimit financiar, arrijmë në konkluzionin se pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë situatën financiare të subjektit më datë 31.12.2021.

I.3.2. Opinioni i auditimit:

Opinion mbi auditimin e përputhshmërisë:

Për drejtimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër.

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nën ligjore (kriteret e paracaktuara të vlerësimit), për veprimtarinë e DRT Shkodër në lidhje me zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor, nga ana e Sektorit të Kontrollit Tatimor në Vend, Sektorit të Kontrollit nga Zyra; Sektorit të Shërbimit ndaj Tatimpaguesve; Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore, në zbatim të Ligjit 9920/2008 me ndryshime “Për procedurat Tatimore në RSH”, për periudhën 2020-Qershor 2022, Zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të KLSH, si dhe auditim financiar mbi llogaritë vjetore të vitit ushtrimor 2021. Auditimi, ka përfshirë ekzaminimin në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin kryerjen e procedurave tatimore, referuar dosjeve përkatëse si dhe të dhënave dhe çdo dokumenti të ndodhur në sistemin C@ts. Në auditimin e çështjeve të mësipërme, ne u

mbështetëm në analizë risku, duke përzgjedhur kampionin mbi të cilin u kryen testet analitike.

Opinion i Modifikuar, i cilësuar (kualifikuar).

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të cilësuar në paragrafin e “Bazës për opinionin e cilësuar” subjekti i audituar, Drejtoria Tatimore Rajonale Shkodër, ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit (Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligj nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligj nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar, etj.), gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Baza për opinion e Modifikuar, të cilësuar.

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar DRT Shkodër, në disa raste nuk ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Shkeljet e evidentuara në disa çështje të audituara, janë materiale por jo të përhapura, referuar popullatave, nën popullatave të kampionuara dhe kampioneve të testuara, sipas përshkrimit të mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore.

1-Nga auditimi i procedurave të kryera nga Sektori i Kontrollit nga Zyra është konstatuar se si pasojë e moskryerjes në kohë dhe me efektivitetin e kërkuar të detyrave funksionale; mungesës së planeve mujore të punës, e analizave nga Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit, kanë rezultuar mangësi në administrimin dhe monitorimin e situatave financiare të tatimpaguesve, konkretisht:

- Janë evidentuar diferenca të konsiderueshme të konstatuara në qarkullimin e të ardhurave të deklaruara në kasat fiskale me të ardhurat e deklaruara në deklaratat e TFTH-së dhe TVSH-së; në qarkullimin e deklaruar në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e Tatimit mbi Fitimit për periudhën objekt auditimi, **në shumën 754,281,903 lekë**, të cilat konsiderohen të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

1- Janë evidentuar paraprakisht diferenca të konsiderueshme të konstatuara në vlerën e importeve dhe eksporteve të deklaruar në tatime dhe të deklaruar në doganë, për periudhën objekt auditimi, **në shumën 355,266,336 lekë** të cilat konsiderohen të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

2- Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, ka rezultuar se:

- në disa raste nuk ishin analizuar në përputhje me Ligjin nr. 9920/2008, kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, kërkesat e Programit të Kontrollit, pasqyrat financiare të subjekteve tatimpagues dhe deklarimet e tatimpaguesve, gjë e cila ka sjellë ri karakterizimin e situatës, si dhe evidentimin paraprak të të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit **në shumën 86,409,676 lekë**.

- nga 30 dosje kontrolli tatimor të audituara, në 15 prej tyre, nga ana e inspektorëve të kontrollit nuk janë zbatuar në mënyrën e duhur procedurat e kontrollit, mbi analizimin e situatës financiare dhe deklarimeve të subjektit, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, kërkesat e programeve të kontrollit, si dhe Ligjin nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, me ndryshime.

- nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor në vend, në kontrollet e ushtruara (6 raste), nuk janë analizuar në mënyrën e duhur llogaritë "Detyrime afat shkurtër" (detyrime ndaj ortakut) dhe Detyrime afatgjatë" (hua).

3- Nga gjendja e detyrimeve të papaguara në fund të muajit Qershor 2022 për rajonin Verior rezulton 13,290,528 mijë lekë, që i përkasin 23,816 debitorëve, nga vlera 11,007,343 mijë lekë që paraqitej në fund të muajit dhjetor 2020. Trendi për detyrimet për periudhën janar 2020-qershor 2022 paraqitet me një rritje të ndjeshme, situatë e ndikuar nga mungesa e efektivitetit të masave shtrënguese të ndërmarra për arkëtimin e borxhit, moszbatimi i tyre në mënyrë shteruese, ristrukturimi i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara në Rajon Verior dhe periudha e vështirë shkaktuar nga pandemia e Covid-19 gjatë vitit 2020.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër:

Strukturat drejtuese të DRT Shkodër, janë përgjegjëse për realizimin e të ardhurave tatimore, në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar (kriteret e vlerësimit). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në fushën e kontrollit dhe vlerësimit të subjekteve tatimpaguese, menaxhimin e borxhit tatimor, shërbimin ndaj tatimpaguesve, nxjerrjen e vendimeve etj.. Gjithashtu, strukturat drejtuese të DRT Shkodër janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktivitetëve të kontrollit, gjurmës së auditimit për të aktivitet kryesore të saj.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurtisë së arsyeshme nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Opinionit i auditimit mbi pasqyrat financiare:

KLSH, ka audituar pasqyrat financiare të DRT Shkodër për periudhën ushtrimore 01.01.2021-31.12.2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumën dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit arrijmë në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, nuk janë materiale, dhe as të përhapura, në llogaritë përmblendhëse vjetore të konsoliduar të vitit 2021, të cilat justifikojnë dhënien e opinionit të pa modifikuar.

Opiniononi i pa modifikuar:

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit më 31 dhjetor 2021, referuar Udhëzimit të MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” me ndryshime dhe Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin e MFE Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” me ndryshime, mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinionin:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga Subjekti, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme¹ për të dhënë një bazë për opinionin tonë². Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se; pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet mbi to, *janë përfshirë në deklaratat financiare, si dhe nuk përmbajnë gabime materiale*. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar miratuar me Vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 të Kryetarit të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 është 2,044 mijë lekë.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të DRT Shkodër:

Strukturat drejtuese të DRT Shkodër, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e udhëzimeve të MFE “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Staf drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuar (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurtisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara ligjore, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të

¹ SNA-2500

² SNA-2700

periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

II.1. Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 814/1, datë 09.09.2022, ndryshuar me shkresën nr. 814/2, datë 24.10.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 15.09.2022 deri në datë 02.12.2022 në subjektin DRT Shkodër për periudhën e veprimtarisë së subjektit nga data 01.01.2020 deri në 30.06.2022, u krye auditimi “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- B.Z., Përgjegjës Grupi
- A.D., Auditues
- A.H., Auditues
- J.T., Audituese
- E.H., Audituese

Titulli: Auditim Financiar dhe Përputhshmërie

Marrësi: DRT Shkodër

II.2. Objektivat dhe qëllimi.

- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, për të arritur objektivin e këtij auditimi, që është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2020, 2021 dhe 6 mujor i I-rë 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë, si dhe në pasqyrat financiare (2021) të subjektit të audituar paraqesin në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të subjektit më 31.12.2021, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

- Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH.” me ndryshime, Ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” me ndryshime, Ligjin 92/2014 datë 24.07.2014 “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, etj., me synim dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbimeve e investimeve.

Ky projekt auditimi do të shtrihet për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2020 deri në datë 30.06.2022, si dhe do të ketë si fushëveprimi zbatimin e procedurave tatimore gjatë vlerësimit, kontrollit dhe ofrimit të shërbimit ndaj tatimpaguesve, nga ana e administratës tatimore të DRT Shkodër; funksionimin e MFK, plotësimin e Pasqyrave Financiare, si dhe kryerjen e shpenzimeve në përputhje me kriteret e vlerësimit, zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të KLSH, etj.

II.3. Identifikimi i çështjes.

Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit si dhe ai i aplikuar gjatë fazës së auditimit në terren, vijon të mbetet i vlefshëm, si dhe nuk ka rishikim të tij.

Sa më sipër, fushat me risk të lartë u përcaktuan si drejtimit e auditimit të miratuara me Programin e Auditimit nr. 814/1 datë 09.09.2022, si më poshtë:

- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.
- Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.
- Mbi programimin e të ardhurave tatimore, realizimin e tyre, ndarë sipas strukturës së të ardhurave tatimore për periudhën objekt auditimi.
- Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, të veprimtarisë së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.
- Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, të veprimtarisë së Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara.
- Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, të veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve.
- Mbi përgatitjen e Pasqyrave Financiare dhe raportimin financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në ekzekutimin e buxhetit vjetor, për periudhën nën auditim.

II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të DRT Shkodër, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuar (kriteret e vlerësimit), për të fushat e veprimtarisë së DRT Shkodër në drejtim të vlerësimit. Kontrollit, shërbimit ndaj tatimpaguesve. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

II.5. Përgjegjësitë e audituesve.

- Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurtisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

- Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
- Përgjegjësi e audituesit, lidhen me faktin e marrjes së sigurisë së arsyeshme, në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.

Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

II.6. Kriteret e vlerësimit.

1. Standardet e Auditimit:
 - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI/IFPP 100; 200; 400 etj.;
 - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC);
2. Manuale:
 - Manuali i Auditimit të Përputhshmërisë të KLSH, miratuar me Vendimin nr. 245, datë 29.12.2022;
 - Manuali i Auditimit Financiar të KLSH, miratuar me Vendimin nr. 246, datë 29.12.2022;
 - Manuali i Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Vendimin e Ministrit të Financave;
 - Manuali i Ndjekjes së Zbatimit të Rekomandimeve, miratuar me Vendimin nr. 67, datë 23.06.2020, etj.;
 - Manuali i Kontrollit Tatimor;
3. Akte ligjore, me ndryshime:
 - Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
 - Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”;
 - Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”;
 - Ligj nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) në Republikën e Shqipërisë”;
 - Ligj nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të Ardhurat”;
 - Ligj nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”;
 - Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”;
 - Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;
 - Ligjet dhe VKM mbi “Prokurimin publik”, sipas periudhave përkatëse (2020-2022), etj.;
4. Udhëzime, Urdhra dhe Rregullore:
 - Udhëzimi MFE nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme” ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.02.2022;
 - Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik";

- Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 197, datë 12.10.2022;
- Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH e ndryshuar me Vendimin nr. 63, datë 22.06.2020;
- Rregullore mbi organizimin dhe funksionimin e DRT etj.

II.7. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës.

Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 200-299 “Parimet bazë të auditimit financiar”, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”.

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”

ISSA 130 “Kodin Etik”

ISSAI 2315 “Risku”

ISSAI 2320-2450 “Materialiteti”

ISSAI 2500 “Dokumentimi”

II.8. Metodatat e auditimit.

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Duke qenë se thelbi i MFK-së ka të bëjë me menaxhimin dhe kontrollin e të ardhurave, shpenzimeve, aktiveve, detyrimeve, etj., si dhe mënyrës së funksionimit të njësisë, së pari u vlerësua niveli i zbatimit të këtij ligji si dhe funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm nga njësia e audituar, për aq sa ka detyrim si njësi e varësisë së DPT.

Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer intervista verbale, ka kryer teste kontrolli. Nga vlerësimi i riskut në fazën e planifikimit dhe në fazën e auditimit në terren, ka rezultuar se sistemi i kontrollit të brendshëm, përgjithësisht ka funksionuar në mënyrën e duhur, si dhe është konsideruar me risk të mesëm, për këtë arsye për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe korrektësisë (në auditimin e përputhshmërisë) nga ana e subjektit të audituar, janë aplikuar:

Testet e Kontrollit, të cilat janë përdorur nga Grupi i Auditimit, janë të mbështetura tek niveli i materialitetit dhe vlerësimit të riskut, shkalla e sigurisë që përfitohet nga kryerja e testeve të kontrollit, teknikat e kampionimit dhe zgjedhjes rastësore.

Testet e detajeve, të cilat janë përdorur nga Grupi i Auditimit, për të marrë evidencë auditimi për pohimet (ekzistenca e një ngjarje ekonomike, ligjshmëria dhe vlerësimi i saj).

II.9. Dokumentimi i auditimit:

Dokumentimi i auditimit është mbështetur në kërkesat e manualeve të auditimit, në Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e ezauruara (planifikim dhe auditim në terren). Nga Grupi i auditimit janë plotësuar të

gjitha dokumentet standarde të auditimit, si dhe është lënë gjurmë auditimi për të gjitha procedurat e kryera nga Grupi i auditimit.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

III.1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Drejtoria Rajonale Tatimore (Shkodër) është strukturë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve që merret direkt me mbledhjen e detyrimeve tatimore, me ofrimin e shërbimeve dhe asistencës për tatimpaguesit, kontrollin e deklaratave dhe pagesave, kontrollin e tatimpaguesve. Njësitë përbërëse të kësaj Drejtorie Rajonale Tatimore (Drejtoritë Funksionale, Sektorët, Zyrat apo punonjësit që zbatojnë një funksion të caktuar) operojnë mbi bazën e manualeve procedurale të përgatitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ku përshkruhen me hollësi veprimet që këto njësi ndërmarrin sipas funksioneve të administrimit tatimor.

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër përbëhet nga 3 drejtori dhe një sektor: Drejtoria e Kontrollit Tatimor, Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve dhe Drejtoria e Funksioneve Mbështetëse dhe Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave.

Objektivat strategjike të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër për periudhën objekt auditimi kanë qenë:

- Të sigurojnë ndërmarrjen e të gjithë veprimeve në aktivitetin e tyre të cilat çojnë në zbatimin rigoroz të planit strategjik të administratës tatimore qendrore;
- Të mbledhin të ardhurat tatimore në përputhje me procedurat e përcaktuara në legjislacionin tatimor në fuqi me koston më të ulët të mundshme, nëpërmjet nxitjes dhe vetëvlerësimit e plotësimit vullnetar të detyrimeve nga tatimpaguesit dhe nëpërmjet kontrolleve të paanshme për të gjithë tatimpaguesit, për të zbuluar dhe korrigjuar rastet e moszbatimit të ligjeve tatimore;
- Të bashkëpunojnë me drejtoritë përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për zbatimin e planit operacional në përputhje me objektivat e vendosura në planin strategjik të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve;
- Të përcaktojnë plane operationale vjetore me shkrim për çdo funksion;
- Të bashkëpunojnë me strukturat përkatëse në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për trajnimin e punonjësve;
- Të hartojnë dhe zbatojnë programe në mënyrë që përgjegjësit të përgatisin raporte me shkrim për vlerësimin e punës së kryer gjatë vitit nga punonjësit nën varësinë e tyre;
- Të ndjekin të gjitha procedurat standarde të punës, të përcaktuara nga drejtoritë funksionale në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

III.2. REZULTATET E AUDITIMIT SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT:

III.2.1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për auditimin dhe në lidhje me rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm rezultoi që:

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ushtruar auditim në DRT Shkodër në bazë të Programit të Auditimit nr. 55/1, datë 20.01.2020, ndryshuar me nr.55/2, datë 20.02.2020.

Nga verifikimi rezulton se KLSH, ka dërguar në DRT Shkodër, Raportin Përfundimtar të Auditimit me Rekomandimet, me anë të shkresës përcjellëse nr. 55/9, datë 13.05.2020, “Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet”.

Gjithashtu nga KLSH, sipas Programit të auditimit nr. 250 , datë 11.02.2021, me objekt “Për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm”, është kryer auditim mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të cilat janë dërguar në DRT Shkodër me shkresën nr. 250/6, datë 19.04.2021.

Nga Grupi i Auditimit u audituan nën çështjet e mëposhtme:

1. Hartimi i programit (Plan veprimit) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve.

- Nga DRT Shkodër, me shkresën nr. 4340 prot., datë 04.06.2020, është dërguar plani i masave në vijim të zbatimit të rekomandimeve të lëna me shkresën nr. 55/9, datë 13.05.2020 të KLSH-së, **brenda afatit ligjor, prej 20 ditësh**, në përputhje me kërkesat e nenit 15, shkronja “j”, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.
- Nga DRT Shkodër, me shkresën nr. 1446/8 prot., datë 07.05.2021, është dërguar informacion në lidhje me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të ri kërkuara me shkresën e KLSH-së, nr. 250/6 prot., datë 19.04.2021, brenda afatit ligjor prej 20 ditësh.

2. Realizimi programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6/mujor.

Në zbatim të Plan veprimit për zbatimin e rekomandimeve, ish Drejtori Rajonal z. M.B., ka nxjerrë Urdhrin nr. 19, protokolluar me nr. 7654, datë 19.10.2020 “Për zbatimin e planit të masave në zbatim të rekomandimeve të KLSH”, ku është urdhëruar raportimi brenda datës 20.10.2020 në lidhje me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve.

Nga auditimi ka rezultuar se, DRT Shkodër ka kthyer përgjigje me shkresë nr. 331/1, datë 13.11.2020, **brenda afatit 6-mujor**, nga data e njoftimit të raportit të auditimit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna, veprim ky, në përputhje me kërkesat e nenit 30, pika 2, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.

Në lidhje me masat e rekomanduara, gjendja në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

Lloji i rekomandimeve	Rekomandime të dhëna	Pranuar				Pa pranuar
		Zbatuar plotësisht	Zbatuar pjesërisht	Në proces zbatimi	Pa zbatuar	
Masa organizative	8	6			1	1
Masa shpërblim dëmi (1,444,208 lekë)	3		2			1
Masa për eliminimin e efekteve negative	12	12				
Masa disiplinore	4	2			2	
Totali	27	20	2		3	2

Referuar të dhënave të mësipërme në mënyrë të përmbledhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Titulli i gjetjes 1: Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Situata: Masa organizative:

Në auditimin e mëparshëm janë rekomanduar 8 (tetë) masa organizative nga të cilat janë pranuar 7 (shtatë) masa dhe realizuar 6 (gjashtë) prej tyre. Nuk është pranuar Rekomandimi nr. 1.1, i cili i është adresuar DPT për zbatim me shkresën nr. 3933 datë 21.05.2020. Niveli i zbatimit 87.5 %.

Masa shpërblim dëmi:

Në auditimin e mëparshëm janë rekomanduar 3 (tre) masa shpërblim dëmi në shumën totale 1,444,208 lekë, nga të cilat janë pranuar dy (dy) masa në shumën 1,292,979 lekë, si dhe nuk është pranuar 1 (një) masë shpërblim dëmi në shumën 151,229 lekë, që i përket Rekomandimit nr. 3.1. Niveli i zbatimit paraqitet në masën 66.6 %. Nga dy masat shpërblim dëmi të pranuar, është arkëtuar deri në përfundim të auditimit shuma 546,747 lekë, ose në masën 37.8 % ndaj totalit.

Masa për eliminimin e efekteve negative në buxhetin e shtetit:

Nga auditimi i mëparshëm janë rekomanduar 12 (dymbëdhjetë) “Masa për eliminimin e efekteve negative”, janë zbatuar plotësisht 11 prej tyre, ose në masën 92 %, si dhe (1) një rekomandim është zbatuar pjesërisht.

Masa disiplinore:

Janë rekomanduar masa disiplinore me shkresën nr. 55/10 prot., datë 13.05.2020 “Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet”, rikërkuar përsëri me shkresën nr. 250/6 prot., datë 19.04.2021 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me lëndë “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm”, për të cilat nuk është zbatuar asnjë rekomandim i KLSH-së dhe nuk ka një qëndrim administrativ ligjor nga nëpunësit zyrtarë z. H.J. në cilësinë e ish-Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër deri në periudhën 10.07.2020, z. M.B. në cilësinë e ish-Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër nga periudha 10.07.2020 deri 03.03.2021, z. A.H. në cilësinë e ish-Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër nga periudha 03.03.2020 deri 27.05.2021 dhe në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit pranë DRT Shkodër nga periudha 18.12.2020 deri në periudhën aktuale në vijim z. S.I.. Nga auditimi rezulton se, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër nuk është dërguar shkresë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me qëllim ngritjen e Komisionit Disiplinor për dokumentimin e shkeljeve ligjore të konstatuara nga KLSH, si dhe referimin e shkeljes disiplinore efektive të rekomanduar pranë Komisionit të Shërbimit Civil për z. H. H. me rekomandim “Dhënie Mase Largim nga Shërbimi Civil”, si dhe nuk është kryer adresim ligjor shkresor për rekomandimin e masave disiplinore për personat përgjegjës të trajtuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit sipas përcaktimeve të Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 i ndryshuar për z. F.T., me detyrë (Ish Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut, për periudhën 20.11.2018-11.01.2019; 20.05.2019-17.06.2019 dhe 02.07.2019-07.10.2019) për z. A. A., me detyrë (Ish Drejtori i Komanduar i Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut, për periudhën 17.06.2019 - 02.07.2019) dhe për Z. D.D., me detyrë (Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut për periudhën 07.10.2019), për z. M. S. (Ish Drejtori i Drejtorisë së Hetimit Tatimor Rajoni i Veriut, për periudhën 01.01.2018-20.11.2018) nga të cilët aktualisht z. A. A. dhe z. D. D. janë me detyra funksionale pranë Drejtorisë Rajonale Shkodër në Drejtorinë e Monitorimit të Terrenit në Rajonin Verior dhe z. F. T. me detyra funksionale pranë Drejtorisë Rajonale Tiranë në Drejtorinë e Monitorimit të

	Terrenit në Rajonin Qëndror. Niveli i zbatimit të rekomandimit për masa disiplinore është në masën 0 %.
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Mungesë në të ardhurat e Buxhetit të Shtetit si rezultat i mos mbledhjes detyrimit tatimor.
Shkaku:	Moszbatim nga ana e strukturave drejtuese dhe titullarëve të detyrimeve ligjore përsa i përket zbatimit të përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollin të Lartë të Shtetit”.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandimi 1:	Drejtori Rajonal i DRT Shkodër, në lidhje me rekomandimet e pa realizuara të rishqyrtojë dhe të analizojë situatën, duke marrë masa të menjëhershme administrative dhe ligjore për nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësive konkrete të veprimeve të kryera dhe të konsumuara nga ana e nëpunësve zyrtarë të autorizuar për moszbatimin e rekomandimeve, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 250/6 Prot. KLSH datë 19.04.2021 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me lëndë “Dërgohet raporti përfundimtar i auditimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm”.

Për sa më sipër është mbajtur akti konstatimit nr. 10 datë 02.12.2022, protokolluar në DRT Shkodër me protokoll nr. 3313/3, datë 02.12.2022, si dhe trajtuar në PRA, mbi të cilin është paraqitur observacioni i mëposhtëm.

Pretendimi i subjektit:

1. Në observacionin nr. 3313/50, datë 19.01.2023, nga ish Drejtori i DRT Shkodër, **H.J.** është sqaruar se, nga ana ime në zbatim të rekomandimeve të KLSH të lëna me shkresën nr. 55/9, datë 13.05.2020, është miratuar Plani i masave të cilin është përcjellë në KLSH me shkresë nr. 4340, datë 04.06.2020, si dhe është nxjerrë urdhri nr. 331/15, datë 05.06.2020, për zbatimin e tij. Për periudhën që i përket raportimit të zbatimit të rekomandimeve unë nuk kam qenë në detyrën e Drejtorit të DRT Shkodër, sipas Urdhrit të DPT nr. 58/1, datë 18.08.2020.
2. Në observacionin nr. 3313/57, datë 23.01.2023 nga inspektore e Sektorit të Analizës dhe Kontabilitetit, **M.K.**, është sqaruar se inspektori i analizës dhe kontabilitetit, nuk është përgjegjës për ndjekjen e detyrimeve tatimore dhe kontribute jashtë sistemit. Detyra e sektorit të kontabilitetit dhe analizës është të japë informacion mbi subjekte (NIPT), llojin e tatimit, kamatëvonesat apo gjobat lidhur me këto detyrime. Bashkëngjitur dokumentacioni.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Observacioni i ish Drejtorit të DRT Shkodër z. H.J., është i argumentuar, është pranuar dhe është reflektuar në RPA.
2. Referuar Urdhrit nr. 146 datë 14.10.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për ngritjen e grupit të punës për trajtimin e problematikave të detyrimeve jashtë sistemit C@ts, pika 2, afati i realizimit të kësaj detyre duhej të ishte data 1 Dhjetor 2022. Deri në këtë datë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër nuk është vendosur në dispozicion asnjë rezultat zyrtar mbi zgjidhjen e kësaj problematike dhe konkludime të grupit të punës të ngritur nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe ky proces rekomandimi ka status të pazbatuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

1. Z. M.B. me detyrë ish-Drejtori Rajonal pranë DRT Shkodër nga periudha 10.07.2020 deri 03.03.2021;
2. Z. A.H. me detyrë ish-Drejtori Rajonal pranë DRT Shkodër nga periudha 03.03.2020 deri 27.05.2021;
3. Z. S.I. me detyrë Drejtor Rajonal aktual pranë DRT Shkodër nga periudha 27.05.2021 deri në periudhën objekt auditimi;
4. Z. A.B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit pranë Drejtorisë së Kontrollit Tatimor pranë DRT Shkodër për periudhën objekt auditimi;
5. Znj. M.K., Inspektore në Sektorin e Kontabilitetit, si person përgjegjës për zbatimin e rekomandimeve 2.1 dhe 2.2, sipas Planit të masave nr. 4340, datë 04.06.2020 të Drejtorit të DRT Shkodër.

III.2.2. Mbi programimin e të ardhurave tatimore, realizimin e tyre, ndarë sipas strukturës së të ardhurave tatimore për periudhën objekt auditimi.

Informacioni dhe dokumentacioni i shqyrtuar:

- Treguesit e planit dhe realizimit të planit të DRT Shkodër.
- Raporte elektronike të gjeneruar prej sistemit informatik C@ts.
- Akt-Rakordimet mujore dhe vjetore për të ardhurat e xhiruara në degën e thesarit të rrethit Shkodër.

Drejtoria Rajonale Shkodër realizon monitorimin e të ardhurave tatimore të përqendruara në një llogari të qendëruar në DPT dhe ardhurave dytësore nga subjektet tatimpagues dhe përgatit në fund të çdo muaji dhe tremujori raporte dhe evidenca për DPT dhe Titullarin e institucionit për realizimin e treguesve të të ardhurave tatimore, si dhe evidencat të detyrimeve debitorë që mbahen jashtë sistemit informatik C@ts. Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër nëpërmjet sektorit të analizës dhe të kontabilitetit të të ardhurave kryen ndjekjen e realizimit të arkëtimit të ardhurave nga subjektet tatimpagues të këtij qarku nga sistemi informatik E-Tax duke përgatitur raporte me qëllim monitorimin e tyre. Të ardhurat arkëtohen në një llogari të vetme në DPT. Raportimi mujor dhe progresiv finalizohet në fund viti duke nënshkruar evidencën përfundimtare nëpërmjet përfaqësuesit të Degës së Thesarit Shkodër dhe DPT.

Plani vjetor dhe realizmi i të ardhurave tatimore për periudhën 2020-2021-6 Mujor 2022

Tabela nr. 1 “Plani me ndryshime” (000/lekë)

Zërat e të ardhurave	2020			2021			6-Mujor 2022		
	Plani fillestar	Ndryshime	Plan përfundimtar	Plani fillestar	Ndryshime	Plan përfundimtar	Plani fillestar	Ndryshime	Plan përfundimtar
TVSH	730,000	(100,000)	630,000	685,000	24,000	709,000	324,510	-	324,510
TF	490,000	(100,000)	390,000	380,000	7,000	387,000	224,512	-	224,512
TAP	940,000	(120,000)	730,000	730,000	3,000	733,000	411,463	-	411,463
TK	35,000	(5,000)	35,000	35,000		35,000	25,313	-	25,313
SIG	4,220,000	(360,000)	3,860,000	3,895,000	25,000	3,920,000	2,174,343	-	2,174,343
Totali	6,415,000	(685,000)	5,730,000	5,725,000	59,000	5,784,000	3,160,141	-	3,160,141

Burimi i të dhënave: DRT Shkodër, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se plani i të ardhurave tatimore për vitin 2020 ka pësuar rënie në raport me planin fillestar në shumën (685,000) mijë lekë, kjo si rezultat i ndikimit të situatës pandemike Covid-2019. Në vitin 2021 plani përfundimtar paraqitet me një rritje kundrejt planit fillestar në shumën 59,000 mijë lekë.

Tabela nr. 2 “Realizimi i planit të të ardhurave 2020-6 M 2022” (000/lekë)

Zërat e të ardhurave	Viti 2020			Viti 2021			6-Mujor 2022		
	Plan	Fakt	R %	Plan	Fakt	R %	Plan	Fakt	R %
TVSH	630,000	656,001	104	709,000	609,508	86	324,510	296,017	91
Tatim Fitimi	390,000	342,021	88	387,000	403,122	104	224,512	321,427	143
TAP	730,000	699,421	96	733,000	861,458	117	411,463	428,859	104
TK	35,000	28,596	82	35,000	38,549	110	25,313	16,955	67
Gjoha		11,656			9,769			6,416	
SIG	3,860,000	3,747,847	97	3,920,000	4,181,039	107	2,174,343	2,175,344	100
Totali	5,730,000	5,485,542	95.5	5,784,000	6,103,445	105	3,160,141	3,245,018	103

Burimi i të dhënave: DRT Shkodër, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

- Realizimi i të ardhurave tatimore gjithsej në vitin 2020 është në masën 95.5 % ose me 256,114 mijë lekë më pak, kjo si pasojë e ndikimit të pandemisë në performancën e ekonomisë gjatë kësaj periudhe. Në vitin 2020 me mosrealizim paraqiten të ardhurat nga TF me 87.6 %, ose me 47,979 mijë lekë më pak dhe të ardhurat nga TAP me 60,5789 mijë lekë më pak, ose në masën 96 % kundrejt planit.
- Gjatë vitit 2021 dhe 6 mujori i parë i vitit 2022, realizimi i tyre paraqitet në masën 105 % dhe 103 % si total të ardhura. Në vitin 2021 paraqiten me mosrealizim të ardhurat nga TVSH në shumën 99,492 mijë lekë më pak, ose me një realizim në masën 86 % kundrejt planit. 6 mujorin e parë paraqiten me mosrealizim të ardhurat nga TVSH me 91 % dhe të ardhurat nga TK me 67 %, por duhet të kemi në konsideratë faktin se kjo taksë ka peshën specifike më të ulët kundrejt totalit të të ardhurave.
- Gjatë vitit 2021 dhe 6-mujori i parë 2022, një faktor që ka ndikuar në rënien e të ardhurave nga TVSH, ka qenë rënia e pagesës së TVSH në disa sektorë, veçanërisht në sektorin e prodhimit. Trendi i pagesës së TVSH në vitin 2020 në krahasim me vitin 2019 dhe 2021 në krahasim me vitin 2020, sipas sektorëve të ekonomisë paraqitet më poshtë:

Tabela nr. 3 “Pagesa e TVSH” (në lekë)

Sektori	Pagesa e TVSH-së			2019/2020	2020/2021
	2019	2020	2021	%	%
Ndërtimit	157,306,632	101,849,339	171,686,025	-35%	34%
Prodhimit	113,893,695	92,599,120	84,586,381	-19%	-54%
Shërbimit	141,391,795	92,067,560	75,222,111	-35%	-30%
Transportit	25,908,190	16,177,746	13,688,392	-38%	-22%
Tregtisë	173,941,258	170,424,925	160,883,667	-2%	-17%

Burimi i të dhënave: DRT Shkodër, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Në realizimin e të ardhurave në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020, por dhe në mosrealizimin e të ardhurave nga TVSH, ka patur rritja e numrit të subjekteve të regjistruara në total, si dhe rënia e subjekteve "Biznes i vogël" me TVSH me 72 subjekte më pak, në krahasim me vitin e mëparshëm, për shkak të ndryshimeve ligjore referuar VKM nr.576, datë 22.07.2020 “Për disa ndryshime në VKM nr. 953, datë 29.12.2014 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/214 “Për TVSH në Republikën e Shqipërisë” të cilat paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 4 “Regjistrimet e reja dhe çregjistrimet”

Statusi ligjor	Regjistrimet			Çregjistrimet		
	2020	2021	6-M 2022	2020	2021	6-M 2022
Biznes i madh	37	41	12	17	6	2
Ente publike OJF	11	20	10			
Biznes i vogël me TVSH	124	52	26	30	52	26
Biznes i vogël pa TVSH	430	660	417	185	216	98
Totali i Bizneseve të reja	602	773	465			
Prodhues bujqësor (F fermer)	449	810	818			
Totali (Biznese + fermer)	1051	1583	1,283	232	274	126

Burimi i të dhënave: DRT Shkodër, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr. 5 “Ndryshimi i numrit të subjekteve aktive”

Data. Muaji. Viti	31.12.2019	31.12.2020	31.12.2021	Ndryshimi (2020-2019)	Ndryshimi (2021-2020)
Subjekte aktive	10.486	11.013	11.772	+527	+759
Nga te cilat:					
Subjekte aktive Biznesi i madh	1.163	1.205	1.244	+42	+39
Subjekte aktive OJF, Buxhetore	378	363	294	-15	-69
Subjekte aktive Biznesi i vogël	3.514	3.464	4.630	-50	+1.166
Subjekte aktive Biznesi i vogël me TVSH	1.504	1.607	388	+103	-1.219
Fermer	4.305	4.737	5.510	+432	+773

Burimi i të dhënave: DRT Shkodër, të përpunuara nga grupi i auditimit të KLSH

Si konkluzion:

Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se gjatë periudhës objekt auditimi 2020-6 mujor i parë 2022, DRT Shkodër paraqitet me tregues pozitivë në realizimin e të ardhurave tatimore: (viti 2020 me 95.5 %; viti 2021 me 105 % dhe 6-mujori i parë i vitit 2022 me 103 %, kundrejt planit. Sipas llojit të të ardhurave tatimore përgjithësisht janë realizuar, me përjashtim të të ardhurave nga TVSH, për të cilën janë dhënë dhe shpjegimet përkatëse në lidhje me faktorët ndikues, ndërsa përsa i përket TK ato paraqiten me një mosrealizim të theksuar në 6-mujorin e parë të vitit 2022, por cilësojmë faktin që zënë një peshë specifike të ulët kundrejt të ardhurave tatimore në total, si dhe duhet të pritët dhe vlerësohet dhe ecuria e tyre gjatë 6-mujorit të dytë të këtij viti.

Sa më sipër është mbajtur nr. Akt Konstatimi nr.2, datë 02.12.2022, protokolluar me nr. 3313/6, datë 02.12.2022, mbi të cilin është paraqitur observacioni nr. 3313/26, datë 09.12.2022, si dhe trajtuar në PRA.

III.2.3. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, të veprimtarisë së drejtorisë së kontrollit tatimor.**II.2.3.1. Kontrolli tatimor në vend:**

DRT Shkodër gjatë periudhës objekt auditimi ka kryer 144 kontrolle të plota, nga të cilat u audituan 30 kontrolle të plota dhe 4 kontrolle tematike “vizita fiskale” të përzgjedhura sipas analizës së riskut të Grupit të auditimit.

Në lidhje me kontrollet e plota të ushtruara nga Drejtoria e Kontrollit në vend në DRT-në Shkodër, paraqiten të dhënat si më poshtë për periudhën në auditim nga 01.01.2020 deri 30.06.2022:

Zgjedhje Automatike nga Sistemi (1), Propozimi i DRT (2), Burime të tjera (3)	Kontrollet e ushtruara sipas sektorëve të ekonomisë					Totali i Kontrolleve të ushtruara	Raporti në % sipas zgjedhjes
	Sektori i Ndërtimit	Sektori i Prodhimit	Sektori i Shërbimit	Sektori i Tregtisë	Sektori i Transportit		
Tipologjia 1	9	25	12	51	3	100 Kontrolle	69%
Tipologjia 2	6	10	11	14	3	44 Kontrolle	31%
Total	15	35	23	65	6	144	100%
Raporti në % sipas sektorëve të ekonomisë	10%	24%	16%	45%	4%		
Përzgjedhja sipas sektorëve	4	8	5	11	2	30	21

Konkluzion:

Nga DRT Shkodër, për çdo muaj janë dërguar në DPT, shkresat “Propozim për kontroll”. Përzgjedhja e tyre është kryer bazuar në analizë risku, dhe janë hartuar sipas Formularëve standard. Për secilin subjekt është aplikuar pikëzimi referuar elementëve të riskut. Nga DRT Shkodër janë propozuar në total 44 kontrole, duke respektuar kufirin 30 % ndaj totalit të kontroleve. Këto veprime janë në përputhje me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2 “Plani i kontroleve”.

Për auditimin e këtij drejtimi të Programit të Auditimit, grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim çështjet e mëposhtme:

1. Zbatimi i afateve të kontrollit;
2. Zbatimi i programit të kontrollit dhe procedurave të ndjekura nga inspektorët e kontrollit tatimor, referuar Manualit të Kontrollit, dhe Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” me ndryshime;
3. Vlerësimi i subjektit nga inspektori në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore.

Mbulimi sipas viteve

Periudha	Kontrole të kryera	Kampionimi	% e mbulimit
2020	35	8	23%
2021	66	14	21%
2022	43	8	19%

Nga auditimi i tyre ka rezultuar:

1. Auditim mbi zbatimin e afateve të kryerjes së procedurës së kontrollit, në zbatim të Manualit të Kontrollit Tatimor.

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua i gjithë dokumentacioni i ndodhur në dosjet e kontrollit dhe të arkivuara në arkivin e DRT Shkodër, si më poshtë:

Dokumentacioni	Të dhëna/ sipas dosjes	
	Numër	Datë
Shtojca 1 “Pyetësor i vetë deklarimit para kontrollit”		
Njoftimi i kontrollit tatimor		
Formular nr. 1 “Raporti i strategjisë para kontrollit”		
Program i Kontrollit		
Koha e kryerjes së kontrollit		
Proces verbal mjete monetare		
Proces verbal inventarizimi		
Proces verbale gjatë kryerjes së kontrollit		
Akt verifikimi mbi numrin e punonjësve		
Formular nr. 2 “Listë verifikimi i detyrueshëm për masat gjatë kontrollit”	Inspektori Përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë Drejtori i DRT	
Formulari nr. 3 “Raport i vizitës së kontrollit”	Inspektori Përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë Drejtori i DRT	
Formulari nr. 5 “Analiza e llogarive vjetore”	Inspektori Përgjegjësi Drejtori i Drejtorisë Drejtori i DRT	
Raport Kontrolli Paraprak (hartuar)		
Raport Kontrolli Paraprak (dërguar)		
Raporti Përfundimtar (hartuar)		
Raporti Përfundimtar (dërguar)		
Njoftim vlerësimi për detyrimet		

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm në lidhje me respektimin e afateve të kryerjes dhe evadimit të 30 kontrolleve tatimore në vend ka rezultuar:

Titulli i gjetjes 1: Mbi zbatimin e afateve të kryerjes së kontrollit në vend.

Situata:

Nga auditimi i kontrolleve tatimore në vend, në lidhje me respektimin e afateve të kryerjes së kontrollit (qëndrimi në subjekt), hartimi i Raportit të Kontrollit Tatimor, shqyrtimi i observacioneve të subjektit, hartimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit, miratimi nga Përgjegjësi i Sektorit, Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit, Drejtori i DRT, si dhe dërgimi i këtyre akteve në subjektin tatimpagues ka rezultuar se **në 6 raste** (kontrollat e subjekteve “M”; “L.G.”, “S.A.”, “A.G.”, “P” dhe “A-D”) kemi konstatuar tejkalim të këtyre afateve.

1- Kontrolli i subjektit “M” SHPK është mbyllur sipas Programit të kontrollit më datë 04.12.2019. Raporti i kontrollit duhej të hartohej brenda datës 11.12.2019 (afati 7 ditë), në fakt është hartuar 12 ditë më vonë, në datë 23.12.2019 dhe është përcjellë në subjekt më datë 06.01.2020. Nga ana e inspektorit të kontrollit më datë 23.12.2019, është mbajtur Procesverbal, në tejkalim të afatit të qëndrimit në subjekt datë 04.12.2019.

2- Kontrolli i subjektit “L.G.” PF është mbyllur sipas Programit të kontrollit më datë 18.08.2021. Raporti i kontrollit duhej të hartohej brenda datës 25.08.2021 (afati 7 ditë), në fakt është hartuar 15 ditë më vonë, në datë 10.09.2021 dhe është përcjellë në subjekt më datë 15.09.2021;

3- Kontrolli i subjektit “S.A.” SHPK është mbyllur sipas Programit të kontrollit më datë 19.04.2022. Raporti i kontrollit duhej të hartohej brenda datës 26.04.2022 (afati 7 ditë), në fakt është hartuar 14 ditë më vonë, në datë 10.05.2022 dhe është përcjellë në subjekt më datë 19.05.2021;

4- Kontrolli i subjektit “A.G.” SHPK është mbyllur më datë 09.04.2021, duke rezultuar me një vonesë prej dy muajsh.

Në lidhje me vonesën e mësipërme në hartimin e Raportit të Kontrollit, duke marrë në shqyrtim dhe observacionet e Inspektorit të kontrollit, duhet të theksojë se kjo vonesë është e pajustificueshme. Tejkalimi i afatit të kryerjes së këtij kontrolli, i cili që prej marrjes së Autorizimit nr. 5/2, datë 02.02.2021, për shtesën në grupin e kontrollit të inxhinierit, deri në hartimin e Akt konstatimeve datë 02.04.2021, nuk është i pranueshëm, për vetë faktin që kryerja e gjithë kontrollit referuar Programit të Kontrollit ka patur në dispozicion 5 ditë nga data 18.01.2021-23.01.2021. Sa më sipër, kryerja e këtij kontrolli nga 5 ditë e përcaktuar në program në 3.5 muaj faktikisht, përbën shkelje të Ligjit nr. 9920/2008, neni 83 dhe 84 dhe është e pajustificuar. Veprim ky në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor, pika 2.1 “Procedurat e kryerjes së kontrollit tatimor” ku cilësohet se: *“Afati për kryerjen e kontrollit tatimor mund të zgjatet pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm, por jo më shumë se 15 ditë pune”*.

5- Kontrolli i subjektit “P” SHPK është mbyllur sipas Programit të kontrollit më datë 18.06.2021. Raporti i kontrollit është hartuar më datë 25.06.2021, brenda afatit 7 ditë, nga mbyllja e kontrollit në terren, ndërsa Raporti Përfundimtar i Kontrollit është hartuar më datë 04.08.2021 dhe është përcjellë në subjekt më datë 11.08.2021, pas dy muajsh nga dërgimi i Raportit të Kontrollit. Duke marrë në konsideratë 15 ditë afat në dispozicion të

subjektit për observime si dhe afatin për përgatitjen e Raportit Përfundimtar të Kontrollit brenda 5 ditëve, rezulton se kemi një vonesë prej 19 ditësh.

6- Kontrolli i subjektit “A-D” SHPK është mbyllur sipas Programit të kontrollit më datë 21.08.2020. Raporti i kontrollit është hartuar më datë 31.08.2020, brenda afatit 7 ditor, ndërsa Raporti Përfundimtar i Kontrollit është hartuar me 8 ditë më vonë. Raporti i Kontrollit është përcjellë në subjekt më datë 28.09.2020, duke marrë në konsideratë dhe afatin 20 ditor për observimet e subjektit dhe përgatitjen e Raportit Përfundimtar të Kontrollit, duhej të ishte hartuar nga inspektorët e kontrollit më datë 18.10.2020, ndërsa është përgatitur më datë 26.10.2020 dhe është dërguar në subjekt më datë 29.10.2020.

Kriteri:

Ligji nr. 9920/1998 “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 83 “Raporti i kontrollit tatimor”, ku cilësohet:

1. Inspektori i grupit të kontrollit tatimor është përgjegjës për përgatitjen e raportit të kontrollit, brenda shtatë ditëve kalendarike pas datës së përfundimit të kontrollit tatimor.

4. Tatimpaguesi ka të drejtë t’i kundërshtojë rezultatet e kontrollit tatimor brenda 15 ditëve kalendarike pas datës, kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi.

6. Grupi i kontrollit e shqyrton kundërshtimin, brenda 5 ditëve pune nga data e marrjes së kundërshtimit, ose që vlerësohet të jetë marrë dhe arsyetimi i dhënë nga grupi i kontrollit për kundërshtimin përfshihet në raportin përfundimtar të kontrollit.

Ligji nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 84 ku cilësohet:

1. Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor plotësohet dhe nënshkruhet nga të gjithë pjesëtarët e grupit të kontrollit dhe miratohet nga urdhëruesi i kontrollit, brenda 14 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kundërshtimit të tatimpaguesit, ose që vlerësohet të jetë marrë nga grupi i kontrollit tatimor. Manuali i Kontrollit Tatimor, Kapitulli II, pika 2.3 “Menaxhimi i kohës për kontroll”.

Ndikimi/Efekti:

Mos reflektimi në kohë i gjetjeve të kontrollit tatimor.

Shkaku:

Mos veprim brenda afateve të përcaktuara nga ana e strukturave të kontrollit.

Rëndësia:

E mesme

Rekomandimi:

Drejtori i Drejtorisë Tatimore Shkodër, në cilësinë e Titullarit, duhet të nxjerrë përgjegjësitë si dhe të marrë masa të menjëhershme, për respektimin e afateve të përmbylljes së kontrolleve në afatet e përcaktuara në programet e kontrollit, si dhe evadimin e tyre, përcjelljen në subjektin tatimpagues brenda afateve të përcaktuara.

Pretendimi i subjektit:

1. Në observacionin nr. 3313/52, datë 20.01.2023 dhe nr. 3313/63, datë 23.01.2023, nga inspektorët e kontrollit A.K. dhe E.K., mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “M” SHPK, është paraqitur observacioni si në fazën e hartimit të Projekt Raportit të Auditimit, mbi akt konstatimet.

2. Në observacionin nr. 3313/63, datë 23.01.2023, nga inspektori i kontrollit E.K., mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “SH-A” SHPK, në lidhje me respektimin e afateve të hartimit të Raportit të Kontrollit, pretendohet se janë respektuar afatet. Bashkëngjitur historiku e çështjes.

3. Në observacionin nr. 3313/53, datë 20.01.2023, nga inspektori i kontrollit **F.M.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “A.G.” SHPK, është sqaruar: -Sipas Akt-konstatimit inspektori ka dy muaj tejkalim të mbylljes së kontrollit në terren si dhe 10 ditë vonesë në dërgimin e Raportit Përfundimtar në kundërshtim me pikën nr.1 të nenit nr.83 të Ligjit 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar sipas të cilit cilësohet se: “inspektori i grupit tatimor është përgjegjës për përgatitjen e Raportit të kontrollit brenda 7 ditëve kalendarike pas datës të përfundimit të kontrollit tatimor” dhe pikës nr.1 të nenit nr.84 ku thuhet se “Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor plotësohet dhe nënshkruhet nga të gjithë pjesëtarët e grupit të kontrollit dhe miratohet nga urdhëruesi i kontrollit brenda 14 ditëve kalendarike nga data e marrjes së kundërshtimit të tatimpaguesit ose që vlerësohet që është marrë nga grupi i kontrollit tatimor”.

Më duhet të evidentoj faktin se Raport kontrolli paraprak mbi kontrollin e ushtruar tek ky subjekt është mbajtur me datë 09.04.202, po ju citoj të dhënat kryesore të dala nga ky aktkontroll (tekstualisht tek faqe nr.1) ku thuhet se: mbahet sot më datë 09.04.2021 në subjektin “A.G.” SHPK në mes të përfaqësuesit të këtij subjekti z. E.B. nga njëra anë dhe grupit të inspektorëve të kontrollit (sektori i Kontrollit në Vend në Drejtorinë e Kontrollit pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër), F.M. dhe A.K. nga ana tjetër lidhur me kontrollin e ushtruar në këtë subjekt, në zbatim të Njoftimit të Kontrollit nr.5 datë 18.01.2021 dhe Program-Kontrollit të konfirmuar nga përfaqësuesi i subjektit.

Bazuar në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar, nenin nr. 81 pika 1 dhe 1/1 subjektit i është dërguar Njoftimi Kontrollit Tatimor i cili përcakton tatimpaguesin si subjekt të kontrollit tatimor. Po kështu referuar pikës nr. 3 të nenit të mësipërm me njoftimin e kontrollit tatimor, tatimpaguesit i është dhënë mundësia të deklarojë çdo të dhënë për transaksione të padeklaruara, për të cilat nuk është paguar tatimi. Ky deklaram është bërë nëpërmjet formularit pyetësor të vetë deklaramit para kontrollit (prot.nr.100 datë 08.01.2021).

Po kështu subjekti ka paraqitur pranë DRT Shkodër një kërkesë ku kërkon që në kontrollin e planifikuar mbi TVSH të përfshihen dhe periudhat tatimore Tetor, Nëntor dhe Dhjetor 2020, bazuar tek kjo kërkesë dhe nisur nga fakti se është planifikuar dhe kontroll mbi Tatim-Fitimin e vitit 2020 grupi i kontrollit ka paraqitur një shkresë ku kërkohet si përfshirje të këtyre periudhave tatimore dhe zgjatjen e kohës së kontrollit (bashkëngjitur sistemit C@ts).

Theksojmë se më datë 19.01.2021 nga ana jonë është kërkuar asistencë teknike për zbërthimin e situacioneve nga ana e inxhinierit të ndërtimit, pasi objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie është fusha e ndërtimit. (bashkëngjitur kërkesën prot 5/1 datë 19.01.2021). Po kështu DRT Shkodër bazuar tek kërkesa, i ka dërguar shkresën DPT e cila përmes shkresave nr.19292/2 datë 17.11.2020, shkresës nr.27161 datë 20/11/2020 dhe shkresës nr.27161/1 datë 03.12.2020 autorizohet z. A.K. me detyrë inspektor kontrolli dhe profesion inxhinier ndërtimi pranë DRT Tiranë të ushtrojë kontroll tek subjekti “A.G.” SHPK. Autorizimi për kryerje kontrolli ndaj kësaj shoqërie nga inspektori me profesion ing. z. A.K. është prot nr.05/2 datë 02.02.2021 (një kopje bashkëngjitur). Inspektori me profesion ing. z. A.K. ka bërë zbërthimin e situacioneve dhe më datë 02.04.2021 ka mbajtur akt-konstatim protokolluar pranë DRT Shkodër nr.05/3 datë 02.04.2021 (një kopje e relacionit të ing. bashkëngjitur).

Nisur nga arsyet e trajtuara sa më lart, akt kontrolli paraprak dhe proces-verbalet përkatëse mbahen më datë 08.04.2021. Nga sa më sipër rezulton se janë zbatuar me rigorozitet nga ana ime si inspektor të gjitha afatet ligjore të përgatitjes së raport-kontrollit në referencë të pikës nr.1 të nenit nr.83 dhe pikës 1 të nenit nr.84 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH” i ndryshuar. Gjithashtu theksoj se sipas sistemit C@ts për subjektin në fjalë janë zbatuar të gjitha afatet ligjore deri në evadimin përfundimtar të Raport-Kontrollit tatimor.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga inspektorët A.K. dhe E.K., evidentojmë faktin se, janë të njëjtët të paraqitur në fazën e mëparshme të auditimit, gjë për të cilën sqarimet tona janë trajtuar hollësisht në PRA. Observacioni nuk pranohet, pasi janë mbajtur akte pas datës së qëndrimit në subjekt nga inspektori i kontrollit, si dhe vonesat në dërgimin e RK, edhe pas kësaj date nuk janë të justifikuara.
2. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga inspektori i kontrollit E.K., mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “SH-A” SHPK, është paraqitur observacioni si dhe është bashkëngjitur dokumentacioni i printuar nga C@ts, mbi historikun e çështjes. Observacioni është pranuar dhe është reflektuar në RPA.
3. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga inspektori i kontrollit F.M., mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “A.G.” SHPK. Observacioni juaj përsa i përket përgjegjësisë në vonesën e mbylljes së Raportit paraprak të kontrollit pranohet dhe është reflektuar në PRA.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

- Z. E.K.
- Znj. A.K.
- Z. A.K.
- Z. A.M.
- Z. B.L.
- Z. G.B.

2. Zbatimi i procedurave të ndjekura nga DRT (Drejtori i DRT; Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor; Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit në Vend dhe Inspektori i Kontrollit), referuar Manualit të Kontrollit, dhe Ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” me ndryshime.

Titulli i gjetjes 2: Mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, në lidhje me analizimin e llogarive vjetore të subjekteve tatimpaguese, trajtimi i çështjeve të kontrollit, argumentimi dhe dokumentimi i tyre.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se nga 30 dosje kontrolli tatimor të audituara, në 15 prej tyre, janë evidentuar mangësitë si më poshtë:

1. Subjekti “SH-A”, me NIPT-X.

Nga shqyrtimi i RPK ka rezultuar se:

Nuk janë analizuar në mënyrën e duhur llogaritë vjetore të subjektit, për periudhën e kontrollit mbi tatim fitimin (2015-2018), gjë e cila është reflektuar në mos rakordimin e “Pasqyrës së fluksit monetar” dhe aktiveve monetare të “Pasqyrës së Pozicionit Financiar”;

Nuk është paraqitur analizë mbi AQT, sipas kërkesave të Programit të Kontrollit.

2. Subjekti “B” SHPK me NIPT-X.

Nga shqyrtimi i RPK ka rezultuar se:

Nuk është kryer një analizë mbi AQT, shpenzime konsumi dhe amortizimi, referuar Programit të kontrollit ku kërkohet të kryhet nga inspektori i kontrollit analizat dhe verifikime si: “*Inventar i AQT, verifikimi i pasqyrave të lëvizjes së AQT, saktësia e llogaritjes së amortizimit dhe respektimi i normave të amortizimit*”.

Në pasqyrën e shpenzimeve (Pasqyra e Performancës Financiare) nga inspektori i kontrollit janë paraqitur në mënyrë analitike "Shpenzime të tjera shfrytëzimi", por nuk është analizuar dhe cilësuar se çfarë përfaqëson zëri "të tjera" dhe "trajtime të përgjithshme" për vitet 2016-2020, sipas tabelës së mëposhtme:

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019	2020
Trajtime të përgjithshme	850,822	567,340	370,275	5,980	70,000
Të tjera	1,680,856	2,607,687	1,199,642		3,102,000
Totali	2,531,67	3,175,027	1,569,917	5,980	3,172,000

3. Subjekti "S.P." SHPK me NIPT-X.

Nga shqyrtimi i RPK ka rezultuar se në përgjithësi RPK është trajtuar dhe hartuar në përputhje me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor dhe Programin e Kontrollit, me përjashtim të faktit që nuk është analizuar fakti që në përllogaritjen e amortizimit nga subjekti nuk është paraqitur në mënyrë të saktë çelja në 01.01.2019, i AAM "Ndërtesa", në shumën 14,895,000 lekë, e cila nuk figuron në mbyllje të vitit 2018.

4. Subjekti "M" SHPK me NIPT-X.

Nga shqyrtimi i RPK ka rezultuar se në përgjithësi RPK është trajtuar dhe hartuar në përputhje me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor dhe Programin e Kontrollit, me përjashtim të rastit ku inspektori tatimor nuk ka kryer një analizë mbi AQT dhe shpenzimet e amortizimit, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor dhe Programit të kontrollit. Nga të dhënat e RPK, rezulton se nuk janë paraqitur shpenzimet e amortizimit sipas zërave (ndërtesa, makineri e pajisje, mjete transporti etj. si dhe totali i tyre), por vetëm gjendja në fillim e AQT, pakësimet dhe gjendja në fund të periudhës ushtrimore.

5. Subjekti "L.C." SHPK, me NIPT-X.

Nga shqyrtimi i RPK ka rezultuar se:

Nuk është kryer një analizë mbi AQT, shpenzime konsumi dhe amortizimi, referuar Programit të kontrollit ku kërkohet të kryhet nga inspektori i kontrollit analizat dhe verifikime si: *"Inventar i AQT, dokumentet përkatëse mbi zotërimin e titullit të pronësisë, vlerësimi në mënyrë korrekte, regjistrimi në mënyrë korrekte, verifikimi i pasqyrave të lëvizjes së AQT, saktësia e llogaritjes së amortizimit dhe respektimi i normave të amortizimit"*.

Në RPK nga inspektori i kontrollit është cilësuar se ka kryer analizën e blerjeve dhe shitjeve, por është evidentuar se nga ana e tij janë pasqyruar çmime për njësi të disa artikujve kryesorë vetëm në blerje, gjë e cila është një e dhënë e pamjaftueshme për të kryer një analizë mbi marzhin e fitimit, në kundërshtim me Manualin e Kontrollit Tatimor.

6. Subjekti "L" SHPK me NIPT-X.

Nga kontrolli mbi zbatimin e procedurave të kontrollit referuar Manualit të Kontrollit ka rezultuar këto mangësi:

Mbi analizën e shpenzimeve: Nga ana e inspektores së kontrollit nuk është kryer një analizë mbi shpenzimet e kryera për periudhën objekt kontrolli. Nga ana e saj në mënyrë të përgjithshme janë cilësuar dhe trajtuar këto shpenzime, pa dhënë informacionin e duhur se çfarë realisht përfaqësojnë këto vlera dhe sa këto shpenzime janë në funksion të objektit të veprimtarisë së subjektit.

Në vitin 2018, faqe 10 të RPK, janë cilësuar shpenzime në total në shumën 56,569,503 lekë, nga e cila shuma prej 32,489,787 lekë e cilësuar si shpenzime "trajtime të përgjithshme" nuk është trajtuar dhe analizuar se çfarë përfaqëson.

Në vitin 2019, faqe 13 të RPK, janë cilësuar shpenzime në total në shumën 77,493,874 lekë, nga e cila shuma prej 2,449,708 lekë e cilësuar si shpenzime “transferime” nuk është trajtuar dhe analizuar se çfarë përfaqëson.

Në vitin 2020, faqe 16 të RPK, janë cilësuar shpenzime në total në shumën 102,268,622 lekë, nga e cila shuma prej 3,716,661 lekë e cilësuar si shpenzime “të tjera” nuk është trajtuar dhe analizuar se çfarë përfaqëson.

7. Subjekti “G-2012” SHPK me NIPT-X.

Nga shqyrtimi i RPK ka rezultuar:

Nuk ndodhet në dosjen e kontrollit procesverbali mbi gjendjen e mjeteve monetare në arkë ditën e fillimit të kontrollit. Në kundërshtim me kërkesat e programit të kontrollit.

Nga inspektori nuk është analizuar gjendja e lartë e llogarisë klientë, veçanërisht e klientit “A” SHPK i cili paraqitet me detyrime në shumën 274,979,591 lekë në vitin 2014; në vitin 2015 nuk rezulton si klient, në vitin 2016 me 47,586,374 lekë dhe 2017 në shumën 41,870,585 lekë etj.

8. Subjekti “A.G.” SHPK me NIPT-X.

Nga shqyrtim i RPK ka rezultuar:

Nuk është paraqitur analitiku i llogarisë “të pagueshme ndaj furnitorëve” për vitin 2020;

Nuk është analizuar ndryshimi i gjendjes së arkës nga viti 2018/2019 dhe 2019/2020, pasi rezulton ndryshim në vlerë 9,953,661 lekë, ku gjendja e vitin paraardhës rezulton 0 lekë dhe në vitin pasues rezulton në shumën 134,071 lekë;

Nuk është shpjeguar se çfarë përfaqëson gjendja në arkë e mjeteve monetare në shumën 9,953,661 lekë, dhe nëse kjo vlerë ka të bëjë apo jo me likuidim malli të pa faturuar;

Gjithashtu, nuk është verifikuar dhe dokumentuar kontrolli i llogarisë “Arka”, mbi arkëtimet, pagesa, dokumenteve në pritje dhe mungon Akt konstatimi mbi “Inventarin e mjeteve monetare në momentin e kontrollit”.

9. Subjekti “G.J.I.” SHPK me NIPT-X.

Nga shqyrtim i RPK ka rezultuar:

Inspektori i kontrollit është shprehur se: “U bë analiza e veprimtarisë financiare ekonomike e shoqërisë si llogaritja e kostos së plotë për çdo lloj malli (çmim blerje sipas faturave, shpenzime transporti, taksa doganore dhe shpenzime të përgjithshme dhe krahasimi i saj me çmimin e shitjes deklaruar nga shoqëria si dhe krahasimi me çmimet analoge të tregut dhe nuk u vunë re diferenca për tu patur në konsideratë”. Në lidhje me këtë pohim nga ana e inspektorit nuk është paraqitur asnjë e dhënë apo analizë e kryer, të cilat do të përbënin gjurmën e auditimit në lidhje me këtë pohim;

Inspektori i kontrollit është shprehur se: “U bë kontrolli i arkës, u bë verifikimi i arkëtimeve dhe nuk kishte pasaktësi. Nuk u vërejtën arkëtime të cilat të jenë nga burime shitjesh të padeklaruara”. Nuk është shprehur mbi pagesat me arkë.

10. Subjekti “P.M.” SHPK me X.

Nga shqyrtim i RPK ka rezultuar:

Nuk është kryer një analizë mbi AQT, shpenzime konsumi dhe amortizimi, referuar Programit të kontrollit ku kërkohet të kryhet nga inspektori i kontrollit analizat dhe verifikime si: “Inventar i AQT, dokumentet përkatëse mbi zotërimin e titullit të pronësisë, vlerësimi në mënyrë korrekte, regjistrimi në mënyrë korrekte, verifikimi i pasqyrave të lëvizjes së AQT, saktësia e

llogaritjes së amortizimit dhe respektimi i normave të amortizimit”, në kundërshtim me kërkesat e Programit të kontrollit.

Kontrolli i Aktiveve të Qëndrueshme Financiare dhe Jo-financiare

Kontroll i inventarëve dhe prodhimit në proces

Për punimet në proces

Nuk është kryer analizë mbi aktivitetin e subjektit referuar faktit se, zhvillon disa lloje veprimtarish ekonomike (import eksporte, prodhim dhe shitje më pakicë dhe shumicë), për të cilat nga inspektori i kontrollit tatimor duhej të kryeshin analiza të veçanta bazuar në kërkesat e MKT, pika 2.10. Analiza e normave (raporteve) ku cilësohet:

Të gjithë bizneset tatimpaguese operojnë në sektorë të cilët kanë disa karakteristika. Këto karakteristika zakonisht formojnë bazën për analizat e normave (raporteve) kryesore apo tendencave të tyre, për arsye tregtare apo për nevoja të qeverisë. Analizimi i tendencave të sektorëve kyç dhe krahasimi me subjektin ku ushtrohet kontroll, mund të zbulojnë diferenca që nuk priten dhe që kanë nevojë për verifikime dhe shpjegime të mëtejshme.

Inspektori i kontrollit duhet të kryejë analiza specifike të raporteve të bizneseve nën kontroll për të gjetur anomali, si gjatë inspektimit për kontroll paraprak, ashtu edhe gjatë kontrollit të programuar. Sektorët ekonomike që i nënshtrohen TVSH mbi shitjet klasifikohen në grupime sipas Kodit të Klasifikimit për Standardet në Industri. Çdo klasifikim ka disa karakteristika për veprimtarinë e subjekteve, me anë të cilëve mund të krijohet një tablo në lidhje me subjekte mesatare.

Në faqet 26-27 të RPK nga inspektori i kontrollit është cilësuar se ka kryer analizën e blerjeve dhe shitjeve, por është evidentuar se nga ana e tij vetëm janë pasqyruar çmime për njësi të disa artikujve kryesorë (17 artikuj) të cilët rezultojnë të njëjtë si në blerje dhe shitje, për të gjithë periudhën e analizuar, duke theksuar faktin se ka dhe përsëritje të paragrafëve ku trajtohen çmimet për njësi deri në 5 herë. Për ilustrim nga inspektori është trajtuar si më poshtë:

Artikulli	Njësia matëse	Çmim blerje	Çmim shitje
Shirit llamarinë zinku	kg	88	88
Bojë pluhur për ngjyrosje	kg	314	314
Shufra plastike	copë	657	657
Lëndë druri e sharruar	m3	18,000	18,000
Profile alumini grezo	kg	313	313
Etj.			

Nga ana e inspektorit të kontrollit, ka pohime të cilat nuk qëndrojnë, në lidhje me verifikimet dhe analizat që ka kryer gjatë këtij kontrolli, si dhe ka paqartësi në hartimin e RPK, në kundërshtim me kërkesat e MKT, pika 2.5 “Përgatitja e RK”, siç kemi ilustruar me të dhënat e mësipërme ku nga ana e inspektorit cilësohet në RPK, se ka kryer analizë të nivelit të çmimeve, (normë fitimi) etj.

11. Subjekti “H” SHPK me NIPT-X.

Nuk është paraqitur asnjë analizë mbi ndryshimin e AAGJM/përlllogaritje e amortizimit, gjë e cila është reflektuar dhe në përlllogaritjen jo të saktë të tij nga ana e subjektit.

12. Subjekti “A.B.” SHPK me NIPT-X.

Nga shqyrtimi i RPK ka rezultuar:

Në pasqyrën e Performancës Financiare janë deklaruar AAM në shumën 173,336 lekë, ndërsa në Pasqyrën e flukseve monetare janë deklaruar shpenzime për blerjen e AAM në shumën 260,000 lekë, të cilat kanë të bëjnë me shtesë të AAM-ve. Fitimi dhe humbja sipas pasqyrave financiare të

subjektit është në shumën 416,171 lekë, ndërsa në FDP e TF rezulton në shumën 2,549,200 lekë. Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk janë analizuar këto mospërputhje në deklarin e tatim fitimit.

13. Subjekti “P” SHPK me NIPT-X.

Nga shqyrtimi i RPK ka rezultuar:

Nuk ka kryer analizë të blerjeve sipas natyrës së shpenzimit (lëndë e parë, shërbime, paga, sigurime, etj.).

14. Subjekti “A.K.” SHPK me NIPT-X.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në Dosjen e kontrollit dhe atij të ngarkuar në sistemin C@ts në lidhje me zbatimin e programit dhe procedurave të kontrollit me përjashtim të rastit të mëposhtëm nuk rezultuan mangësi.

Nga auditimi është konstatuar se gjetjet e inspektorëve të kontrollit për diferenca në deklarin e të ardhurave tatimore në FDP e TF nuk janë të sakta. Deklarimet e subjektit janë si më poshtë:

Viti	FDP e TF	Të ardhura nga aktiviteti kryesor PASH	Të ardhura të tjera të shfrytëzimit PASH	Totali PASH	Diferenca
2019	227,154,494	223,344,629	3,809,865	227,154,494	0
2020	226,850,558	220,722,432	6,128,126	226,850,558	0

Rivlerësimi i të ardhurave të tatueshme dhe tatim fitimi i llogaritur për vitin 2019 dhe 2020, referuar Procesverbalit nr. 2, datë 05.04.2022, nuk qëndrojnë. Inspektorët e kontrollit nuk kanë bërë një vlerësim të saktë të deklarimeve të subjektit.

15. Subjekti “M” SHPK me NIPT- X.

Në lidhje me analizimin e llogarisë “Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit/ortakë” ka rezultuar se nga inspektori i kontrollit nuk janë dhënë sqarime të mjaftueshme mbi lëvizjet e llogarisë “Të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit” për vitet ushtrimore 2019-2020, pasi referuar të dhënave të mëposhtme, rezulton se ka diferencë midis shumës në mbyllje të vitit 2019 dhe çelje të vitit 2020 në shumën 52,597,753 lekë. Sipas shpjegimit të subjektit (referuar observacionit të paraqitur) kjo shumë i përket faturës me nr. Serial 42261451, në shumën 52,597,753 lekë, deklaruar te libri i blerjeve datë 02.01.2016 dhe që ka të bëjë me blerje “aktivesh/ndërtesë”, paraqitur tek kjo llogari që në vitin 2016, gjë e cila nuk është e saktë pasi gjendja e kësaj llogarie në vitin 2018 dhe 2019 nuk e përfshin këtë vlerë, e cila sipas shpjegimeve të inspektorit duhej të paraqitej si shtesë në vitin 2020 dhe jo si çelje.

PF-2019		PF-2020		Diferencat në mbyllje 2019 dhe çelje 2020
Çelje (1)	Mbyllje (2)	Çelje (1)	Mbyllje (2)	
11,872,493	39,842,446	92,440,199	59,192,080	52,597,753
Diferencat {(2)-(1)}	27,969,953		-33,248,119	

Kriteri:

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat Tatimore në RSH" me ndryshime, Kreu X “Kontrolli tatimor”, neni 80; me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII “Kryerja e kontrollit tatimor”; me kërkesat e Programit të Kontrollit, si dhe Ligjin nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 4, pika 19 "Gjurma e auditimit".

Ndikimi/Efekti:	Mos kryerja e analizave të duhura mbi pasqyrat financiare, llogaritë, gjendjet e tyre, ndryshimet nga një periudhë në tjetrën, është reflektuar në cilësinë e Raporteve Përfundimtare të Kontrollit si dhe vlerësimin real të detyrimeve të subjekteve tatimpaguese.
Shkaku:	Mos zbatim i kërkesave të detajuara të programit të kontrollit, Manualit të Kontrollit, si dhe e mosfunksionimit në mënyrën e duhur të stadeve të kontrollit, brenda Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT Shkodër.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtori i Drejtorisë Tatimore Shkodër, në cilësinë e Titullarit, duhet të nxjerrë përgjegjësitë si dhe të marrë masa të menjëhershme, për forcimin e kontrolleve të cilësisë, mbi kontrollet e ushtruara nga inspektorët e kontrollit tatimor në vend, nga ana e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit Tatimor në Vend dhe Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.

Pretendimi i subjektit:

1. Në observacionin nr. 3313/52, datë 20.01.2023, nga inspektore e kontrollit **A.K.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “L” SHPK, është paraqitur i njëjti observacion si në fazën e hartimit të Projekt Raportit të Auditimit, mbi akt konstatimet.

Përsa i përket shpenzimeve trajtime të përgjithshme në shumën 32,489,787 lekë (viti 2018, faqe 10 të RPK) përfshihen: bileta tragei dhe telepass në shumën 11,371,753 lekë nga subjekti D.T.S.; bileta tragei 16,589,040 lekë nga Ventouris Ferries; tarifa doganore 373 920 lekë; shërbim GPS, polica sigurimi, tarifa kalime tuneli 3,383,887 lekë; transport nga të tretët 500,000 lekë; shërbim mirëmbajtje 271,187 lekë.

-Shpenzime transferimi 2,449,708 lekë (viti 2019, faqe 13 të RPK) përfshihen: shërbime doganore jashtë vendi 1,402,692 lekë; qira 16,000 lekë; polica sigurimi, shërbim GPS 1,022,246 lekë; leje transporti 8,770 lekë.

-Shpenzime të tjera 3,716,661 lekë (viti 2020, faqe 16 të RPK) përfshihen: shpenzime riparim mjetesh 578,336 lekë; taksa doganore brenda vendit 338,521 lekë; tarifa aderimi në shoqatë 253,000 lekë; shërbime doganore jashtë vendi, shërbime GPS dhe tarifa autostradave 2,313,969 lekë; shërbim kontabiliteti 120,000 lekë; shpenzime qeraje 24,000 lekë, shpenzime noteriale dhe kancelarie 88,835 lekë.

2. Në observacionin nr. 3313/55, datë 20.01.2023, nga inspektore e kontrollit **P.D.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “A.K.” SHPK, është paraqitur i njëjti observacion si në fazën e hartimit të Projekt Raportit të Auditimit, mbi akt konstatimet. Në lidhje me pikën 1.2. Referuar të dhënave të situatës financiare të TVSH për vitin 2019 rezulton se shitjet totale janë 223,587,823 lekë ndërsa referuar të dhënave të Pasqyrës së Performancës Financiare të vitit 2019 të ardhurat jashtë situatës financiare të TVSH janë 3,742,643 lekë nga ku rezulton se totali i të ardhurave tatimore për vitin 2019 është 227,330,466 lekë.

Në deklaratën e TF 2019 tatimpaguesi ka raportuar të ardhura tatimore në vlerën 227,154,494 lekë, nga ku rezulton se kemi një diferencë të ardhurash në vlerën 175,972 lekë. Për këtë arsye bazuar në ligjin nr.8438/1998 dhe ligjin nr.9920/2008 do të rivlerësohen të ardhurat e tatueshme në deklaratën e TF 2019 për vlerën 175,972 lekë. Detyrimi i TF 2019 është 26,396 lekë.

Bazuar në ligjin 9920/2008, neni 115 pika 1, tatimpaguesi detyrohet të paguajë gjobë të barabartë me 0.06% të shumës së detyrimit të paguar çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Gjoba për TF 2019 është 5,781 lekë ($26,396 \cdot 0.06\% \cdot 365$ ditë).

Referuar të dhënave të situatës financiare të TVSH për vitin 2020 rezulton se shitjet totale janë 221,102,301 lekë ndërsa referuar të dhënave të Pasqyrës së Performancës Financiare të vitit 2020 të ardhurat jashtë situatës financiare të TVSH janë 6,023,687 lekë nga ku rezulton se

totali i të ardhurave tatimore për vitin 2020 është 227,125,988 lekë. Në deklaratën e TF 2020 tatimpaguesi ka raportuar të ardhura tatimore në vlerën 226,850,558 lekë, nga ku rezulton se kemi një diferencë të ardhurash në vlerën 275,430 lekë. Për këtë arsye bazuar në ligjin nr.8438/1998 dhe ligjin nr.9920/2008 do të rivlerësohen të ardhurat e tatueshme në deklaratën e TF 2020 për vlerën 275,430 lekë. Detyrimi i TF 2020 është 41,314 lekë.

Bazuar në ligjin 9920/2008, neni 115 pika 1, tatimpaguesi detyrohet të paguajë gjorbë të barabartë me 0.06% të shumës së detyrimit të paguar çdo ditë gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike. Gjoba për TF 2020 është 9,048 lekë ($41,314 \cdot 0.06\% \cdot 365$ ditë).

3. Në observacionin nr. 3313/53, datë 20.01.2023, nga inspektori i kontrollit **F.M.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “A.G.” SHPK, është paraqitur i njëjti observacion si në fazën e hartimit të Projekt Raportit të Auditimit, mbi akt konstatimet. -Sipas Akt-konstatimit mangësi të tjera janë: nuk është paraqitur analitiku i llogarisë “të pagueshme ndaj furnitorëve për vitin 2020, nuk është analizuar ndryshimi i gjendjes së arkës për vitet 2019 dhe 2020, nuk është shpjeguar çfarë përfaqëson gjendja e arkës”.

Përsa i përket furnitorëve analitike në faqe nr.26 dhe 27 e akt-kontrollit të mbajtur kam theksuar tekstualisht llogaria “Të pagueshme ndaj furnitorëve” paraqitur në postin e bilancit në shumën 32,973,064 lekë. Bashkëngjitur me bilancin gjendet dhe inventari analitik i furnitorëve vlerat e të cilës përputhen me të dhënat e pasqyrës së bilancit.

Gjithashtu në faqe nr.21 dhe 22 të këtij aktkontrolli mbi kontrollin e llogarive monetare kam theksuar tekstualisht: llogarinë analitike “Arka” e paraqitur në postin e bilancit të vitit ushtrimor përfshin gjendjen e kësaj llogarie në 31.12.2019, e cila sipas bilancit dhe dokumentacionit paraqitet me vlerë 9,949,312 lekë dhe përfaqësojnë tërheqje nga banka për nevojat e shoqërisë (blerje në vlera të vogla ne kufijtë e lejuar të ligjit për nevojat e aktivitetit ekonomik kryesisht nga biznese të vogla pa TVSH). Gjatë kontrollit u verifikua me zgjedhje lëvizja e parasë arkë-bankë dhe ato përputheshin me datën përkatëse. Nga kontrolli i lëvizjes së arkës të vitit ushtrimor në asnjë rast nuk u konstatuan transaksione të vlerave mbi limitet e përcaktuara në legjislacionin tatimor në fuqi që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me furnitorët dhe klientët.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga inspektore A.K. evidentojmë faktin se, janë të njëjtat pretendime të paraqitura në fazën e mëparshme të auditimit, gjë për të cilën sqarimet tona janë trajtuar hollësisht në PRA. Nga Grupi i auditimit në AK e mbajtur, është evidentuar pikërisht fakti se nga ana e inspektore së kontrollit tatimor, nuk janë kryer analiza mbi çështjet nën kontroll, referuar kërkesave të Programit të kontrollit dhe Manualit të Kontrollit. Analiza dhe detajimi i mësipërm duhej të ishte pjesë e RPK dhe përshkrimit të veprimeve dhe transaksioneve në RPK. Observacioni nuk pranohet.

2. Observacioni juaj nuk qëndron, pasi po ti referoheni Pasqyrës së Performancës Financiare të dorëzuar nga subjekti në Excel dhe PDF, do të verifikoni se shifrat tuaja janë gabim.

3. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga inspektori F.M., sqarojmë:

Observacioni juaj në lidhje me zbatimin e procedurave të përcaktuara në Manualin e Kontrollit dhe programin e kontrollit, nuk pranohet.

Nga ana jonë është evidentuar fakti që këto analiza nuk kanë qenë pjesë e RPK.

Në lidhje me analizën e llogarisë arka jeni shprehur:

“Llogarinë analitike “Arka” e paraqitur në postin e bilancit të vitit ushtrimor përfshin gjendjen e kësaj llogarie me 31.12.2019 e cila sipas bilancit dhe dokumentacionit paraqitet me 9 949 312 lekë. Gjatë kontrollit u verifikua me zgjedhje lëvizja e parasë arkë – bankë dhe ato përputheshin me datën përkatëse. Nga kontrolli i lëvizjes së arkës të vitit ushtrimor në asnjë rast nuk u konstatuan transaksione të vlerave mbi limitet e përcaktuara në legjislacionin tatimor

në fuqi që kanë të bëjnë me marrëdhëniet me furnitorët dhe klientët”, pa kryer një analizë të ndryshimit të gjendjes së arkës referuar vitit të mëparshëm dhe pasues, shënimeve shpjeguese, veprime në kundërshtim me kërkesat e Manualit të kontrollit dhe Programit të kontrollit, ku cilësohet:

Kontroll i llogarisë së Arkës

- Verifikimi i arkëtimeve.
- Verifikimi i pagesave.
- Verifikimi i dokumenteve në pritje.
- Inventari i mjeteve monetare në momentin e kontrollit.

Në lidhje me analizën e llogarisë “Furnitorë” për dy vitet jeni shprehur:

“Me furnitorët e mësipërm kishte marrëveshje për likuidime. Për vitin 2019 likuidimi i faturave të furnitorit ishin bere përmes llogarive bankare.

Llogaria “Të pagueshme ndaj furnitorëve “ paraqitur në postin e bilancit në shumën 32 973 064 lekë. Bashkëngjitur me bilancin gjendet dhe inventari analitik i furnitorëve vlerat e të cilës përputhen me të dhënat e pasqyrës së bilancit .Me furnitorët subjekti kishte marrëveshje për likuidime. Për vitin 2020 likuidimi i faturave të furnitorit ishin bere përmes llogarive bankare.

Lidhur me llogaritë e furnitorëve.”

Sa më sipër në Manualin e kontrollit dhe Programin e kontrollit ju kërkohet:

- *Të përshkruhet analitikisht lëvizja e llogarisë së furnitorëve, ku të paraqitet në mënyrë analitike çelja në fillim të vitit ushtrimor plus shtesat minus pakësimet dhe të dalë rezultati në fund të vitit.*
- *Të verifikohet nëse marrjet e fundit të ushtrimit janë marrë në konsideratë si në llogaritë e inventarëve dhe në ato të furnitorëve.*
- *Të verifikohet nëse nuk janë përfshirë në ushtrimin e mëparshëm marrjet e para të ushtrimit pasardhës.*
- *Të verifikohet nëse kthimet e fundit ndaj furnitorëve nuk janë përfshirë në gjendjet e mallrave dhe që vlerat përkatëse janë provizionuar nëse ka qenë e nevojshme.*
- *Të verifikohet nëse kthimet e para të ushtrimit pasardhës të mos jenë përfshirë në ushtrimin e mëparshëm.*
- *Të sigurohemi që furnitorët me tepriceë debitore figurojnë në aktiv të bilancit.*

Titulli i gjetjes 3: Mbi mos analizimin e llogarisë "Detyrime afat shkurtër" (detyrime ndaj ortakut) dhe Detyrime afatgjata" (hua).

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor në vend, në kontrollet e ushtruara (6 raste) në subjektet tatimpagues "SH-A" SHPK, "D.G." SHPK, "A-D" SHPK, "M" SHPK, "P" dhe "A.B.07" nuk janë analizuar në mënyrën e duhur llogaritë "Detyrime afat shkurtër" (detyrime ndaj ortakut) dhe Detyrime afatgjata" (hua).

1. Nga shqyrtimi i kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues "SH-A" SHPK, ka rezultuar se sipas pasqyrave të pozicionit financiar për periudhën 2015-2018, subjekti paraqitet me detyrime afatshkurtra dhe afatgjata kundrejt institucioneve financiare apo dhe të tretë (hua). Detyrimet afatgjata “Hua” të krijuara në vitin 2015 në shumën 11,200,000 lekë, janë rritur në vitin 2016 në shumën 31,180,000 lekë dhe rezultojnë në këtë vlerë edhe për vitin 2017 dhe 2018. Në lidhje me këto detyrime evidentohet fakti se rezultojnë të pandryshuara në tre periudha ushtrimore, si dhe duke analizuar shpenzimet (kostot) e kësaj kredie/huaje (Pasqyra e Performancës Financiare) rezulton se ato paraqiten në shumën 0 lekë, për të gjithë periudhën e kontrolluar. Nga

ana e inspektorit të kontrollit në RPK, nuk është cilësuar dhe analizuar burimi i këtyre të ardhurave dhe të dhëna të tjera, pasi dhe në shënimet shpjeguese të PF, të vitit 2017 nuk është analizuar dhe shpjeguar kjo shumë, por është cituar vetëm se: “Shuma prej 31,180,000 lekë është hua e marrë me akte noteriale dhe kaluar me bankë”. Në asnjë prej rasteve të mësipërme të huamarrjes, nuk janë cilësuar institucionet financiare (banka etj.), apo huadhënës, kontratat e kredisë apo huadhënies, aktet noteriale, termat e referencës së kredive, plani i amortizimit etj.

2. Nga shqyrtimi i kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues “D.G.” SHPK, ka rezultuar se, nuk është analizuar llogaria e pasivit "Detyrime afatshkurtra", "Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit" e cila për vitin 2020, paraqitet në vlerën 14,992,619 lekë. Nuk është cilësuar në RPK, dokumenti bankar mbi hyrjen e mjeteve monetare të pronarit për llogari të shoqërisë, burimi i këtyre të ardhurave dhe të dhëna të tjera.

3. Nga shqyrtimi i kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues “A-D” SHPK, ka rezultuar se nga kontrolli i llogarive të pasivit paraqitet gjendje e lartë e injektimit të likuiditeteve në shoqëri nga ana e ortakut, të cilat nuk janë analizuar nga inspektori i kontrollit. Këto detyrime paraqiten në shumën 47,300,000 lekë për vitin 2016; 53,200,000 lekë për vitin 2017 dhe 54,400,000 lekë për vitin 2018. Nga ana e inspektorit të kontrollit në RPK, nuk është cilësuar dhe analizuar burimi i këtyre të ardhurave dhe të dhëna të tjera.

4. Nga shqyrtimi i kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues “A.B.07” SHPK, ka rezultuar se:

Nuk është analizuar llogaria e ortakut “Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit/ortaku” ku sipas Pasqyrave Financiare të vitit 2016 është në shumën 32,046,368 lekë, ndërsa në RPK rezulton në shumën 33,250,300 lekë. Në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, në postin “Detyrimet dhe kapitali”/Detyrimet afatshkurtra, në vitin 2017 kundrejt vitit 2016 rezulton se janë zvogëluar detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut, për shumën 7,910,886 lekë, ndërsa në vitin 2019 dhe 2020, kemi lëvizje të llogarisë së ortakut, ku janë shtuar detyrimet afatshkurtra të shoqërisë kundrejt ortakut, respektivisht në shumat 13,473,658 lekë dhe 14,278,933 lekë, për të cilat në RPK nuk është kryer asnjë analizë. Nga ana e inspektorit për vitin 2017 është cilësuar: *“Tek zëri arkëtuar ishin kryer veprime si kalime në llogari dhe huadhënie nga ortakut” në shumën 600,000 lekë*. Referuar këtij pohimi rezulton që detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut janë rritur dhe jo zvogëluar, siç rezulton nga diferenca e kësaj llogarie në fund dhe çelje të vitit ushtrimor. Në vitin 2019, është cilësuar se: *“Gjatë vitit 2019 nga kontrolli i ditarit të arkës dhe Ditarit të Bankës rezulton se Ortaku ka derdhur në Bankë për nevoja të shoqërisë”*. Në vitin 2020, në analizën që i është bërë kësaj llogarie është cilësuar se: *“Gjendja e llogarisë “Të pagueshme ndaj ortakut” paraqitet më vlerën e mbetur 53,092,005 lekë. Gjatë vitit 2020 nga kontrolli i ditarit të arkës rezulton se ortakut ka derdhur në arkë nga llogaria e tij për nevoja të shoqërisë vlera në kufijtë e lejuar deri në 150,000 lekë”,* çka do të thotë që shuma prej 14,278,933 lekë është kaluar nëpërmjet veprimeve me arkë. Kjo vlerë është e pasqyruar edhe në pasqyrën e flukseve monetare

(cashflow). Referuar faktit që nga ana e inspektorit të kontrollit është deklaruar se nuk janë bërë derdhje mbi 150,000 cash, shuma e derdhur nga ortaku për shoqërinë në shumën 14,278,933 lekë rezulton të jetë realizuar nëpërmjet 95 derdhjeve cash në arkë.

5. Nga shqyrtimi i kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues **“M” SHPK**, ka rezultuar se nga kontrolli i llogarive të pasivit ka rezultuar nuk është analizuar llogaria "Dhënie huaje" në shumën 64,528,949 lekë. Në RPK, inspektori i kontrollit është shprehur se: "Në llogarinë "Dhënie hua" paraqitet kredia e dhënë pa interes për subjektin "G & G-S" SHPK e mbartur nga vitet e mëparshme", po ti shtojmë këtu dhe faktin që shoqëria "M" dhe shoqëria "G & G-S" SHPK, janë shoqëri të lidhura. Në të njëjtën periudhë subjekti tatimpagues M, në vitin 2014, paraqitet me detyrime afatgjata kundrejt bankës (hua/kredi) në shumën 63,063,000 lekë, ku janë paraqitur në detyrime (pasiv) "Shërbime bankare" në shumën 610 000 lekë, "Shpenzimet nga interesat" në shumën 934 897 lekë dhe "Shpenzime të tjera financiare" në shumën 610 197 lekë, për të cilat nuk është kryer asnjë analizë, referuar kontratës së kredisë me Bankën Venetto datë 20.03.2014 e noterizuar me nr. 886.

6. Nga shqyrtimi i kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues **“P” SHPK me NIPT-X**, në vitin 2017 në Pasqyrën e Pozicionit Financiar në aktiv paraqitet llogaria huadhënie afatshkurtër në vlerën 2,667,400 lekë, ku nga ana e subjektit është cilësuar se përbën një huadhënie ndaj një personi me kontratë noteriale. Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk janë dhënë të dhëna mbi kushtet e huadhënies, si dhe kjo vlerë e cila është e mbartur nga viti 2017, nuk është analizuar në asnjë rast. Ky transaksion nuk është pasqyruar në pasqyrën e flukseve monetare të vitit 2017 (vlerë e cila duhet të përfaqësonte dalje likuiditeti). Gjithashtu, në Pasqyrën e Performancës Financiare të vitit 2017-2020, nuk pasqyrohen të ardhura nga interesat e mundshme të huasë.

Kriteri: Këto mosveprime janë në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, kërkesat e detajuara të Programit të kontrollit tatimor, si dhe me Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF nr. 16, datë 16.02.2009 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave", neni 5 "Raportimi i aktivitetit të dyshimtë (RAD)", pika 1 dhe 2.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e analizave të duhura mbi llogaritë e detyrimeve, llogarinë e ortakut dhe kapitalin, nuk mundëson një pasqyrim të saktë të gjendjes së tyre, të lëvizjes së flukseve monetare si dhe burimin e krijimit të vlerave monetare etj., të injektuara nga ortaku në shoqëri.

Shkaku: Mos zbatim i Ligjit 9920/2008 "Për procedurat tatimore në RSH" me ndryshime, kërkesave të detajuara të programit të kontrollit, Manualit të Kontrollit, Ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF Nr. 16, datë 16.02.2009 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave", neni 5 "Raportimi i aktivitetit të dyshimtë (RAD)", pika 1 dhe 2, si dhe e mosfunksionimit në mënyrën e duhur të stadeve të kontrollit, brenda Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT Shkodër.

Rëndësia:

E lartë.

Rekomandimi:

Drejtori i Drejtorisë Tatimore Shkodër, në cilësinë e Titullarit, duhet të nxjerrë përgjegjësitë për të gjitha rastet e evidentuara, si dhe në vijimësi të kërkojë që nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor në vend, të analizohen dhe të jepet informacion mbi cilësimin e institucioneve financiare (banka etj.), apo huadhënës; kontratat e kredive apo huadhënies; aktet noteriale; termat e referencës së kredive; plani i amortizimit etj., si dhe të deklarohet burimi i krijimit të të ardhurave të “ortakut” të injektuara si likuiditet apo çdo formë tjetër në shoqëri.

Pretendimi i subjektit:

1. Në observacionin nr. 3313/56, datë 20.01.2023, nga Inspektori **F.D.**, mbi kontrollin e kryer në subjektin “M” SHPK, është observuar: Përsa i përket detyrimeve në pasiv të Pasqyrës të pozicionit financiar e cila është shtuar në vlerën 39,842,446 lekë, nuk ishte vlerë monetare, por ishte ndërtesa dhe toka e vënë në bilanc tek zëri “Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit (afatgjatë)” që nga viti 2016, në vlerën 52,597,753 lekë, e cila ishte shitur subjektit në vitin 2016, e paraqitur tek libri i blerjeve datë 02.01.2016 me faturën me Nr. serial 42261451 dhe nr. fature 1 me vlerën 52,597,753 lekë. Kjo vlerë ishte bartur tek zëri “Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit (afatgjatë)” deri në vitin 2020, e cila pas legalizimit të ndërtesës në emër të subjektit, është transferuar te “të tjera të pagueshme” llogari kjo e cila tregon borxhin e tatimpaguesit ndaj personit, të blerë me faturë gjatë vitit 2016. Pra tatimpaguesi e ka borxh ndërtesën (jo vlerë monetare) të cilën nuk e ka likuiduar. Gjatë vitit 2021, tatimpaguesi e ka në zbritje këtë llogari dhe gjatë pasqyrave financiare të vitit 2021 e cila nga vlera 63,530,456 lekë është zbritur 48,430,456 lekë, pra tregon se tatimpaguesi e ka këtë shumë drejt likuidimit.

2. Në observacionin nr. 3313/63, datë 23.01.2023, nga inspektori i kontrollit **E.K.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “SH-A” SHPK, është paraqitur i njëjti observacion si në fazën e hartimit të Projekt Raportit të Auditimit, mbi akt konstatimet.

3. Në observacionin nr. 3313/59, datë 23.01.2023, nga inspektori i kontrollit **H.R.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “A-D” SHPK është sqaruar: Në lidhje me shprehjen nga ana juaj me të ardhurat e individëve, ato nuk janë të programuara në programin e kontrollit dhe për rrjedhojë nuk janë objekt kontrolli në vend. Me këtë pjesë merret Drejtoria e Specializuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

4. Në observacionin nr. 3313/53, datë 20.01.2023, nga inspektori i kontrollit **F.M.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “A.B.07” SHPK është sqaruar: Për disa mangësi të tjera pa efekte tatimore më duhet të them se janë trajtuar në mënyrë analitike të mbështetura në dokumentacion ligjor dhe sipas referencave ligjore si më poshtë:

Mbi inventarin fizik, theksoj se në proces-verbalin e mbajtur mbi inventarin fizik njësitë matëse janë përshtatur me kontabilitetin. Nga shënimet e mbajtura në momentin e kontrollit në prani dhe të përfaqësuesit rezulton se subjekti ka patur gjendje çimento në dy forma, rifuxhio dhe në thasë. Çimentoja rifuxhio ruhet në depozita metalike (silose) me kapacitete të përcaktuara të montuara në ambientet e shoqërisë si dhe çimento në thasë në paleta brenda një magazine. Në momentin e firmosjes së proces-verbalit janë konvertuar në ton (njësi matëse e kontabilitetit). Po kështu është vepruar dhe për materiale të tjera. Kontrolli është bërë me zgjedhje për ato asortimente që zënë peshën specifike më të madhe në totalin e inventarit kontabël.

Sipas grupit të auditimit theksohet se nga inspektori i kontrollit nuk është kryer analiza e kostove ...etj. Nga aktkontrolli i mbajtur po citoj: Analiza e treguesve kryesorë ekonomikë, nga kontrolli i çmimeve të blerjeve sipas faturave tatimore të blerjeve të vendit dhe çmimeve referuese të mallrave sipas të dhënave të Doganës dhe çmimeve të shitjes për mallrat që tregton u konstatua se shoqëria nuk ka tregtuar mallra nën koston e blerjes. Gjithashtu nga kontrolli i

kryer mbi çmimet e shitjes së shoqërisë dhe krahasuar këto me çmimin e blerjes, rezultoi se shoqëria aplikonte një marzh fitimi në vartësi të artikujve të shitur.

Në fund të Observacionit më duhet të theksoj disa të dhëna mbi shoqërinë të cituara nga Aktkontrolli: a) nga kontrolli u verifikua llogaria e tatimpaguesit në sistemin informatik për detyrime të papaguara nga ku rezulton se ky subjekt deri në momentin e kontrollit nuk ka detyrime të papaguara. Nga të dhënat e sistemit C@ts për subjektin në fjalë rezulton se ndaj subjektit nga DRT Shkodër kontroll i plotë i fundit është mbajtur me datë 23.09.2016 nga inspektorë të tjerë të kontrollit me objekt: Tatim-Fitimin e viteve 2014 dhe 2015 si dhe TVSH dhe kontribute për periudhat tatimore 2014/10 deri 2016/05. Subjekti ka qenë i rregullt me shlyerjen e detyrimeve të dala nga kontrollet e mëparshme. Po kështu theksojmë se ndaj subjektit janë ushtruar kontrole të verifikimit në vend nga Drejtoria e Kontrollit Tatimor Shkodër si dhe nga Drejtoria e Hetimit Tatimor (Rajoni Verior) sektori i zbatimit. Në të gjitha akt konstatimet e mbajtura dhe të skanuara në sistemin C@ts rezulton se subjekti ka qenë i rregullt dhe nuk kishte asnjë penaltet. b) Treguesit kryesorë të performancës sipas aktkontrollit dhe sa më sipër janë mbi mesataret e simotrave të kësaj shoqërie. c) Shuma totale e zbulimeve gjithsej nga ky kontroll kap shumën 1,465,012 lekë ose afër 1% e totalit të qarkullimit për periudhat tatimore të kontrolluara 2017/01 deri 2021/07.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1. Observacioni i inspektorit F.D., është pranuar pjesërisht dhe është trajtuar në Gjetjen nr. 2.
2. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga inspektori E.K., evidentojmë faktin se, janë të njëjtët të paraqitur në fazën e mëparshme të auditimit, gjë për të cilën sqarimet tona janë trajtuar hollësisht në PRA, si më poshtë:

Nga grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni bashkëngjitur observacionit në lidhje me Kontratat e huamarrjes:

Hua nr. rep 1010; kol nr. 693, datë 08.11.2016, në shumën 30,000 euro me afat 3 vjet, deri në 08.11.2019, pa interesa midis SH-A dhe G.D (huadhënësi);

Hua nr. rep 518; kol nr. 378, datë 26.07.2016, në shumën 40,000 euro me afat 5 vjet, deri në 26.07.2021, pa interesa midis SH-A dhe SH.D. (huadhënësi);

Hua nr. rep 1658; kol nr. 863, datë 28.12.2015, në shumën 50,000 euro me afat 2 vjet, deri në 28.12.2017, pa interesa midis SH-A dhe G.SH. (huadhënësi);

Hua nr. rep 1231; kol nr. 845, datë 20.12.2016, në shumën 20,000 euro me afat 3 vjet, deri në 20.12.2019, pa interesa midis SH-A dhe G.D (huadhënësi);

Nga analizimi i kontratave të huasë të paraqitura me observacionin e mësipërm, rezulton se:

Detyrime afatgjata	2015	2016	2017	2018
Hua sipas PF	11,200,000	31,180,000	31,180,000	31,180,000
Hua sipas kontratave	6,000,000	10,800,000		

Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se shumat e huave sipas kontratave janë në vlerë më të vogël se detyrimet afatgjata (hua) të paraqitura në PF, gjë e cila nuk është analizuar nga inspektori tatimor. Këto huamarrje në vlera të konsiderueshme sipas cilësimit në kontratat përkatëse nuk kanë të specifikuar dokumentin bankar apo mandat arkëtimin nr., datë mbi të cilën është kryer transaksioni. Përsa i përket të ardhurave të dhënë hua sipas personave përkatës rezulton se ato nuk kanë të analizuar burimin e financimit referuar faktit se për shumën 1,000,000 lekë, duhet të zbatohen kërkesat e Ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit” Kreu II “Vgjilënca e duhur”.

Gjithashtu, cilësojmë se një prej kontratave në shumën 50,000 euro duhej të shlyhej brenda dy viteve, deri në 28.12.2017. Referuar të dhënave evidentohet fakti se shumën e detyrimeve të SH-A nuk ka ndryshuar në fund të vitit 2017 dhe vitit 2018. Observacioni i subjektit nuk pranohet.

3. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga inspektori H.R., Grupi i auditimit ka evidentuar faktin që nuk është analizuar burimi i të ardhurave të individit “ortak”, gjë të cilën ju duhet ta kishit analizuar referuar dhe llogarisë 108 “llogaria e pronarit”, ku evidentohen të gjitha lëvizjet (debitim dhe kreditime të saj-tërheqje apo injektim në para apo forma të tjera në shoqëri) dhe mbyllja në debi ose kredi të llogarisë “Kapitali”. Në lidhje me këto veprime ju keni detyrim ti zbatoni sipas kërkesave të Manualit, si dhe Programit të kontrollit. Observacioni nuk pranohet.

4. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga inspektori F.M., Grupi i auditimit ka evidentuar faktin që në RPK, nga ana juaj edhe pse subjekti A.B.07, rezulton se kryen disa aktivitete: si blerje-shitje, prodhim, dhe ofrim shërbime transporti, nuk është kryer asnjë analizë ku të përcaktoheshin kostot dhe çmimet e shitjes së produktit të prodhuar (bazuar në kartat teknologjike); kosto blerje dhe çmim shitje për aktivitetin tregtar, kosto dhe shitje e shërbimit të transportit, etj., si dhe asnjë analizë në lidhje me llogarinë “Detyrime/ortaku”, ku sipas analizës tuaj ka rezultuar se Ortaku ka injektuar në shoqëri shumën 14,278,933 lekë (janë bërë derdhje jo më shumë se 150,000 lekë cash/ në një derdhje, duke rezultuar që shuma e derdhur nga ortaku për shoqërinë të jetë realizuar nëpërmjet 95 derdhjeve cash në arkë. Ky fakt i cilësuar në MKT si faktor risku edhe pasaktësi të tjera, duhej të trajtoheshin me detaje nga ana juaj. Observacioni nuk pranohet.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

Inspektorët e kontrollit tatimor, sipas dosjeve përkatëse (E.K., R.O., M.S., G.B., A.K., F.M., A.K., A.P., L.Ç., P.D., F.D. dhe H.R.)

Përgjegjësit e Sektorit të Kontrollit Tatimor në Vend;

Drejtorët e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor;

Drejtori i Drejtorisë Tatimore;

Sipas dosjeve përkatëse të shqyrtuara si dhe përcaktimit të përgjegjësisë të përshkruara në:

Rregulloren e funksionimit të administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192 datë 12.08.2020.

- Neni 59 “Përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorit të sektorit të kontrollit në vend”, pika 1;
- Neni 58 “Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjësit të sektorit të kontrollit në vend”, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8;
- Neni 57 “Përgjegjësitë dhe detyrat e drejtorit të drejtorisë së kontrollit tatimor në drejtoritë e tjera rajonale”, pikat 2, 7;
- Neni 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore”, pikat 3, 10, 11, 18;
- Manuali i Kontrollit Tatimor;
- Programet e Kontrollit.

3. Vlerësimi i subjektit nga inspektori në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore;

Nga Grupi i auditimit u shqyrtua dokumentacioni i ndodhur në Dosjen e kontrollit, dokumentacioni i ngarkuar në C@ts, në lidhje me argumentimin, dokumentimin e vlerësimit tatimor të subjekteve për periudhën objekt auditimi, ku kanë rezultuar mangësitë e mëposhtme:

Titulli i gjetjes 1: Mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, në lidhje me vlerësimin e AAM-ve.

Situata: 1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nga inspektorët e kontrollit tatimor në vend, nuk është evidentuar dhe trajtuar në raportet e kontrollit tatimor, fakti që nga ana e subjekteve tatimpaguese, nuk është përlogaritur saktë amortizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale (AAM), pasqyrimi i amortizimit si shpenzim në Pasqyrën e Performancës Financiare,

si dhe mos paraqitja e tyre me vlerën neto kontabël në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 22 “Amortizimi”; Manualin e Procedurave të Kontrollit Tatimor, si dhe kërkesat e programeve të kontrollit, mbi analizimin e AAM-ve. Për diferencat e evidentuara në përlogaritjen e shpenzimeve të amortizimit, për 6 subjektet sipas tabelës së më poshtme, është kryer ri karakterizim i situatës dhe përlogaritjet e detyrimeve, në zbatim të Ligjit 9920 datë 18.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, germa “b”, neni 72, germa “a” dhe neni 115, pika 1 “Plotësim i pasaktë i deklarates tatimore”.

Nr.	Subjekti tatimpagues	Detyrimi i përlogaritur	Penalitetet
1	B	5,649,678	1,014,995
2	S.P.	946,542	170,051
3	L	960,482	172,556
4	A-D	1,431,721	257,217
5	I-T	1,806,498	324,548
6	A.B.07	13,910,306	2,499,061
7	Shuma	24,705,227	4,113,880

Kriteri: Ligji 8438/1998 “Për të ardhurat tatimore në RSH” me ndryshime neni 22 “Amortizimi”;

Ligji nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, germa “b”, neni 72, germa “a” dhe neni 115, pika 1 “Plotësim i pasaktë i deklarates tatimore”;

Manuali i Kontrollit Tatimor, Programi i kontrollit tatimor.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e analizave të duhura mbi pasqyrat financiare, llogaritë, gjendjet e tyre, ndryshimet nga një periudhë në tjetrën, është reflektuar në cilësinë e Raporteve Përfundimtare të Kontrollit si dhe vlerësimin real të detyrimeve të subjekteve tatimpaguese, të reflektuar në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mos zbatim i Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH” me ndryshime, kërkesave të detajuara të programit të kontrollit, Manualit të Kontrollit, si dhe e mosfunksionimit në mënyrën e duhur të stadeve të kontrollit, brenda Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT Shkodër.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **24,705,227 lekë, nga e cila penalitetet 4,113,880 lekë.**

Pretendimi i subjektit:

1. Në observacionin nr. 3313/56, datë 20.01.2023, nga inspektori i kontrollit **F.D.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “M” SHPK.

Bazuar tek Ligji 8438 “Për Tatimin mbi të ardhurat” si dhe Udhëzimin nr.5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar” pika 3.7 Amortizimi, 3.7.2 pika b, cilësohet: Aktivitet e patrupëzuar të biznesit si patentat, markat tregtare, shpenzimet e nisjes së aktivitetit, “emri i mirë” në rastet kur ky i fundit është blerë, etj. amortizohen me një normë të lejuar për efekt fiskal prej 15 përqind. Baza e llogaritjes së amortizimit për dy kategoritë “a” dhe “b”

të aktiveve të përmendura më sipër është vlera fillestare e aktivitet (kosto historike) të cilës i shtohen edhe kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktivitet. Për llogaritjen e amortizimit merret për bazë koha (muaji) e hyrjes apo e daljes së aktivitet, sipas përcaktimit të bërë në Planin Kontabël. Përsa i përket aktiveve të blera gjatë muajit dhjetor nuk u llogaritet amortizim për arsye se ishin blerë në fund të periudhës dhe amortizimi do të llogaritet gjatë vitit pasardhës. (Regjistri i AAGJ)

		Koha e blerjes për shtesat gjatë vitit	vlera	amortizimit sipas periudhës	Amortizimi për vitin	Shënime
Toka	Toka		1,755,600	0%	-	
Ndërtesa	Ndërtesë		42,912,978	5%	2,145,649	
Ndërtesa	Ndërtesë	Dhjetor 2020	8,153,629	0%		përfunduar ndë
Makineri dhe paisje	Transportues	Maj 2020	183,333	7/12x20%(11.6%	21,267	
Makineri dhe paisje	Dhomë frigoriferike		762,940	20%	152,171	
Makineri dhe paisje	Panele		356,402	20%	71,086	
Makineri dhe paisje	Transportier vezësh		1,042,215	20%	207,873	
Makineri dhe paisje	Gjenerator	korrik 2020	1,036,083	5/12x20%(8.3%	85,995	
Makineri dhe paisje	Makineri për pastimin zgjedhjen e ve	Dhjetor 2020	5,967,373	0%		nuk është mont
Makineri dhe paisje	Linjë makineri shperndarese pulari	Dhjetor 2020	12,357,515	0%		nuk është mont
Makineri dhe paisje	Tharës Ajri	Dhjetor 2020	67,000	0%		nuk është mont
Makineri dhe paisje	Inverter Makinerie	Dhjetor 2020	413,000	0%		nuk është mont
Mjete transporti	Mercedes Benz		877,487	20%	175,018	
Mjete transporti	Autoveture range rover		8,014,417	20%	1,598,504	
Mjete transporti	Furgon Ford	shtator 2020	448,947	3/12x15% (3.7%	16,611	
Kompjuterike	Kompjuterike		12,315	25%	3,070	
Kompjuterike	Kasa Fiskale		26,798	25%	6,681	
Kompjuterike	Kasa Fiskale	maj 2020	27,563	7/12x25%(14.58	4,019	
Kompjuterike	Kasa Fiskale	shtator 2020	27,563	3/12x25% (6.2%	1,709	
			84,443,158		4,489,652	

Ndërtesa e bërë gjatë muajve nëntor dhjetor 2020 e paraqitur nga tatimpaguesi tek librat e blerjeve punime të kryera nga tatimpaguesit Z. dhe C.C, e paraqitur në deklarata tatimore tek zëri blerje të investime vendase pa tvsh dhe blerje investime vendase me tvsh nuk ishte kryer amortizim gjatë kësaj periudhe sepse ndërtimi kishte kryer dt 31.12.2020.

Makineri dhe paisje nuk ishte bërë amortizimi për blerjet e dhjetorit për arsye se ishin makineri për pastrimin dhe ndarjen e vezëve për të cilat duhej kohë për vendosjen në punë nuk u bë amortizimi për këto paisje për këtë periudhë.

2. Me observacionin nr. 3313/51, datë 20.01.2023 dhe 3313/60, datë 23.01.2023, nga inspektorët e kontrollit **G.B. dhe R.H.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin tatimpagues "D.G.", është sqaruar se: Për shtesën e AQT për vitin 2019 në vlerë 981,811 lekë dhe për vitin 2020 në vlerë prej 1,291,892 lekë sqarojmë se investim në proces (Pajisje për montim i makinerisë për shkrirjen e metaleve të çmuara) të marra nga importi me DAV R-4874 datë 11.09.2019 të importuar nga Turqia dhe që është regjistruar në AQT bazuar në proceset e punës së montimit të makinerisë.

Meqënëse montimi i makinerise për shkrirje të metaleve të çmuara, nuk është kryer deri më 31.12.2020, makineria nuk është në punë dhe si e tillë nuk ju shërben tranaksioneve të tatueshme dhe amortizimi për këto AQT në proces nuk llogaritet, bazuar kjo në Ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhuarit" i ndryshuar, neni 20, paragrafi i parë (Për përcaktimin e fitimit të tatueshëm në Republikën e Shqipërisë njihen si shpenzime ato që kryhen për qëllime fitimi, sigurimi dhe ruajtje të fitimit, në masën që këto shpenzime provohen dhe dokumentohen nga tatimpaguesi, si dhe kur janë objekt i kufizimeve të specifikuar nga ky ligj.)

3. Në observacionin nr. 3313/60, datë 23.01.2023, nga inspektori i kontrollit **G.B.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “B” SHPK, është sqaruar se: Nga kontrolli në vend është parë që subjekti B ka kryer një vlerësim real të amortizimit, duke mos tejkaluar në asnjë rast normat ligjore.

Për diferencat e konstatuara nga ana juaj, nuk janë marrë për bazë shtesat e krijuara gjatë periudhës të cilat nuk janë përdorur krejt vitin, si dhe të tjerat nuk janë vënë në funksion po kështu ka patur edhe makineri të pa përdorshme, për efekt të pamundësisë së shfrytëzimit për mungesë personeli dhe rrjedhimisht nuk është llogaritur amortizim, për kto kategori asetesh. Nga kontrolli janë parë të detajuara kartelat analitike të amortizimit për AAM të përdorura në fakt, rrjedhimisht dhe nuk janë evidentuar tejkallime dhe as llogaritje nën norma.

Theksojmë se subjekti B është 100% eksportues i cili punon nën regjimin e përpunimit aktiv rrobaqepësi me material porositësi. Kjo praktikë është ndjekur nga subjekti për të gjitha periudhat e kontrolluara nga ana ime. Prandaj nuk janë cilësuar nga ana ime shpenzimet e amortizimit të gabuara, por jemi shprehur që nuk ka tejkallim normash amortizimi.

4. Në observacionin nr. 3313/61, datë 23.01.2023, nga Inspektori i kontrollit **M.S.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “S.P.” SHPK, është sqaruar se: Ndërtesa me vlerë 14,985,000 lekë bën fjalë për ndërtesën e ish shtëpisë së oficerave të cilën subjekti e ka blerë për ta rikonstruktuar totalisht, sipas lejes së ndërtimit të marrë në bashki. Objekti është i paisur me leje ndertimi nga Bashkia Shkodër me Nr. 120 datë 23.06.2017 me destinacion Rikonstruksion+Shtese Horizontale 6 kate, trajtuar në fletën nr. 28 të akt kontrollit të kryer nga ana ime. Sa më sipër ndërtesa në fjalë, nuk është përdorur për nevoja të aktivitetit të tatueshëm të subjektit, në periudhën e kontrolluar, veçse ka qenë në proces rikonstruksioni total, prandaj me të derjtë edhe nuk është përfshirë në shpenzime amortizimi nga ana e subjektit.

5. Në observacionin nr. 3313/61, datë 23.01.2023, nga Inspektori i kontrollit **M.S.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “H” SHPK, është sqaruar se:

Shoqëria “H” SHPK e ka transferuar veprimtarinë e tij ekonomike që nga viti 2016 në ambiente të tjera, marrë me qira nga qiradhënësi Ridvan Domnori përfaqësues me prokurë, sipas kontrat qiraje nr. 3338 rep. dhe 2198 kol., hartuar nga notere V. F.

Sa më sipër nga kontrolli është cilësuar e drejtë mos llogaritja e amortizimit për efekt fiskal Me të drejtë nuk është llogaritur amortizim për AAM ndërtesat e mbetura në bilanc, pasi në atë ndërtesë nuk është ushtruar aktivitet për periudhën e kontrolluar.

Ndërsa shtesa gjatë vitit 2018 vlera e AAM shtesa, prej 2,000,000 lekë, është autoveturë e cila nuk është përdorur për qëllime të biznesit, për periudhën e kontrolluar dhe sipas ligjit 92/2014, shpenzimet për autovetura janë furnizime të përjashtuara.

6. Në observacionin nr. 3313/58, datë 23.01.2023, nga Inspektori i kontrollit **R.O.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “L.C.” SHPK, është sqaruar se: Arsytimi pse shoqëria nuk ka llogaritur amortizimin në vlerën e plotë; Subjekti “L.C.” ka llogaritur shpenzim amortizimi për vitin 2020 vlerën prej 250,000 lekë, vetëm për asetet e përdorura por duke qenë se subjekti ka blerë asete gjatë vitit 2020 dhe nuk i ka përdorur ato gjatë po të njëjtit vit rezulton që amortizimi fiskal të mos i përgjigjet vlerës së blerjes. Duke qenë se shoqëria ka objekt veprimtarie kryesisht ndërtimin, për arsye garancie pune blen asete edhe pa qenë nevoja e përdorimit efektiv momental por për periudha të mëpasshme të mundësisë të fitimit të tenderave në të cilët merr pjesë. Subjekti gjatë vitit 2020 ka blerë paisje dhe mobilje zyre për zyren e re në të cilën është zhvendosur në vitin 2021 dhe defakto janë montuar dhe vendosur në punë në fillim të vitit 2021, si edhe paisje pune të cilat janë blerë për procesin e rindërtimit, puna e të cilit ka filluar gjatë vitit 2021. Duke qenë se këto makineri nuk janë përdorur gjatë vitit 2020, konsumi i tyre ka qenë zero, dhe rrjedhimisht dhe shpenzimi i amortizimit për to nuk është llogaritur për vitin 2020.

7. Në observacionin nr. 3313/59, datë 23.01.2023, nga Inspektori i kontrollit **H.R.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “A-D” SHPK, është sqaruar se: Në lidhje me mos llogaritjen e amortizimit, nga ana e tatimpaguesit, sqarojmë se objektivi i kontrollit është mosnjohja e shpenzimeve sipas referencës (ligji nr.8438 datë 28/12/1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat (ndryshuar) neni 21 shpenzime të panjohura germa j- shpenzime të cilat tejkalojnë kufijtë e përcaktuar në ligj, apo në akte nënligjore) dhe jo rritja e tyre, kur nuk është llogaritur nga tatimpaguesi.

Përsa i përket rivlerësimit të shitjeve (të ardhurave) duke ju referuar neneve 71 dhe 72 të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” (ndryshuar) duke marrë për bazë mungesën e shpenzimeve të padeklaruara mendojmë se është i pasaktë pasi nuk ka lidhje korrelative në mes të shpenzimeve të amortizimit, dhe nivelit të ardhurave të deklaruara, të ardhurat rrjedhin nga shitjet me faturë tatimore dhe pasqyrohen nga pagesat në bankë apo nga shtimi i klientëve për periudhën.

8. Në observacionin nr. 3313/53, datë 20.01.2023, nga inspektori i kontrollit **F.M.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “IBC” SHPK.

-Nga ana e inspektorit nuk është evidentuar fakti që shpenzimet e amortizimit nuk janë përlllogaritur në mënyrën e duhur nga subjekti për vitet 2019 dhe 2020.

Subjekti ka kryer një vlerësim real të amortizimit si më poshtë:

Ka klasifikuar në mënyrë të drejtë grupet e klasifikimit të AAM-ve. Sipas të dhënave analitike të marra nga kontabiliteti i shoqërisë normat e amortizimit të linjave të transmetimit të internetit janë AAM me afate të gjata përdorimi që shkojnë mbi 20 vjet dhe është zbatuar një normë amortizimi 5 %, bazuar në pikën nr.3, të nenit nr.22 të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat ku cilësohet se “kostot e blerje ose ndërtimit, kostot e përmirësimit, të rinovimit të konstruksioneve dhe makinerive e pajisjeve me afat të gjatë shërbimi amortizohen veçmas me vlerën e mbetur me 5 %”. Gjithashtu sipas Udhëzimit nr.5 datë 30.01.2006, i ndryshuar në shërbim të Ligjit të mësipërm tek pika 7.2 theksohet se “...po në këtë mënyrë amortizohen edhe impiantet e ndryshme të transportimit si: ujësjellësit, naftësjellësit, gazsjellësit, linjat hekurudhore, tensionit të lartë teleferike dhe të tjera aktive të ngjashme me to. Norma e amortizimit e këtyre aktiveve është 5 % mbi vlerën e mbetur.”

Ka vepruar në referencë ligjore pika nr.7 e nenit nr.2 ku citohet se: “Baza e amortizimit të jetë vlera kontabël e kategorisë së regjistruar në bilancin e hapjes së periudhës tatimore a) duke i shtuar koston e blerjeve apo krijimit të aktivitetit dhe koston e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të kategorisë gjatë periudhës tatimore b)duke i zbritur çmimin e shitjes së aktiveve dhe kompensimet e marra për humbjen e aktiveve për shkak të humbjeve të tjera madhore apo shndërrimeve të tjera të pavullnetshme gjatë periudhës tatimore”.

Theksoj se çdo vlerësim teorik i AQT-bazuar në % maksimale të normave të amortizimit rrit shpenzimet e amortizimit padrejtësisht dhe jep efekte fiskale në Tatim-Fitim.

9. Në observacionin nr. 3313/53, datë 20.01.2023, nga Inspektori i kontrollit **F.M.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “A.B.07” SHPK, është sqaruar se: Nga ana e inspektorit nuk është evidentuar fakti që shpenzimet e amortizimit nuk janë përlllogaritur në mënyrën e duhur nga subjekti për vitet 2017 deri 2020.

Më duhet të sqaroj se amortizimi është trajtuar nga inspektori tek faqet 38-39, 45, 52 dhe 58 e Raport kontrolli paraprak (gjithsej 70 faqe) dhe është llogaritur në referencë ligjore të nenit 22 e Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar). Subjekti ka kryer një vlerësim real të amortizimit si më poshtë: Ka klasifikuar në mënyrë të drejtë grupet e klasifikimit të AAM-ve -Sipas të dhënave analitike të marra nga kontabiliteti i shoqërisë normat e amortizimit të linjave të prodhimit dhe përpunimit të inerteve janë AAM me afate të gjata përdorimi që shkojnë mbi 20 vjet dhe është zbatuar një normë amortizimi 5 % bazuar në pikën nr.3, nenit 22 e Ligjit 8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të ardhurat ku thuhet tekstualisht “Kostot e blerjes ose ndërtimit, kostot e përmirësimit, të rinovimit të

konstruksioneve dhe makinerive e pajisjeve me afat të gjatë shërbimi amortizohen veçmas me vlerën e mbetur me 5%”. Gjithashtu sipas Udhëzimit nr.5 datë 30.01.2006, i ndryshuar në shërbim të Ligjit të mësipërm tek pika 7.2 në mes të tjerash theksohet se “...po në këtë mënyrë amortizohen edhe impiantet e ndryshme të transportimit si ujësjellësit, naftësjellësit, gazsjellësit, linjave hekurudhore, tensionit të lartë teleferikë dhe të tjera aktive të ngjashme me to. Norma e amortizimit e këtyre aktiveve është 5% mbi vlerën e mbetur.”

Ka vepruar në referencë ligjore pika nr.7 e nenit 2 ku thuhet: “Baza e amortizimit të jetë vlera kontabël e kategorisë së regjistruar në bilancin e hapjes së periudhës tatimore a)duke i shtuar koston e blerjeve apo krijimit të aktivitetit dhe koston e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të aktiveve të kategorisë gjatë periudhës tatimore b)duke i zbritur çmimin e shitjes së aktiveve dhe kompensimet e marra për humbjen e aktiveve për shkak të humbjeve të tjera madhore apo shndërrimeve të tjera të pavullnetshme gjatë periudhës tatimore”. Theksoj se çdo vlerësim teorik i AQT- bazuar në % maksimale të normave të amortizimit rrit shpenzimet e amortizimit padrejtësisht dhe jep efekte fiskale në Tatim-Fitim.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

1. Mbi observacionin e bërë nga Inspektori F.D., subjekti “M” SHPK.

Nga ana e subjektit është argumentuar ligjërisht, si dhe është paraqitur dokumentacion shtesë “Regjistri i AAGJ” të subjektit tatimpagues, ku është paraqitur edhe koha e blerjes së AAGJ, i cili vërteton pretendimin e tij. Observacioni i mësipërm është marrë në konsideratë dhe është reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

2. Mbi observacionin e bërë nga inspektori G.B., subjekti “D.G.” SHPK.

Nga ana e subjektit është argumentuar ligjërisht, si dhe janë paraqitur të dhëna dhe informacion shtesë, mbi mospërfshirjen në përlllogaritjen e amortizimit për vlerën e AAGJ në proces, duke vërtetuar pretendimin e tij. Observacioni i mësipërm është marrë në konsideratë dhe është reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

3. Mbi observacionin e bërë nga inspektori G.B., subjekti “B” SHPK. Nga shqyrtimi i observacionit është marrë në konsideratë pretendimi i subjektit mbi përlllogaritjen e amortizimit mbi shtesat gjatë vitit ushtrimor, si dhe është kryer rillogaritja e tij dhe diferencat sipas tabelave të mëposhtme, duke i reflektuar trajtimin e saj në gjetjen nr. 1.

Viti 2016	Vlera Neto 01.01.2016	Shtesa	Pakësimi	Amortizimi sipas DRT	Amortizim sipas KLSH	Diferenca
Makineri pajisje	13,163,290	6,501,076	-	658,165	2,632,658	1,974,493
Te tjera	4,914,259	3,367,177	-	950,371	950,371	0
Aktivitet AGJ	17,915,140	9,868,253	-	1,608,536	3,583,028	1,974,493
Viti 2017	Vlera Neto 01.01.2017					
Makineri pajisje	19,006,201	2,830,860	-	612,590	3,801,240	3,188,650
Te tjera	7,168,657	1,706,594	-	937,082	1,433,731	496,649
Aktivitet AGJ	26,174,858	4,537,454	-	1,549,672	5,234,972	3,685,300
Viti 2018	Vlera Neto 01.01.2018					
Makineri pajisje	18,722,633	2,319,611	-	510,191	3,744,527	3,234,336
Te tjera	10,440,007	253,208	-	599,225	2,088,001	1,488,776
Aktivitet AGJ	29,162,640	2,572,819	-	1,109,416	5,832,528	4,723,112
Viti 2019	Vlera Neto 01.01.2019					
Makineri pajisje	20,532,053	165,544	-	1,026,603	4,106,411	3,079,808
Te tjera	10,093,990	642,335	-	2,239,560	2,018,798	(220,762)
Aktivitet AGJ	30,626,043	807,879	-	3,266,163	6,125,209	2,859,046

Përshkrimi	2016	2017	2018	2019
Baza e tatueshme	1,974,493	3,685,300	4,723,112	2,859,046
Tatim fitimi	296,174	552,795	708,467	428,857
Gjoha	64,862	121,062	155,154	93,920
TVSH	394,898	737,060	944,622	571,809
Gjoha	86,483	161,416	206,872	125,226
Totali	842,417	1,572,333	2,015,116	1,219,812

4. Mbi observacionin e bërë nga inspektori M.S., subjekti “S.P.” SHPK. Nga shqyrtimi i observacionit është marrë në konsideratë pretendimi i subjektit pasi janë paraqitur argumente, informacion dhe dokumentacion shtesë, mbi përlllogaritjen e amortizimit mbi zërin “Ndërtesa” në shumën 14,895,000 lekë, si dhe bazuar në to, është kryer rilllogaritja e amortizimit (viti 2019) sipas tabelave të mëposhtme, duke i reflektuar trajtimin e saj në Gjetjen nr. 1.

Viti 2019							
Zërat	Norma	Vlera e mbetur 01.01.2019	Shtesa	Pakësimi	Amortizimi sipas subjektit	Amortizimi sipas KLSH	Diferenca Baza e tatueshme
Toka	0					-	
Ndërtesa	0.05	14,895,000				-	
Makineri dhe pajisje	0.2	51,600			10,320	10,320	
Mjete transporti	0.2	6,346,969	2,901,835		1,307,122	1,849,761	
Kompjuterike	0.25					-	
Zyre	0.2	27,273	37,500		47,211	12,955	
Te tjera	0.2	255,342	88,500			68,768	
Pajisje informatike	0.25						
		21,576,184	2,939,335	-	1,364,653	1,941,804	577,151
Totali							

Përshkrimi	2019
Baza e tatueshme	577,151
Tatim fitimi	86,573
Gjoha	18,959
TVSH	115,430
Gjoha	25,279
Totali	246,241

Observacioni i DRT, është pranuar për amortizimin e ndërtesës në shumën 14,895,000 lekë, si dhe pas përlllogaritjeve detyrimet për vitin ushtrimor 2018, janë në shumën 700,301 lekë dhe **në total 946,542 lekë.**

5. Mbi observacionin e bërë nga inspektori M.S., subjekti “H” SHPK. Nga shqyrtimi i observacionit është marrë në konsideratë pretendimi i subjektit pasi janë paraqitur argumente, informacion dhe dokumentacion shtesë, si dhe është reflektuar në RPA.

6. Mbi observacionin e bërë nga inspektori R.O., subjekti “L.C.” SHPK. Nga shqyrtimi i observacionit, nuk evidentohet, argumentohet dhe dokumentohet fakti se si inspektori i kontrollit tatimor, ka vërtetuar për sa është shprehur më lart. Observacioni nuk pranohet.

7. Mbi observacionin e bërë nga inspektori H.R., subjekti “A-D” SHPK. Nga Grupi i auditimit është evidentuar fakti se, ju nuk jeni shprehur për pasaktësitë në përlllogaritjen e amortizimit, veprim në kundërshtim me kërkesat e Programit të kontrollit, ku ju kërkohet të kryeni analizë të detajuar të AQT, përfshirë këtu respektimin e normave të amortizimit bazuar në Ligjin nr. 8438/1998 me ndryshime neni 22. Gjithashtu, theksojmë faktin që objekti juaj është analizimi i çdo llogarie, të PF, deklarimeve në sistem, dokumentacionit kontabël me qëllim identifikimin e mospërputhjeve, procedura të cilat i keni të përcaktuara qartë në manual dhe në listën e verifikimeve për çdo çështje kontrolli të përcaktuara në program. Në rast të ri karakterizimit të kryer nga grupi i kontrollit, është kryer bazuar në nenin 71 dhe 72 të Ligjit 9920/2008 me ndryshime, duke cilësuar faktin që mos pasqyrimi i saktë i gjendjes së llogarive në pasqyrat financiare, impakton të gjithë situatën financiare të subjektit në një moment të dhënë (aktualisht 31.12), si dhe nuk mund të deklarohemi për saktësi të tyre.

8. Mbi observacionin e bërë nga inspektori F.M., subjekti “I-T” SHPK. Grupi i auditimit ka marrë në konsideratë observacionin tuaj, referencën ligjore dhe ka reflektuar në PRA, duke rillogaritur me normën 5 % shpenzimet e amortizimit. Gjithashtu referuar regjistrin të AQT, ku është evidentuar koha e blerjes së tyre janë kryer ri llogaritjet, duke mos përllogaritur amortizim për blerjet e kryera në fund të vitit ushtrimor 2019 dhe 2020.

9. Mbi observacionin e bërë nga inspektori F.M., subjekti “A.B.07” SHPK.

Në lidhje me përllogaritjen e shpenzimeve të amortizimit, argumentet tuaja nuk qëndrojnë, për dy arsye:

Së pari norma e amortizimit të aplikuar nga subjekti varion në 0.8 %, ndërkohë që ju vetë pranoni që duhet të përllogariten më 5 %;

Së dyti norma e amortizimit 5 % e cilësuar nga ana juaj referuar ligjit nr. 8438/1998 neni 22, si dhe Udhëzimit nr. 5/2006 neni 7.2 nuk përfshin AQT që disponon subjekti A.B.07.

Udhëzimi nr. 5/2006 “Për tatimin mbi të ardhurat i ndryshuar”, pika 3.7.2 Normat e amortizimit sipas grupeve Amortizohen individualisht dhe në mënyrë lineare:

a. *Kostot e blerjes ose ndërtimit, kostot e përmirësimit, rinovimit dhe rikonstruksionit të ndërtesave, si dhe kostot e konstruksioneve, makinerive e pajisjeve me afat përdorimi më të madh se 20 vjet, të trupëzuara në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me ndërtesat ose tokën. Të tilla janë sendet e ngjitura me plumb, gips ose tjetër që nuk mund të shkëputen pa u thyer ose pa u cenuar, ose pa prishur apo dëmtuar pjesën e tokës ose të ndërtesës me të cilën është trupëzuar si p.sh. ashensorët, konstruksionet metalike pjesë e ndërtesës, instalimet elektrike dhe hidraulike, etj. Po në këtë mënyrë amortizohen edhe impiantet e ndryshme të transportimit si: ujësjellësit, naftësjellësit, gazsjellësit, linjat hekurudhore, linjat e tensionit të lartë, teleferikët, e të tjera aktive të ngjashme me to. Norma e amortizimit të këtyre aktiveve është 5 për qind mbi vlerën e mbetur.*

Gjithashtu referuar analizës së AAM të kryer nga ana juaj në RPK, të cituar më poshtë, rezulton se subjekti ka një numër të konsiderueshëm mjete transporti me të cilat kryen edhe aktivitet “transport”, të cilat si AAM nuk përfshihen në klasifikimin e gërmës (a).

Analiza në RPK: Llogaria “Aktive afat gjatë” në vlerë 57 803 566 lekë, paraqet vlerën e mbetur kontabel të zerave sa me sipër me 31.12.2017 respektivisht – ndërtesa në vlerën e mbetur 1 251 370 leke, - makineri dhe pajisje me vlerën e mbetur 51 590 937 lekë dhe pajisje kompjuterike dhe zyre në vlerën e mbetur 4 961 259 lekë. Gjatë vitit 2017 ka patur shtesa tek zeri “Makineri dhe pajisje” në vlerë 1 191 095 lekë (import nga Italia) dhe blerje vendi pajisje zyre në vlerë 130 825 lekë pra shtesa gjithsej 1 321 920 lekë. Gjithashtu gjatë vitit 2017 ka patur dhe pakesime tek zeri “Makineri dhe pajisje” në vlerën 170 000 lekë (shitje një ½ rimorkio). Gjendja e AAM të pasqyruar në bilanc vertetohet me inventarin fizik të datës 31 dhjetor 2017. Pronesia e AAM vertetohet me dokumentat perkatese të pronësive që dispononte shoqëria. Shoqëria dispononte inventarin e sakte të Aktive afatgjata materiale sipas zërave të bilancit dhe të pasqyruara saktë në bilancin financiar të vitit 2017. Të gjitha zërat në çelje janë trajtuar në mënyrë analitike nga inspektorët të tjerë të kontrollit tek Tatim – Fitimi i vitit 2016 (kamionë + fadroma + auto betonierë + impiant pjesor betoni + kompresorë + bazament impianti + aksesore të gjitha në shërbim të aktivitetit prodhim dhe shitje inertesh), të cilat nuk janë analizuar nga ana juaj për efekt të përllogaritjes së amortizimit. Observacioni nuk pranohet.

Titulli i gjetjes 2: Mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, në lidhje me vlerësimin e blerjeve për mallra të lëndë të parë, pjesë e përllogaritjes së Kostos së Mallrave të Shitura (KMSH), dhe deklarimit të tyre në FDP e Tatim Fitimit (TF)

Situata: Nga auditimi, në 5 raste, sipas tabelës së mëposhtme, janë evidentuar mospërputhje në deklarimin e blerjeve mallra e lëndë të parë gjatë vitit (shitesa gjatë vitit), e cila ka ndikuar në përlogaritjen e KMSH sipas Formularit nr. 5, Pasqyrën e Performancës Financiare dhe FDP e tatim fitimit, ku për të gjitha rastet e mospërputhjeve, diferenca e konstatuar ka shërbyer si bazë e tatueshme për të kryer ri karakterizimin dhe përlogaritjen e detyrimeve tatimore, referuar Ligjit nr.9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”, germa (b) si dhe bazuar në nenin 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit” është kryer rivlerësimi sipas të cilit janë përlogaritur detyrimet dhe gjobat e mësipërme në zbatim të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklarates tatimore”, pika 1.

Përshkrimi	Norma	M	S.A.	M	G-2012	A.K.
Baza e tatueshme		3,551,850	2,138,228	996,711	8,590,761	859,560
Tatim fitimi	15 %	532,778	320,733	149,506	1,288,615	128,934
Gjoha	21.9 % e TF	116,678	70,240	32,419	282,206	28,236
Totali		649,456	390,973	181,925	1,570,821	157,170

Kriteri: Ligji nr. 9920/2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime; Ligji 8438/1998 “Për të ardhurat tatimore në RSH” me ndryshime; Manuali i Kontrollit Tatimor, ku evidentohet se KMSH është një element i rëndësishëm i përlogaritjes së TF, si dhe blerjet neto të analizuar (mallra, lëndë e parë, për rishitje) janë pjesë e KMSH.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e analizave të duhura mbi pasqyrat financiare, llogaritë, gjendjet e tyre, ndryshimet nga një periudhë në tjetrën, është reflektuar në cilësinë e Raporteve Përfundimtare të Kontrollit si dhe vlerësimin real të detyrimeve të subjekteve tatimpaguese, të reflektuar në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mos zbatim i Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH” me ndryshime, kërkesave të detajuara të programit të kontrollit, Manualit të Kontrollit, si dhe e mosfunksionimit në mënyrën e duhur të stadeve të kontrollit, brenda Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT Shkodër.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht **në shumën 2,950,345 lekë, nga e cila penaliteti 529,779 lekë.**

Pretendimi i subjektit:

1. Në observacionin nr. 3313/56, datë 20.01.2023, nga Inspektori i kontrollit **F.D.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “M” SHPK. Për tatimpaguesit “M” me Nuis JC duke pare situatën financiare e sqaruar analitikisht më poshtë sipas kontrollit të imtësishëm të faturave tatimore dhe sipas përshkrimit të inspektorit me detaje në program kontrolli në faqen 5,6 si dhe në faqen 28,29 rezultoi:

Situata financiare e tatimpaguesit e paraqitur në sistemin c@ts.

Blerje të përjashtuara	39,980,219
Importe mallrash të përjashtuara nga TVSH	1,052,375
Blerje nga furnitorë vendas me TVSH 20%	18,858,071
Blerje nga fermerët vendas	132,402,882
Totali i blerjeve malli	192,293,547

Situata financiare e tatimpaguesit për blerjet e mallit për rishitje analitikisht sipas kontrollit të imtësishëm të faturave tatimore dhe sipas përshkrimit të inspektorit me detaje në program kontrolli në faqen 5,6 si dhe në faqen 28,29 rezultoi si më poshtë:

Blerje të përjashtuara 39,980,219 lekë ishin mallra të blera nga fermerët vendas pa NIPT 27,108,214 lekë si dhe 12,872,005 lekë transport ndërkombëtarë.

Importe mallrash të përjashtuara nga TVSH vlera 1,052,375 lekë ishin blerje malli për rishitje vlera 996,711 si dhe blerje pjesë për mirëmbajtjen e makinerive vlera 55,664 lekë.

Blerje nga furnitorë vendas me TVSH 20% vlera 18,858,071 lekë nuk ishin mallra për rishitje. Blerje nga fermerët vendas vlera 132,402,882 lekë ishin të gjitha mallra për rishitje.

Pra blerje malli për rishitje KMSH për vitin 2020 ishte. Pra Kosto e mallrave të shitura ishte paraqitur drejt nga tatimpaguesi për këtë periudhë.

Blerje mallra viti 2020	
Blerje të përjashtuara	27,108,214
Importe mallrash të përjashtuara	996,711
Blerje nga fermerët vendas	132,402,882
Blerje malli total	160,507,807

Përshkrimi	
Gjendje në fillim	61,715,550
Blerje	160,507,807
Gjendje në fund	(54,214,805)
KMSH	168,008,552

2. Me observacionin nr. 3313/52, datë 20.01.2023 dhe nr. 3313/63, datë 23.01.2023, nga inspektorët e kontrollit **A.K. dhe E.K.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin "M" SHPK, është paraqitur i njëjti observacion si në fazën e hartimit të Projekt Raportit të Auditimit, mbi akt konstatimet.

3. Me observacionin nr. 3313/54, datë 23.01.2023 nga inspektori i kontrollit **L.Ç.**, në lidhje me KMSH është sqaruar se, për formularin 5, kosto për vitet 2015-2018 është llogaritur saktë si tabela më poshtë:

Fundi i vitit	2015	2016	2017	2018
Malli gjendje në fillim të ushtrimit	146,427,322	158,229,375	68,796,089	42,186,443
(shto +) blerjet	177,838,953	30,901,173	43,914,139	38,361,668
(zbrit -) malli gjendje në fund	158,229,375	68,796,089	42,186,443	37,543,480
(=) kostoja e mallit të shitur	166,036,900	120,334,459	70,523,785	43,732,327

Ndërsa blerjet e relatuar në formularin 5, aneksi c, janë në total, të cilat nuk japin të detajuar koston e mallrave, por kanë si qëllim krahasimi i tatimit të zbritshëm me blerjet e llogaritura, pasi në totalin e blerjeve përfshihen edhe blerjet e tjera, referencat doganore, blerjet investime, etj.

Diferenca e totalit të blerjeve me koston e blerjeve sipas viteve 2015-2018 rezulton si tabela më poshtë:

viti	2018	2017	2016	2015
Totali i blerjeve	41,602,711	44,510,156	39,400,977	179,157,343
tot.blerje kosto mallrave	38,361,688	43,914,139	30,901,173	177,838,953
diferenca	3,241,023	596,017	8,499,804	1,318,390

Totali i blerjeve për vitin 2017 ka ndryshuar pas ndërhyrjeve me akt kontroll pasi tatimpaguesit janë ri vlerësuar blerjet e përjashtuara të cilat kanë qenë të relatuar në kontabilitet por jo në

FDP. Pas rivlerësimit, totali i blerjeve është ai i situatës financiare në sistemin C@ts si më sipër.

Diferenca e totalit të blerjeve me koston e mallit të blerë të relatuar në bilance sipas viteve të sqaruara në akt-kontroll, janë si tabela më poshtë:

Blerjet diferencë sipas viteve	2018	2017	2016	2015
Investime	0	0	1,263,640	0
shpenzime te tjera me fatura	804,862	62,141	5,567,577	866,806
Referenca doganore ne import	423,650	533,876	512,420	451,584
Materiale publicitare import falas	2,012,511	-	1,156,167	-
Total blerje tjera	3,241,023	596,017	8,499,804	1,318,390

-Rubrika investime për vitin 2016 në shumën 1,263,640 lekë e cila kalon në AAM të bilancit,

-Shpenzime të tjera për furnitura, të relatuar në bilanc të cilat janë me fatura sipas viteve, të pasqyruara analitike në akt kontroll ne fq.29, 34, 39 e 44, sipas viteve përkatëse.

-Tatimpaguesi ka patur referenca doganore në importe si tabela më sipër të cilat, janë rivlerësime në doganë për të cilat paguan TVSH dhe vlera tyre rritet për efekt statistikor, relatuar në akt kontroll në pjesën e shqyrtimit të TVSH-së, vlerë të cilën me të drejtë deklarohet në FDP të e TVSH por nuk llogaritet në kosto.

-Në vitin 2016, tatimpaguesi ka marrë përfaqësinë e birrës warshteiner dhe me marrjen e kësaj përfaqësie, furnitori gjerman i ka dhënë falas materiale publicitare si çadra, bluza, kapele, etj., në shumat e relatuar në tabelën më sipër dhe në akt kontroll në pjesën e shqyrtimit të TVSH për vitet përkatëse 2016 e 2018, pra janë me vlerë 0 lekë. Por në momentin e hyrjes në doganë, autoriteti doganor i vendos vlerë statistikore për të cilën paguan TVSH në doganë dhe tatimpaguesi i deklaroi me të drejtë, si blerje importe në FDP e TVSH. Këto materiale të cilat janë falas nga furnitori, janë deklaruar me vlerë 0 në kontabilitet inventar, të cilat janë shpërndarë falas nga tatimpaguesi, pra nuk llogariten kosto pasi nuk krijojnë të ardhura.

Nga sa më sipër nuk kemi diferenca FDP-PASH për vitet 2015-2018.

viti	2018	2017	2016	2015
diferenca blerje -total blerje tjera	-	-	-	-

4. Me observacionin nr. 3313/55, datë 20.01.2023 nga inspektori i kontrollit P.D., në lidhje me KMSH është sqaruar se, në lidhje me pikën 1.3 Në raport kontrolli është trajtuar se në rubrikën “Të tjera shpenzime, lënda e parë dhe materiale të konsumueshme”, në shumën 187,085,771 lekë tatimpaguesi ka përfshirë koston e mallrave të shitura në vlerën 186,226,211 lekë dhe shpenzime karburanti në vlerën 859,559 lekë.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

1. Mbi observacionin e inspektorit F.D., subjekti “M” SHPK.

Kostoja e mallrave, produkteve apo shërbimeve të shitura, është një nga treguesit kryesorë për përcaktimin e të ardhurës bruto dhe neto nga aktiviteti i shitjes të njësisë ekonomike. Kostoja e mallrave të shitura (KMSH) llogaritet si shumë algjebrike e koston së mallrave, prodhimeve, shërbimeve gjendje në fillim të periudhës + blerjet neto gjatë periudhës - gjendjen në fund të periudhës.

Gjendja në fillim dhe në fund i referohet gjendjes së inventarit në çelje dhe mbyllje të vitit ushtrimor, ndërsa blerjet neto kanë të bëjnë vetëm me blerjet që janë për rishitje.

Sipas analizës së kryer në Raportin Përfundimtar të Kontrollit Tatimor, blerjet neto janë:

Në faqe 5 të RPK, keni analizuar se: “...Shoqëria për periudhën janar 2020 deri dhjetor 2020 ka realizuar blerje nga impoti mallra të përjashtuara në vlerën 1,052,375 lekë ishin pjesë për makineritë e përpunimit të produkteve blegtorale ndërsa një pjesë ishin sherebelë për qëllim

përpunimin dhe eksportimin e produktit...”. Nga inspektori nuk është analizuar sa janë blerjet neto të përfshira në shumën 1,052,375 lekë.

Në faqe 5 të RPK, keni analizuar se: “...Shoqëria për periudhën janar 2020 deri dhjetor 2020 ka realizuar blerje të përjashtuara në vlerën 39,980,219 lekë të cilat pjesa më e madhe ishin fermerë që nuk ishin paisur me certifikatë regjistrimi dhe përveç këtyre blerjeve tatimpaguesi bënte dhe blerje si më poshtë: siguracion makinash blerje, taksë për energjinë elektrike, shërbime doganore etj.”, ku nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është analizuar sa janë blerjet neto. Sipas analizës në faqe 28, shuma prej 12,872,005 lekë, përfaqëson shpenzime të tjera, të cilat nuk janë blerje neto.

Në faqe 6 të RPK, keni analizuar se: “...Shoqëria për periudhën janar 2020 deri dhjetor 2020 ka realizuar blerje nga furnitorë vendas me TVSH 20% me vlerë të tatueshme në shumën 18,858,071 lekë dhe TVSH të kreditueshme në shumën 3,771,614 lekë. Këto blerje përbëhen kryesisht nga blerje nga tatimpaguesit e tjerë të bimëve medicinale për energji elektrike, shpenzime telefoni interneti, karburant (kreditimi ishte bërë sipas udhëzimit nr. 6 për tatimin mbi vlerën e shtuar Neni 55), riparime për shtim të ambienteve të punës (bashkangjitur situacioni), disinfektim i bimëve medicinale, ambalazhim dhe transport brenda vendit etj.”, të cilat nuk janë pjesë e blerjeve neto.

Në faqe 6 të RPK, keni cilësuar se: “Shoqëria për periudhën janar 2020 deri dhjetor 2020 ka realizuar blerje nga fermer vendas me TVSH 6% në vlerë të tatueshme në shumën 132,402,882 lekë dhe TVSH, peshën më të madhe të blerjeve e kishte nga fermerët vendas nga ku blinte produkte bujqësore aromantike dhe medicinale si sherebelë, levandë, dëllinjë e zezë, trumz, rigon, hithra dhe gjethe midrre, blerje neto. Sa më sipër, observacioni nuk pranohet.

Blerje neto viti 2020	DRT	KLSH
Blerje të përjashtuara	27,108,214	27,108,2014
Importe mallrash të përjashtuara	996,711	-
Blerje nga fermerët vendas	132,402,882	132,402,882
Blerje malli total	160,507,807	159,511,096

2. Në lidhje me observacionin e paraqitur nga inspektorët A.K. dhe E.K., evidentojmë faktin se, janë të njëjtët të paraqitur në fazën e mëparshme të auditimit, gjë për të cilën sqarimet tona janë trajtuar hollësisht në PRA, si më poshtë:

Nga ana jonë është cilësuar saktë se ku qëndron diferenca, pra midis shpenzimeve për lëndë të parë e mallra (blerje gjatë vitit) të analizuar nga ana juaj në faqe 11 të RPK, dhe atyre të deklaruara në Formularin nr. 5. (blerje gjatë viti).

Blerjet gjatë vitit sipas analizës tuaj në PRK janë në shumën 15,730,312 lekë;

Blerjet sipas Formularit nr. 5 të plotësuar nga ana juaj janë në shumën 19,282,162 lekë, duke deklaruar më shumë shpenzime për blerje gjatë vitit, nga sa keni analizuar vetë. Për këtë diferencë në shumën 3,551,850 lekë, është kryer ri karakterizimi dhe janë përllogaritur detyrimet në shumën 649,456 lekë. Observacioni nuk pranohet.

3. Në lidhje me observacionin e inspektorit L.Ç.. Përsa i përket “blerjeve gjatë vitit”, si element i përllogaritjes së PASH, nga Grupi i auditimit janë mbledhur vlera e blerjeve importe “Lëndë e parë dhe mallra” në vlerën 164,343,776 lekë si dhe vlera e blerjeve “Mallra për rishitje dhe lëndë e parë vlerë të tatueshme” 14,146,963 (faqe 5 dhe 6 e RPK), në total 178,490,739 lekë. Gjithashtu në këtë pjesë të RPK, ju keni analizuar se shpenzime për mallra dhe lëndë të parë janë si më poshtë:

“Shoqëria për periudhën viti 2015 ka realizuar blerje nga furnitorë vendas me TVSH 20% me vlerë të tatueshme në shumën 14,513,567 lekë dhe TVSH të kreditueshme në shumën 2,902,713 lekë të cilat përbëhen nga:

- Shërbime doganor e tjera, vlerë të tatueshme 260,413 lekë dhe TVSH 52,084 lekë,
- Shpenzime mirëmbajtje etj., vlerë të tatueshme 106,191 lekë dhe TVSH 21,239 lekë,

-Mallra për rishitje dhe lëndë e parë vlerë të tatueshme 14,146,963 lekë dhe TVSH 2,829,390 lekë". Sa më sipër, (edhe vitet e tjera në analogji me 2015) observacioni juaj nuk pranohet.

4. Në lidhje me observacionin e inspektore P.D.. Referuar të dhënave të PF, dhe analizës së shpenzimeve për vitin 2019 të kryer nga ana juaj në RPK faqe 18-19, nuk keni analizuar asnjë shpenzim karburanti dhe aq më pak në këtë vlerë e cilësuar nga ana jonë si diferencë në deklarimin e KMSH sipas F5, PASH dhe FDP të TF. Observacioni juaj nuk pranohet.

Titulli i gjetjes 3: Mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, në lidhje me evidentimin e diferencave në inventarin e subjekteve tatimpagues.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se në dy raste, bazuar në të dhënat mbi gjendjen e inventarëve sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit dhe të dhënave në C@ts, kanë rezultuar diferenca në inventar. Konkretisht:

- Për subjektin tatimpagues "A.PH." në datë 31.12.2019 gjendja e inventarit në C@ts paraqitet në shumën 114,575,466 lekë, ndërsa gjendja e inventarit në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (2019) paraqitet në shumën 137,524,665 lekë, duke rezultuar me një diferencë në vlerën 22,949,199 lekë. Diferenca në gjendjen e inventarit, ka shërbyer si bazë e tatueshme për ri karakterizimin e situatës dhe përllogaritjen e detyrimeve si më poshtë:

Përshkrimi	Norma	Vlera
Baza e tatueshme		22,949,199
Tatim fitimi	15 %	3,442,380
Gjoba	21.9 %	753,881
TVSH	20 %	4,589,840
Gjobë vlerë e TVSH	21.9 %	1,005,175
Total detyrimi		9,791,276

- Për subjektin tatimpagues "A-2011" SHPK, në datë 31.12.2018 gjendja e inventarit në C@ts paraqitet në shumën 48,768,761 lekë, ndërsa gjendja e inventarit në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (2018) paraqitet në shumën 47,441,195 lekë, duke rezultuar me një diferencë në vlerën 1,327,566 lekë. Diferenca në gjendjen e inventarit ka shërbyer si bazë e tatueshme për ri karakterizimin e situatës dhe përllogaritjen e detyrimeve.

Përshkrimi	Norma	Vlera
Baza e tatueshme		1,327,566
Tatim fitimi	15 %	199,135
Gjoba	21.9 %	43,611
TVSH	20 %	265,513
Gjobë vlerë e TVSH	21.9 %	58,147
Total detyrimi		566,406

Ri karakterizimi është kryer bazuar në Ligjin nr. 9920/2008 me ndryshime neni 71 dhe 72, për shkelje referuar nenit 115, pika 1 të këtij ligji.

Kriteri: Ligji nr. 9920/2008 "Për procedurat Tatimore në RSH" me ndryshime; Ligji 8438/1998 "Për të ardhurat tatimore në RSH" me ndryshime; Manuali i Kontrollit Tatimor, Programi i kontrollit tatimor.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e analizave të duhura mbi pasqyrat financiare, llogaritë, gjendjet e tyre, ndryshimet nga një periudhë në tjetrën, është reflektuar në cilësinë e Raporteve Përfundimtare të Kontrollit si dhe vlerësimin real të detyrimeve të subjekteve tatimpaguese, të reflektuar në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Shkak: Mos zbatim i Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH” me ndryshime, kërkesave të detajuara të programit të kontrollit, Manualit të Kontrollit, si dhe e mosfunksionimit në mënyrën e duhur të stadeve të kontrollit, brenda Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT Shkodër.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregulsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht **në shumën 10,357,682 lekë, nga e cila penalitete 1,860,814 lekë.**

Titulli i gjetjes 4: **Mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, në lidhje me analizimin dhe evidentimin e shpenzimeve të panjohura, për efekt të vlerësimit të TVSH-së.**

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor në vend, nuk janë analizuar në mënyrën e duhur shpenzimet për efekt të kreditimit të TVSH (shpenzimet e panjohura).

- Në kontrollin e ushtruar në subjektin tatimpagues "A.B.07" SHPK, përlllogaritja e shpenzimeve të karburantit për shkak të njohjes së shpenzimeve për efekt të kreditimit të TVSH, nga inspektori i kontrollit, nuk është kryer në mënyrën e duhur, pasi sipas Udhëzimit nr. 6/2015 normativa për inertet është 33 % dhe për betonin është 14 %. Nga përlllogaritja referuar normativave dhe peshës specifike të dy produkteve, përqindja që duhej aplikuar është 23.2 %.

Si rezultat i mos aplikimit të përqindjes së duhur kundrejt shitjeve (beton dhe inerte), është kryer ri karakterizimi i situatës dhe janë kryer përlllogaritjet e detyrimeve.

Referuar të dhënave mbi shitjet e tatueshme dhe shpenzimeve për karburant, për periudhën 2017-2020, subjekti “A.B.07 2007”, ka shitur beton në vlerën 10,899 mijë lekë në vitin 2017, ku shpenzimi për karburant ka peshë specifike 49 % ndaj shitjeve të tatueshme, ndërsa në vitin 2018 ka shitur 2 herë më shumë se në vitin 2017, ndërsa shpenzimi për karburant është 32.8 % më pak se në vitin 2017; në vitin 2019 ka shitur 1.5 herë më shumë, ndërsa shpenzimi për karburant ndaj shitjeve të tatueshme është 67.7 % më pak se në vitin 2017 dhe në vitin 2020 ka shitur 1.9 herë më shumë, ndërsa shpenzimi për karburant është 81 % më pak se në vitin 2017.

Rillogaritja e detyrimeve:

Viti	Vlera e pa kreditueshme		
	DRT	KLSH	Diferenca
2017	3,969,920	6,390,641	2,420,721
2018	-	3,413,941	3,413,941

Viti	Ulje blerje e tatueshme	Ulje gjendje kreditore (TVSH)	Gjopa	Total detyrime	Rritje blerje të përjashtuara
------	-------------------------	-------------------------------	-------	----------------	-------------------------------

2017	2	3=2*20%	4=3*20%	5=3+4	6=2+3
DRT	3,969,920	793,984	158,796	952,781	4,763,904
KLSH	6,390,641	1,278,128	255,625	1,533,753	7,668,769
Diferenca	2,420,721	484,144	96,829	580,973	2,904,865
2018					
DRT	-	-	-	-	-
KLSH	3,413,941	682,788	136,557	819,345	4,096,729
Diferenca	3,413,941	682,788	136,557	819,345	4,096,729

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.6/2015, neni 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime”, Nga rivlerësimi i bërë në zbatim të Ligjit 9920/2008 neni 68 “Vlerësimi tatimor” dhe neni 115 “Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore”, pika 3, bazuar në përlllogaritjet e mësipërme detyrimi total rezulton në **shumën 1,400,317 lekë**.

Kriteri: Ligji nr. 9920/2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime; Ligji 8438/1998 “Për të ardhurat tatimore në RSH” me ndryshime; Manuali i Kontrollit Tatimor, Programi i kontrollit tatimor.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e analizave të duhura mbi pasqyrat financiare, llogaritë, gjendjet e tyre, ndryshimet nga një periudhë në tjetrën, është reflektuar në cilësinë e Raporteve Përfundimtare të Kontrollit si dhe vlerësimin real të detyrimeve të subjekteve tatimpaguese, të reflektuar në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mos zbatim i Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH” me ndryshime, kërkesave të detajuara të programit të kontrollit, Manualit të Kontrollit, si dhe e mosfunksionimit në mënyrën e duhur të stadeve të kontrollit, brenda Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT Shkodër.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht **në shumën 1,400,317 lekë, nga e cila penaliteti 233,386 lekë**.

Pretendimi i subjektit:

1. Në observacionin nr. 3313/64, datë 23.01.2023, nga Drejtori i kontrollit **A.H.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “P” SHPK, është sqaruar se: Në lidhje me shpenzimet e tjera në shumën 591,766 lekë, mbi të cilën janë bërë përlllogaritjet duke i konsideruar si shpenzime të panjohura që nuk i shërbejnë aktivitetit, rezulton se janë shpenzime për shërbime kontabiliteti, noter, mirëmbajtje pajisjesh fiskale etj. (bashkëngjitur lista analitike e faturave).

2. Në observacionin nr. 3313/53, datë 20.01.2023, nga inspektori i kontrollit **F.M.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “A.B.07” SHPK, është sqaruar se: Mbi kreditimin e TVSH ku theksohet se nga ana e inspektorit të kontrollit përlllogaritja e shpenzimeve të karburanteve për shkak të përjashtimit të zbritjes së TVSH-së nuk është llogaritur në mënyrën e duhur sipas Udhëzimit nr.6/2015 ku normativat për inertet është 33% dhe për betonin 14% (referencë ligjore neni nr.55 “kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime ku theksohet normativat e përdorimit të gazoilit sipas veprimtarive përcaktohet 1- Ndërtim-a) prodhim material inerte deri 33 % dhe ç) prodhim betoni deri 14 % .

Në faqe nr.2 të aktkontrollit të mbajtur në datë 25.10.2021 theksohet se lloji i veprimtarisë për periudhat e kontrolluara ka qenë: “Prodhimi, përpunimi dhe shitja e materialeve inerte dhe ndërtimi si dhe cituar se” në fakt nga kontrolli i dokumentacionit për gjithë periudhat e kontrolluara objekt i vetëm i aktivitetit ekonomik i kësaj shoqërie ka qenë prodhimi përpunimi dhe shitja e inerteve si granile, rërë, çakull lumi dhe stabilizant si dhe shitje produkt betone të tipeve të ndryshme subjekteve ndërtuese nga inertet e prodhuar nga ky subjekt .”

Nisur nga objekti i veprimtarisë subjekti zotëron Leje Mjedisore nr.2191 datë 05.04.2016 nga Ministria e Mjedisit ku theksohet se subjektit në fjalë i jepet leja për nxjerrjen e mineralit, rërës dhe argjilës me shfrytëzim në qiell të hapur dhe gurore në vendndodhjen: zonë minerare nr.441/2, Kosmaç, Bushat-Vau i Dejes. Leje mjedisore e tipit B “Për përzierjen e çimentos dhe përdorimin e saj në sasi të madhe”. - Leje shfrytëzimi për materialin zhurë së bashku me Akt miratimin nr.1800 datë 10.05.2016, bazuar në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në R.SH.” i ndryshuar, referuar sa më sipër shoqëria ka përgjegjësinë mbi rentën minerare dhe kontrolli përfshin dhe detyrimet nga Taksa e Rentës Minerare. Ky kontroll bëhet në referencë të Ligjit nr.9975 datë 28.07.2008 “Për Taksat Kombëtare” i ndryshuar. Gjithashtu kontrolli si bazë ligjore ka dhe vendim nr.7, datë 04.01.2012 “për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare” i ndryshuar si dhe udhëzim nr.26, datë 04.09.2008 për taksat kombëtare i ndryshuar.

Nga kontrolli i dokumentacionit origjinal dhe të dhënat e vetë deklaruara dhe të gjeneruara në sistemin C@ts tek Deklaratat e Taksës së Rentës Minerare rezulton se për periudhat tatimore 2017/01 deri 2021/07 subjekti kishte vetë llogaritur dhe kryer pagesat e kësaj takse në referencë të ligjeve sa më sipër Shoqëria zotëronte evidencat e detajuara të pagesave të rentës minerare sipas zërave (rërë, zhavor, mikse dhe stabilizant) të dorëzuara çdo tremujor pranë DRT Shkodër dhe institucione të tjera përkatëse. Po kështu subjekti zotëronte dhe lejet nga Dikasteret përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave për të cilat kishte bërë pagesat e taksave dhe tarifave. Nga kontrolli rezulton se subjekti ka llogaritur dhe kryer pagesa përmes sistemit bankar për Rentën minerare. Për periudhat e kontrolluara të dhënat mbi pagesat e rentës minerare jepen sipas pasqyrës:

Pra nisur nga sa më sipër dhe nga kontrolli i dokumentacionit rezulton se për të gjithë periudhat e kontrolluara objekt i vetëm i aktivitetit ekonomik i kësaj shoqërie ka qenë: prodhimi dhe përpunimi i inerteve si granile, rërë, çakull lumi dhe stabilizant”.

Theksoj se një pjesë nga prodhimi dhe përpunimi i inerteve është bërë shitje subjekteve juridike si granile, rërë, çakull lumi dhe stabilizant si dhe një pjesë e tyre nga inertet e prodhuara si granile, rërë, çakull lumi dhe stabilizant është bërë shitje si produkt betone të tipeve të ndryshme të përpunuara nga vetë subjekti. Janë këto arsytet që subjekti për blerje karburanti duhet të veprojë në referencë të nenit nr.74 të Ligjit nr.92/2014 (kufizimet e të drejtës së zbritjes të TVSH) germa a/ii ku thekson se: Përrjashtohen nga e drejta e zbritjes së TVSH-së shpenzimet për blerjen, importin e mallrave, shpenzimet për shërbimet si: shpenzimet e karburantit, përveç rastit kur karburanti i blerë është përdorur për nevoja teknologjike në funksion të arritjes së qëllimit primar të biznesit si dhe neni nr.5 pika 1 germa a e Udhëzimit nr.6 në shërbim të këtij ligji ku theksohet se lejohet kreditimi i TVSH për blerje karburanti për subjektet me aktivitet prodhim materiale inerte deri më 33% të qarkullimit total. Për shkeljet e vërejtura, sipas Udhëzimit nr.6/2015 normativat për betonin 14% (referencë ligjore neni 55 “kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime ku theksohet normativat e përdorimit të gazoilit sipas veprimtarive përcaktohet 1-Ndërtim-ç) prodhim betoni deri 14 % - është e vlefshme për subjektet të cilat nuk i prodhojnë vetë inertet si granile, rërë, çakull lumi dhe stabilizant për prodhim betoni por i blejnë nga furnitorë prodhues të inerteve siç është subjekti “A.B.07 07” e subjekte të tjera prodhuese.

Theksoj se grupi i auditimit shpenzimet për karburante për efekte të kreditimit të TVSH sipas akt konstatimit për pjesën e prodhimit të betonit të përpunuar nga inertet e prodhuara nga subjekti dhe jo të blera nga furnitorë të tjerë duhet ti kishte kryer llogaritjet me 33% dhe jo me 14%. Në faqen 8-9 e aktkontrollit citoj se “Nga dokumentacioni rezulton se subjekti për blerje karburanti nuk kishte vepruar në referencë të nenit 74 ligji 92/2014 (kufizimet e të drejtës së zbritjes të TVSH) germa a/ii ku thekson se: Përrjashtohen nga e drejta e zbritjes së TVSH-së shpenzimet për blerjen, importin e mallrave, shpenzimet për shërbimet si: shpenzimet e karburantit, përveç rastit kur karburanti i blerë është përdorur për nevoja teknologjike në funksion të arritjes së qëllimit primar të biznesit si dhe neni 55 pika 1 germa a e Udhëzimit nr.6 në shërbim të këtij ligji ku theksohet se lejohet kreditimi i TVSH për blerje karburanti për subjektet me aktivitet prodhim materiale inerte deri më 33%; të qarkullimit total. Nga të dhënat e subjektit për periudhat e kontrolluara të vitit 2017 blerje karburante zë 49.1 % $(12,121,797 / 24,702,657 * 100 \%)$ e totalit të të ardhurave. Karburanti i blerë është përdorur për nevoja teknologjike në funksion të arritjes së qëllimit primar të biznesit. Sipas referencave sa më sipër vlera e blerjeve të karburanteve e njohur si e kreditueshme për vitin 2017 duhet të jetë $24,702,657 \times 33\% = 8,151,877$ lekë dhe TVSH 1,630,375 lekë. Vlera e karburantit që nuk njihet e kreditueshme është 3,969,920 lekë $(12,121,797 - 8,151,877)$ dhe TVSH prej 793,984 lekë. Nga rivlerësimet e bëra në referencë neni nr.68 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar këto blerje gazoili regjistrohen si blerje e përjashtuar dhe bazuar në nenin 115 pika 3, të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, subjekti përveç detyrimit të TVSH duhet të paguajë gjobë. Të gjitha sa më sipër jepen sipas kësaj pasqyre:

dhe në faqen 28-29 citoj nga të dhënat e subjektit për periudhat e kontrolluara blerje karburante zë 34.73% e totalit të të ardhurave. Karburanti i blerë është përdorur për nevoja teknologjike në funksion të arritjes së qëllimit primar të biznesit.

Sipas referencave sa më sipër vlera e blerjeve të karburanteve e njohur si e kreditueshme duhet të jetë $18,932,629 \times 33\% = 6,247,767$ lekë dhe TVSH 1,249,553 lekë. Vlera e karburantit që nuk njihet e kreditueshme është 327,948 lekë $(6,575,715 - 6,247,767)$ dhe TVSH prej 65,590 lekë. Nga rivlerësimet e bëra në referencë neni 68 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar këto blerje gazoili në periudhën tatimore 2021/07 regjistrohet si blerje e përjashtuar dhe bazuar në nenin 115 pika 3, të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH” i ndryshuar, subjekti përveç detyrimit të TVSH duhet të paguajë gjobë. Të gjitha sa më sipër jepen sipas kësaj pasqyre:

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1. Mbi observacionin e bërë nga Drejtori i Kontrollit A.H., subjekti “P” SHPK. Nga shqyrtimi i observacionit dhe dokumentacionit bashkëngjitur, ka rezultuar se vërtetojnë pretendimin e subjektit të audituar. Observacioni merret në konsideratë dhe është reflektuar në RPA.

2. Mbi observacionin e bërë nga inspektori i kontrollit F.M., subjekti “A.B.07” SHPK. Nga Grupi i auditimit u shqyrtuan argumentet e mësipërme, duke ri parë edhe njëherë referencat ligjore të cilësuar si Ligjit 92/2014, neni 74; Udhëzimi nr. 6/2015 neni 55, (të cilësuar si referenca ligjore/kritere vlerësimi edhe nga Grupi i auditimit në trajtimin e kësaj shkelje) dhe nuk rezulton një përcaktim mbi normën e pranueshme të shpenzimeve të karburantit nëse inertet e përdorura në prodhimin e betonit janë (blerje apo prodhim nga vetë subjekti). Shtuar këtu edhe faktin që nga ana juaj nuk është kryer asnjë analizë paraprakisht mbi aktivitetin e prodhues të këtij subjekti referuar kartave teknologjike, me qëllim që të identifikoni sasi të inerteve të prodhuara, shitura apo të futura në prodhim. Observacioni juaj nuk pranohet.

Titulli i gjetjes 5: **Mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, në lidhje me mos pasqyrimin e flukseve monetare dhe mos rakordimin e tyre në fund të vitit ushtrimor me gjendjen e aktiveve monetare në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.**

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, në kontrollin e ushtruar në subjektin tatimpagues "S.A." SHPK, nga inspektori i kontrollit tatimor, nuk është analizuar fakti që në Pasqyrën e flukseve monetare, nuk është paraqitur në vitin ushtrimor 2019 shuma 18,334,540 lekë dhe në vitin ushtrimor 2020 shuma 24,732,964 lekë, si hua të arkëtuara në seksionin e flukseve monetare nga/përdoruar në aktivitetin e financimit. Mosparaqitja e këtyre shumave ka impaktuar mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fund të periudhave ushtrimore, vlerë e cila duhet të jetë e barabartë me mjetet monetare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Për rrjedhojë aktivet janë paraqitur me pak për shumat respektive 18,334,540 lekë në vitin 2019 dhe 24,732,964 për vitin 2020, Këto diferenca kanë shërbyer për ri karakterizimin e situatës dhe përllogaritjen e detyrimeve, referuar Ligjit 9920/2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 71 "E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi", germa (b); nenin 72 "Baza e mënyrave alternative të vlerësimit". Përllogaritjet e detyrimeve dhe gjobat në shumën 4,522,422 lekë, janë kryer në zbatim të nenit 115 "*Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore*", pika 1

Përshkrimi	Viti 2016
Baza e tatueshme	24,732,964
Tatim fitimi (15%)	3,709,945
Gjobë 0.06 %* 365	812,478
Total detyrime sipas viteve	4,522,422

Kriteri: Ligji nr. 9920/2008 "Për procedurat Tatimore në RSH" me ndryshime; Ligji 8438/1998 "Për të ardhurat tatimore në RSH" me ndryshime; Manuali i Kontrollit Tatimor, Programi i kontrollit tatimor dhe "Ligji për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e analizave të duhura mbi pasqyrat financiare, llogaritë, gjendjet e tyre, ndryshimet nga një periudhë në tjetrën, është reflektuar në cilësinë e Raporteve Përfundimtare të Kontrollit si dhe vlerësimin real të detyrimeve të subjekteve tatimpaguese, të reflektuar në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mos zbatim i Ligjit 9920/2008 "Për procedurat tatimore në RSH" me ndryshime, kërkesave të detajuara të programit të kontrollit, Manualit të Kontrollit, si dhe e mosfunksionimit në mënyrën e duhur të stadeve të kontrollit, brenda Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT Shkodër.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorin e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjes përkatëse të kontrolluar prej tij, nga auditimi i të cilës janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 "Ri kontrolli tatimor" të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht në shumën 4,522,422 lekë, nga e cila penaliteti 812,478 lekë.

Titulli i gjetjes 6: Mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, në lidhje me pa saktësitë e evidentuara në pasqyrimin e llogarive "Të drejta të arkëtueshme/Klientë" dhe "Detyrime afatshkurtra/Furnitorë".

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se në tre raste, në kontrollin e ushtruar në subjektet tatimpaguese "P.GJ." SHPK, "G-2012" SHPK dhe "A-2011" SHPK, nga inspektorët e kontrollit tatimor, nuk janë analizuar llogaritë "Të drejta të arkëtueshme/Klientë" dhe "Detyrime afatshkurtra/Furnitorë", në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor dhe programeve të kontrollit.

- Nga analiza furnitorë-klientë, për subjektin "L.G." PF është evidentuar se, subjekti "P.GJ." me NIPT-X, rezulton se ka kryer blerje tek subjekti "L.G." në shumën 2,147,015 lekë, të cilën e ka paraqitur si detyrim afatshkurtër "furnitorë" ndërsa subjekti "L.G." nuk e ka përfshirë në analizën e llogarisë "klientë" dhe në të drejtat e arkëtueshme, për shkak se transaksionet janë kryer me pagesa cash/kasë fiskale dhe të regjistruara në librat e shitjes. Klientët për vitin 2019 në mënyrë analitike të paraqitura nga vetë subjekti, rezultojnë si më poshtë:

Nr.	Klientë	Shuma
1	F	2,613,802
2	B	630,131
3	I	4,684,056
4	C	(600,000)
5	Totali	7,327,989
6	Aktivi (Të drejta të arkëtueshme)	7,327,989
7	Klient "P.GJ."	0
8	Furnitor "L.G."	2,147,015

Nga analiza e llogarisë analitike të "Furnitorëve" të subjektit "P.GJ." rezulton se ka detyrime kundrejt subjektit "L.G." në shumën 2,147,015 lekë, duke rënduar në këtë mënyrë pasivin e bilancit. Sa më sipër është kryer ri karakterizimi i situatës dhe përlllogaritjet e detyrimeve të subjektit "P.GJ." SHPK si më poshtë:

Përshkrimi	Norma	Vlera
Baza e tatueshme		2,147,015
Tatim fitimi	15 %	322,052
Gjoba	21.9 %	70,529
TVSH	20 %	429,403
Gjobë vlerë e TVSH	21.9 %	94,039
Total detyrimi		916,023

- Nga analiza furnitorë-klientë me subjektin "A" SHPK, ka rezultuar se, subjekti "G-2012" paraqet në vitin 2014 në "Të drejta të arkëtueshme/klientë" në shumën 274,979,591 lekë, ndërsa në Pasqyrat Financiare të subjektit "A" SHPK, në llogarinë "Të pagueshme/ furnitorë" paraqitet në shumën 232,187,646 lekë, me një diferencë në shumën 42,791,945 lekë, të cilat përfaqësojnë shitje të deklaruara të "G-2012" kundrejt subjektit "A" SHPK, shtuar këtij faktin që dy shoqëritë kanë të njëjtin pronar.

Aktivi (Të drejta të arkëtueshme) "G-2012"	274,979,591 lekë
Pasivi (Të pagueshme/Furnitor) "A"	232,187,646 lekë
Diferenca	42,791,945 lekë

Për shitjet (të ardhura) e padeklaruara në shumën 42,791,945 lekë, do të kryhet ri karakterizimi si më poshtë:

Përshkrimi	Norma	Vlera
Baza e tatueshme		42,791,945
Tatim fitimi	15 %	6,418,792
Gjoha	21.9 %	1,405,715
TVSH	20 %	8,558,389
Gjobë vlerë e TVSH	21.9 %	1,874,287
Total detyrimi		18,257,184

- Nga auditimi i subjektit “P.GJ.” me NIPT-X, rezulton se ka kryer blerje tek subjekti “A-2011” në shumën 1,130,314 lekë, të cilën e ka paraqitur si detyrim afatshkurtër “furnitorë” ndërsa subjekti “A-2011” nuk e ka përfshirë në analizën e llogarisë klientë dhe në të drejtat e arkëtueshme, të cilat për vitin 2019 paraqiten në vlerën 325,600 lekë.

Klient “P.GJ.” 0 lekë

Furnitor “A-2011” 1,130,314 lekë

Për shitjet (të ardhura) e padeklaruara në shumën 1,130,314 lekë, do të kryhet rivlerësimi si më poshtë:

Përshkrimi	Norma	Vlera
Baza e tatueshme		1,130,314
Tatim fitimi	15 %	169,547
Gjoha	21.9 %	37,131
TVSH	20 %	226,063
Gjobë vlerë e TVSH	21.9 %	49,508
Total detyrimi		482,248

Kriteri: Ligji nr. 9920/2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime; Ligji 8438/1998 “Për të ardhurat tatimore në RSH” me ndryshime; Manuali i Kontrollit Tatimor, Programi i kontrollit tatimor.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e analizave të duhura mbi pasqyrat financiare, llogaritë, gjendjet e tyre, ndryshimet nga një periudhë në tjetrën, është reflektuar në cilësinë e Raporteve Përfundimtare të Kontrollit si dhe vlerësimin real të detyrimeve të subjekteve tatimpaguese, të reflektuar në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mos zbatim i Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH” me ndryshime, kërkesave të detajuara të programit të kontrollit, Manualit të Kontrollit, si dhe e mosfunksionimit në mënyrën e duhur të stadeve të kontrollit, brenda Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT Shkodër.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht në shumën 19,655,455 lekë, nga e cila penalitetet 3,531,209 lekë.

Pretendimi i subjektit:

1. Në observacionin nr. 3313/60, datë 23.01.2023, nga inspektori i kontrollit **G.B.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “L.G.”, ka sqaruar: Subjekti “L.G.” për periudhën e kontrolluar nga ana ime të gjitha faturat e lëshura ndaj subjektit “P.GJ.” janë fatura me kupon fiskal nga kasa fiskale me likuidim me lek në dorë, kjo e relatuar edhe në librat e shitjes

respektive, pasi edhe vlerat e tyre janë dukshëm të ulëta në vlerë gjatë vitit 2019 që fillon nga fatura e parë lëshuar me datën 04.01.2019 me vlerë 34,677 lekë deri në faturën e fundit me nr. 11116 datë 30.12.2019 me vlerë 14,400 lekë. Bashkëngjisim në këtë observacion pasqyrën me veprimet kontabël me të gjithë kuponat e shitjes ndaj subjektit P.GJ., ku në fund detyrimi i tij ndaj subjektit L.G. rezulton zero. Shitjet e bëra ndaj subjektit Prelë Gjoni në vlerën prej 2,176,522 lekë, janë arkëtuar në vend. Sa më sipër subjekti blerës P.GJ. mund të ketë bërë lapsus në plotësimin e pasqyrës së tij të furnitorit për vitin 2019. Pra ndaj subjektit L.G. nga ana ime me të drejtë nuk i është llogaritur detyrim shtesë, për këtë çështje të trajtuar nga ana juaj ne piken 3 fleta 29-31 të projekt raportit. Bashkëngjitur Kartelat e klientit, me analizat e likuiditeteve mes palëve.

2. Në observacionin nr. 3313/54, datë 23.01.2023, nga inspektori i kontrollit L.Ç., mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “G-2012” SHPK, ka sqaruar: Në lidhje me llogarinë e aktiveve (të drejta të arkëtueshme) në pasqyrat financiare të vitit 2014 të cilat janë realizuar analitik në akt-kontroll, për subjektin “G-2012” ndaj subjektit “A” SHPK në shumën 274,979,591 lekë. Detyra e grupit të kontrollit është të zbatojë pikat e program kontrollit në lidhje me verifikimin e llogarive të tatimpaguesit nga e cila është verifikuar kartela e marrëdhënies me tatimpaguesin “A” SHPK si më poshtë:

Çelje 01.01.2014	shtesa (shitur) viti 2014	pakësime (likuidime) viti 2014	Gjendje 31.12.2014
81,074,409	296,053,991	21,074,400	274,979,591

Bashkëngjitur kartela e klientit të “G-2012” për vitin 2014, me subjektin “A” SHPK. Shuma gjendje janë të faturuara, pra të deklaruar shite dhe të pa likuiduara, të cilat përkojnë saktësisht me të dhënat e kontabilitetit të relatuar në bilancin e vitit 2014, të subjektit “G-2012”. Pra për tatimpaguesin “G-2012”, nuk rezultojnë diferenca në llogarinë klientë për vitin 2014, e cila ka qenë detyrë sipas program kontrollit. Nuk ka qenë pjesë e këtij program kontrolli verifikimi i llogarive të një subjekti me NIPT tjetër siç është rasti për “A” SHPK, pasi del jashtë programit të kontrollit. **Pas konstatimit Tuaj, u verifikua në sistem për tatimpaguesin “A” SHPK tek rubrikat bilancet.** Ku rezultoi se në versionin e tretë PDF përfundimtar të bilancit 2014, vlera e furnitorit analitik të AT nga “G-2012” ishte e relatuar në vlerën 273,801,252 lekë.

Bashkëngjitur për vitin 2014, furnitori analitik gjendje 31.12.2014 i “A” SHPK, të printuara nga versioni i fundit PDF në sistemin C@ts.

Pra verifikohet lehtë **se kemi një gabim nga “A” SHPK** në deklarinë e gjendjes së furnitorit analitik në bilancin e vitit 2014, nga versioni excel në atë PDF, të cilin nuk ka qenë detyrë e grupit të kontrollit, ta kontrollojë “A” SHPK, pasi del jashtë detyrave të program kontrollit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1. Mbi observacionin e bërë nga Inspektori G.B., subjekti “L.G.” SHPK.

Nga ana e subjektit është argumentuar ligjërisht, si dhe është paraqitur informacion dhe dokumentacion shtesë mbi subjektin tatimpagues. Observacioni i mësipërm është marrë në konsideratë dhe është reflektuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Në lidhje me pasaktësinë e plotësimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2019 nga ana e subjektit “P.GJ.”, i cili ka paraqitur në pasiv “Detyrime afatshkurtra/Furnitorë”, vlerën 2,176,522 lekë më shumë kundrejt subjektit “L.G.”, subjekt me të cilin ka operuar me pagesa cash/kasë fiskale, është rishqyrtuar RPK i subjektit “P.GJ.”, ku ka rezultuar se nga ana e tij në analitikun e Furnitorëve është cilësuar se ka detyrime kundrejt subjektit “L.G.”, në shumën 2,176,522 lekë. Në bazë të Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, neni 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, duhet të aplikohet kundrejt kësaj shumë TF, TVSH dhe gjoba përkatëse, të cilat u reflektuan në RPA, si detyrim kundrejt subjektit “P.GJ.” SHPK.

2. Në lidhje me observacionin e mësipërm nga Grupi i auditimit është evidentuar fakti që në RPK, nuk është kryer një analizë e gjendjes së lartë të llogarisë “Të drejta të arkëtueshme “G-

2012” në raport me “Detyrime afatshkurtra-A”, gjë e cila është kërkesë e Manualit të Kontrollit për kryerjen e kontrollit tatimor, ku:

në pikën 2.8 “Vlerësimet paraprake të tatimpaguesit”, germa (e) “Shqyrtim paraprak analitik”, ju kërkohet: **“Kontrolli që bën një analizë në formë analitike të detajuar analizon thellë marrëdhëniet (lidhjet) midis zërave të ndryshëm të të dhënave dhe pastaj kryerjen e investigimit për ndryshime, diferenca të papritura që identifikohen me anë të analizave dhe krahasimeve”;**

në pikën 2.9 “Përdorimi i burimeve të informacionit”, pika 2.9.2 “Informacione specifike nga drejtori të tjera tatimore”, ku cilësohet: “Drejtori të tjera tatimore rajonale mund të dërgojnë kërkesa për **verifikimin e transaksioneve të tjera rutinë bazuar në kushtin që shitjet e një personi të jenë blerje të personit tjetër**. Përveç kësaj, një kontroll që ushtrohet në një biznes të një drejtori rajonale tatimore të një zone, shpesh hedh dyshime për klientët apo furnizuesit e atij biznesi, për të cilët nga ana e tyre kërkohen referenca (kërkesa) specifike për t’u vërtetuar”, aq më tepër për subjekte të cilat operojnë në të njëjtën DRT.

në pikën 2.10. “Analiza e normave (raporteve)”, pika 2.10.3 “Subjekte furnizuese dhe klientët”, ku cilësohet: **“Shitjet ju bëhen klientëve dhe blerjet kryhen prej furnizuesve. Të pyeturit në mënyrë direkte të furnizuesve dhe klientëve mund të zbulojnë diferenca edhe në transaksionet e deklaruar më parë dhe ato aktuale”, etj.**

Gjithashtu, referuar dokumentacionit bashkëngjitur keni dërguar listën analitike të llogarisë “Detyrime afatshkurtra” të subjektit “A” SHPK, ku pretendoni diferenca e konstatuar nga Grupi i auditimit, në fakt është një lapsus i bërë nga “A” SHPK, dhe jo nga “G-2012” SHPK. Nga verifikimi i listës analitike të furnitorëve të “A” SHPK më datë 31.12.2014 ka rezultuar se ka mospërputhje midis vlerës së furnitorëve të brendshëm dhe të jashtëm (lekë/valutë) me totalin e paraqitur në PF (318,492,970 lekë). Konkretisht nëse do të verifikoni totalet e paraqitura të analitikut të furnitorëve të “A” SHPK (dokumenti i mëposhtëm) rezulton:

	Furnitorë A analitik	A PF	G-2012	
	(1)	(2)	(3)	(4 = 2-3)
Furnitorë të brendshëm	317,794,233			
G-2012	273,801,252	232,187,646	274,979,591	42,791,945
Furnitorë të jashtëm	41,893,367			
Furnitorë të jashtëm	418,976			
Totali sipas pasqyrës	318,492,970			
Totali sipas pasqyrës i korrigjuar	360,106,571	232,187,646	274,979,591	42,791,945
Diferenca	41,613,601			

Arësi dhe Forma ligjore ARSENI SHPK
K67015001V
Gjendje e furnitoreve me 31.12.2014

pershkrim	fund	
Lek Shqiptar		
GENCLAUDIS SH.A	7,566,562.00	L
VODAFONE ALBANIA SH.A	29,270.87	L
"ATEARJO" SHPK	681,168.89	L
MESSER ALBAGAZ SHPK	1,282,200.89	L
B.B.I.GROUP	703,600.00	L
ELLEDI SHPK	3,486,134.00	L
GAMMA 2012 SHPK	273,801,302.21	L
CAD PRINT	723,001.00	L
ALBAKONTROLL SHPK	40,833.98	L
LIJANI A	132,400.00	L
TEL DE	19,867,008.88	L
SCAN SH.A	1,398,180.00	L
TOP CHANNEL	14,133,000.00	L
EDIPACK SH.A	1,042,542.84	L
	317,794,233.07	
Euro		
N.T.P.ESAROM KOSOVA	12,950.40	E
	1,607,862.05	
AKRAS FLAVOUR GMBH	42,645.00	E
	5,976,410.44	
DESTILERIJA ZARICKOSJERIC	7,000.00	E
	980,980.00	
PRIMAR TEKNO	232,573.00	E
	32,682,700.22	
Rivleresim valute dt. 31/12/2014	1,420.00	E
	188,998.80	
PACKER KFT	2,400.00	E
	336,336.00	
	279,760.91	
	41,893,387.52	
USD		
PRUTARDOM LTD	3,636.00	S
	418,976.28	
	3,636.00	
	418,976.28	
Total	318,492,970.26	

Hartuesi i Pasqyrave Financiare Administratori

ARSENI SH.P.K.
IMPORT - EXPORT
SUPERSTRAZA SHKRODITJE
RADI - BELIT 8000

Sa më sipër diferenca e evidentuar nga Grupi i auditimit qëndron, si dhe të dy subjektet janë palë të lidhura, duke patur në konsideratë faktin që kanë të njëjtin ortak të vetëm, gjë e cila nuk është evidentuar nga ana juaj si një faktor risku. Observacioni nuk pranohet.

Titulli i gjetjes 7: Mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, në lidhje me pa saktësitë e evidentuara në pasqyrimin e llogarive "Të drejta të arkëtueshme/Klientë" dhe "Detyrime afatshkurtra/Furnitorë", të subjektit tatimpagues "A.B.07"

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, sipas analizimit të detyrimeve afatshkurtra "Furnitorë", të subjektit tatimpagues "A.B.07", në shumicën e rasteve detyrimet kundrejt furnitorëve janë të pa ndryshuara nga viti në vit. Më i dukshëm ky fenomen rezulton në 13 raste të furnitorëve, që zënë mbi 90 % të totalit të detyrimeve afatshkurtra. Nga analiza e historikut të këtyre furnitorëve rezulton se, tatimpaguesi "A.B.07", ka detyrime permanente, të pandryshuara në 4 (katër) vite ushtrimore, të analizuar, ndaj 13 subjekteve, të cilat kanë tejkaluar afatin e detyrimeve afatshkurtra, referuar SNK 1 "Detyrimet afatshkurtra", paragrafi 69.

Sipas kryqëzimit të të dhënave të deklaruara (të mundshme për tre rastet e mëposhtme) në C@TS, (Libra blerje/A.B.07 dhe Libra Shitje/A.B.072006, si dhe Libra blerje A.B.07 në raport me subjektet "F.I" dhe "B.E") nuk ka asnjë blerje të deklaruar tek këta subjekte/furnitorë, të detajuar si më poshtë:

Furnitorë A.B.07	Detyrime afatshkurtra (pasivi) A.B.07	Libra blerje A.B.07 (C@ts)	Diferenca
A-2006	21,219,708	0	21,219,708
F.I.	3,905,660	0	3,905,660
B.E.	4,119,177	0	4,119,177
Totali			29,244,545

Në lidhje me tre subjektet A-2006, F.I. dhe B.E., subjekti “A.B.07”, nuk ka deklaruar asnjë faturë blerje në librat e saj, për rrjedhojë është kryer ri karakterizimi i situatës dhe përllogaritjet e detyrimit si më poshtë:

Subjektet	Sipas librit të blerjeve të A.B.07 07	Furnitorë sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar
	Përshkrimi	Viti 2017
A-2006	0	21,219,708
F.I.	0	3,905,660
B.E.	0	4,119,177
Diferenca	0	29,244,545
	Përllogaritja e detyrimeve	
Detyrimi/principali		29,244,545
Norma e fitimit	5.9; 4.1; 4.3dhe 4.1	1,725,428
Shuma/baza e tatueshme		30,969,973
Tatim fitimi	15 %	4,645,496
Gjoha	100 %	4,645,496
TVSH	20 %	6,193,995
Gjoha	100 %	6,193,995
Detyrimi total		21,678,982

Subjekti tatimpagues “A.B.07”, nuk ka dokumentuar TVSH në blerje, për faktin se nuk ka dokumentacion “Faturë blerje të regjistruar në librat e blerjes”, sipas verifikimeve në C@ts, për rrjedhojë është në shkelje të Udhëzimit nr. 6, neni 54 “Kriteret formale për ushtrimin e së drejtës së zbritjes së TVSH-së” pika 1.

Gjithashtu, veprimet e mësipërme, të cilat rezultojnë me dhënien e informacioneve joreale, deklarimeve të pavërteta, përbëjnë evazion fiskal referuar Ligjit 9920/2008 me ndryshime, neni 116 “Evazion fiskal”. Deklarimi i pasaktë i detyrimeve afatshkurtra në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar dhe i pasqyrimit të shpenzimeve të pa justifikuar me dokumentacion (blerje materiale, lëndë të para, etj.) në Pasqyrën e Performancës Financiare, ndikon drejtpërsëdrejti në llogarinë “Fitim apo humbje nga veprimtaria e shfrytëzimit” (të ardhura-shpenzime) dhe për pasojë në përllogaritjen dhe deklarimin e TF.

Kriteri: Ligji nr. 9920/2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime; Ligji 8438/1998 “Për të ardhurat tatimore në RSH” me ndryshime; Manuali i Kontrollit Tatimor, Programi i kontrollit tatimor.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e analizave të duhura mbi pasqyrat financiare, llogaritë, gjendjet e tyre, ndryshimet nga një periudhë në tjetrën, është reflektuar në cilësinë e Raporteve Përfundimtare të Kontrollit si dhe vlerësimin real të detyrimeve të subjekteve tatimpaguese, të reflektuar në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mos zbatim i Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH” me ndryshime, kërkesave të detajuara të programit të kontrollit, Manualit të Kontrollit, si dhe e mosfunksionimit në mënyrën e duhur të stadeve të kontrollit, brenda Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT Shkodër.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me

kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht **në shumën 21,678,982 lekë, nga e cila penaliteti 10,839,491 lekë.**

Pretendimi i subjektit:

1. Në observacionin nr. 3313/53, datë 20.01.2023, nga inspektori i kontrollit **F.M.**, mbi kontrollin e ushtruar në subjektin “A.B.07” SHPK, ka sqaruar: Mbi analizën “detyrimeve afatshkurtra”, llogaria furnitorë.

Më duhet të sqaroj se kjo llogari është trajtuar nga inspektori në mënyrë analitike tek faqet 36-37,43,50 dhe 57 e Raport kontrolli paraprak (gjithsej 70 faqe) dhe është llogaritur në referencë ligjore të Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat” i ndryshuar).

Sipas Akt-konstatimit nga verifikimi i librave të blerjeve të subjektit “A.B.07” SHPK për të gjitha periudhat e kontrolluara 2017/01-2021/07 nuk ka blerje me furnitorët sa më poshtë:

Kam theksuar në Akt-kontroll se tre subjektet furnitorë të mësipërm janë furnitorë të pa likuiduar në çelje të vitit 2017 dhe përfaqësojnë vlerën e tyre të mbartur nga vitet e tjera deri me 31.12.2016 të cilat janë kontrolluar nga inspektorë të tjerë të kontrollit. Këta furnitorë nuk janë objekt kontrolli nga ana ime si inspektor pasi objekt kontrolli për Tatim-fitimin janë vitet 2017, 2018, 2019 dhe 2020. Gjithashtu subjekti sipas dokumentacionit rezulton se nuk ka patur nga këta furnitorë asnjë blerje për periudhat tatimore të kontrolluara nga 2017/01 deri 2021/07. Këta furnitorë të mbartur nga vitet para 2017 vazhdojnë të qëndrojnë furnitorë gjendje në listën analitike të furnitorëve çdo vit si furnitorë të pa likuiduar deri në momentin e likuidimit të tyre nga subjekti ose të mbarimit të procedurave ligjore. Nga sa më sipër rezulton se për këto subjekte nuk lind asnjë detyrim fiskal për asnjë vit tatimor dhe aq më tepër që për të njëjtën vlerë që mbartet në kontabilitet deri në momentin e shlyerjes së tyre këto detyrime fiskale të llogariten çdo vit.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

1. Mbi observacionin e bërë nga Inspektori F.M., subjekti “A.B.07” SHPK.

Në lidhje me observacionin e mësipërm nga Grupi i auditimit është evdidentuar fakti që në RPK, nuk është kryer një analizë e gjendjes së lartë të llogarisë “Detyrime afatshkurtra-furnitorë”, gjë e cila është kërkesë e Manualit të Kontrollit për kryerjen e kontrollit tatimor, ku: në pikën 2.8 “Vlerësimet paraprake të tatimpaguesit”, germa (e) “Shqyrtim paraprak analitik”, ju kërkohet: **“Kontrolli që bën një analizë në formë analitike të detajuar analizon thellë marrëdhëniet (lidhjet) midis zërave të ndryshëm të të dhënave dhe pastaj kryerjen e investigimit për ndryshime, diferenca të papritura që identifikohen me anë të analizave dhe krahasimeve”;**

në pikën 2.9 “Përdorimi i burimeve të informacionit”, pika 2.9.2 “Informacione specifike nga drejtori të tjera tatimore”, ku cilësohet: “Drejtori të tjera tatimore rajonale mund të dërgojnë kërkesa për **verifikimin e transaksioneve të tjera rutinë bazuar në kushtin që shitjet e një personi të jenë blerje të personit tjetër.** Përvëç kësaj, një kontroll që ushtrohet në një biznes të një drejtori rajonale tatimore të një zone, shpesh hedh dyshime për klientët apo furnizuesit e atij biznesi, për të cilët nga ana e tyre kërkohen referenca (kerkesa) specifike për t’u vërtetuar”, aq më tepër për subjekte të cilat operojnë në të njëjtën DRT.

në pikën 2.10. “Analiza e normave (raporteve)”, pika 2.10.3 “Subjekte furnizuese dhe klientët”, ku cilësohet: **“Shitjet ju bëhen klientëve dhe blerjet kryhen prej furnizuesve. Të pyeturit**

në mënyrë direkte të furnizuesve dhe klientëve mund të zbulojnë diferenca edhe në transaksionet e deklaruar më parë dhe ato aktuale”, etj.

Gjithashtu në RPK në lidhje me analizën e furnitorëve ju shpreheni:

Llogaria “Furnitorë për mallra dhe shërbime” me vlerë 57 331 680 lekë e detajuar analitikisht në tabelat plotësuese te pasqyrave financiare te bilancit te vitit 2017. Nga kontrolli i ushtruar mbi llogaritë e furnitorëve, rezultoi qe kjo llogari ishte analizuar për çdo furnitor. Ishte e azhurnuar për të tërë periudhën e kontrolluar dhe shpreh sakte gjendjen e saj. Gjendja e saj ne bilancin e vitit 2017 përputhej me listën analitike si me poshtë;

Gjendja analitike me 31.12.2017 jepet sipas pasqyrës:

Nr.	Furnitorë	Vlera me 31/12/2017
1	X	1 830 000
2	X	75 900
3	X	378 024
4	I.Z.	3 872 568
5	X	158 405
6	X	76 189
7	X	76 432
8	X	84 509
9	X	17 698
10	X	43 200
11	X	115 410
12	X	36 000
13	X	60 690
14	X	96 300
15	B.E.	4 119 177
16	X	90 503
17	X	10 560
18	X	24 120
19	X	29 500
20	X	697 607
21	X	139 200
22	X	3 939 727
28	X	3 989 213
29	X	39 205
30	X	2 204 185
31	X	3 777 000
32	X	854 725
33	X	596 132
34	X	149 093
35	F.I.	3 905 660
36	X	5 488
37	X	101 800
38	X	1 575 292
39	A-2006	21 219 708
40	X	1 925 964
41	X	447 540
42	X	376 351
43	X	29 999
44	X	162 000

Me furnitorët e mësipërm kishte marrëveshje për likuidime. Për vitin 2017 likuidimi i faturave të furnitorit ishin kryer përmes llogarive bankare.

Sa më sipër, ju keni bërë pohime të pavërteta, të pakonfirmuara, si dhe nuk jeni shprehur në asnjë vit mbi gjendjen e lartë të furnitorëve “detyrime afatshkurtra”, të cilat janë shndërruar në “detyrime afatgjata”. Gjithashtu, nuk keni kryer asnjë veprim për kryqëzimin e të dhënave furnitorë/klientë, veprime këto në shkelje të MKT dhe kërkesave të Programit të auditimit. Përsa ju përket llogaritjeve për çdo vit të detyrimeve, observacioni pranohet dhe është reflektuar në PRA, ndërsa për çështjet e tjera të kësaj pike observacioni nuk pranohet.

Titulli i gjetjes 8: Mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, në lidhje me mos analizimin e “Detyrimeve afatgjata” dhe efektin në rezultatin financiar të vitit ushtrimor përkatës.

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, referuar të dhënave të pasqyrave të pozicionit financiar për periudhën 2015-2018, ka rezultuar se subjekti “SH-A” SHPK, paraqitet me detyrime afatshkurtra dhe afatgjata kundrejt institucioneve financiare apo dhe të tretë (hua). Këto detyrime janë paraqitur si detyrime afatshkurtra dhe detyrime afatgjata. Detyrimet afatshkurtra (kredi) janë në shumën 26,600,000 në vitin 2017 dhe 24,684,000 lekë në vitin 2018, për të cilat janë përlllogaritur shpenzimet financiare të paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare në shumën 210,540 lekë dhe 482,078 lekë respektivisht për vitet 2017 dhe 2018.

Detyrimet afatgjata “Hua” të krijuara në vitin 2015 në shumën 11,200,000 lekë, janë rritur në vitin 2016 në shumën 31,180,000 lekë dhe rezultojnë në këtë vlerë edhe për vitin 2017 dhe 2018. Në lidhje me këto detyrime evidentohet fakti se rezultojnë të pandryshuara në tre periudha ushtrimore, si dhe duke analizuar shpenzimet (kostot) e kësaj kredie/huaje rezulton se ato paraqiten në shumën 0 lekë për të gjithë periudhën e kontrolluar.

Nga ana e inspektorit të kontrollit në RPK, nuk është cilësuar dhe analizuar burimi i këtyre të ardhurave dhe të dhëna të tjera, pasi dhe në shënimet shpjeguese të PF, të vitit 2017 nuk është analizuar dhe shpjeguar kjo shumë, por është cituar vetëm se: “Shuma prej 31,180,000 lekë është hua e marrë me akte noteriale dhe kaluar me bankë”.

Në asnjë prej rasteve të mësipërme të huamarrjes nuk janë cilësuar institucionet financiare (banka etj.), apo huadhënës, kontratat e kredisë apo huadhënies, aktet noteriale, termat e referencës së kredive, plani i amortizimit etj., në kundërshtim me kërkesat e programit të kontrollit. Gjithashtu, këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF nr. 16, datë 16.02.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5 “Raportimi i aktivitetit të dyshimtë (RAD)”, pika 1 dhe 2. Nga grupi i auditimit, referuar situatës së paraqitur më lart, e cila nuk është në kushtet e përcaktuara në nenin 131 “Mos shlyerja e kredisë” të Ligjit nr.

9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, pasi subjekti jo vetëm që nuk ka zvogëluar, por ka zmadhuar kapitalin nga viti në vit, si dhe paraqitet me një rezultat financiar pozitiv (fitim), për gjatë gjithë periudhës (2015-2018), ka kryer ri karakterizimin si më poshtë:

Përshkrimi	Viti 2018
Detyrimi afatgjatë (hua)	31,180,000
Shpenzime interesi (5 %)	1,559,000
Marzhi i fitimit (%)	19
Baza e tatueshme (shpenzime+marzh fitimi)	1,855,210
Tatim fitimi (15%)	278,282
Gjobë 21.9 %	60,944
TVSH (20 %)	371,042
Gjobë 21.9%	81,258
Total detyrime sipas viteve	791,526

Kriteri: Ligji nr. 9920/2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime; Ligji 8438/1998 “Për të ardhurat tatimore në RSH” me ndryshime; Manuali i Kontrollit Tatimor, Programi i kontrollit tatimor.

Ndikimi/Efekti: Mos kryerja e analizave të duhura mbi pasqyrat financiare, llogaritë, gjendjet e tyre, ndryshimet nga një periudhë në tjetrën, është reflektuar në cilësinë e Raporteve Përfundimtare të Kontrollit si dhe vlerësimin real të detyrimeve të subjekteve tatimpaguese, të reflektuar në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mos zbatim i Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH” me ndryshime, kërkesave të detajuara të programit të kontrollit, Manualit të Kontrollit, si dhe e mosfunksionimit në mënyrën e duhur të stadeve të kontrollit, brenda Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT Shkodër.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht **në shumën 791,526 lekë, nga e cila penaliteti 142,202 lekë.**

Titulli i gjetjes 9: **Mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, në lidhje me mos paraqitjen e shpenzimeve për “Paga”, në Pasqyrën e Performancës Financiare dhe për rrjedhojë edhe në FDP e TF.**

Situata: Nga auditimi ka rezultuar se, nuk janë pasqyruar në Pasqyrën e Performancës Financiare shpenzimet për paga të kryera për vitin 2020. Nga verifikimi në C@ts i listë pagesave të vitit 2020 të subjektit tatimpagues **“S.A.” SHPK**, rezulton se shpenzimet për paga janë në shumën 815,000 lekë. Për këto shpenzime të pa përfshira në PASH dhe FDP e tatim fitimit është kryer ri

karakterizimi si më poshtë, bazuar në Ligjin nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH” me ndryshime, neni 71 dhe 72.

Përshkrimi	Norma	2020
Baza e tatueshme		815,000
Tatim fitimi	15 %	122,250
Gjoha	21.9 %	26,773
TVSH	20 %	163,000
Gjohë vlerë e TVSH	21.9 %	35,617
Total detyrimi		347,720

- Kriteri:** Ligji nr. 9920/2008 “Për procedurat Tatimore në RSH” me ndryshime; Ligji 8438/1998 “Për të ardhurat tatimore në RSH” me ndryshime; Manuali i Kontrollit Tatimor, Programi i kontrollit tatimor.
- Ndikimi/Efekti:** Mos kryerja e analizave të duhura mbi pasqyrat financiare, llogaritë, gjendjet e tyre, ndryshimet nga një periudhë në tjetrën, është reflektuar në cilësinë e Raporteve Përfundimtare të Kontrollit si dhe vlerësimin real të detyrimeve të subjekteve tatimpaguese, të reflektuar në të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit.
- Shkaku:** Mos zbatim i Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH” me ndryshime, kërkesave të detajuara të programit të kontrollit, Manualit të Kontrollit, si dhe e mosfunksionimit në mënyrën e duhur të stadeve të kontrollit, brenda Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DRT Shkodër.
- Rëndësia:** E lartë.
- Rekomandimi:** Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht **në shumën 347,720 lekë, nga e cila penaliteti 62,390 lekë.**

Në lidhje me nën çështjen nr. II.2.3.1/3, trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit nr. 814/4, datë 30.12.2022, protokolluar në DRT Shkodër me nr. 3313/48, datë 04.01.2023, janë paraqitur observacionet përkatëse të cilat janë trajtuar më lart, rast pas rasti.

Nga auditimi mbi “Vizitat fiskale”:

Nga auditimi i vizitave fiskale nga ana e Grupit të Auditimit të KLSH-së, janë përzgjedhur 4 (katër) vizitat fiskale si më poshtë:

- Vizita fiskale e ushtruar në subjektin “M” shpk me NIPT-X, nga Inspektori z.F.D.;
- Vizita fiskale e ushtruar në subjektin “HA-PJE” me NIPT-X, nga Inspektori z.S.I.;
- Vizita fiskale e ushtruar në subjektin “L.M.” me NIPT-X, nga Inspektori z.E.K.;
- Vizita fiskale e ushtruar në subjektin “N.L.” me NIPT-X nga Inspektori z.L.Ç.;

Nga auditimi ka rezultuar se në përgjithësi në kontrollet e ushtruara “Vizita fiskale”, nga ana e inspektorëve të kontrollit janë respektuar kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, kryerja e tyre

është bazuar në shkresat e DPT, si dhe dosjet e kontrollit ishin të plotësuar me dokumentacionin përkatës. Nga ana e inspektorëve të kontrollit për rastet përkatëse është kryer:

- analiza e blerjeve dhe e shitjeve për periudhën e kontrolluar
- lëvizja e bilancit material
- analiza e gjendjes kreditore

U evidentuan mangësi në kontrollin e kryer në subjektin “M” SHPK, ku DPT, me vendimin nr.16035, datë 02.09.2021, ka vendosur ri kontroll për këtë subjekt pasi nga ana e kontrollit të parë nuk është kryer analizë për shitjet e përjashtuara në vlerën 1,154,382 lekë se çfarë përfaqësojnë këto shitje si dhe ndikimi i tyre në njohjen e kreditimit të TVSH-së.

Gjithashtu nuk është kryer analizë mbi blerjet me TVSH që janë kryer nga ana e subjektit për rikonstruksion nëse janë prerë fatura situacionimi për shumën 2,137,550 lekë me TVSH respektive në shumën 427,510 lekë.

Nga verifikimi i Raportit Përfundimtar të Kontrollit, bazuar në cilësimet e vendimit të DPT-së, ka rezultuar se nuk është kryer analizim i plotë i blerjeve me TVSH, për materiale ndërtimi të blera nga subjekti, në shumën 2,137,550 lekë.

III.2.3.2. Mbi auditimin e veprimtarisë së Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit:

Në kuadër të auditimit të ushtruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, në zbatim të pikës nr.3 “Vlerësimi i përputhshmërisë ligjore në veprimtarinë e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor” të Programit të Auditimit Nr.814/1 prot datë 09.09.2022, i ndryshuar, për periudhën 01.01.2020-30.06.2022, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. *Plane mujore të punës.*
2. *Ndarjet e NIPT-ve sipas inspektorëve.*
3. *Deklaratat mujore në nivel subjekti të TVSH.*
4. *Deklaratat vjetore në nivel subjekti të TVSH.*
5. *Tepricat kreditore TVSH-TF-TTHF.*
6. *Deklaratat e TF-TTHF.*
7. *Rivlerësimet e kësteve të TF.*
8. *Deklaratat e tatimit në burim dhe pagesat e tatimit mbi dividendin.*
9. *Kasat fiskale.*
10. *Gabimet e kasave.*
11. *Pasqyrat financiare të subjekteve.*
12. *Sistemi C@TS*

*** Çdo informacion dhe dokumentacion shtesë i vlerësuar për kontroll nga grupi i auditimit dhe i vënë në dispozicion nga Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.

-Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me Manualin për Kontrollin nga Zyra, pika 5 e të cilit “Organizimi i inspektorëve të kontrollit nga zyra”, përcakton se “Në muajin Janar të çdo viti, Drejtori i Kontrollit Tatimor / Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit nga Zyra në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve, merr listën e plotë të tatimpaguesve të rajonit, përfshirë Persona fizikë : tatimpaguesit e regjistruar për TFTH & TVSH, tatimpaguesit me Xhiro e parashikuar < 2.000.000, Persona juridikë : tatimpaguesit e regjistruar për TF & TVSH, si dhe Individët. Bazuar në këtë listë, Drejtori i Kontrollit Tatimor /Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit nga Zyra bën ndarjen e të gjithë tatimpaguesve sipas inspektorëve të kontrollit nga zyra, ku ngarkesa për çdo inspektor do jetë sipas llojit të biznesit. Bizneset e mëdha do verifikohen, mbikëqyren nga inspektorët e kontrollit

nga zyra të cilat kanë më shumë eksperience dhe janë të mirë përgatitur. Ndërkohë Biznesi i Vogël dhe Biznesi i Vogël me TVSH do i përkasë inspektorëve më të rinj gjë e cila do i ndihmoj ata të krijojnë eksperiencën e duhur. Pra në mënyrë të përmbledhur ndarja do bëhet:

Biznesi i Madh – Inspektorë me eksperiencë

Biznesi i Vogël – Inspektorë të rinj

Biznesi i Vogël me TVSH – Inspektorë të rinj

OJF, Ente Shtetërore – Inspektorë të përcaktuar për këtë kategori

Në përgatitjen e listës së tatimpaguesve sipas inspektorëve, Drejtori i Kontrollit mban parasysht ndarjen e barabartë të tyre, për të krijuar ngarkesë të barabartë pune për inspektorët.”, u konstatua se nga DRT Shkodër është kryer një ndarje në nipte sipas rendit kronologjik të tyre, në mënyrë rastësore e të barabartë nëpërmjet inspektorëve, ndarje e cila nuk përmban kriteret e përcaktuara në manual si më sipër cituar, duke reflektuar kështu mangësi në kryerjen e detyrave përkatëse nga ana e Drejtorit të Kontrollit Tatimor /Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra në Drejtorinë Rajonale të Tatime në DRT Shkodër.

-Nga auditimi u konstatua se në kundërshtim me pikën 8 “Përgjegjësitë për kryerjen e funksionit të monitorimit të saktësisë së deklaratave dhe të vlerësimit të detyrimeve tatimore” të Manualit për Kontrollin nga Zyra ku përcaktohet se “... Pjesë përbërëse e strukturës të Drejtorive Rajonale të Tatimeve janë Drejtoritë e Kontrollit, Sektori i Kontrollit nga Zyra, të cilat përgjigjen për zbatimin me korrektesë e në mënyrë të vazhdueshme të këtij monitorimi. Për këtë përgatit dhe implementon planin vjetor dhe mujor të punës si pjesë e planit të përgjithshëm operacional të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor të inkuadruar në planin e përgjithshëm të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve”, nga ana e DRT Shkodër nuk u vendos në dispozicion plani vjetor apo mujor i punës sipas së cilit duhet të bazohet dhe organizohet puna e sektorit, duke reflektuar kështu mangësi në kryerjen e detyrave përkatëse nga ana e Drejtorit të Kontrollit Tatimor /Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra në Drejtorinë Rajonale të Tatime në DRT Shkodër.

-Struktura aktuale e sektorit paraqitet me 2 vakanca, përkatësisht në pozicionin e inspektorëve të kontrollit. Deri në qershor 2022 ajo paraqitej me 1 vakancë; në fund të vitit 2021 ajo paraqitej me 1 vakancë (1 inspektor i dytë); dhe në fund të vitit 2020 me 3 vakanca (3 inspektorë të parë).

*-Grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me aktivitetin e personelit të kontrollit nga zyra për periudhën nën auditim, për të cilën ndër të tjera u vendos në dispozicion urdhri nr.2, datë 21.07.2021 “Për transferim të përkohshëm ndërmjet sektorëve” i Drejtorit Rajonal të DRT Shkodër, z. S.I., sipas së cilit është urdhëruar transferimi i përkohshëm i z. L.C. nga Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, në Sektorin e Kontrollit në Vend, duke mos cituar periudhën kohore gjatë të cilës do të jetë i vlefshëm ky transferim, dhe as bazën ligjore në të cilin është mbështetur ky urdhër. Ky urdhër i titullarit të DRT Shkodër rezulton i pa mbështetur në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe përmban riskun për të ndikuar në keqfunksionimin dhe performancën e dobët të sektorit të kontrollit nga zyra, veprim ky në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore si më poshtë: *Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin Nr.19 (Nr.1482/2., prot) datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave: Pika 3, 5, 10, 11, 18, 20 të nenit 4 “Drejtore të Drejtorisë Rajonale Tatimore”*. Sipas shkresës nr. 3802/1, prot datë 15.03.2020 me urdhër nr. 6, datë 15.03.2022 “Për rikthim nga transferimi i përkohshëm ndërmjet sektorëve” të drejtorit të DRT Shkodër **(pra rreth 8 muaj pas shkresës së mëparshme)** është urdhëruar rikthimi i z. L.C. me të gjitha funksionet pranë Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit. Si rezultat, për një periudhë rreth 8 muajore punonjësi ka ushtruar kompetencat e një pozicioni, komandimi për të cilin është kryer në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Sipas komunikimit verbal me Drejtorin e DRT Shkodër ky urdhër ka ardhur pas konfirmimit*

nga DPT se urdhri i mëparshëm nuk ishte kryer konform kuadrit ligjor e rregullator në fuqi. Sipas shkresës nr. 7306, datë 5.5.2022 të DPT, me urdhër nr. 58, datë 5.5.2022 “Për caktimin e një nëpunësi për ushtrimin e funksioneve” të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT , është caktuar z. L.C. për ushtrimin e detyrave funksionale të inspektorit në Sektorin e Kontrollit në vend në Drejtorinë e Kontrollit Tatimor pranë DRT Shkodër (Pra në detyrën që punonjësi kishte mbajtur për rreth 8 muaj me autorizimin e Drejtorit Rajonal të DRT Shkodër).

Mbi analizimin e tepricave kreditore për top 50 subjektet

Në drejtim të përgjegjësi të Sektorit të Kontrollit nga Zyra, përcaktuar në Manualin për Kontrollin nga Zyra si më poshtë (pika 4, 7 dhe 9) , u analizuan 50 subjektet me tepricën më të lartë të tatim fitimit, tepricën kreditore të TVSH-së, tepricën kreditore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për të shqyrtuar rolin e sektorit të kontrollit nga zyra për kërkesat për kontroll me qëllim monitorimin dhe verifikimin e këtyre deklarimeve, sikundër manuali parashikon: “4. Objekt i punës të kontrollit tatimor nga zyra “Analizon nëpërmjet raporteve të implementuar në sistem, nxjerr konkluzione përkatëse për situata të parregullta të deklaratave të ndryshme tatimore, tatimpaguesit me gjendje të lartë e të vazhdueshme kreditore TVSh, tatim fitimi, mos deklarues për lloje të ndryshme tatimi, deklaruesit pa veprimtari apo tatimpaguesit që kanë ndërprerë deklarimin.”

7. Monitorimi dhe saktësimi i vlerësimeve të deklaratave tatimore, “Inspektorët e kontrollit nga zyra duke patur parasysh dhe zhvillimet e ndodhura në sistemin informatik dhe deklarimet on-line të tatimpaguesve duhet të përqendrojnë punën e tyre në drejtimet si më poshtë: - Të monitorojnë saktësinë e plotësimit të çdo deklarate tatimore mbi bazën e informacioneve të ndryshme që ata kanë dhe mbi bazën e analizës së raporteve të ndryshme të mara nga sistemi informatik apo të kërkuara nga Drejtoria e IT-së”.

9. Kalendar i punëve për strukturat e sektorit të kontrollit nga zyra “...Nxjerrin raportet për mënyrën e plotësimit të rubrikave të ndryshme të TVSh-së, si rubrikat “Rregullime të TVSh-së së zbritshme...”, “Autongarkesë e TVSH-së në blerje me të drejtë kreditimi (reverse charge)”, “Autongarkesë TVSH-së në shitje (reverse charge)”, “Shitjet me shkallë 0 %”, “Shitjet pa TVSH” e rubrika të tjera që plotësimi gabim i tyre çon në uljen e pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar apo rrisin artificialisht gjendjen kreditore dhe kërkesat për rimbursim të TVSh-së....” “..Ndjekin me përparësi dorëzimin e deklaratës së tatimit të thjeshtuar të fitimit, tatim fitimit..” , “..Nxjerr raportet për treguesit kryesorë të deklaratave të pagesës së tatim fitimit për vitin e kaluar dhe përcakton e harton planin e kontrollit dhe verifikimit të deklaratës me treguesit e pasqyrave financiare...”, “..Kontrollon e verifikon plotësimin sipas ligjit të gjithë rubrikave të deklaratës së pagesës së tatim fitimit, në mënyrë të veçantë të “Tatim Fitimi i Shtyrë”, “Humbje e Mbartur”, “Tatim fitimi me shkallën tatimore standarde”, “Tatim fitimi me përqindje të tjera”, sidomos kur këto të fundit kanë vlera të dyja njëkohësisht dhe për çdo konstatim i plotësimit jo korrekt të tyre bën korrigjimin e deklaratës nga tatimpaguesi ose vetë inspektori...”. Më hollësisht:

Mbi tepricat kreditore të TVSH-së

Nga përzgjedhja e 50 subjekteve me tepricën më të lartë kreditore, u krye një analizë krahasuese në formë horizontale nga viti 2020 deri në 6 mujorin e parë të vitit 2022 mbi trendin e ndryshimit të këtyre tepricave, ku situata paraqitet sipas aneksit bashkëlidhur raportit. Sipas kësaj analize vëmë re se teprica kreditore e subjekteve ka tendenca rritjeje, veçanërisht në subjektet aktivitet i së cilave është tregtia apo shërbimet, në të cilat risku i evazionit për shkak të mos deklarimit të shitjeve apo dorëzimi i faturave fiktive në blerje është më i lartë. Nga kjo zgjedhje me një numër të kufizuar subjektesh në raport me totalin e DRT Shkodër (vetëm 50 subjekte), të cilat përbëjnë

36% në vitin 2020, 39% në vitin 2021 dhe 37% në periudhën e audituar për vitin 2022 të totalit të tepricës kreditore të TVSH-së për të gjithë subjektet e DRT Shkodër. Pavarësisht se sikundër rezulton nga kjo analizë këto subjekte duhet të ishin objekt monitorimi dhe verifikimi nga ana e inspektorëve, rezulton se nga këto subjekte janë kaluar për kontroll vetëm 19 prej tyre, pra nuk rezultojnë të jenë marë masa veprimi konkrete nëpërmjet kërimit të informacionit për verifikimin e situatës së rritjes së vazhdueshme të tepricës së TVSH-së. Kjo, pasi për ta duhet të bëhej verifikimi në vend nëpërmjet kombinimit me sektorin e kontrollit dhe monitorimit nga zyra për të verifikuar n.q.s. ekzistojnë dhe kanë gjendje malli apo aktive në vendndodhjet e deklaruara të biznesit në përputhje me deklaratimet e tyre. Gjithashtu, nga një analizë e grupit rezulton se 14 nga 50 subjektet mara nën shqyrtim kanë tendencë rritjeje të tepricës kreditore të tatimit mbi fitimin. Kjo zgjedhje e kufizuar subjektsh, përbën 23% në vitin 2020, 20% në vitin 2021 dhe 29% në periudhën e audituar për vitin 2022 të totalit të tepricës kreditore të tatimit fitimit për të gjithë subjektet e DRT Shkodër. Nga totali i 50 subjekteve me deklaratimet më të larta të tepricës kreditore të tatimit fitimit janë kaluar për kontroll vetëm 7 prej tyre, nga të cilët vetëm 2 janë subjekte që sipas tabelës së mësipërme kanë paraqitur tendencë rritjeje të tepricës, duke ndikuar kështu në reduktimin e performancës për deklaratimet tatimore të tatimpaguesve. Për sa i përket tepricave kreditore të subjekteve për tatim fitimin e thjeshtuar, nga analiza rezulton se top 50 subjektet nuk kanë diferencë (me përjashtim të vetëm 1 rasti) në deklaratimet e kryera për tepricat kreditore për tatim të thjeshtuar mbi fitimi gjatë periudhës të marrë nën shqyrtim, dhe asnjë prej tyre nuk është përfshirë në listën e subjekteve të kaluara për kontroll gjatë periudhës objekt auditimi. Kjo zgjedhje e kufizuar subjektsh, përbën 21% në vitin 2020, 22% në vitin 2021 dhe 22% në periudhën e audituar për vitin 2022 të totalit të tepricës kreditore të tatimit fitimit të thjeshtuar për të gjithë subjektet e DRT Shkodër.

-Mbi problematikat e konstatuara në drejtim të shpenzimeve për paga nga ana e tatimpaguesve jashtë fushës së zbatimit të TVSH-së

Grupi i auditimit kreu një analizë lidhur me numrin e subjekteve që operojnë në DRT Shkodër me një numër mesatar mbi 5 punonjësish dhe që figurojnë jashtë fushës së zbatimit të tatimit mbi vlerën e shtuar. Kjo situatë përbën një risk të shtuar për fshehjen e xhiros të subjektit për të shmangur pagesën e TVSH-së, pasi nga një analizë e kryer mbi shpenzimet e fondit të pagave për vitin 2021, rezultojnë mos përputhje mes këtyre shpenzimeve dhe të ardhurave të subjektit sipas sektorit ku bëjnë pjesë (Paga minimale në vlerën 30,000 lekë-paga neto në vlerën 26,400 lekë; sigurime shoqërore $*15\%=4,500$ lekë- sigurime shëndetësore $*1.7\%=510$ lekë, pra me një kosto totale për pagë mujore minimale pre 31,650 lekë). Për këto raste nga ana e inspektorëve të kontrollit nga zyra konstatohen mangësi në drejtim të ndërmarrjes së veprimeve konkrete nëpërmjet dokumentimit të kryerjes së verifikimeve të burimeve të financimit për shpenzime të këtyre subjekteve, të cilat pasohen me një efekt në të ardhurat e arkëtuara në sistemin tatimor, parashikuar në nenin 12 të ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili përcakton se “a) zbatimi i njëjtë dhe efektiv i legjislacionit nga ana e administratës tatimore; b) vetëvlerësimi dhe vete deklaratimit i detyrimit tatimor nga ana e tatimpaguesit; dh) ndjekja e ndryshimeve në mjediset e biznesit dhe atij legjislativ, si dhe përshtatja e sistemeve të organizimit të burimeve, të teknologjisë së informacionit dhe proceseve të punës, për arritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të duhur.”; dhe gjithashtu në kundërshtim edhe me UMF Nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 12, shkronjat a, b, pikat 43.2.1 dhe 43.2.3 ku përcaktohet se: “12.a) zbatimi i njëjtë dhe efektiv i legjislacionit nga ana e administratës tatimore, që do të thotë që legjislacioni tatimor,

dispozitat nënligjore, përfshirë udhëzimet teknike dhe manualët tatimore, zbatohen në mënyrë uniforme dhe të logjikshme për çdo tatimpagues në rrethana të njëjta dhe të ngjashme; 12.b) nxitja e vetëvlerësimit dhe vetëdeklarimit të detyrimeve tatimore nga ana e tatimpaguesit, që nënkupton të drejtën e tatimpaguesit për llogaritur dhe përmbushur në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi detyrimet e tyre tatimore; 43.2.1 Në rastet kur përgjegjësia tatimore pas regjistrimit fillestar ndryshon, personi i tatueshëm është i detyruar të njoftojë drejtorinë tatimore rajonale të juridiksionit për ndryshimet e ndodhura. Drejtoria rajonale tatimore i reflekton këto ndryshime në sistemin e administrimit tatimor duke bërë sistemit e duhura edhe në dosjen e personit të tatueshëm; 43.2.3 Në rastet kur një person i tatueshëm nuk ka njoftuar administratën tatimore për ndryshimin e ndodhur, megjithëse ka detyrim ligjor për ta bërë një gjë të tillë, dhe një gjë e tillë konstatohet dhe verifikohet nëpërmjet një kontrolli nga administrata tatimore, kjo e fundit bën menjëherë ndryshimin e duhur dhe njofton personin e tatueshëm. Kështu, për shembull, në bazë të një kontrolli tatimor të kryer në vend të personi i tatueshëm apo në bazë të të dhënave të importeve të marra nga dogana rezulton se një tatimpagues i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, ka plotësuar kushtet për të qenë person i regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, por vetë personi i tatueshëm, megjithëse i detyruar sipas ligjit për tatimin mbi vlerën e shtuar, nuk ka bërë regjistrimin si tatimpagues TVSh-je. Në këtë rast, administrata tatimore gëzon të drejtën, për të plotësuar në emër të personit të tatueshëm, formularin përkatës të ndryshimeve në regjistrim, ta hedhë atë në sistemin elektronik dhe të njoftojë njëkohësisht për këtë personin e tatueshëm.” dhe manualit të Kontrollit nga Zyra pika 9, “Objekt i Punës të Kontrollit Tatimor nga Zyra”, ku përcaktohet se: “Analizon nëpërmjet raporteve të implementuar në sistem, nxjerr konkluzione përkatëse për situata të parregullta të deklaratave të ndryshme tatimore, tatimpaguesit me gjendje të lartë e të vazhdueshme kreditore TVSh, tatim fitimi, mos deklarues për lloje të ndryshme tatimi, deklaruesit pa veprimtari apo tatimpaguesit që kanë ndërprerë deklarimin. ; - Analizon dhe nxjerr konkluzione nëpërmjet kryqëzimit të librave të shitjes dhe të blerjes për deklarimin e faturave tatimore të shitjes apo blerjes duke përcaktuar detyra për sisteme e rivlerësime të ndryshme tatimore kur është e nevojshme.”

-Mbi procedurat e kontrolleve për rimbursimin e TVSH

Në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit Nr.19 datë 28.04.2020 të Komitetit të Reformave në DPT, sipas së cilit është miratuar urdhri nr.19/1 datë 28.04.2020 me nr.7158/1 Prot., datë 28.04.2020 “Për miratimin e rregullores së rimbursimit të TVSh-së, mbështetur në analizën e riskut”, janë përcaktuar procedurat e kontrolleve për rimbursim që do të kryhen nga Sektori i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit si më poshtë:

Marrja e kërkesave për rimbursim: Kërkesat për rimbursim i vijnë DRTVSH-së përmes platformës dixhitale të rimbursimit sipas formularit të miratuar. Formulari i kërkesës i plotësuar e-Albania ose e Filling do të pajiset me një *Numër Identifikimi të Kërkesës* dhe *Kodin e Sigurisë*, të cilat garantojnë trajtimin e praktikave sipas radhës dhe lejojnë gjurmimin e kërkesës në çdo kohë.

Verifikimi i kërkesave për rimbursim: Drejtoria e Rimbursimit të TVSh-së do të vlerësojë çdo kërkesë dhe do ta trajtojë atë përmes hapave që përshkruhen qartësisht në rregulloret dhe legjislacionin në fuqi. Të gjitha rastet që do t’ju përcillen DRT-ve për kontroll dhe verifikim të situatës, do t’i përcillen vetëm në njoftimin elektronik (*Në formë “Pop Up” ose e-mail me nënshkrim elektronik*) nëpërmjet DRTVSH-së. DRT me marrjen e njoftimit për kontroll menjëherë hap çështje kontrolli nga zyra ose në vend të lidhur me çështjen e rimbursimit. Procedura e

kontrollit kryhet siç është parashikuar në Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kalimi i rasteve tek njësitë e tjera: Të gjitha rastet e përcjella nga ana e DRTVSH-së trajtohet me përparësi nga ana e DRT-ve sipas parashikimeve dhe afateve të parashikuara shprehimisht në ligjet respektive. Procedura e verifikimit të tepricës kreditore nga ana e DRT-ve, nuk duhet të konfundohej me procedurat standarde të kontrolleve tatimore që DRT kryen në përmbushje të detyrave të saj funksionale.

Detyrat e DRT-ve: Struktura përkatëse në Drejtoritë Rajonale duhet t’i ngarkojë menjëherë kërkesat kontrollorit dhe të kujdesen që të kryhet sipas afateve ligjore. Qëllimi i këtyre kontrolleve, si nga zyra ashtu edhe ato të plota, është thjesht dhe vetëm për të verifikuar vlefshmërinë e kërkesës, duke kontrolluar me evidencat shkresore dhe kushtet e subjektit. Nëse nga këto nuk del asnjë dëshmi evazioni fiskal apo shkelje, kontrolli mbyllet me miratimin e shumës për rimbursim.

Afatet e veprimeve tek DRT-të:

a. DRT me marrjen e njoftimit për kontroll menjëherë hap çështje kontrolli nga zyra ose në vend, të lidhur me çështjen e rimbursimit duke ia kaluar një punonjësi në Drejtorinë e Kontrollit, **së bashku me orët për kontroll**, të cilat do të caktohen bazuar në rregulloren e Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut.

b. Raporti i kontrollit duhet të ngarkohet në çështjen e kontrollit (e cila lidhet me çështjen për rimbursim), dhe njëkohësisht njoftohet elektronikisht (në formë “Pop Up” ose e-mail me nënshkrim elektronik) DRTVSH-ja (Inspektori i çështjes dhe Drejtori i Drejtorisë), jo më vonë se 5 (pesë) ditë para përfundimit të afatit të parashikuar për rimbursim (30/60 ditë).

c. Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së mbi baza mujore pas raportimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore, evidenton vonesat në fillimin e kontrollit të rimbursimit ose vonesa në përfundimin e procedurave të kontrollit. Drejtoria e Rimbursimit të TVSH pas evidentimit të vonesave nga Drejtoritë Rajonale, njofton Drejtorinë e Kontrollit në DPT për fillimin e moszbatimit të afateve ligjore në mbylljen e kontrolleve për rimbursim.

Procedurat e kontrolleve për rimbursim të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSh-së) të kryera nga Sektori i Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit për periudhën objekt auditimi pranë DRT Shkodër paraqiten sipas aneksit bashkëlidhur raportit. Sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, udhëzimeve dhe rregulloreve duhet që kontrolli të kryhet në zbatim të neneve 81, 83 dhe 84 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Njoftimet e kontrollit të shoqëruar me programet e kontrollit për rimbursimin e TVSH-së nga Kontrolli nga Zyra që ju dërgohen tatimpaguesve **nuk** u përmbahen kërkesave ligjore përcaktuar në nenin 81 “Njoftimi i kontrollit tatimor”, pika 2, gërma f e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku konkretisht përcaktohet: “f) datën dhe orën kur fillon dhe kur përfundon kontrolli tatimor. Kohëzgjatja e nevojshme e kontrollit përcaktohet nga të dhënat e analizës së riskut.” Nga auditimi konstatohet se nuk janë evaduar në sistemin C@ts procedurat e kontrollit sipas kërkesave dhe afateve që përcaktohen në legjislacionin në fuqi, si dhe nuk është përcaktuar ora kur fillon dhe kur përfundon kontrolli tatimor. Kohëzgjatja e nevojshme e kontrollit nuk është përcaktuar nga të dhënat e analizës së riskut. Gjithashtu u konstatuan veprime që lidhen me mos respektim të afateve të rimbursimit të TVSH-së dhe të cilat janë në shkelje të kërkesave ligjore të cituara si më poshtë:

-Sipas pikave të programit dhe në zbatim të nenit 75/1 të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcaktohet se: “Personat e tatueshëm, të regjistruar për TVSH-në, që rezultojnë me tepricë kreditore, kanë të drejtë të paraqesin kërkesën për rimbursimin e TVSH-së së paguar tepër pranë Drejtorisë së Rimbursimit

të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Kjo kërkesë paraqitet sipas formularit të miratuar “Kërkesë për rimbursimin e TVSH-së. Brenda 60 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesit dhe brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës së tatimpaguesve eksportues, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në bashkëpunim me drejtorinë rajonale tatimore, ku është i regjistruar tatimpaguesi, verifikojnë situatën tatimore të tatimpaguesit dhe miratojnë tepricën kreditore si të rimbursueshme. Kur është e nevojshme, administrata tatimore ushtron kontroll bazuar në analizën e riskut. Pagesa e tepricës kreditore të rimbursueshme kryhet brenda pesë ditëve, nëpërmjet sistemit të thesarit, në bazë të rregullave të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave. Në rast të kundërt, personit të tatueshëm i lind e drejta e mos pagesës së detyrimeve të tjera tatimore në masën e TVSH-së së pretenduar për rimbursim. 1/1. Në rastin kur tatimpaguesi, i cili ka kërkuar rimbursim, i nënshtrohet kontrollit, sipas analizës së riskut, me qëllim respektimin e afatit të rimbursimit, sipas këtij neni, afatet e përcaktuara nga nenet siç është parashikuar në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Me qëllim respektimin e afateve të rimbursimit të TVSH-së, në rastet kur tatimpaguesi i nënshtrohet kontrollit tatimor, afati për përfundimin e Raportit 83 dhe 84 nuk do të zbatohen dhe çdo afat do të jetë 5 ditë kalendarike. -Ndërkohë sipas nenit 75/1 pikës 2.5.2 të Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcaktohet se: “2.5.2 Nëse kërkesa për rimbursim rezulton me risk për rimbursim, Drejtoria e Rimbursimit të TVSH-së, në DPT, e dërgon në drejtorinë rajonale ku është regjistruar tatimpaguesi për kontroll nga zyra ose në vend para se të rimbursohet. Procedura e kontrollit kryhet të Kontrollit nga inspektori/inspektorët është, jo më shumë se 5 ditë kalendarike pas përfundimit të tij. Gjithashtu, edhe afati për kundërshtimin e rezultateve të kontrollit tatimor nga tatimpaguesi është jo më shumë se 5 ditë kalendarike pas datës kur vlerësohet se është marrë. I njëjti afat prej 5 ditësh kalendarike zbatohet dhe për plotësimin dhe nënshkrimin e Raportit Përfundimtar të Kontrollit nga të gjithë pjesëtarët e grupit të kontrollit. (Ndryshuar me Udhëzim Nr.7, datë 10.01.2017. Botuar në Fletoren Zyrtare Nr.4 datë 19.01.2017).”

Në praktikën e rimbursimit të TVSH-së nëpërmjet procedurës së kontrollit nga zyra në DRT Shkodër konstatohet se nga ana e Drejtorit të Kontrollit në DRT Shkodër, Përgjegjësit të Sektorit të Procedurave të Kontrollit dhe Monitorimit në DRT Shkodër dhe inspektorëve përkatës sipas subjekteve që kanë zhvilluar kontrollin, nuk janë zbatuar përcaktimet sipas kuadrit rregullator e ligjor në fuqi në drejtim të dorëzimit të Raportit Përfundimtar të Kontrollit Tatimor sipas përcaktimeve dhe afateve ligjore të nenit 84, si dhe në drejtim të krijimit të kushteve të nevojshme për tatimpaguesit për të vepruar sipas së drejtës së tyre për t’i kundërshtuar rezultatet e kontrollit brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike pas datës, kur vlerësohet se raporti është marrë nga tatimpaguesi, duke rezultuar kështu në kundërshtim me nenin 81 “Njoftimi i kontrollit tatimor”, gërma f, pika 2; nenin 83 “Raport Kontrolli”; Neni 84 “Raporti përfundimtar i kontrollit tatimor”; e Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Neni 75/1 pikës 2.5.2 të Udhëzimit Nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Pika 3, 10, 11, 16 të Neni 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale” e Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin Nr.19 (Nr.1482/2., prot) datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave. Gjithashtu, nga verifikimi i procedurave të rimbursimit të kryera nga ana e sektorit të kontrollit nga zyra pranë DRT Shkodër u konstatua se dosjet e procedurave të rimbursimit janë të pa inventarizuara dhe të pa arkivuara, në kundërshtim me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, si dhe “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë”, neni 13. Grupi i auditimit hasi vështirësi në

vendosjen e tyre në dispozicion gjatë auditimit (me vonesa të konsiderueshme), dhe në fund të auditimit në terren jo të gjitha dokumentacionet e praktikave të kampionit të përzgjedhur u vendosën në dispozicion, duke reflektuar kështu mungesë sigurie për ekzistencën e tyre, dhe saktësinë e plotësinë e ruajtjes së informacionit nga ana e strukturave përgjegjëse pranë DRT Shkodër, ndryshe nga sa përcakton ligji nr.10296, datë 08.07.2010 i ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues” ku përcaktohet se *“Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: përgatitjen dhe monitorimin e sistemeve për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar”*. Dosjet ishin të pajisura vetëm me shkresat për njoftim kontrolli (jo në të gjitha rastet pjesë e praktikave), raportin përfundimtar me shkresën përcjellëse, dhe shkresat përkatëse për njoftimin e operatorit mbi vlerësimin për detyrimet. Në shkresën përcjellëse për subjektin është paraqitur edhe inventari shkresor i dosjes përkatëse (pavarësisht se dosjet nuk janë të inventarizuara sipas përcaktimeve të kuadrit nënligjor në fuqi), informacion ky i panevojshëm për subjektin, pasi i përket strukturave përkatëse të brendshme pranë DRT Shkodër, trajtuar më hollësisht në aneksin bashkëlidhur. Nga verifikimi i praktikave të rimbursimit u konstatua se për subjektet që operojnë nën regjimin e përpunimit aktiv (fasonët), nga ana e administratës tatimore nuk ishin administruar kartat teknologjike sipas së cilave përshkruhet edhe aktiviteti i operatorit, firot / rezultatet e së cilit duhet të jenë primare në analizat që do të kryhen me objekt miratimin e TVSH-së së rimbursuar, në zbatim të VKM-së nr. 434, datë 20.05.2015 “Për përcaktimin e normativave për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportit etj, të njohura për qëllimet fiskale”, pika 7, dhe 8 e saj. Në rastet e operatorëve të operojnë me fermerët vendas, në dosje nuk disponohen kontratat përkatëse të lidhura me fermerët, likuidimet me bankë për çdo faturë, apo evidenca të tjera që vërtetojnë sasinë e përpunuar të mallit. Për operatorët që kanë kryer investime, në dosje nuk kishte evidenca për lejet përkatëse të këtyre investimeve, raportet e inxhinierëve të ndërtimit për kostot e ndërtimit (analiza kosto/sasi/situacion). Për subjektet e tjera, konstatohet sërish mungesa e evidencave për shpenzimet e kryera (transport, normativat e konsumit për km, shpenzime për personelin (ushqim/pije), etj). Në kushtet kur rimbursimi është miratuar nga ana e personelit tatimor sipas hierarkisë përkatëse (duke filluar nga inspektori përkatës, përgjegjësi i sektorit e në fund nga drejtori rajonal) pa dokumentuar kryerjen verifikimeve dhe pajisjen e praktikave me të gjithë dokumentacionin e duhur, konstatohet mungesë sigurie në vlerat e miratuara të rimbursimit të TVSH-së për të gjitha rastet në periudhën objekt auditimi. Me ndryshimin në manual, rimbursimi i TVSH-së nuk kryhet më nga ana e Sektorëve të Kontrollit nga Zyra në DRT.

Mbi diferencat në deklarimin e eksporteve mes doganave dhe tatimeve

Grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me deklaratimet e kryera nga ana e subjekteve mbi importet dhe eksportet e kryera për periudhën nën auditim (e-mail i datës 19.09.2022), për të verifikuar nëse ekzistojnë diferenca mes deklarimeve të kryera në administratën doganore dhe asaj tatimore, të cilat u përcollën nga struktura përkatëse sipas email-it të datës 10.10.2022. Këto të dhëna rezultuan të pasakta dhe pas rishikimit të tyre, informacioni i ri u dërgua sipas email-it të datës 15.11.2022. Grupi i auditimit përzgjedhi një kampion me qëllim verifikimin e rasteve konkrete lidhur me këto diferenca (email-i i datës 16.11.2022), për të cilat pas një sërë rikujtesash u dërgua email-i i datës 24.11.2022 në të cilin janë pasqyruar disa komente të përgjithshme nga ana e inspektorëve, pa u shoqëruar me evidencat apo dokumentacionet përkatëse që vërtetojnë

situatën e pretenduar. Këto komente të përgjithshme duhet të ishin të përgatitura më parë nga inspektorët si pjesë e detyrave të tyre përcaktuar në aktet nënligjore përkatëse duke kryer edhe sistemimin e tyre në kohë, detyra këto të përcaktuara më hollësisht Manuali i Kontrollit Tatimor pika 4, 6,8,11; Rregullorja e Funksionimit të Administratës Tatimore pika 2, 6, 9 e nenit 26; Rregullorja për Funksionimin e Drejtorive Rajonale neni 4, 55, 56, 60, 61.-Disa nga komentet e inspektorëve identifikonin si shkaqe të diferencave faktin që tatimpaguesi disponon DAV-in origjinal dhe e ka paraqitur atë, ndërkohe që dogana nuk e ka sjellë si informacion pranë DRT-së; tatimpaguesi është në kontroll të plotë, apo ka kaluar kontrollin dhe çdo diferencë do të sistemohet apo është sistemuar; etj; komente të cilat janë të pamjaftueshme për të konkluduar mbi vlerën e saktë të diferencave në mungesë edhe të evidencave përkatëse në situatën kur këto konkluzione nuk janë të shoqëruara me dokumentacionet që vërtetojnë kryerjen e këtyre verifikimeve në periudhat respektive nga ana e inspektorëve. Për më tepër këto diferenca që i përkasin vitit 2021 apo 2020, duhet të ishin sistemuar nga ana e inspektorëve, pasi i përkasin periudhave të mbyllura financiare. Në këto kushte, grupi i auditimit e pati të pamundur verifikimin e tyre dhe krahasimin e diferencave të konstatuara me evidenca/dokumentacione që reflektojnë situatën e pretenduar nga subjekti i audituar. Nga kryqëzimi i të dhënave sipas situatës financiare të TVSh-së, librat e blerjes dhe të shitjes me të dhënat e deklaruar sipas doganës janë konstatuar diferenca në të dy kahet:

- Rastet kur vlera e deklaruar sipas tatimeve është më e madhe se ajo sipas doganave. (Diferencë në vlerë pozitive).
- Rastet kur vlera e deklaruar sipas tatimeve është më e vogël se ajo sipas doganave. (Diferencë në vlerë negative).

Diferenca në import

Nga auditimi nuk u dokumentua kryerja nga ana e inspektorëve të zyrës të monitorimeve dhe verifikimeve të nevojshme për të kërkuar informacion nga tatimpaguesit mbi diferencave mes deklarimit në dogana dhe tatime sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 60 “Detyrimi i tatimpaguesit për të dhënë informacion dhe për të lejuar hyrjen në mjediset e veprimtarisë ekonomike” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe për të sistemuar dhe rivlerësuar këto diferenca dhe mospërputhje të konstatuara sipas neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi” dhe neni 71/1 “Letër kujtesa” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Nisur nga periudha që po zhvillohet faza në terren e auditimit (viti 2022), nga ana e inspektorëve të monitorimit dhe kontrollit nga zyra duhet të ishin sistemuar dhe vlerësuar këto mospërputhje, maksimumi brenda vitit ushtrimor 2021. Për diferencat e konstatuara të vitit 2022, të cilat rezultojnë me një vlerë të konsiderueshme, veçanërisht për rastet kur vlera e deklaruar nga tatimet është më e lartë, duke qenë se periudha e deklarimit financiar nuk ka përfunduar, këto raste janë identifikua nga grupi, për t’u monitoruar në vijim nga inspektorët përkatës, pa u përfshirë në totalin e përllogaritur për të ardhurat e munguara. Aktualisht, këto subjekte rezultojnë me diferenca të pa rivlerësuar nga administratës tatimore, dhe të pa justifikuar me evidenca mbështetëse që vërtetojnë kryerjen e verifikimeve përkatëse, **efekti i të cilave sjell një mungesë të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së) dhe tatimin mbi fitimin të pa llogaritur dhe njëkohësisht vlerë e munguar në buxhetin e shtetit bashkë me penalitetet përkatëse, siç paraqiten më konkretisht si në vijim, në kushtet kur evidencat justifikuese për kryerjen e verifikimeve së bashku me dokumentacionin justifikues sipas rastit (të tilla si deklarata doganore, etj) dhe iniciativat për sistemimin e diferencave nga ana e inspektorëve nuk u vendosën në dispozicion:**

Diferenca pozitive³

Në lekë

Nr subjektsh	Viti	Vlera e tatueshme Diferenca	TVSH Diferenca (+)
86	2020	91,632,265	12,817,339
111	2021	196,042,887	25,710,812
Total		287,675,152	38,528,151

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Gjithashtu, për vitin 2022 (periudhë ende e pa mbyllur deklarimesh financiare) u konstatuan diferenca negative për 44 raste në vlerën e tatueshme prej 121,293,557 lekë, dhe në TVSH 23,595,020 lekë, objekt verifikimi nga DRT Shkodër në vijim.

Në lekë

Zëri/Emërtimi	2020	2021	Total
Vlera e tatueshme e shmangur (Importi)	91,632,265	196,042,887	287,675,152
TVSH (20%)	12,817,339	25,710,812	38,528,151
Gjobë TVSH në masën (21.9%) sipas nenit 115 Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar	2,806,997	5,630,668	8,437,665
Tatim Fitimi (15%)	13,744,840	29,406,433	43,151,273
Gjobë TF në masën (21.9%) sipas nenit 115 Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar	3,010,120	6,440,009	9,450,129
Totali: Gjobë pagesë e vonuar dhe kamatëvonesë sipas sistemit C@ts	19,561,957	41,477,110	61,039,067

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Diferenca negative⁴

Në lekë

Nr subjektsh	Viti	Vlera e tatueshme Diferenca	TVSH Diferenca (+)
99	2020	121,027,228	18,410,001
138	2021	84,665,293	21,882,211
Total		205,692,521	40,292,212

Burimi: DRT Shkodër

Gjithashtu, për vitin 2022 (periudhë ende e pa mbyllur deklarimesh financiare) u konstatuan diferenca negative për 308 raste në vlerën e tatueshme prej 738,987,323 lekë, dhe në TVSH 162,603,126 lekë, objekt verifikimi nga DRT Shkodër në vijim.

Në gjykimin e grupit të auditimit, ky lloj deklarimi është rezultat i një situate ku është kryer importi pa faturë, për të cilën duhet të ishte kryer rivlerësim nga zyra nga ana e inspektorëve të kontrollit nga zyra në zbatim të Ligjit nr. 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar, neni 71, pika b. Nga situatat e mësipërme ku kemi deklarimin e importeve në dogana më të lartë/ulët se ai në tatime jemi në kushtet kur kemi të bëjmë me diferenca materiale në llogaritë, regjistrimet dhe regjistrat e subjekteve përkatëse në lidhje me furnizimet dhe transaksionet e kryera prej tyre, veprime këto në kundërshtim me: *Udhëzimin Nr.24, datë 02.09.2008, i ndryshuar pika 57.1, ku përcaktohet: "Personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo të tatimit mbi fitimin, janë të detyruar të mbajnë llogari, regjistrime dhe regjistra për të gjitha ngjarjet dhe veprimet që përfshijnë furnizimet e kryera nga ana e tyre, furnizimet e marra prej tyre nga persona të tjerë, për të gjitha importet nga jashtë vendit dhe eksportet për jashtë vendit, në përputhje me dispozitat e Ligjit "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", dhe me aktet e tjera të nxjerra në zbatim të tij". Në gjykimin e grupit të auditimit kur deklarimi në dogana është më i lartë se në tatime dhe gjithashtu në rastin që deklarimi në tatime është më i lartë se në dogana jemi në*

³ Për efekt përlllogaritjeje u përzgjedhën diferencat pozitive më të mëdha se 1,000 lekë

⁴ Për efekt përlllogaritjeje u përzgjedhën diferencat negative më të vogla se -1,000 leke

situatën kur diferenca do të konsiderohet si shmangie e TVSH-së dhe TF. Dhe penalizimi për këto shkelje të mos deklarimit të saktë të qarkullimit real duhej të kryhej sipas përcaktimeve ligjore të pikës 1 të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklarates tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: “Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”. Më hollësisht, penalteti:

Në lekë

Zëri/Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021	Total
Vlera e tatueshëm e shmangur (Importi)	121,027,228	84,665,293	205,692,521
TVSH (20%)	18,410,001	21,882,211	40,292,212
Gjobë TVSH në masën (21.9%) sipas nenit 115 Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ⁵	4,031,790	4,792,204	8,823,994
Tatim Fitimi (15%)	18,154,084	12,699,794	30,853,878
Gjobë TF në masën (21.9%) sipas nenit 115 Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar	3,975,744	2,781,254.88	6,756,999
Totali: Gjobë pagesë e vonuar dhe kamatëvonesë sipas sistemit C@ts	26,161,619	20,273,253	46,434,872

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Pra, rezultojnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit gjithsej në vlerën prej 107,473,939 lekë si rezultat i diferencave të deklarimeve të importeve.

Diferenca ne eksport

Nga ana e inspektorëve të zyrës nuk rezulton të jenë kryer monitorimet dhe verifikimet e nevojshme për të kërkuar informacion nga tatimpaguesit mbi këdo diferenca sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 60 “Detyrimi i tatimpaguesit për të dhënë informacion dhe për të lejuar hyrjen në mjediset e veprimtarisë ekonomike” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe për të sistemuar dhe rivlerësuar këto diferenca dhe mospërputhje të konstatuara sipas neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi” dhe neni 71/1 “Letërkujtesa” të Ligjit Nr.9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Nisur nga periudha që po zhvillohet faza në terren e auditimit (viti 2022), nga ana e inspektorëve të monitorimit dhe kontrollit nga zyra duhet të ishin sistemuar dhe vlerësuar këto mospërputhje, maksimumi brenda vitit ushtrimor 2021. Aktualisht deri përfundimit të fazës në terren, këto subjekte rezultojnë me diferenca të pajustificuara dhe të pa rivlerësuara nga administratës tatimore, **efekti i të cilave sjell një mungesë të tatimit mbi vlerën e shtuar (TVSH-së) dhe tatimin mbi fitimin të pa llogaritur dhe njëkohësisht vlerë e munguar në buxhetin e shtetit bashkë me penaltitetet përkatëse, siç paraqiten më konkretisht si në vijim:**

Diferenca pozitive⁶

Në lekë

Nr subjektsh	Viti	Vlera e tatueshme Diferenca
35	2020	55,785,833
41	2021	60,401,419
Total		116,187,252

Burimi: Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

⁶ Për efekt përlllogaritjeje u perzgjodhen diferencat pozitive me te mëdha se 1,000 leke

Gjithashtu, për vitin 2022 (periudhë ende e pa mbyllur deklarimesh financiare) u konstatuan diferenca pozitive për 30 raste në vlerën e tatueshme prej 7,110,337 lekë, objekt verifikimi nga DRT Shkodër në vijim.

Diferenca negative⁷

Në lekë

Nr subjektsh	Viti	Vlera e tatueshme Diferenca
49	2020	195,732,207
85	2021	335,259,374
Total		530,991,581

Burimi: Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Gjithashtu, për vitin 2022 (periudhë ende e pa mbyllur deklarimesh financiare) u konstatuan diferenca negative për 72 raste në vlerën e tatueshme prej 211,164,827 lekë, objekt verifikimi nga DRT Shkodër në vijim.

Nga situatat e mësipërme ku kemi deklarimin në dogana më të lartë/ulët se ai në tatime jemi në kushtet kur kemi të bëjmë me diferenca materiale në llogaritë, regjistrimet dhe regjistrat e subjekteve përkatëse në lidhje me furnizimet dhe transaksionet e kryera prej tyre, veprime këto në kundërshtim me: Udhëzimin Nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar pika 57.1, ku përcaktohet: “Personat e tatueshëm, subjekte të tatimit mbi vlerën e shtuar apo te tatimit mbi fitimin, janë të detyruar të mbajnë llogari, regjistrime dhe regjistra për të gjitha ngjarjet dhe veprimet që përfshijnë furnizimet e kryera nga ana e tyre, furnizimet e marra prej tyre nga persona të tjerë, për të gjitha importet nga jashtë vendit dhe eksportet për jashtë vendit, në përputhje me dispozitat e Ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, dhe me aktet e tjera të nxjerra në zbatim”.

Nga analiza e diferencave të konstatuara nga grupi i auditimit konstatohet se **Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi** nuk ka kryer vlerësimin alternativ për këta subjekte sipas të ardhurave të vetëdeklaruara nga subjekti në kundërshtim me nenin 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika b), ku përcaktohet: Administrata tatimore ka të drejtë të përdorë mënyra alternative vlerësimi të detyrimit tatimor të tatimpaguesit dhe të nxjerrë një vlerësim, në rastet kur: **b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara;**

Në gjykimin e grupit të auditimit kur deklarimi në dogana është më i lartë se në tatime jemi në situatën e shmangies së TF, kurse në rastin që deklarimi në tatime është më i lartë se në dogana jemi në situatën kur diferenca do të konsiderohet si shmangie e TVSH-së dhe TF. Penalizimi për këto shkelje të mos deklarimit të saktë të qarkullimit real duhej të kryhej sipas përcaktimeve ligjore të pikës 1 të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: “Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”. Më hollësisht, penalteti:

Në lekë

Zëri/Emërtimi	2020	2021	Total
Vlera e tatueshme e shmangur (Eksporti)	55,785,833	60,401,419	116,187,252
Tatim Fitimi (15%)	8,367,875	9,060,213	17,428,088
Gjobë në masën (21.9%) sipas nenit 115 Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar	1,832,565	1,984,187	3,816,751
Totali: Gjobë pagesë e vonuar dhe kamatëvonesë sipas sistemit C@ts	10,200,440	11,044,399	21,244,839

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

⁷ Për efekt përlllogaritjeje u perzgjedhen diferencat negative me te vogla se -1,000 leke

Në lekë

Zëri/Emërtimi	2020	2021	Total
Vlera e tatueshëm e shmangur (Eksporti)	195,732,207	335,259,374	530,991,581
TVSH (20%)	39,146,441	67,051,875	106,198,316
Gjobë TVSH në masën (21.9%) sipas nenit 115 Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar	8,573,071	14,684,361	23,257,431
Tatim Fitimi (15%)	29,359,831	50,288,906	79,648,737
Gjobë TF në masën (21.9%) sipas nenit 115 Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar	6,429,803	11,013,270	17,443,073
Totali: Gjobë pagesë e vonuar dhe kamatëvonesë sipas sistemit C@ts	83,509,146	143,038,412	226,547,558

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Pra, rezultojnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit gjithsej në vlerën prej 247,792,397 lekë si rezultat i diferencave në deklarime të eksporteve. Diferencat trajtuar më hollësisht në aneksin bashkëlidhur.

Mbi problematikat e konstatuara në kuadër të plotësimit të deklaratës së TFTH-së

Diferenca të ardhura

Grupi i auditimit analizoi të dhënat e vendosura në dispozicion lidhur me deklaraten tatimore vjetore të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, pra të ardhurave totale të periudhës tatimore (rubrika nr. 8 “Të ardhura” e sistemit informatik C@ts) dhe të ardhurat që i përkasin aktivitetit të tatueshëm të formularit (rubrika nr. 9 “Të ardhura tatimore” e sistemit informatik C@ts), nga ku rezultojnë diferenca mes këtyre deklarimesh, duke rezultuar me risk të shtuar për pasaktësi në llogaritjen e tatim fitimit të thjeshtuar, për të cilat nga ana e DRT Shkodër nuk është mundësuar kryerja e verifikimeve dhe saktësimeve të situatës për llogaritjen e detyrimit në zbatim të nenit 115 “Plotësim i saktë i deklaratës tatimore” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, pika 1 e së cilës përcakton se: “Dorëzimi i një deklaratë tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0.06 % të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”. Për këtë situatë, nuk rezultojnë të jenë kryer verifikimet nga ana e inspektorëve të kontrollit nga zyra, për parregullsitë në të ardhurat e deklaruar nga biznesi i vogël për vitin 2020 në 83 raste me një diferencë në vlerë absolute (+/-) prej 39,966 mijë lekë, dhe për vitin 2021 për 78 raste në diferencën 70,331 mijë lekë.

Në lekë

Viti	Subjekte	Të ardhurat ushtrimore	Të ardhurat tatimore	Diferenca ⁸
2020	83	64,983,039	66,306,443	39,966,074
2021	78	93,025,986	73,560,155	70,331,609
Total	161	158,009,025	139,866,598	110,297,6837

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Diferenca shpenzime

Gjithashtu, diferenca u konstatuan edhe në drejtim të shpenzimeve totale të periudhës ushtrimore (rubrika nr. 10 “Shpenzimet e ushtrimit” e sistemit informatik C@ts) dhe shpenzimet që i përkasin aktivitetit të tatueshëm të formularit të deklarimit (rubrika nr. 11 “Shpenzimet tatimore”), të cilat në gjykimin e grupit të auditimit përbëjnë një risk të shtuar për plotësimin e pasaktë të deklaratës për të ulur fitimin real tatimor gjatë vetëdeklarimit. Për këtë situatë, nuk rezultojnë të jenë kryer

⁸ Diferenca në vlerë absolute e përlllogaritur në total për të dyja raste (+ose-)

verifikimet nga ana e inspektorëve të kontrollit nga zyra, për parregullsitë në të ardhura e deklaruar nga biznesi i vogël për vitin 2020 në 134 raste me një diferencë në vlerë absolute (+/-) prej 53,775 mijë lekë, dhe për vitin 2021 për 123 raste në diferencën 131,743 mijë lekë.

Në lekë

Viti	Subjekte	Shpenzimet ushtrimore	Shpenzimet tatimore	Diferenca ⁹
2020	134	53,029,129	75,535,388	53,775,201
2021	123	92,389,460	98,425,669	131,743,477
Total	257	145,418,589	173,961,057	185,518,678

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Lidhur me diferencat e konstatuara në pagesat e tatimit të thjeshtuar për përlogaritjen e shkallës tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, nevojitet kryerja e analizës për çdo rast për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, sipas qarkullimit vjetor të tatimpaguesit dhe shkallës së tatimit objekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim që ka qenë në atë periudhë në fuqi për këtë kategori tatimpaguesish.

Mbi diferencat mes deklarimit të TVSH-së (FDP) dhe tatim fitimit

Grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me deklarimet e TVSH-së dhe atyre të tatim fitimit për periudhën nën auditim, nga ku rezultuan diferenca si në xhiro sipas shitjeve më të larta se deklarata e tatim fitimit, ashtu edhe në xhiro sipas shitjeve më të ulta se deklarata e tatim fitimit, për të cilat nga ana e inspektorëve nuk janë kryer monitorimet dhe verifikimet e nevojshme për këto diferenca, sipas nenit 60 “Detyrimi i tatimpaguesit për të dhënë informacion dhe për të lejuar hyrjen në mjediset e veprimtarisë ekonomike” të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar, pika 3 e së cilit; si dhe për të kryer më pas sistemimin dhe rivlerësimin e diferencave në zbatim të nenit 71 “E drejta për të përdorur metoda alternative vlerësimi” dhe nenit 71/1 “Letërkujtesa” e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar. Aktualisht, gjatë periudhës së auditimit në terren këto diferenca nuk janë sistemuar, duke sjellë mungesë të tatim fitimit të pa llogaritur dhe TVSH-së (sipas diferencës, pra pozitive apo negative) shoqëruar edhe me penalitetet përkatëse, trajtuar më hollësisht në aneksin bashkëlidhur. Për sa më sipër konstatohen mangësi në drejtim të marrjes së masave nga ana e inspektorëve të zyrës, për të kryer sistemimet dhe rivlerësimet në diferencat e konstatuara, në zbatim të nenit 71 dhe 71/1 të ligjit, ku penalizimi respektiv përcaktohet në pikën 1 të nenit 116 për TVSH-në e papaguar si më poshtë:

Analiza e diferencave kur vlera në deklaraten e TVSH-së, është më e vogël se në deklaraten e Tatimit mbi Fitimin.

Në lekë

Viti	Nr Subjektesh	Të ardhura FDP-TVSH	Të ardhura Deklarata TF	Konkluzioni mbi Diferenca (-)
2020	32	2,879,429,138	3,390,709,794	27,612,829
2021	30	2,762,024,300	3,343,523,383	81,327,484
Total	62	5,641,453,438	6,734,233,177	108,940,313

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Në lekë

Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021	Total
Diferenca	27,612,829	81,327,484	108,940,313
TVSH (20%)	5,522,566	16,265,497	21,788,063
Penaliteti sipas nenit 115 (0.06%*365 dite)	1,209,442	3,562,144	4,771,586
Total	6,732,008	19,827,641	26,559,648

⁹ Diferenca në vlerë absolute e përlogaritur në total për të dyja raste (+ose-)

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

- Për vitin 2020 rezultuan 32 subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të vogël se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën 27,612,829 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 6,732,008 lekë. Për vitin 2021 rezultuan 30 subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të vogël se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën 81,327,484 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 19,827,641 lekë.

Analiza e diferencave kur vlera në deklaratën e TVSH-së është më e madhe se në Tatimin mbi Fitimin.

Në lekë

Viti	Nr Subjektesh	Të ardhura FDP-TVSH	Të ardhura Deklarata TF	Konkluzioni mbi Diferenca (+)
2020	15	1,385,718,495	798,559,112	514,038,736
2021	17	1,165,315,939	921,377,216	205,687,978
Total	32	2,551,034,434	1,719,936,328	719,726,714

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Në lekë

Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021	Total
Diferenca midis të ardhurave TVSH-TF	514,038,736	205,687,978	719,726,714
TF munguar (15%)	77,105,810	30,853,197	107,959,007
Gjobë në masën (0.06% * 365 ditë) sipas nenit 115	16,886,172	6,756,850	23,643,022
Totali: Gjobë pagesë e vonuar dhe kamatëvonesë sipas sistemit C@ts	93,991,983	37,610,047	131,602,030

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Për vitin 2020 rezultuan 15 subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të madh se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën 514,038,736 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 93,991,983 lekë. Për vitin 2021 rezultuan 17 subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të madhe se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën 205,687,978 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 37,610,047 lekë.

Pra, rezultojnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit gjithsej në vlerën prej 158,161,678 lekë, si rezultat i diferencave në deklarime për efekt të TVSH-së dhe TF-së.

Gjatë periudhës nën auditim, janë sistemuar diferencat pas konstatimit të grupit të auditimit për ekzistencën e tyre, si më poshtë:

NIPT	Subjekti	TA TF 20-A	TA TF 21-A	TA TVSH 20-A	TA TVSH 21-A	Diferenca 20-A	Diferenca 21-A	Inspekt or/e
X	M	8,969,389	6,572,029	7,201,644	6,545,519	-1,767,745	-26,510	R.R.
X	ML	22,840,811	36,770,690	22,878,685	36,791,729	37,874	21,039	U.A.
X	A.B.	20,360,046	42,351,102	20,360,046	41,472,536	0	-878,566	U.A.
X	T		6,500,000		4,369,365	0	-2,130,635	Dh.D.
X	AB	1,784,995	2,747,772	1,784,996		1	-2,747,772	Xh. U.
X	UM	460,165	1,897,475	460,165		0	-1,897,475	Xh. U.
X	PM	135,718,891	379,098	135,086,653	318,502	-632,238	-60,596	XH. U.
X	EB	8,071,514	9,395,930	8,071,514	7,500,100	0	-1,895,830	Xh. U.

X	I	114,676,447	144,152,596	114,596,428	144,152,594	-80,019	-2	A. Ç.
X	K	20,474,518	29,274,097	20,421,211	29,246,407	-53,307	-27,690	A. Ç.
X	IA	13,677,640	12,698,256	13,742,790	12,635,785	65,150	-62,471	A. Ç.
X	Q	3,853,599	3,750,578	3,729,157	3,750,578	-124,442	0	A. Ç.
X	MD	52,243,601	39,124,472	53,780,517	40,686,593	1,536,916	1,562,121	M.H.
Total diferenca me vlere absolute						4,297,692	11,310,707	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

- Analiza e diferencave të qarkullimit kasave fiskale dhe deklarimit në sistem.

Nga grupi i auditimit u kryqëzuan dhe u përpunuan të dhënat dhe informacionet e marra nga IT pranë DRT Shkodër në lidhje me kasat fiskale dhe gabimet e kasave, për të nxjerrë xhiron e korrigjuar të subjekteve, të cilat u krahasuan me xhiron/qarkullimin e subjekteve sipas deklaratave të TTHF dhe TVSH për subjektet e vogla pa TVSH, me TVSH dhe subjekte të mëdha nga ku rezultuan diferenca të pajustificuara. Në mënyrë të detajuar janë paraqitur në anekse xhirot e kasave të korrigjuara të zhveshura nga vlera e shtuar (TVSH-ja) dhe krahasimi me qarkullimin sipas deklaratave të TTHF dhe TVSH. Qarkullimi i korrigjuar sipas kasës duke e zhveshur nga TVSH, u krahasua me shumatoren e plotë të kategorive: shitje të përjashtuara nga TVSH, shitje pa TVSH, eksporte mallrash, furnizime me shkallë 0%, shitje të tatueshme me shkallë 20%, shitje të tatueshme me shkallë 10%, shitje të tatueshme me shkallë 6%, shitje të tatueshme sipas regjimeve të agjentit të udhëtimit/të marzhit të fitimit/të shitjeve në ankand kurse në rastin e deklaratës së TTHF u krahasua me rubrikën “Të Ardheura”. Nga grupi i auditimit është vlerësuar risku dhe në testim u morën rastet kur qarkullimi sipas kasës rezultonte më e madhe se qarkullimi sipas deklaratës së TVSH-së/TTHF, ku u konstatuan diferenca si në vijim. Informacioni u kërkuar fillimisht në datën 15.09.2022, ku pas sqarimeve me subjektin munda të dërgohej i plotë në datën 04.11.2022. Pas përzgjedhjes së kampionit të parë në datën 15.11.2022, u dërgua informacioni në datën 22.11.2022, i pasqyruar me dokumentacionin mbështetës. Më pas u përzgjodh një tjetër kampion (email datës 23.11.2022), i cili deri në përfundim të auditimit nuk u vendosur në dispozicion, pavarësisht rikujtesave të shpeshta.

Pas përzgjedhjes së një kampioni lidhur me identifikimin e shkaqeve të këtyre diferencave dhe hapave të ndërmarra nga DRT Shkodër për sistemimin e tyre, sipas komenteve të përcjella nga inspektorët përkatës, si shkak i diferencave paraqitej fakti se: “Raportet e fundit të nxjerra nga AKSHI nuk pasqyrojnë vlerat e pajisjeve fiskale të cilat janë çregjistruar”, apo “Tek raporti i fiskalizmit dalin edhe importet sikur janë shitje” për të cilin grupi konkludon në pamundësi për paraqitjen e informacionit përkatës në kushtet kur nga strukturat tatimore nuk mundësohen statistikën e kësaj periudhe për kryerjen e verifikimeve përkatëse (këto raste nuk janë përfshirë në përlogaritjen e detyrimeve dhe do të trajtohen si raste të veçanta). Në disa raste të tjera, diferencat janë sistemuar pas kërkesës së grupit për identifikimin e shkaqeve të tyre, pavarësisht se këto hapa duhet të ishin ndërmarrë nga inspektorët përkatës sipas periudhave respektive, në përmbyllje të detyrave të tyre funksionale. Në kushtet ku për asnjë rast nuk janë paraqitur evidencat përkatëse, grupi i auditimit e ka të pamundur të konkludojë nëse ato janë të justifikueshme apo jo, pasi nga ana e inspektorëve nuk rezultojnë të jenë ndërmarrë veprimet e duhura sikundër përcakton manuali, pjesë e detyrave të tyre funksionale për sistemimin e diferencave, apo shoqërimin e tyre me dokumentacionin që vërteton komunikimet shkresore në kohë me subjektet për shkaqet e diferencave.

Nga analiza e diferencave të konstatuara nga grupi i auditimit konstatohet se **Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi** nuk ka kryer vlerësimin alternativ për këta subjekte sipas të ardhurave

të vetëdeklaruar nga subjekti në kundërshtim me nenin 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika b), ku përcaktohet: Administrata tatimore ka të drejtë të përdorë mënyra alternative vlerësimi të detyrimit tatimor të tatimpaguesit dhe të nxjerrë një vlerësim, në rastet kur: **b) deklarata tatimore përmban të dhëna të pasakta ose të falsifikuara.** Penalizimi për këto shkelje të mos deklarimit të saktë të qarkullimit real duhej të kryhej sipas përcaktimeve ligjore të pikës 1 të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: “Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”.

Mungesa e veprimeve konkrete monitoruese dhe rregulluese nga ana e administratës së DRT Shkodër ka bërë që procesi i vetëdeklarimit të të ardhurave nga ana e subjekteve të paraqitet me shumë mangësi dhe parregullsi me ndikime dhe kosto të lartë në të ardhurat tatimore, veprime dhe mosveprime këto të cilat çenojnë parimet e administrimit tatimor të parashikuara në nenin 12 pikat a, b, ç, dh të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe UMF Nr.24 datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 12/a, ku përcaktohet se:

- a. zbatimi i njëjtë dhe efektiv i legjislacionit nga ana e administratës tatimore;
- b. vetëvlerësimi dhe vetëdeklarimi i detyrimit tatimor nga ana e tatimpaguesit;
- ç. hartimi i strategjive dhe marrja e masave përkatëse për pakësimin e rreziqeve që rezultojnë nga mosrespektimi i legjislacionit tatimor;
- dh. ndjekja e ndryshimeve në mjediset e biznesit dhe atij legjislativ, si dhe përshtatja e sistemeve të organizimit të burimeve, të teknologjisë së informacionit dhe proceseve të punës, për arritjen e efikasitetit dhe të efektivitetit të duhur;

Në vijim paraqiten analizat e diferencave të konstatuara nga ana e grupit të auditimit së bashku me llogaritjen e penalteteve të munguara si pasojë e mosveprimeve dhe mos marrjen e masa konkrete verifikuese dhe rregulluese nga ana e punonjësve të kontrollit nga zyra dhe eprorëve të tyre.

a. Nga analiza e diferencave në qarkullim midis xhiros së korrigjuar të kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TTHF për bizneset e vogla pa TVSH, rezultuan si më poshtë:

- Analiza e diferencave të vitit 2020.

Në lekë

Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të Ardhura Deklarata TTHF	Diferenca (+)
266	154,518,926	57,790,244	96,728,682

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

- Analiza e diferencave të vitit 2021.

Në lekë

Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të Ardhura Deklarata TTHF	Diferenca (+)
181	322,174,719	192,599,695	129,575,024

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Penaliteti përkatës për llogaritjet:

Në lekë

	Viti 2020	Viti 2021	Total
Vlera e tatueshme Diferenca	96,728,682	129,575,024	226,303,706
Detyrim TTHF (5%)	4,836,434	6,478,751	11,315,185
Gjohë TTHF (21.9% sipas nenit 115)	1,059,179	1,418,846	2,478,026

Total Detyrim Shtesë	5,895,613	7,897,597	13,793,211
-----------------------------	------------------	------------------	-------------------

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Pra, për vitin 2020 rezultuan 266 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTHF-së në vlerën 96,728,682 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 5,895,613 lekë. Për vitin 2021 rezultuan 181 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTHF-së në vlerën 129,575,024 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 7,897,597 lekë.

b Nga analiza e diferencave në qarkullim midis xhiros së korrektuar të kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TVSH-së (FDP) për bizneset e vogla me TVSH, rezultuan si më poshtë:

- Analiza e diferencave të vitit 2020.

Në lekë

Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të Ardhura Deklarata TVSH	Diferenca (+)
570	942,391,048	312,670,620	629,720,428

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

- Analiza e diferencave të vitit 2021.

Në lekë

Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të Ardhura Deklarata TVSH	Diferenca (+)
22	93,152,366	73,632,314	19,520,052

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Penaliteti i përlogaritur sipas:

Në lekë

Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021	Total
Vlera e tatueshme (Diferenca)	629,720,428	19,520,052	649,240,480
Detyrim TVSH (20%)	125,944,086	3,904,010	129,848,096
Gjobë TVSH (21.9% sipas nenit 115)	27,581,755	854,978	28,436,733
Detyrim TF (15%)	94,458,064	2,928,008	97,386,072
Gjobë TF (21.9% sipas nenit 115)	20,686,316	641,234	21,327,550
Total Detyrim Shtesë	268,670,221	8,328,230	276,998,451

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Pra, për vitin 2020 rezultuan 570 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTHF-së në vlerën 629,720,428 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 629,720,428 lekë. Për vitin 2021 rezultuan 22 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTHF-së në vlerën 19,520,052 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 8,328,230 lekë.

c. Nga analiza e diferencave në qarkullim midis xhiros së korrektuar të kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TVSH-së (FDP) për bizneset e mëdha me TVSH, rezultuan si më poshtë:

- Analiza e diferencave të vitit 2020.

Në lekë

Nr Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të ardhura Deklarata TVSH	Diferenca (+)
1	2,326,140	1,891,510	434,630

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

- Analiza e diferencave të vitit 2021.

Në lekë

Nr Subjekte	Qarkullimi sipas Kasës	Të ardhura Deklarata TVSH	Diferenca (+)
158	2,809,890,566	2,094,683,424	715,207,142

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Penaliteti i përllogaritur sipas:

Në lekë

Emërtimi	Viti 2020	Viti 2021	Total
Vlera e tatueshme (Diferenca)	434,630	715,207,142	715,641,772
Detyrim TVSH	86,926	143,041,428	143,128,354
Gjobë TVSH (21.9% sipas nenit 115)	19,037	31,326,073	31,345,110
Detyrim TF	65,195	107,281,071	107,346,266
Gjobë TF (21.9% sipas nenit 115)	14,278	23,494,555	23,508,832
Total Detyrim Shtesë	185,435	305,143,127	305,328,562

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

- Për vitin 2020 rezultoi 1 subjekt i cili kishte qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTHF-së në vlerën 434,630 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 185,435 lekë. Për vitin 2021 rezultuan 158 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTHF-së në vlerën 715,207,142 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 305,143,127 lekë.

Pra, rezultojnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit gjithsej në vlerën prej 596,120,224 lekë si rezultat i diferencave me kasën dhe deklaratat e TF apo TTHF.

Gjithashtu, në aneksin më poshtë janë trajtuar më vete rastet në të cilat sipas komenteve të inspektorëve, shkak i diferencës lidhet me faktin se raportet e fundit të nxjerra nga AKSH-i nuk pasqyrojnë vlerat e pajisjeve fiskale të cilat janë çregjistruar, të cilat janë trajtuar më vete në mënyrë që të ndiqen nga DRT Shkodër pas dërgimit të informacionit të saktë nga AKSHI, në kushtet kur informacioni i saktë nuk u vendos në dispozicion gjatë auditimit në terren. Këto raste nuk u përfshinë në totalin e të ardhurave të munguara.

Marrëveshjet me këste

-Pas riorganizimit të kryer në strukturat tatimore, ndjekja e akt marrëveshjeve ka mbetur nën kompetencën e Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT-ve përkatëse. Gjatë vitit 2021 nga ana e DPT është kryer rishikimi i Manualit të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, ku është hequr kapitulli që më parë parashikonte procedurat që do të ndiqen për zbatimin e marrëveshjeve me këste. Si rezultat, këto procedura nuk janë përfshirë në asnjë prej akteve nënligjore sipas së cilave funksionojnë Drejtoritë e Kontrollit (ndër të tjera edhe DRT Shkodër) dhe si rezultat, procesi që do të ndiqet për akt marrëveshjet me këste rezultoi i pa rregulluar dhe i pa mbuluar me akte administrative, manuale apo udhëzime të DPT, duke cënuar kështu veprimtarinë e këtyre strukturave përgjegjëse për monitorimin e tyre. I vetmi dokument i vendosur në dispozicion është një shkresë sqaruese e përcjellë nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT për atë periudhë, znj. D. I. nr. 18839 prot datë 28.09.2020 me lëndë “Në zbatim të nenit 77 dhe 78 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Sipas informacionit të strukturës së kontrollit nga zyra, për periudhën objekt auditimi gjatë së cilës monitorimi i akt marrëveshjeve ka qenë kompetencë e tyre, rezultojnë të jenë lidhur në total 65 akt marrëveshje me një vlerë totale të tatimit për të cilin është lidhur A-M prej 323,333 mijë lekë, nga të cilat 8 gjatë vitit 2020, 42 gjatë vitit 2021 dhe 15 deri në Qershor të vitit 2022. Nga analiza e kryer rezultoi se 1 akt marrëveshje është transferuar në DRT Tiranë (me vlerë 1,508 mijë lekë); 24 akt marrëveshje janë anuluar (me vlerë totale 168,241 mijë lekë); 28 akt marrëveshje rezultojnë në vazhdim (me vlerë totale 135,815 mijë lekë) (deri në fund të vitit 2022 pra përtej periudhës objekt auditimi) dhe 12 akt marrëveshjeve u ka mbaruar afati (me vlerë 17,769 mijë lekë). Për sa i përket A-M për të cilat ka mbaruar afati, rezultojnë të jenë paguar detyrime në vlerën 17,263 mijë lekë, dhe mbetur pa paguar 521 mijë lekë.

-Nga auditimi u konstatuan mangësi në drejtim të administrimit të të dhënave lidhur me akt marrëveshjet nga struktura përkatëse pranë DRT Shkodër, për shkak të mos rakordimit të totalit të vlerës së akt marrëveshjes me pagesat e kryera dhe vlerës së mbetur pa paguar; një pjesë e informacionit lidhur me pagesat e kryera për marrëveshjet e anuluar u plotësua gjatë auditimit; kishte mungesë të historikut të subjekteve para ndryshimit të përgjegjësisë për monitorimin e tyre, etj; të cilat e kanë kufizuar auditimin në lidhje me vlerësimin e ndjekjes së ecurisë së akt-marrëveshjeve nga ana e Drejtorisë së Kontrollit dhe marrjen e masave në kohë në lidhje me zgjidhjen e tyre për mosplotësim të kushteve.

-Mbi marrëveshjet e anuluar

Situata lidhur me numrin e marrëveshjeve të anuluar për vitin 2021 vendosur në dispozicion nga struktura e kontrollit nga zyra paraqitet si më poshtë:

Nr	Tatimpaguesi	NIPTI	Data e Akt-Marrëveshjes	Shuma tatimit për të cilin është lidhur A-M	Afati zbatueshmerise se A-M	Pagesa te pa kryera ne raport e totalin e vlerës së marrëveshjes
1	KFV	X	29.03.2021	131,551,016	22.12.2022	81%
2	OG	X	29.06.2021	19,057,042	21.12.2022	78%
3	UKP	X	12.01.2021	2,198,994	20.12.2021	100%
4	E	X	15.10.2020	2,751,404	20.12.2021	27%
5	K	X	02.02.2021	1,115,646	01.04.2022	60%
6	AP	X	11.08.2021	2,679,790	29.03.2022	83%
7	UKP,	X	29.09.2021	1,728,619	22.12.2022	100%
8	A	X	18.02.2021	944,466	23.05.2022	94%
9	GB	X	08.11.2021	386,584	20.12.2022	78%
10	KN	X	14.06.2021	746,376	10.06.2022	100%
11	BG	X	10.11.2021	269,835	05.04.2022	71%
12	BTH	X	30.10.2020	697,233	20.10.2021	23%
13	V	X	03.03.2021	637,709	20.10.2022	100%
14	D.G.	X	11.02.2022	551,632	28.05.2022	57%
15	AM	X	17.05.0022	464,000	20.12.2023	100%
16	BM	X	23.02.2021	410,067	22.12.2022	57%
17	AP	X	22.02.2022	432,416	23.08.2022	83%
18	MK	X	17.02.2022	350,636	20.12.2023	97%
19	AG	X	25.05.2021	313,449	25.05.2022	67%
20	B	X	07.10.2020	303,344	20.10.2021	100%
21	K	X	16.12.2021	226,061	21.12.2022	77%
22	SHD	X	12.02.2021	188,631	20.12.2021	100%
23	P	X	14.07.2021	129,544	20.12.2021	100%
24	PE	X	18.03.2022	106,625	20.12.2022	58%

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Nga sa më sipër rezulton se janë anuluar 24 akt marrëveshje të lidhura me subjektet (37% e totalit të akt marrëveshjeve të lidhura). Në tabelë paraqitet edhe përqindja e detyrimeve të mbetura të papaguara deri në momentin e anulimit të tyre, ku 8 raste rezultojnë me 100% detyrim i papaguar në raport me vlerën për të cilën është lidhur akt marrëveshja; 14 raste me mbi 50% dhe vetëm 2 raste me më pak se 50%. Në total vlera e detyrimit për të cilin është lidhur akt marrëveshja e anuluar paraqitet në vlerën 168,241 mijë lekë (52 % e totalit të vlerës së akt marrëveshjeve të lidhura). Nga detyrimi për të cilën është lidhur AM rezultojnë të jenë likuiduar 34,192 mijë lekë, ose vetëm 20% e totalit të vlerës. Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcakton në pikën 78 të tij “Zgjidhja e marrëveshjes së pagesës me këste” se: “Marrëveshja e pagesës me këste mund të zgjidhet nga administrata tatimore në momentin e parë që personi i tatueshëm nuk e respekton atë lidhur me rregullshmërinë e pagesave si dhe kur ai nuk paguan detyrimet e tjera tatimore që lindin gjatë periudhës së mbuluar

nga marrëveshja. Në këtë rast, personi i tatueshëm është i detyruar të paguajnë të gjitha detyrimet tatimore të papaguara që mbulohen nga kjo marrëveshje, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit të zgjidhjes së marrëveshjes. Nëse këto detyrime nuk paguhen, administrata tatimore mbledh detyrimet në përputhje me dispozitat e Kreut XI të Ligjit. ”. Nga ana e strukturave përgjegjëse në DRT Shkodër, për këta tatimpagues nuk është kryer ose nuk ka qenë efektive analiza për të vlerësuar riskun lidhur me përmbushjen e kushteve të marrëveshjes, si dhe nuk është analizuar në mënyrë efektive situata nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore, duke mos respektuar pikën 2 dhe 3 të Nenit 18 të Rregullores së funksionimit të DRT-ve.

-Mbi marrëveshjet e përsëritura

Grupi i auditimit kërkoi informacion lidhur me marrëveshjet e përsëritura, i cili u vendos në dispozicion vetëm për periudhën pasi monitorimi i tyre ka kaluar në kompetencën e drejtorive të kontrollit në DRT (fundi i 2020-2021-2022), pasi këto struktura nuk gjeneronin informacion të mëparshëm për këto akt marrëveshje për periudhën kur monitorimi i tyre kishte qenë nën mbikëqyrjen e drejtorive të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, duke rezultuar kështu me mangësi në drejtim të dorëzimit të punës dhe materialeve përkatëse pas rishpërndarjes së përgjegjësi. Gjithashtu, mungesa e informacionit të strukturës aktuale përgjegjëse për ndjekjen e akt marrëveshjeve, cënon efektivitetin e vendimmarrjes së saj lidhur me këto akt marrëveshje në momentin që nuk është vepruar duke vlerësuar dhe analizuar edhe historikun e mëparshëm të këtyre subjekteve, sikundër përcakton rregullorja e funksionimit të DRT, neni 18 pika 2 përcakton se “*struktura përgjegjëse në DRT pasi merr në dorëzim kërkesat për marrëveshje i analizon ato duke përcaktuar riskun përkatës*” dhe pika 3 “*nëse plotëson kushtet pas analizës harton draft marrëveshjen përkatëse për pagesën me këste duke analizuar për të parë situatën nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore*”; gjithashtu udhëzuesi i përgjithshëm i procedurave të mbledhjes me forcë datë 15.03.2018 pika 10 përcakton se “*Drejtoritë rajonale tatimore mund të lejojnë tatimpaguesit në çdo kohë dhe sa herë që është e nevojshme të lidhë marrëveshje të pagesës me këste, por, në të njëjtën kohë ai duhet të vërtetojë pamundësinë aktuale financiare, si dhe të tregojë që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e marrëveshjes*”. Për të gjykuar në lidhje me pamundësinë financiare mund të shërbejnë pasqyrat financiare të shoqërisë, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet etj;”.

Nga regjistri i vendosur në dispozicion, rezultojnë akt marrëveshjet e përsëritura për subjektet si më poshtë, për të cilët nuk është kaluar në masa të tjera shtrënguese, situatë kjo e cila përbën në nga indikatorët matës për efektivitetin e analizës së kryer nga struktura përgjegjëse pranë DRT Shkodër, lidhur me përmbushjen e kushteve të nevojshme të marrëveshjes dhe situatës sipas përcaktimeve në kuadrin rregullator dhe ligjor në fuqi.

Në lekë

Tatimpaguesi	Nipti	Data e Akt-Marrëveshjes	Shuma tatimit për të cilin është lidhur A-M	Afati zbatueshmeris e se A-M	Pagesat e kryera	Arsyet e anulimit të A-M
UKP	X	12.01.2021	2,198,994	20.12.2021	0	Anuluar Mosrespektim A.M.
UKP	X	29.09.2021	1,728,619	22.12.2022	0	Anuluar Mosrespektim A.M.
E	X	15.10.2020	2,751,404	20.12.2021	2,002,900	Anuluar Mosrespektim A.M.
E	X	25.01.2022	748,504	26.12.2022	566,807	

KFV	X	29.03.2021	131,551,016	22.12.2022	25,581,516	Anulluar Mosrespektim A.M.
KFV	X	22.10.2021	62,481,539	21.12.2022	13,388,901	
OG	X	29.06.2021	19,057,042	21.12.2022	4,241,383	Anulluar Mosrespektim A.M.
OG	X	19.01.2022	23,217,913	19.12.2022	15,652,959	

Burimi: DRT Shkodër

BM me TF me humbje për 3 vite të njëpasnjëshme

Nga testet e kryera dhe kryqëzimi i të dhënave të vendosura në dispozicion nga IT, kanë rezultuar 30 subjekte, të cilët kanë deklaruar humbje tatimore për 3 vite të njëpasnjëshme për të cilat nga ana e Sektorit të Kontrollit Tatimor dhe Monitorimit nga Zyra, nuk dokumentohet puna për kryerjen e një analize të hollësishme sipas inspektorëve për evidentimin e këtyre subjekteve, arsyet dhe argumentimin e humbjes, vlerësimin në rritje të të ardhurave apo ulje të shpenzimeve, sipas informacioneve me shkrim që duhet të kishin kërkuar tatimpaguesve apo letërkujtesave, veçanërisht për bizneset e BM kategoria e të cilave cilësohet si me një risk më të madh.

Në lekë

Viti	Humbja e deklaruar në total
2019	103,496,017
2020	79,397,130
2021	82,530,487

Burimi: DRT Shkodër

Për sa më sipër konstatohet një monitorim i dobët për këto biznese, për kategorinë BM, i cilësuar me risk të lartë. Nga ana e Sektorit të Kontrollit Tatimor dhe Monitorimit nga Zyra për BM, nuk dokumentohen shkresa për kalimin/propozimin e kontrolleve në Drejtorinë e Kontrollit. Nga këto subjekte, 11 prej tyre rezultojnë me humbje 3 vite rresht, mbi 1,000,000 lekë, për të cilat DRT Shkodër nuk dokumentohet të ketë kërkuar në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 104 “Fillimi i procedurave të falimentimit”, të Ligjit 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenit 14 “Kërkesa për hapjen e procedurës së falimentimit” të Ligjit Nr.8901 datë 23.05.2002 “Për Falimentimin”, i ndryshuar dhe nenit 16 “Kërkesat e kreditorit” të Ligjit Nr.110/2016 datë 27.10.2016 “Për falimentimin”, i ndryshuar i cili parashikon fillimin e procedurës së falimentimit për tatimpaguesit, shoqëri tregtare që deklarojnë me humbje të kapitaleve të veta për të paktën 3 vite rresht për të cilat DRT ka detyrimin të kryejë verifikimet e nevojshme dhe të kërkojë në gjykatë fillimin e procedurës kundrejt një tatimpaguesi nëse ai plotëson kushtet e parashikuara për falimentim. Mos fillimi i procedurës për këta tatimpagues përbën mangësi të theksuara në kryerjen e detyrave funksionale nga punonjësit e ngarkuar të DRT Shkodër.

BV me TTTF me humbje tatimore për 3 vite të njëpasnjëshme

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion rezultojnë 55 subjekte të cilët kanë deklaruar humbje tatimore për 3 vite të njëpasnjëshme, për të cilat nga Sektori i Kontrollit Tatimor dhe Monitorimit nga Zyra për BV, nuk ka një analizë të hollësishme sipas inspektorëve për evidentimin e këtyre subjekteve, arsyet dhe argumentimin e humbjes, vlerësim në rritje të të ardhurave apo ulje të shpenzimeve, sipas informacioneve me shkrim që duhet të kishin kërkuar tatimpaguesve apo letërkujtesave.

Në lekë

Viti	Humbja
2019	10,984,495
2020	18,595,18

2021	55,093,595
------	------------

Burimi: DRT Shkodër

Nga ky total rezultojnë 11 tatimpagues që kanë deklaruar për 3 vite rresht humbje mbi 500,000 lekë për të cilat konstatohet një monitorim i dobët për këto biznese, në kategorinë BV, ku nuk dokumentohen shkresa për kalimin/propozimin e kontrolleve në Drejtorinë e Kontrollit apo kërkimin në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit në kundërshtim me dispozitat ligjore përkatëse. Mos fillimi i procedurës për këta tatimpagues përbën mangësi të theksuara në kryerjen e detyrave funksionale nga punonjësit e ngarkuar të DRT Shkodër.

-Nisur nga deklarata e tatim fitimit të vitit 2020 si dhe 2021 si dhe të dhënave të përpunuara nga sistemi informatik C@ts, u kërkuar të dhëna lidhur me totalin e subjekteve rezultojnë debitorë në mos likuidimin e tatim fitimit të vetëdeklaruar në DRT Shkodër, informacioni i saktë i të cilit nuk u vendos në dispozicion deri në përfundim të periudhës së auditimit apo pas dorëzimit të akt konstatimeve.

Biznese pa ndryshuar përgjegjësinë tatimore të TVSH-së

Grupi i auditimit kërkoi vendosjen në dispozicion të të dhënave mbi subjektet që nuk kanë ndryshuar përgjegjësinë tatimore të TVSH-së, pavarësisht tejkalimit të kufirit sipas deklaratave të TTHF në zbatim të VKM-së Nr.953 datë 29.12.2014, Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; Vendimit Nr.652, datë 10.11.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.953, Datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr 92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; Vendimit Nr.576, datë 22.7.2020 “Për disa ndryshime në Vendimin Nr. 953, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për Dispozitat Zbatuese të Ligjit Nr.92/2014, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; si dhe përcaktimet e dispozitave të Ligjit 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar neni 122 pika 1, e cila përcakton se: *“Kur kufiri minimal i regjistrimit për TVSH-në tejkalohet më parë se 12 muaj, atëherë personi i tatueshëm duhet të kërkojë të regjistrohet menjëherë brenda 15 ditëve nga data e kalimit të kufirit. Data e kalimit të kufirit konsiderohet dita e fundit e muajit kalendarik, në të cilin realizohet tejkalimi i kufirit minimal të regjistrimit”*; Pika 7, neni 5, të UMF Nr.6 datë 30.01.2015 “Për TVSH-në”, ku përcaktohet se: *“Detyrimet për TVSH-në për furnizimet (shitjet) e kryera për periudhat e mëparshme që ka qenë i detyruar të regjistrohej, i llogariten me efekt nga data kur ka qenë i detyruar të regjistrohej. Këto detyrime do të vlerësohen në regjistrin e TVSH-së në emër të personit të tatueshëm në periudhën e parë që ai regjistrohet për TVSH-në”*. Manual për Kontrollin nga Zyra, pika 4 “Objekt i punës të kontrollit tatimor nga zyra”, ku përcaktohet se: *“Analizon dhe nxjerr konkluzione nëpërmjet kryqëzimit të librave të shitjes dhe të blerjes për deklarimin e faturave tatimore të shitjes apo blerjes duke përcaktuar detyra për sistemime e rivlerësime të ndryshme tatimore kur është e nevojshme”*. Pika 9 “Kalendari i punëve për strukturat e sektorit të kontrollit nga zyra” “Monitorojnë dhe ndjekin volumin e qarkullimit të tatimpaguesve dhe kur kanë të dhëna se volumi i qarkullimit të kalon kufirin e regjistrimit në TVSH apo në tatim fitimi, bëjnë sipas rastit ndryshimin e përgjegjësisë tatimore të tatimpaguesit”; pikës 1 të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, të Ligjit Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: *“Dorëzimi i një deklarate tatimore të pasaktë dënohet me një gjobë të barabartë me 0,06 për qind të shumës së detyrimit të papaguar për çdo ditë, gjatë së cilës pagesa nuk është kryer. Në asnjë rast, gjoba nuk llogaritet për një periudhë më të gjatë se 365 ditë kalendarike”*.

Nga ana e DRT Shkodër u raportua se nuk ka raste të tatimpaguesve të cilët nga informacioni i transmetimeve me pajisje fiskale kanë xhiro mbi 10,000,000 lekë dhe nuk janë aktivizuar për TVSH. Nga ana tjetër ka patur 3 tatimpagues të cilët sipas transmetimeve me pajisje fiskale kanë xhiro mbi 10,000,000 lekë, por nga ana tjetër kanë dorëzuar proces verbalet “Mbi pasqyrimin e saktësisimit të një gabimi nga veprimi i pandërgjegjshëm në përdorimin e pajisje fiskale” por nuk janë pasqyruar në raportin e IT për periudhat përkatëse. Për këto raste u kërkua vendosja në dispozicion e dokumentacionit mbështetës, të cilat nuk u përcollën për grupin e auditimit deri në përfundim të auditimit në terren, por u dërguan me dokumentacionin e përcjellë së bashku me observacionet pas dorëzimit të akt konstatimeve (kërkesat dhe procesverbalet për 3 rastet).

- Rishikimi i kësteve të tatimit mbi fitimin.

Nga grupi i auditimit janë shqyrtuar vlerësimet e kërkesave të subjekteve në format excel të siguruar nga IT për uljen e kësteve të tatim fitimit për periudhën objekt auditimi, paraqitur si më poshtë:

Në lekë

Nipti	Kësti fillestar	Kësti përfundimtar	Paguar këste	Tatim fitimi	Parapag ime	Diferenca në %	Diferenca në vlerë	Data e Kërkesës
X	2,856,161	2,181,156	3,941,947	4,548,158	606,211	650%	3,941,947	10.07.2020
X	7,540,063	3,370,295	1,463,794	1,720,294	0	0%	1,720,294	26.08.2020
X	879,649	626,914	1,170,916	778,754	0	0%	778,754	30.09.2020
X	3,503,442	2,814,462		144,708	144,708	0	0	28.09.2020
X	5,254,181	3,665,318		0	0	0	0	17.09.2020
X	1,559,394	827,122	262,860	0	0	0	0	31.08.2020
X	3,326,484	2,108,714	448,277	448,277	0	0	448,277	27.07.2020
X	407,562	223,406	204,656	0	0	0	0	31.08.2020
X	3,020,302	1,496,782	3,938,400	3,938,418	0	0	3,938,418	25.06.2020
X	1,146,351	869,193	656,906	11,209	0	0	11,209	30.09.2020
X	2,730,637	2,104,219	748,169	0	0	0	0	30.09.2020
X	331,009	163,489	285,008	229,208	45,812	366%		21.12.2020
X	794,513	268,931	202,667	454,199	0	0	454,199	20.05.2021
X	2,586,928	1,703,840	1,081,020	544,609	0	0	544,609	27.08.2021
X	740,481	370,413		0	0	0	0	26.11.2021
X	4,839,841	2,525,004	1,926,839	833,781	0	0	833,781	10.05.2021
Totali i diferencave							12,671,488	
Penaliteti sipas Udhëzimit Nr.5 datë 30.01.2006 i ndryshuar, pika 3.13. Parapagimet							633,574	

Burimi: Përpunuar nga grupi i auditimit sipas të dhënave të DRT Shkodër

Në zbatim të ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Neni 3 “Parapagimet”, pika 5 e cila citon se : “Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, vërteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrit të Financave. Në rast se subjekti ka ulur kështu e parapagimit, të caktuara nga organi tatimor, dhe detyrimi tatimor vjetor për tatim fitimin, që rezulton nga bilanci, tejkalon parapagimin me më shumë se 10%, subjekti duhet të paguaj kamatëvonesa mbi diferencën ndërmjet detyrimit real vjetor dhe shumës së parapaguar gjatë vitit, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrit të Financave”; si dhe udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.13. “Parapagimet” , çështja 3.13.3 “Korrigjimi në ulje i kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin” e cila citon se: “Si fakte të cilat mund të argumentojnë kërkesën për uljen e kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin mund të merren:

-Shitjet gjithsej të realizuara dhe të deklaruara nga tatimpaguesi, për muajt e kaluar të vitit vijues, në raport me shitjet gjithsej të dy viteve të mëparshme. Nëse këto shitje janë ulur në mënyrë të

dukshme, administrata tatimore pranon uljen e kësteve proporcionalisht me uljen e vëllimit të shitjeve.

-Mungesa në vijim e kontratave të shitjes së mallrave apo shërbimeve, kontratave të punimeve etj., të cilat do ta reduktojnë në mënyrë domethënëse veprimtarinë dhe të ardhurat e tatimpaguesit për muajt e mbetur të vitit vijues për të cilin kërkohet reduktimi i kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin.

-Mbarimi i kontratave mbi bazën e të cilave janë realizuar të ardhurat në vitet e mëparshme, përfundimi i objekteve apo punëve të tjera publike të kryera.

-Fatkeqësi apo dëme të tjera që mund t'i kenë ndodhur tatimpaguesit gjatë vitit vijues dhe që do të çojnë në uljen e volumit të veprimtarisë së tij ekonomike.

-Mbyllja e linjave, veprimtarive të caktuara, shkurtimi i ndjeshëm i fuqisë punëtore si rezultat i tkurrjes së veprimtarisë.

“Me dorëzimin e deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin, në rast se detyrimi tatimor vjetor për tatimin mbi fitimin tejkalon shumën e paguar të kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin me më shumë se 10 për qind, tatimpaguesi detyrohet të paguajë kamatëvonesë, e cila llogaritet në masën 5 për qind për diferencën ndërmjet detyrimit vjetor sipas deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin dhe shumës totale të kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin të paguara gjatë vitit”; si dhe Manuali i Kontrollit nga Zyra, pika 11.4 “Regjistrimi i kësteve të rishikuara të parapagesave të tatimit mbi fitimin”, ku përcaktohet se: “Në rastet kur tatimpaguesi kërkon rishikimin në ulje të kësteve të tatimit fitimit dhe inspektori i kontrollit nga zyra bindet ndaj argumenteve të paraqitura nga tatimpaguesi, bën korrigjimin e kësteve në ulje në bazë të dokumentacionit të paraqitur” u verifikuan rishikimet e kryera për periudhën nën auditim.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

Inspektorët pranë Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit Biznes i madh pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër sipas fashës së nipteve përkatëse (në aneksin bashkëlidhur projekt raportit) për niptet për të cilat janë konstatuar parregullsi në këtë material, duke marrë në konsideratë edhe periudhat e angazhimit të tyre në pozicion sikundër referuar në observacionet përkatëse, pjesë e këtij projektraporti : A.P., Xh.U., L.C., R.R., H.R., E.K., K.P., U.A., M.H., Dh.D., J.G., E.K., A.C., S.S., K.V., D.Gj., Rr.L..

Znj. E.K. në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit Biznes i madh pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër.

Z. A.H. në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor Biznes i madh pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër për periudhën 01.02.2021 deri 01.03.2021 dhe 27.5.2021- ne vazhdim.

Z. A.B. në cilësinë e ish Drejtorit të Kontrollit Tatimor Biznes i vogël pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër për periudhën 01.01.2020 deri 31.10.2020 (i komanduar) .

Z. S.I. në cilësinë e Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër për periudhën 27.05.2021 deri në vazhdim.

z. H.J., në cilësinë e ish Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër për periudhën 01.01.2020-18.08.2020.

z. M.B., në cilësinë e ish Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër për periudhë 18.08.2020-01.03.2021.

z. A.H., në cilësinë e ish Drejtorit Rajonal pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër për periudhë 01.03.2021 -17.05.2021.

Titulli i gjetjes 1: **Diferenca të konsiderueshme të konstatuara në qarkullimin e të ardhurave të deklaruar në kasat fiskale me të ardhurat e deklaruar në deklaratat e TTFH-së dhe TVSH-së; në qarkullimin e deklaruar në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e Tatimit mbi Fitimit për periudhën objekt auditimi.**

Situata 1: Nga auditimi u konstatua se nga ana e DRT Shkodër rezultojnë mangësi në drejtim të detyrimit për saktësimin nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit me qarkullimin më të madh sipas kasës se të ardhurat e deklaruar në deklaratat e TTFH-së dhe TVSH-së, për periudhën objekt auditimi, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e proceduriale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:

a. Nga analiza e diferencave në qarkullim midis xhiros së korrektuar të kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TTFH, për bizneset e vogla pa TVSH, u konstatua se:

- Për vitin 2020 rezultuan 266 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTFH-së në vlerën 96,728,682 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 5,895,613 lekë.

- Për vitin 2021 rezultuan 181 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTFH-së në vlerën 129,575,024 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 7,897,597 lekë.

b. Nga analiza e diferencave në qarkullim midis xhiros së korrektuar të kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TVSH-së (FDP) për bizneset e vogla me TVSH, rezultuan si më poshtë:

- Për vitin 2020 rezultuan 570 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTFH-së në vlerën 629,720,428 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 268,670,221 lekë.

- Për vitin 2021 rezultuan 22 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTFH-së në vlerën 19,520,052 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 8,328,230 lekë.

c. Nga analiza e diferencave në qarkullim midis xhiros së korrektuar të kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TVSH-së (FDP) për bizneset e mëdha me TVSH, rezultuan si më poshtë:

- Për vitin 2020 rezultuan 1 subjekt i cili kishte qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTFH-së në vlerën 434,630 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 185,435 lekë.

- Për vitin 2021 rezultuan 158 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTFH-së në vlerën 715,207,142 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 305,143,127 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, neni 115, UMF nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 71, pika 115, Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin Nr.19 (Nr.1482/2., prot) datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave, Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin

Situata 2:

nr.192, datë 12.08.2020 të Ministrit të Financave, Manualit të Kontrollit nga Zyra. Pra, rezultojnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit gjithsej në vlerën prej 596,120,224 lekë.

Nga auditimi u konstatua se nga ana e DRT Shkodër rezultojnë mangësi në drejtim të detyrimit për saktësimin nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit me diferenca të pajustificuara midis qarkullimit të deklaruar në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e Tatimit mbi Fitimit, për periudhën objekt auditimi , në kundërshtim me përcaktimet ligjore e proceduriale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:

- Për vitin 2020 rezultuan 32 subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të vogël se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën 27,612,829 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 6,732,008 lekë. Gjithashtu rezultuan 15 subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të madh se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën 514,038,736 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 93,991,983 lekë.

- Për vitin 2021 rezultuan 30 subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të vogël se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën 81,327,484 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 19,827,641 lekë. Gjithashtu rezultuan 17 subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të madh se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën 205,687,978 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 37,610,047 lekë.

Pra, rezultojnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit gjithsej në vlerën prej 158,161,678 lekë, si rezultat i diferencave në deklarime për efekt të TVSH-së dhe TF-së.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 60, neni 71, neni 71/1, neni 115, UMF nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 60, pika 71, pika 71/1, pika 115, Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin Nr.19 (Nr.1482/2., prot) datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave, Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr.192, datë 12.08.2020 të Ministrit të Financave, Manualit të Kontrollit nga Zyra. Gjatë auditimit u sistemuan nga ana e inspektorëve pas konstatimit të grupit diferencat në vlerë absolute për vitin 2020 në vlerën 4,297,692 lekë, dhe 2021 në vlerën 11,310,707 lekë për 13 raste.

Situata 3:

-Nga auditimi u konstatuan problematika të shumta të lidhura me sistemet sipas së cilave bazohet aktiviteti i punonjësve të sektorit, konfirmuar edhe nga ta nëpërmjet observacioneve të tilla si: me inkorporimin e sistemit të ri fiskal CPCM i cili ka patur mungesë informacioni dhe keqfunksionime si rezultat i të cilave kanë ndodhur shumë problematika në deklarimin e importeve dhe eksporteve në disa raste duke i dubluar ato; Sistemi i kasave Nexus është jashtë funksionit për të kryer verifikime; Raportet e fundit nga

Kriteri:

AKSh-i nuk pasqyrojnë vlerat e pajisjeve fiskale të çregjistruara, duplikime në sistemin selfcare; mangësi dhe mospërputhje me sistemin e vjetër, mungesë aksesit në raportet e kasave; mungesë aksesit për të eksportuar ne excel apo për të aksesuar raportet e shkarkuara nga ana e IT-së çdo muaj për kasat/pajisjet fiskale/ sigurimet/deklaratat e TVSH-ve apo te TTHF,TF,etj.

- Ligji Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, neni 115;

- UMF Nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; pika 71, pika 115;

- Rregullore e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020. të Ministrit të Financave;

- Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin Nr.19 (Nr.1482/2., prot) datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave;

- Manual i Kontrollit nga Zyra

Ndikimi/Efekti:

Vlera të munguara në buxhetin e shtetit (596,120,224 lekë nga diferencat me kasën dhe 165,461,393 lekë nga diferencat e deklaratës së TF dhe TVSH).

Shkaku:

Menaxhim jo efektiv nga strukturat respektive të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për biznesin e madh dhe të vogël sipas detyrave funksionale përkatëse.

Rëndësia:

E lartë.

Rekomandimi 1:

-Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për diferencat e pajustificuara, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në zërat e Tatimit mbi Fitimin, Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH-së në shumën 596,120,224 lekë si rezultat i diferencave me kasën për 1198 raste; dhe si rezultat i diferencave mes të ardhurave të TF dhe TVSH në shumën 158,161,678 lekë për 94 raste, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse si dhe kryerjen e propozimeve përkatëse Sektorit të Kontrollit Operacional në DRT Shkodër për kontrollet e thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

- Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër në bashkëpunim me DPT-në në cilësinë e institucionit epror përgjegjës, t'i drejtohen AKSHI-t me shkresë zyrtare për problematikën e hasura gjatë kryerjes së detyrave funksionale të punonjësve tilla si: normalizimin e situatës së funksionimit të sistemit informatik tatimor dhe rikthimin e dokumentacionit dhe informacionit të fshirë në postën elektronike zyrtare të institucionit; përmirësimin e problematikave të lidhura me inkorporimin e sistemit të ri fiskal CPCPM, zgjidhjen e mangësive dhe mospërputhjeve me sistemin e vjetër ku nevojitet mundësimi i aksesit në sistemin e vjetër të kasave Nexus për të kryer verifikime ; shqyrtimin e mundësisë për hapjen e aksesëve për të eksportuar ne excel apo për të aksesuar raportet e shkarkuara nga ana e IT-së çdo muaj për kasat/pajisjet fiskale/ sigurimet/deklaratat e TVSH-ve apo te TTHF,TF; pasqyrimin e vlerave të pajisjeve fiskale të çregjistruara nga AKSHI, problemeve të regjistrimit të importeve në sistemin selfcare; dublikime, etj; në mënyrë që DRT Shkodër nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe

Monitorimit, të kryejë verifikimet përkatëse për diferencat e konstatuara nga grupi i auditimit.

Titulli i gjetjes 2: **Diferenca të konsiderueshme të konstatuara në vlerën e importeve dhe eksporteve të deklaruar në tatime dhe të deklaruar në doganë, për periudhën objekt auditimi.**

Situata 1: Nga auditimi u konstatua se DRT Shkodër nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit me diferenca të pajustificuara në vlerën e importeve të deklaruar në tatime dhe të deklaruar në doganë konkretisht:

- Për vitin 2020 rezultuan 99 subjekte, deklarimet e importeve të të cilave paraqiten me një qarkullim vjetor të deklaruar në doganë me një diferencë prej 121,027,228 lekë shumë se vlera e deklaruar në tatime, dhe diferencë TVSH prej 18,410,001 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 26,161,619 lekë. Gjithashtu u konstatuan 86 subjekte ku totali i qarkullimit të deklaruar në doganë për importet është më një diferencë prej 91,632,265 lekë më pak se vlera e deklaruar në tatime dhe TVSH me diferencë 12,817,339 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 19,561,957 lekë.

- Për vitin 2021 rezultuan 138 subjekte, deklarimet vjetore të importeve të të cilave paraqiten me një qarkullim vjetor të deklaruar në doganë me një diferencë prej 84,665,293 lekë shumë se vlera e deklaruar në tatime, dhe TVSH me diferencë 21,882,211 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 20,273,253 lekë. Gjithashtu u konstatuan 111 subjekt ku qarkullimi vjetor i deklaruar në doganë i importeve është më një diferencë prej 196,042,887 lekë më pak se vlera e deklaruar në tatime, dhe TVSH me diferencë 25,710,812 duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 41,477,110 lekë.

Gjithashtu, për vitin 2022 (periudhë ende e pa mbyllur deklarimesh financiare) u konstatuan diferenca pozitive (rastet kur vlera e deklaruar sipas tatimeve është më e madhe se ajo sipas doganave) për 44 raste në vlerën e tatueshme prej 121,293,557 lekë, dhe në 23,595,020 TVSH lekë; dhe diferenca negative (rastet kur vlera e deklaruar sipas tatimeve është më e vogël se ajo sipas doganave) për 308 raste në vlerën e tatueshme prej 738,987,323 lekë, dhe në TVSH 162,603,126 lekë, objekt verifikimi nga DRT Shkodër në vijim.

Pra, rezultojnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit gjithsej në vlerën prej 107,473,939 lekë.

Situata 2: Nga auditimi u konstatua se DRT Shkodër nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit me diferenca të pajustificuara në vlerën e eksporteve të deklaruar në tatime dhe të deklaruar në doganë konkretisht:

- Për vitin 2020 rezultuan 49 subjekte, deklarimet e eksporteve të të cilave paraqiten me një qarkullim vjetor të deklaruar në doganë me një diferencë prej 195,732,207 lekë më shumë se vlera e deklaruar në tatime, duke sjellë të

ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 83,509,146 lekë. Gjithashtu u konstatuan 35 subjekte eksportet e të cilave kanë qarkullim vjetor të deklaruar në doganë më një diferencë prej 55,785,833 lekë më pak se vlera e deklaruar në tatime, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 10,200,440 lekë.

- Për vitin 2021 rezultuan 85 subjekte, deklarimet e eksporteve të të cilave paraqiten me një qarkullim vjetor të deklaruar në doganë me një diferencë prej 335,259,374 lekë më shumë se vlera e deklaruar në tatime, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 143,038,412 lekë. Gjithashtu u konstatuan 41 subjekte ku qarkullimi i deklaruar në doganë është më një diferencë prej 60,401,419 lekë më pak se vlera e deklaruar në tatime, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 11,044,399 lekë.

Gjithashtu, për vitin 2022 (periudhë ende e pa mbyllur deklarimesh financiare) u konstatuan diferenca pozitive për 30 raste në vlerën e tatueshme prej 7,110,337 lekë, dhe diferenca negative për 72 raste në vlerën e tatueshme prej 211,164,827 lekë, objekt verifikimi nga DRT Shkodër në vijim.

Pra, rezultojnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit gjithsej në vlerën prej 247,792,397 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 60, neni 71, neni 71/1, neni 115, UMF nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 60, pika 71, pika 71/1, pika 115, Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin Nr.19 (Nr.1482/2., prot) datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave, Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr.192, datë 12.08.2020 të Ministrit të Financave, Manualit të Kontrollit nga Zyra.

Kriteri: Ligji Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 60, neni 71, neni 71/1, neni 115; UMF Nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; pika 60, pika 71, pika 71.1, pika 115; Rregullore e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020. të Ministrit të Financave; Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin Nr.19 (Nr.1482/2., prot) datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave; Manual i Kontrollit nga Zyra.

Ndikimi/Efekti: Vlera të munguara në buxhetin e shtetit në shumën 107,473,939 në importe dhe 247,792,397 lekë në eksporte.

Shkaku: Menaxhim jo efektiv nga strukturat respektive të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për biznesin e madh dhe të vogël sipas detyrave funksionale përkatëse.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 2: -Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për diferencat e pajustificuara, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në zërat e Tatimit mbi Fitimin dhe

TVSH-së në shumën 107,473,939 lekë në importet për 334 raste dhe 247,792,397 lekë në eksporte për 210 raste duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse.

- Strukturat respektive të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit të kryejnë propozimet përkatëse Sektorit të Kontrollit Operacional në DRT Shkodër për kontrollet e thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

Titulli gjetjes 3: **Mangësi të konstatuara në monitorimin e rishikimeve në ulje të kësteve të tatimit mbi fitimin nga Sektori të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.**

Situata: Nga auditimi i vlerësimeve të kërkesave të subjekteve në lidhje me uljen e kësteve të tatimit rezultuan veprime jo në përputhje me përcaktimet e pikës 5, neni 3 “Parapagimet” të Ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, e cila citon se: “Në rastin kur tatimpaguesi, në çdo kohë, vërteton para organeve tatimore se tatimi mbi fitimin për këtë periudhë tatimore do të jetë, në mënyrë domethënëse, më i ulët se tatimi mbi fitimin në periudhën paraardhëse ose periudhën e dytë paraardhëse, atëherë organet tatimore pranojnë zvogëlimin e parapagimeve, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrit të Financave. Në rast se subjekti ka ulur kështu e parapagimit, të caktuara nga organi tatimor, dhe detyrimi tatimor vjetor për tatim fitimin, që rezulton nga bilanci, tejkalon parapagimin me më shumë se 10%, subjekti duhet të paguajë kamatëvonesë mbi diferencën ndërmjet detyrimit real vjetor dhe shumës së parapaguar gjatë vitit, sipas rregullave të vendosura me udhëzim të Ministrit të Financave”; Udhëzimi Nr.5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.13. “Parapagimet”, çështja 3.13.3 e cila citon se: “Me dorëzimin e deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin, në rast se detyrimi tatimor vjetor për tatimin mbi fitimin tejkalon shumën e paguar të kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin me më shumë se 10 për qind, tatimpaguesi detyrohet të paguajë kamatëvonesë, e cila llogaritet në masën 5 për qind për diferencën ndërmjet detyrimit vjetor sipas deklaratës vjetore të tatimit mbi fitimin dhe shumës totale të kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin të paguara gjatë vitit”; dhe Manualin e Kontrollit nga Zyra, pika 11.4 ku përcaktohet se: “Në rastet kur tatimpaguesi kërkon rishikimin në ulje të kësteve të tatimit dhe inspektori i kontrollit nga zyra bindet ndaj argumenteve të paraqitura nga tatimpaguesi, bën korrigjimin e kësteve në ulje në bazë të dokumentacionit të paraqitur”, si rezultat i së cilave nga përllogaritjet e grupit të auditimit rezultojnë efekte financiare në vlerën 633,574 lekë detyrime TF-je.

Kriteri : - Ligji Nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, neni 3, pika 5;

	Udhëzimi Nr.5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.13 “Parapagimet”, çështja 3.13.3 “Korrigjimi në ulje i kësteve mujore të paradhënies të tatimit mbi fitimin”.
Ndikimi/Efekti:	- Manuali i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi, pika 11.4 “Regjistrimi i kësteve të rishikuara të parapagesave të tatimit mbi fitimin”. Risk për fshehje të xhiros reale, shmangie të pagimit të detyrimeve tatimore si dhe devijime nga parimet e miradministrimit tatimor dhe konkurrencës së drejtë me pasoje mungesën e te ardhurave në buxhet.
Shkaku:	Mosrespektimi të dispozitave dhe përcaktimeve ligjore dhe nënligjore nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit në DRT Shkodër, në lidhje me monitorimin, analizën dhe miratimin e kërkesave të tatimpaguesve për uljen e kësteve të tatimit mbi fitimin; mosnjohja e kuadrit nga inspektorët, neglizhenca në kryerjen e detyrës.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 3:	Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për efektet financiare në vlerën 633,574 lekë detyrime tatim fitimi, që kanë rezultuar si pasojë e mungesës së monitorimit korrekt të kërkesave në ulje të tatimit mbi fitimin, me qëllim arkëtimin e tyre në Buxhetin e Shtetit.
Titulli i gjetjes 4:	Mangësi të konstatuara në monitorimin e tatimpaguesve të biznesit të vogël nga ana e inspektorëve të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor për Biznesin e vogël në DRT Shkodër.
Situata:	Nga auditimi u konstatua se si pasojë e moskryerjes në kohë dhe me efektivitetin e kërkuar të detyrave funksionale, mungesës së planeve mujore të punës, e analizave nga përgjegjësi i sektorit dhe drejtori, kanë rezultuar mangësi në administrimin dhe monitorimin e situatave financiare të tatimpaguesve, konkretisht: - Janë konstatuar 161 subjekte të cilat kanë plotësuar rubrikat e të ardhurave tatimore të deklaratës me të vlera më të ulëta apo të larta me diferencë në vlerë absolute prej 110,297,6837 lekë krahasuar me të ardhurat ushtrimore në mënyrë të paargumentuar dhe të pa verifikuar nga administrata tatimore, nga të cilat për vitin 2020 në 83 raste me një diferencë në vlerë absolute (+/-) prej 39,966 mijë lekë, dhe për vitin 2021 për 78 raste në diferencën 70,331 mijë lekë. - Janë konstatuar 257 subjekte të cilat kanë plotësuar rubrikat e shpenzimeve tatimore të deklaratës me të vlera më të ulëta apo më të larta prej 185,518,678 lekë se shpenzimet ushtrimore në mënyrë të paargumentuar dhe të pa verifikuar nga administrata tatimore, nga të cilat për vitin 2020 në 134 raste me një diferencë në vlerë absolute (+/-) prej 53,775 mijë lekë, dhe për vitin 2021 për 123 raste në diferencën 131,743 mijë lekë. - Pavarësisht se monitorimi dhe mbikëqyrja e veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesit është detyrë e themelore e administratës tatimore, janë konstatuar 60 tatimpagues me mbi mesatarisht 5 punonjës përgjatë një periudhe tatimore të cilët rezultojnë pa përgjegjësi tatimore të TVSH-së, gjë e cila pavarësisht qarkullimit të deklaruar prej administratës tatimore duhet të

	ndërmerreshin verifikimet përkatëse nëpërmjet evidentimit dhe analizave të thelluara të kostove duke verifikuar kështu dhe burimet e financimit të këtyre tatimpaguesve për përballimin e tyre. Mungesa e veprimeve konkrete nga ana e administratës së DRT Shkodër ka bërë që procesi i monitorimit të përgjegjësive tatimore të paraqitet me mangësi dhe parregullsi të cilat kanë ndikime të rëndësishme në strukturën e të ardhurave, risk të lart për fshehje të xhiros reale dhe mosregjistrim në regjimin e TVSH-së si dhe krijojnë devijime nga parimet e miradministritimit tatimor dhe kokurencës së drejtë.
Kriteri:	Ligji Nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 12; UMF Nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 12, pika 43.2.1, pika 43.2.3; Rregullore e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhërin Nr.192, datë 12.08.2020. të Ministrit të Financave; Manual i Kontrollit nga Zyra.
Ndikimi/Efekti:	Risk i shtuar për fshehje të xhiros reale dhe mosregjistrim në regjimin e TVSH-së si dhe devijime nga parimet e miradministritimit tatimor
Shkaku:	Menaxhim jo efektiv i situatës për punonjësit sipas detyrave funksionale përkatëse.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 4:	DRT Shkodër të marrë masat për dokumentimin e kryerjes së verifikimeve përkatëse për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, sipas qarkullimit vjetor dhe shkallës së tatimit objekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim që ka qenë në fuqi për atë kategori tatimpaguesish, duke verifikuar mospërputhjet midis deklaratës së qarkullimit sipas kasës dhe të ardhurave sipas TTHF; si dhe të propozojë sipas rastit ndryshimin e përgjegjësive tatimore për tatimpaguesit të cilët plotësojnë kushtet për kalimin në përgjegjësinë tatimore të TVSH-së dhe Tatimit mbi Fitimin, apo kryerjen e kontroleve të thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra.
Titulli i gjetjes 5:	Mangësi të konstatuara në lidhjen e Akt-Marrëveshjeve nga ana e DRT Shkodër
Situata:	-Nga auditimi u konstatua se pas riorganizimit të kryer në strukturat tatimore, ndjekja e akt marrëveshjeve ka mbetur nën kompetencën e Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT-ve përkatëse. Gjatë vitit 2021 nga ana e DPT është kryer rishikimi i Manualit të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, ku është hequr kapitulli që më parë parashikonte procedurat që do të ndiqen për zbatimin e marrëveshjeve me këste. Si rezultat, këto procedura nuk janë përfshirë në asnjë prej akteve nënligjore sipas së cilave funksionojnë Drejtoritë e Kontrollit (<u>ndër të tjera edhe DRT Shkodër</u>) dhe si rezultat, procesi që do të ndiqet për akt marrëveshjet me këste rezulton <u>i pa rregulluar dhe i pa mbuluar me akte administrative, manuale apo udhëzime të DPT, duke cënauar kështu veprimtarinë e këtyre strukturave përgjegjëse për monitorimin e tyre.</u> -Nga auditimi u konstatuan mangësi në drejtim të administrimit të dhënave lidhur me akt marrëveshjet nga struktura përkatëse pranë DRT Shkodër, për

shkak të mos rakordimit të totalit të vlerës së akt marrëveshjes me pagesat e kryera dhe vlerës së mbetur pa paguar; një pjesë e informacionit lidhur me pagesat e kryera për marrëveshjet e anuluar u plotësua gjatë auditimit; mungesa e historikut të subjekteve para ndryshimit të përgjegjësisë për monitorimin e tyre, etj; të cilat e kanë kufizuar auditimin në lidhje me vlerësimin e ndjekjes së ecurisë së akt-marrëveshjeve nga ana e Drejtorisë së Kontrollit dhe marrjen e masave në kohë në lidhje me zgjidhjen e tyre për mosplotësim të kushteve.

-Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë anuluar 24 akt marrëveshje të lidhura me subjektet (37% e totalit të akt marrëveshjeve të lidhura), nga ku 8 raste rezultojnë me 100% detyrim i papaguar në raport me vlerën për të cilën është lidhur akt marrëveshja; 14 raste me mbi 50% dhe vetëm 2 raste me më pak se 50%. Në total vlera e detyrimit për të cilin është lidhur akt marrëveshja e anuluar paraqitet në vlerën 168,241 mijë lekë (52 % e totalit të vlerës së akt marrëveshjeve të lidhura). Nga detyrimi për të cilën është lidhur AM rezultojnë të jenë likuiduar 34,192 mijë lekë, ose vetëm 20% e totalit të vlerës. Nga ana e strukturave përgjegjëse në DRT Shkodër, për këta tatimpagues nuk është kryer ose nuk ka qenë efektive analiza për të vlerësuar riskun lidhur me përmbushjen e kushteve të marrëveshjes, si dhe nuk është analizuar në mënyrë efektive situata nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore, duke mos respektuar pikën 2 dhe 3 të Nenit 18 të Rregullores së funksionimit të DRT-ve.

-Nga auditimi u konstatua se informacioni për A.M nga Drejtoria e Kontrollit u vendos në dispozicion vetëm për periudhën kur monitorimi i tyre ka qenë nën kompetencën e tyre, pasi këto struktura nuk gjeneronin informacion të mëparshëm për këto akt marrëveshje për periudhën kur monitorimi i tyre kishte qenë nën mbikëqyrjen e drejtorive të mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara, duke rezultuar kështu me mangësi në drejtim të dorëzimit të punës dhe materialeve përkatëse pas rishpërndarjes së përgjegjësisë. Mungesa e informacionit të strukturës aktuale përgjegjëse për ndjekjen e akt marrëveshjeve, cënon efektivitetin e vendimmarrjes së saj lidhur me këto akt marrëveshje në momentin që nuk është vepruar duke vlerësuar dhe analizuar edhe historikun e mëparshëm të këtyre subjekteve sikundër përcakton udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar përcakton në pikën 78 të tij se: *“Marrëveshja e pagesës me këste mund të zgjidhet nga administrata tatimore në momentin e parë që personi i tatueshëm nuk e respekton atë lidhur me rregullshmërinë e pagesave si dhe kur ai nuk paguan detyrimet e tjera tatimore që lindin gjatë periudhës së mbuluar nga marrëveshja. ...”*; rregullorja e funksionimit të DRT, neni 18 pika 2 e cila përcakton se *“struktura përgjegjëse në DRT pasi merr në dorëzim kërkesat për marrëveshje i analizon ato duke përcaktuar riskun përkatës”* dhe pika 3 *“ nëse plotëson kushtet pas analizës harton draft marrëveshjen përkatëse për pagesën me këste duke analizuar për të parë situatën nëse plotësohen kushtet e përcaktuara në ligjin e procedurave tatimore”*; udhëzuesi i përgjithshëm i procedurave të mbledhjes me forcë datë 15.03.2018 pika 10 *“... ai duhet të vërtetojë pamundësinë aktuale financiare, si dhe të tregojë që pavarësisht rrethanës financiare të vështirë, është në gjendje të zbatojë kushtet e*

marrëveshjes”. Për të gjykuar në lidhje me pamundësinë financiare mund të shërbejnë pasqyrat financiare të shoqërisë, gjendja e detyrimeve, kapitaleve të shoqërisë, aftësia qarkulluese e inventarit, likuiditetet etj;”. Nga regjistri i vendosur në dispozicion, rezultojnë akt marrëveshjet e përsëritura, për të cilët nuk është kaluar në masa të tjera shtrënguese, situatë kjo e cila përbën në nga indikatorët matës për efektivitetin e analizës së kryer nga struktura përgjegjëse pranë DRT Shkodër, lidhur me përmbushjen e kushteve të nevojshme të marrëveshjes dhe situatës sipas përcaktimeve në kuadrin rregullator dhe ligjor në fuqi.

Kriteri: Ligjin Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 78, Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 78; Rregullore e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin Nr.192, datë 12.08.2020. të Ministrit të Financave, pika 2 dhe pika 3 e neni 18; Manual i mbledhjes me forcë. Udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pika 78 e tij; Rregullorja e funksionimit të DRT, neni 18 pika 2; udhëzuesi i përgjithshëm i procedurave të mbledhjes me forcë datë 15.03.2018 pika 10 .

Ndikimi/Efekti: Mangësi të konstatuara në monitorimin dhe zbatimin e Akt-Marrëveshjeve nga ana e strukturave përkatëse pranë DRT Shkodër

Shkaku: Problematikat e konstatuara në legjislacionin në fuqi; analizë jo efektive nga ana e strukturave përkatëse për përmbushjen e kushteve të nevojshme të marrëveshjes dhe situatës; mangësi në procedurat e dorëzimit të informacioneve si rezultat i ristrukturimit dhe ndryshimit të përgjegjësisë për monitorimin e A.M.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi 5: DRT Shkodër të përcjellë pranë DPT propozimin për parashikimin e procedurës së marrëveshjeve me këste të detyrimeve tatimore në aktet nënligjore miratuar prej saj, ose reflektimin e kësaj çështjeje në një dokument/manual të vetë institucionit, për t’u zbatuar nga strukturat përkatëse të kontrollit, si dhe të marrë masat për kryerjen e analizave efektive përpara lidhjes së Akt-Marrëveshjeve duke shqyrtuar historikun dhe aftësinë paguese të tatimpaguesit; apo edhe gjatë zbatimit, me qëllim përmbushjen e kushteve dhe uljen e riskut të anulimit, apo përsëritjen e tyre për të mos kaluar në masa të tjera shtrënguese.

Titulli i gjetjes 6: **Monitorim i dobët i treguesve me risk që ndikojnë në mirëfunksionimin e punës së Sektori të Kontrollit nga zyra dhe Monitorimit për biznesin e madh dhe të vogël në DRT Shkodër.**

Situata: Nga auditimi u konstatua se nga ana e Sektorit Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit ka munguar monitorimi dhe vlerësimi i treguesve me risk që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës si në vijim:

- Ky sektor nuk disponon plane të plota mujore dhe vjetore ku të përcaktohen objektivat, ndarjet e detyrave për inspektorët në mënyrë që të monitorohen subjektet në mënyrë të vazhdueshme, duke mos vepruar në përputhje me kërkesat e pikave 5, 8 dhe 9 të Manualit të Kontrollit nga Zyra;
- Në lidhje me ndarjen e NIPT-eve, në organizimin dhe monitorimin e

Inspektorëve nuk janë zbatuar kërkesat dhe përcaktimet e pikave 5, 8 dhe 9 të Manualit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, ku paraqitet një ndarje në nipte sipas rendit kronologjik të tyre, në mënyrë rastësore e të barabartë nëpërmjet inspektorëve, i cili nuk përmban kriteret e përcaktuara në manual si më sipër cituar.

- Struktura aktuale e sektorit paraqitet me 2 vakanca, përkatësisht në pozicionin e inspektorëve të kontrollit. Deri në qershor 2022 ajo paraqitej me 1 vakancë; në fund të vitit 2021 ajo paraqitej me 1 vakancë (1 inspektor i dytë); dhe në fund të vitit 2020 me 3 vakanca (3 inspektorë të parë). Nga auditimi u konstatuan se si rezultat i ristrukturimit, vakancave dhe angazhimeve të shpeshta të stafit në pozicione apo detyra të tjera brenda DRT Shkodër, është impaktuar edhe roli kryesor i inspektorëve në sektorin e kontrollit nga zyra, konfirmuar edhe nga punonjësit nëpërmjet observacionet e përcjella.

- Konstatohen teprica kreditore të subjekteve me tendenca rritjeje, veçanërisht në subjektet aktiviteti i së cilave është tregtia apo shërbimet, në të cilat risku i evazionit për shkak të mos deklarimit të shitjeve apo dorëzimi i faturave fiktive në blerje është më i lartë. Nga kjo zgjedhje me një numër të kufizuar subjektesh në raport me totalin e DRT Shkodër (vetëm 50 subjekte), përbëjnë 36% në vitin 2020, 39% në vitin 2021 dhe 37% në periudhën e audituar për vitin 2022 të totalit të tepricës kreditore të TVSH-së për të gjithë subjektet e DRT Shkodër. Pavarësisht se sikundër rezulton nga kjo analizë këto subjekte duhet të ishin objekt monitorimi dhe verifikimi nga ana e inspektorëve, rezulton se nga këto subjekte janë kaluar për kontroll vetëm 19 prej tyre, pra nuk rezultojnë të jenë marë masa veprimi konkrete nëpërmjet kërimit të informacionit për verifikimin e situatës së rritjes së vazhdueshme të tepricës së TVSH-së. Kjo, pasi për ta duhet të bëhej verifikimi në vend nëpërmjet kombinimit me sektorin e kontrollit dhe monitorimit nga zyra për të verifikuar nqs ekzistojnë dhe kanë gjendje malli apo aktive në vendndodhjet e deklaruara të biznesit në përputhje me deklarimet e tyre. Gjithashtu, rezultojnë 14 nga 50 subjektet e mara nën shqyrtim, kanë tendenca rritjeje të tepricës kreditore të tatimit mbi fitimin. Kjo zgjedhje e kufizuar subjektesh, përbën 23% në vitin 2020, 20% në vitin 2021 dhe 29% në periudhën e audituar për vitin 2022 të totalit të tepricës kreditore të tatimit fitimit për të gjithë subjektet e DRT Shkodër. Nga totali i 50 subjekteve me deklarimet më të larta të tepricës kreditore të tatimit fitimit janë kaluar për kontroll vetëm 7 prej tyre, nga të cilët vetëm 2 janë subjekte që kanë paraqitur tendenca rritjeje të tepricës, duke ndikuar kështu në reduktimin e performancës për deklarimet tatimore të taimpaguesve.

Kriteri: Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Rregullore e Funkcionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhërin Nr.192, datë 12.08.2020 të Ministrit të Financave, pikat 1 dhe 2 të neni 60, pikat 1,2,5,6,11 të nenit 55, pikat 1,2,5,6,11 të nenit 57;

Manuali i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi.

Ndikimi/Efekti: Problematika që ndikojnë në mbarëvajtjen normale të punës, si dhe risk të lartë për shmangie nga detyrimet tatimore.

Shkaku:	Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore nga Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për biznesin e madh dhe të vogël në DRT Shkodër. Mangësi në kryerjen e detyrave funksionale nga punonjësit e ngarkuar të DRT Shkodër.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 6:	DRT Shkodër të vlerësojë problematikat e mësipërme me qëllim hartimin e planeve mujore dhe vjetore të punës; ndarjen e nipteve sipas kuadrit rregullator në fuqi dhe intensifikimin e punës në drejtim të analizimit të subjekteve me teprica kreditore me tendencë rritjeje, edhe nëpërmjet kombinimit me kontrollin në vend, duke vlerësuar treguesit me risk që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës; çështje këto që garantojnë se detyrat e ngarkuara të jenë të matshme për secilin pozicion të Drejtorisë së Kontrollit.
Titulli i Gjetjes 7:	Mangësi të konstatuara në monitorimin nga Sektori të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit e subjekteve BM dhe BV, me humbje tatimore për 3 vite të njëpasnjëshme.
Situata:	-Nga auditimi u konstatuan 30 subjekte biznesi i madh, të cilët kanë deklaruar humbje tatimore për 3 vite të njëpasnjëshme për të cilat nga ana e Sektorit të Kontrollit Tatimor dhe Monitorimit nga Zyra, nuk dokumentohet puna për kryerjen e një analize të hollësishme sipas inspektorëve për evidentimin e këtyre subjekteve, arsyet dhe argumentimin e humbjes, vlerësim në rritje të të ardhurave apo ulje të shpenzimeve, sipas informacioneve me shkrim që duhet të kishin kërkuar tatimpaguesve apo letërkujtesave, shkresa për kalimin/propozimin e kontrolleve në Drejtorinë e Kontrollit, kërkim në gjykatë të procedurës së falimentit, etj, veçanërisht për bizneset e BM kategoria e të cilave cilësohet si me një risk më të madh. Nga këto subjekte, 11 prej tyre rezultojnë me humbje 3 vite rresht, mbi 1,000,000 lekë. Gjithashtu, u konstatuan 55 subjekte BV të cilët kanë deklaruar humbje tatimore për 3 vite të njëpasnjëshme, nga të cilat 11 tatimpagues që kanë deklaruar për 3 vite rresht humbje mbi 500,000 lekë, për të cilat u evidentua e njëjta problematikë në monitorimin dhe analizën si për BM trajtuar më sipër.
Kriteri :	Ligji Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 104. Ligji Nr.110/2016 datë 27.10.2016 “Për falimentimin”, i ndryshuar, neni 16 Manuali i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimi.
Ndikimi/Efekti:	Risk i shtuar për mosshlyerje të kreditorëve, për fshehje të xhiros reale, shmangie të pagimit të detyrimeve tatimore si dhe devijime nga parimet e miradministritimit tatimor dhe konkurrencës së drejtë.
Shkaku:	Mosrespektimi i dispozitave dhe përcaktimeve ligjore nga Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit për biznesin e madh dhe të vogël në DRT Shkodër. Mangësi në kryerjen e detyrave funksionale nga punonjësit e ngarkuar të DRT Shkodër.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 7:	DRT Shkodër, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të kryejë një analizë të thelluar të situatës së tatimpaguesve BM dhe BV të cilët rezultojnë me humbje respektivisht mbi 500,000 lekë për tre vite të njëpasnjëshme, si dhe të propozojë kryerjen e kontrolleve të thelluara në

vend/vizitave fiskale për rastet e vlerësuara me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, duke kryer njoftimet përkatëse në gjykatë për fillimin e procedurave të likuidimit.

Titulli i gjetjes 8: Veprime administrative ligjore ne kundërshtim me detyrat funksionale dhe ligjin e procedurave administrative ne RSH

Situata: Gjatë auditimit u konstatua se Urdhri nr. 2, datë 21.07.2021 “Për transferim të përkohshëm ndërmjet sektorëve” i Drejtorit Rajonal të DRT Shkodër, z. S.I. nuk është kryer në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Konstatohet në përmbajtjen e Urdhrit se është urdhëruar transferimi i përkohshëm i nëpunësit të DRT Shkodër z. L.C. nga Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, në Sektorin e Kontrollit në Vend pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, duke mos cituar periudhën kohore gjatë të cilës do të jetë i vlefshëm ky transferim, si dhe duke mos trajtuar edhe bazën ligjore në të cilin është mbështetur ky urdhër, veprime këto në kundërshtim përcaktimet ligjore të Seksionit 3 “Ligjshmëria, pavlefshmëria dhe korigjimi i aktit administrative” konkretisht neni 107 “Ligjshmëria e aktit administrativ” neni 108 ‘Akti administrativ absolutisht i pavlefshëm’, neni 109 “Paligjshmëria e aktit administrativ” të ligjit nr. 44/20151 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”. Sipas shkresës nr. 3802/1, prot DRT Shkodër datë 15.03.2020 me Urdhrin nr. 6, datë 15.03.2022 të drejtorit të DRT Shkodër z. S.I. “Për rikthim nga transferimi i përkohshëm ndërmjet sektorëve” (pra rreth 8 muaj pas shkresës së mëparshme) është urdhëruar rikthimi i nëpunësit të DRT Shkodër z. L.C. me të gjitha funksionet pranë Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit. Si rezultat, për një periudhë rreth 8 mujore punonjësi tatimor z. L.C. ka ushtruar kompetencat e një pozicioni, komandimi për të cilin është vepruar në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Urdhër i titullarit të DRT Shkodër z. S.I. rezulton i pa mbështetur në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, si dhe përmban riskun për të ndikuar në keqfunksionimin dhe performancës e dobët të sektorit të kontrollit nga zyra dhe mbarëvajtjen në tërësi të veprimtarisë së punës të Drejtorisë Rajonale Shkodër veprim ky në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore në fuqi.

Kriteri: - Rregullore e Funksionimit të Administratës Tatimore, pikat 3, 5, 10, 11, 18, 20 të nenit 4.
- Ligji nr. 44/20151 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë” Seksioni 3, neni 107, neni 109.

Ndikimi/Efekti: Risk i larte për të ndikuar në keqfunksionimin dhe performancës e dobët të sektorit të kontrollit nga zyra dhe mbarëvajtjen në tërësi të veprimtarisë së punës të Drejtorisë Rajonale Shkodër veprim ky në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore në fuqi si dhe me risk të shtuar për krijimin e të ardhurave të munguara tatimore në Buxhetin e Shtetit

Shkaku: Veprim administrative te kryera ne kundërshtim me kuadrin ligjor;
Rëndësia: E larte.

Rekomandimi 8: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Shkodër në bashkërendim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrë masa të menjëhershme me qëllim eliminimin

e veprimeve administrative që bien në kundërshtim të hapur me pikat 3, 5, 10, 11, 18, 20 të nenit 4 të përcaktuar në Rregulloren e Funkcionimit të Administratës Tatimore si dhe përcaktimet ligjore të Seksionit 3, neni 107, 108, 109 dhe 114 të ligjit nr. 44/20151 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duke evidentuar rast pas rasti në bashkëpunim me strukturat në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, pasojat ekonomike administrative ligjore me efekte në të ardhurat tatimore në Buxhetin e Shtetit që kanë lindur si pasojë e veprimeve të kryera pas nxjerrjes së aktit administrativ të kundërligjshëm sipas Urdhrit nr. 2, datë 21.07.2021 “Për transferim të përkohshëm ndërmjet sektorëve” gjatë periudhës dhe fushës materiale që ka mbuluar akti administrativ.

Në lidhje me këtë çështje u mbajt Akt Konstatimi nr. 8, datë 02.12.2022. Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur observacionet ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

-Nga ana e inspektorit znj. U.C. u përcoll observacioni me shkresën nr.3313/65, prot në DRT Shkodër datë 23.01.2023 në të cilën shprehen pretendime lidhur me problematikat për disa tatimpagues për të cilët është komentuar se diferencat vijnë si rezultat i problematikave në të dhënat e AKSHI-t. Gjithashtu, për tatimpaguesin X diferenca e vitit 2021 me vlerë 1,939,664 (bashkëngjitur bilancin për periudhën tatimore dhe sqarime në lidhjet me shitjet e përjashtuara dhe parapagimet: Diferenca në mes raportimit të shitjeve (libër shitje dhe fdp Tvsh =18,875,782) Me të dhënat sipas bilancit 2021 që është 15,447,309 lekë, $18,875,782 - 14,447,309 = 3,428,473$ lekë, duke zbritur dhe diferencën e kursit të këmbimit që është 9,563 lekë është vlera 3,418,910 lekë që është e pasqyruar në bilanc tek të ardhurat e shtyra. Diferenca 1,939,664 e pasqyruar tek detyrimet e shtyra në bilancin 2020 është shuma e papaguar nga investitore, banesa private, e cila është e mbyllur me punimet e bëra dhe të situacionuara gjatë vitit 2021.(bashkëngjitur bilanci i vitit 2021). Pra diferencat janë parapagimet të deklaruara dhe të sqaruara në bilancet e viteve 2020 dhe 2021. Tatimpaguesi X, është aktivizuar me përgjegjësi tatimore TVSH me datë 21.07.2021. Për vitin 2020 ka deklaruar Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin me vlerë 3,701,375 lekë duke mos qenë i regjistruar me TVSh. Për vitin 2021 ka deklaruar dy deklarata TFTh dhe TF dhe ka ndryshuar dhe përgjegjësinë duke u aktivizuar me TVSh.

- Nga ana e inspektorit znj. Dh.D. u përcoll observacioni me shkresën nr.3313/68, prot në DRT Shkodër datë 23.01.2023 në të cilën shprehen pretendime lidhur me diferencat e konstatuara për deklarimet TF me TVSH për subjektin X i cili është regjistruar me TVSH në datën 07.10.2022, për këtë arsye nuk ka të ardhura të deklaruara në TVSH. Për subjektin X diferenca për periudhën 20-A vjen nga kalimi me TF. Tatimpaguesi ka dorëzuar dy deklarata TTHF 20-A 2,454,040 lekë dhe TF-20A me vlerë 8,839,464 lekë. Subjekti merr fonde nga AZHBR pasqyruar në bilanc dhe detajuar në shënimet shpjeguese që ndikon në mosrakordimin me TA nga TVSH-ja. Subjekti X sipas situatës financiare ka të ardhura sipas tabelës bashkëngjitur pra vlerën 93,621,973 lekë dhe jo vlerën e deklaruar në raport.

-Nga ana e inspektorit z. E.K. u përcoll observacioni me shkresën nr.3313/69 prot në DRT Shkodër datë 23.01.2023 në të cilën shprehen pretendime lidhur me diferencat për subjektet X, me argumentet përkatëse. Për subjektin X është argumentuar se diferenca vjen sipas të ardhurave nga kursi i këmbimit, bashkëlidhur PASH me vlerat e mësipërme.

-Nga ana e inspektorit z. M.H. u përçoll observacioni me shkresën nr.3313/66 prot në DRT Shkodër datë 23.01.2023 në të cilën shprehen pretendime lidhur me subjektin X ku të ardhurat përbëhen nga te ardhura nga aktiviteti normal 20,679,817 Te ardhura te tjera te shfrytëzimit 107,500 lekë, Te ardhura nga Arkëtimi i Kamatave 1,737,228 lekë , Interesa te arkëtueshme dhe te ardhura te tjera grante subvencione 24,268,000 lekë; Te ardhura nga interesi 48, 575 lekë; Fitim nga këmbimet valutore 64 lekë; Totali 46,841,185 lekë pasqyruar në shënimet shpjeguese të bilancit(bashkëngjitur). Për vitin 2021 Të Ardhurat përbëhet nga Te ardhura nga aktiviteti normal 20,454,247 lekë; Te ardhura nga kontratat e lidhjeve te reja 220,550 lekë; Interesa te arkëtueshme dhe te ardhura te tjera grante subvencione 14,168,000; Total 34,841,537 (pasqyruar në PASH bilancin e paraqitur grupit te Auditimit). Subjekti X diferenca përbëhet nga Te ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit 4,049,064 pasqyruar në PASH në bilanc. Subjekti X diferenca gjendet në zërin nga të ardhura te tjera nga veprimtaria e shfrytëzimit dhe të argumentuara ne Shënimet shpjeguese përkatësisht Bonus Furnitori 2,476,923 detyrime te trashëguara dhe te pa arkëtuara (me vendim ortaku nr. 2 dt. 30.12.2021) 2,134,791 Total 4,611,714. Subjekti me Shkresën nr. 4778 dt 31.11.2022 është propozuar për kontroll të thelluar. Subjekti X diferenca janë sistemuar nga Kontrolli operacional sipas program kontrolli nr. 95 dt. 21.09.2022 në dt 04.10.2022 respektivisht të ardhura në TF 2020 53,780,517 lekë dhe Të Ardhura në TF 2021 40,686,593 lekë (bashkëngjitur deklaratat). Subjekti X ku ka diferenca të paraqitur nga grupi i Auditimit për vitin 2020 dhe 2021 ju informoj se subjekti është Aktiv nga dt. 02.10.2020 dhe ka kaluar me përgjegjësi tatimore me TVSh ne dt. 02.10.2020 dhe përgjegjësi tatimore TF në dt. 01.07.2021 (bashkëngjitur tabela e përgjegjësi) Te ardhurat e vitit 2020 janë pasqyruar ne deklaratën e TTHF me vlere 3,512,030 dhe Te ardhurat e vitit 2021 janë pasqyruar ne deklaratën e TTHF me vlere 7,532,313 lekë dhe TF 46,783,187 lekë në total 54,315,500 lekë (bashkëngjitur deklaratat përkatëse te Tf dhe Tthf dhe situata financiate e TVSh-së). Subjekti X diferenca e vitit 2020 është deklaruar në deklaratën e TTHF 3,964,230 lekë, diferenca e vitit 2021 është deklaruar në deklaratën e TTHF 11,958,702 lekë ,subjekti ka kaluar me përgjegjësi tatimore me TVSh ne dt. 16.06.2021 dhe ka kaluar me përgjegjësi tatimore TF në dt 01.10.2021 dhe sipas deklaratave të TVSh-së nuk ka realizuar me aktivitet pas datës së kalimit me përgjegjësi tatimore TF për vitin 2021. Subjekti X e ka deklaruar importin ne blerje te përjashtuar për muajin tetor 2021 (bashkëngjitur deklarata dhe libri) Diferenca e subjektit X e cila i përket muajve Dhjetor 2020, Shtator 2021,Tetor 2021 janë sistemuar sipas program kontrolli nr. 103 dt. 28.09.2022 nga kontrolli operacional në dt. 07.10.2022 në rubrikën blerje furnitorë vendas me TVSh (bashkëngjitur deklaratat).

Nga ana e inspektorit znj. E. T. u përçoll observacioni me shkresën nr.3313/62 prot në DRT Shkodër datë 23.01.2023 në të cilën shprehen pretendime lidhur me diferencat për subjektin X, duke argumentuar se diferenca për vitin 2020 në vlerën 37,478,237 lekë vjen si rezultat i të ardhurave të shtyra; dhe për vitin 2021 në vlerën 63,923,905 lekë si rezultat i rimarrjes së të ardhurave të shtyra dhe arkëtimeve në avancë. Nga subjekti u vunë në dispozicion 3 kontrata shtije të lidhura në vitin 2021 dhe të deklaruara si të ardhura, por nuk është prerë faturë pasi nuk është kryer likuidimi brenda vitit 2021.

Nga ana e inspektorit znj. S. M. (S.) u përçoll observacioni me shkresën nr.3313/67 prot në DRT Shkodër datë 23.01.2023 në të cilën shprehen pretendime lidhur me diferencat për subjektin X ,diferenca per vitin 2021 është pasqyruar në bilanc tek Të ardhurat e tjera: Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit me vlerën prej 73,166 lekë dhe tek Te ardhura nga investimit dhe huatë e tjera ne njësi ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse, pjesë e aktiveve afatgjata, konvertimi me vlerën prej 323,743. Për vitin 2020 diferenca është pasqyruar në bilanc tek Të ardhurat e tjera:

Të ardhura nga aktiviteti dytësor me vlerën prej 2,550,848 lekë, dhe tek Te ardhura nga investimit dhe huatë e tjera ne njësi ekonomike ku ka interesa pjesëmarrëse, pjesë e aktiveve afatgjata, konvertimi me vlerën prej 25,447 lekë.

Për subjektin X , diferenca për vitin 2020 është pasqyruar në bilanc tek të ardhurat e tjera: Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit me vlerën prej 2,283,340 lekë. Për vitin 2021 diferenca është pasqyruar në bilanc tek Të ardhurat e tjera: Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit me vlerën prej 4,090,631 lekë,

Për subjektin X diferenca për vitin 2021 është pasqyruar në bilanc tek Të ardhurat e tjera: Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit me vlerën prej 241,630 lekë. Për vitin 2020 diferenca është pasqyruar në bilanc tek Të ardhurat e tjera: Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit me vlerën prej 3,273,501 lekë. Për subjektin X ,diferenca për vitin 2020 është pasqyruar në bilanc tek Të ardhurat e tjera: Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit me vlerën prej 364,915 lekë. Për subjektin X faturat, që i përkasin mallrave cigare të cilat janë me TVSH zero si në blerje ashtu dhe në shitje me vlerë totale 154,397 lekë, janë regjistruar ne librat e blerjes me vlerën e tyre gjate vitit dhe për rrjedhoje edhe ne kontabilitet si shpenzime. Ne kohen e përgatitjes se pasqyrave financiare ato janë kaluar në te ardhura sepse furnitori i ka falur, nuk kërkon për t'i arkëtuar. Për pasojë janë rritur dhe të ardhurat ne vlerën 154397 lekë më shumë se totali i deklarimeve te FDP dhe librave te shitjes.

Nga ana e Përgjegjëses së Sektorit të Kontrollit nga Zyra znj. E.K. u përcoll observacioni me shkresën nr.313/72, prot në DRT Shkodër datë 03.02.2023, prot në KLSH nr.814/7 datë 07.02.2023, në të cilin është argumentuar lidhur me rekomandimin në faqen 156 të projektraportit të auditimit mbi diferencat e TVSH dhe TF/TTHF; diferencat mes deklarimit të kasës; diferencat mes deklarimeve të import/eksporteve në dogana dhe tatime, se janë vendosur në dispozicion listat me diferencat e konstatuara dhe arsyet pse nuk duhet të bëhet rivlerësim për to. Disa arsye të përgjithshme janë paraqitur në observacion mbi shkaqet e diferencave, duke shtuar edhe se rast pas rasti janë trajtuar nga inspektorët përkatës. Për sa i përket rishikimit të kësteve të tatim fitimit, ulja e tyre është bërë konform legjislacionit. Lidhur me rekomandimin në faqen nr. 161 të projektraportit është argumentuar se nga viti 2021 kontrolli nga zyra nuk kryen më rimbursim TVSH-je. Në lidhje me rekomandimin për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore sqarojmë se nuk kemi asnjë rast pa ndryshuar përgjegjësitë në kohë. Për sa i përket marrëveshjeve me këste ato prishen pasi tatimpaguesi nuk i paguan ato sipas rregullave në fuqi dhe ato mund të rilidhen nëse tatimpaguesi ka vlerësuar aftësinë e tij paguese. Për sa i përket analizës së tepricave kreditore janë sqaruar arsyet dhe shkaqet e tyre, sikundër trajtuar edhe na inspektorët. Për sa i përket rekomandimit në faqen 167 është argumentuar se BV që rezultojnë me humbje për 3 vite ka ardhur si pasojë e nivelit të të ulët të të ardhurave; ndërsa BM nuk kanë plotësuar nivelin e duhur të pikëzimit të analizës së riskut, ndërsa inicimi i proceduës së falimentit lidhet me mungesën e aftësisë paguese të biznesit.

Nga ana e inspektorit R.R. u paraqit observacioni me shkresën nr. 3313/73, prot në DRT Shkodër datë 03.02.2023, prot në KLSH nr. 814/8, datë 10.02.2023 në të cilin shprehen pretendime lidhur me diferencat e konstatuara në deklaratën e TVSH dhe TF. Konkretisht për diferencën e subjektit X diferenca për vitin 2020 vjen si rezultat i të ardhurave të tjera (të tjera, interesa, kursi këmbimit), reflektuar edhe në pasqyrat financiare paraqitet saldoja mes të ardhurave dhe shpenzimeve nga kursi këmbimit (bashkëlidhur pasqyra e performancës dhe shënimet shpjeguese). Diferenca për vitin 2021 vjen si rezultat i prodhimit në proces, bashkëlidhur pasqyra e pozicionit financiar. Për subjektin X diferenca për vitin 2021 vjen pasi subjekti është regjistruar me TVSH në 21.07.2021, dhe bashkëlidhur paraqitet evidenca përkatëse. Subjekti X për vitin 2020 vjen si rezultat i

arkëtimeve nga shitja e investimeve të tjera, fitimi nga shitja e investimeve të tjera, amortizim i akumuluar, ndryshim i inventarit të prodhimit në proces. Bashkëlidhur pasqyra e performancës, pasqyra e pozicionit financiar dhe cash floë ku justifikohen diferencat.

Qëndrimi i grupit të auditimit

Për sa i përket observacioneve që lidhen me problematikat në të dhënat e raportuara nga ana e AKSHI-t për vlerat e kasës, sqarojmë se në raport këto raste janë rekomanduar si masë organizative, objekt verifikimi nga ana e autoritetit tatimor dhe nuk janë përlllogaritur detyrime. Për sa i përket observacioneve të përcjella nga inspektori U.C., sqarojmë se për subjektin X dhe X observacioni u mor në konsiderate dhe u reflektua në material. Për sa i përket observacioneve të përcjella nga inspektori Dh.D., për subjektin X, observacioni me informacionet e dërguara rishtazi në këtë fazë u mor në konsideratë dhe është reflektuar në material. Për subjektin X u rillogarit diferenca pas përcjelljes së situatës aktuale financiare të subjektit.

Për sa i përket observacionit të përcjellë nga inspektori E.K. sqarojmë se për pjesën më të madhe të subjekteve të trajtuara në observacion nga ana jonë nuk ishin konkluduar diferenca. Për një rast në të cilin ishte përlllogaritur diferencë, observacioni i përcjellë nuk kishte bashkëlidhur dokumentacionin justifikues, për këtë arsye nuk merret në konsideratë.

Për sa i përket observacionit të përcjellë nga inspektori M.H., për subjektet në të cilat ishte sjellë dokumentacioni shtesë justifikues, u mor në konsideratë dhe u reflektua. Në rastet e tjera, vlera mbetet e pandryshuar pasi nuk ishte paraqitur dokumenti justifikues listuar në shënime shpjeguese (shkresat që vërtetojnë dhënien e bonusit të furnitorit, vendime të ortakut, etj); apo edhe rastet e diferencave ku kontrollet janë iniciuar pas auditimit në terren dhe janë sistemuar më pas (shtuar në listën e subjekteve të sistemuara pas identifikimit të diferencave nga grupi i auditimit), të cilat duhet të ishin sistemuar nga inspektori si pjesë e detyrave funksionale. Për sa i përket observacionit të përcjellë nga inspektori E. T., për subjektin X sqarojmë se vlerat e paraqitura në observacion janë reflektuar në diferencën e përlllogaritur nga grupi i auditimit, konkretisht diferenca për vitin 2020 në vlerën 37,478,237 lekë dhe për vitin 2021 në vlerën 63,923,905 lekë. Pjesa që mbetet nga diferenca e deklaratës së TVSH me TF, krahasuar me vlerat e argumentuara, është ajo që ka mbetur si diferencë e pa justifikuar. Për më tepër argumenti për kontratat e shitjes të lidhura por pa faturë, nuk merret në konsideratë. Për sa i përket observacionit të përcjellë nga inspektori S. M. (S.), për subjektin X për vitin 2021 observacioni merret në konsideratë, ndërsa për vitin 2020 vlera e diferencës nuk përputhet me vlerat e pretenduara në PASH si shkak i diferencës dhe është reflektuar diferenca mes tyre në raport . Për rastet e tjera ku dokumentacioni justifikues përputhet me diferencën, ato janë reflektuar në material. Rastet e tjera ku kjo diferencë nuk është e njëjtë me atë të pretenduar, apo nuk ka dokumentacion justifikues, kanë mbetur të pandryshuara.

Për sa i përket observacionit të përcjellë nga Përgjegjësja e Sektorit të Kontrollit nga Zyra, konkludojmë se nuk u paraqitën fakte të reja nga sa trajtuar në projektraport. Argumentet e paraqitura sqarojmë se në asnjë rast që është trajtuar në këtë raport, nuk u shoqëruan me dokumentacionin justifikues si gjatë fazës së auditimit në terren, ashtu edhe në fazën e observacioneve. Sqarojmë se nga ana e DRT Shkodër nuk rezultoi të jetë përcjellë asnjë praktikë shoqëruese të bërë sipas manualit ku citohet se inspektori duhet të kryejë verifikimet e nevojshëm e për ca kohë viti 2020 dhe 2021 kanë mbyllur deklaratat financiare, diferencat duhet të ishin shoqëruar me akt vlerësimin tatimor përkatës për këto diferencave sikundër parashikon manuali përkatës. Dërgimi i deklaratave të importit, faturave, apo dokumentacioneve të tjera janë pjesë e punës së Drejtorisë Rajonale Tatimore, në vijim të shqyrtimit të cilave duhet të ishin kryer dhe sistemimet e nevojshme në sistem, si pjesë e detyrave dhe përgjegjësi të funksioneve të tyre. Diferencat e trajtuara si të ardhura të munguara kanë përfshirë vetëm vitin 2020 dhe 2021.

Për sa i përket mosfunksionimit të sistemit elektronik tatimor, sistemin e kasave Nexus, mos pasqyrimin e vlerave të pajisjeve fiskale të çregjistruara në raportet e fundit nga AKSHi, dhe fshirjes së dokumentacionit dhe informacionit nga posta elektronike e punonjësve të institucionit, sqarojmë se këto fakte nuk e rrezojnë konstatimin e ngritur nga grupi i audituesve të KLSH-së në kushtet kur auditimi është kryer në bazë të evidencave të vendosura në dispozicion zyrtarisht nga DRT Shkodër. Megjithatë ne do t'i drejtohem strukturave përgjegjëse me rekomadimin që, t'i drejtohen në mënyrë zyrtare AKSHI-t për normalizimin e funksionimit të sistemit informatik tatimor dhe rikthimin e dokumentacionit dhe informacionit të fshirë në postën elektronike zyrtare të institucionit. Rastet specifike të subjekteve ku si shkak i diferencës është identifikuar kjo arsye nga ana e inspektorëve janë reflektuar në raport në një aneks të veçantë, të pa përfshira në të ardhurat e munguara.

Për sa i përket problematikave të konstatuara në monitorimin e akt marrëveshjeve, apo tepricave kreditore, bizneset që kanë deklaruar nuk u paraqitën fakte të reja nga sa trajtuar në projektraport, dhe qëndrimi i grupit mbetet i njëjtë. Të ardhurat e munguara në rishikimet e kështit të tatim fitimit i përkisnin rastet ku vlera e parapagimit nuk përputhet me kriteret e kuadrit ligjor dhe nuk ishin aplikuar penalitete. Për sa i përket rekomandimit lidhur me rimbursimin e TVSH-së, rekomandimi merret parasysh duke qenë se me ndryshimin në manual, kryerja e rimbursimeve të TVSH-së nuk kryhet më nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra.

Për sa i përket observacionit të paraqitur nga inspektorja R.R. sqarojmë se pas vendosjes në dispozicion të dokumentacionit justifikues observacioni pranohet për dy subjektet ku janë reflektuar diferencat në pasqyrat financiare. Për sa i përket subjektit X, diferenca e justifikuar në PF është reflektuar në diferencën finale të përlllogaritur për subjektin.

III.2.4. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, të veprimtarisë së Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara.

Struktura e DMDTP ka funksionuar me Urdhrin nr.49, datë 27.02.2019 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 126 datë 2.08.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore” dhe me Urdhrin nr.86, datë 03.05.2019 “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, të ndryshuar.

Në vijim struktura me Urdhrin Nr. 33 datë 12.02.2020 “Për miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, është miratuar struktura e dhe plotësimi i saj ka përfunduar në gusht të vitit 2020. Me strukturën e re DMDTP është emërtuar Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara Rajoni Verior dhe përfshin: *Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, Drejtorinë Rajonale Lezhë, Drejtorinë Rajonale Tatimore Dibër, Drejtorinë Rajonale Tatimore Kukës.*

Për periudhën objekt auditimi konstatohen 8 raste delegime dhe transferime të stafit të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, si brenda DRT Shkodër ashtu dhe në DRT të tjera, konkretisht në DRT Lezhë, duke krijuar vakanca që cenojnë përmbushjen e detyrave funksionale të kësaj Drejtorie, duke qenë se nuk sigurohet mbikëqyrje e plotë e punës dhe mbingarkohet pjesa tjetër e punonjësve me kryerjen e procesit të punës. Vendet e lira të punës tregojnë mangësi në procesin e realizimit të strukturës së miratuar. Mosplotësimi me staf i kësaj drejtorie shoqërohet me risk të lartë në mirëfunksionimin e punës.

Niveli i Borxhit tatimor, niveli i arkëtimeve, ecuria e detyrimeve të papaguara për periudhën objekt auditimi.

Për periudhën objekt auditimi, periudha 01.01.2020-30.06.2022, në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër, situata e gjendjes në fillim, krijimi i detyrimit, arkëtimet dhe gjendjes në fund të detyrimit të pa arkëtuar pasqyrohet si në vijim:

1. Të dhënat progresive 2020-2021-30.06.2022

000/lekë

DRT	GJENDJA 01.01.2020		SHTIME Janar - Dhjetor 2020		PAKËSIMET						GJENDJA 31.12.2020		PROCES GJYQ	
					Arkëtuar 2020		Sistemime		Falur Ligji 33/2017					
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
Rajoni Verior	18.421	9.999.592	28.212	2.543.716	16.528	1.413.727	567	122.238	-	-	29.538	11.007.343	3.048	808.527

Gjendja e detyrimeve të papaguara në fund të vitit 2020 është 11,007,343 mijë lekë që i përkasin 29,538 subjekteve. Referuar arkëtimeve gjithsej të realizuara nga Rajoni Verior janë 1,413,727 mijë lekë në vitin 2020, që u përkasin 16,528 subjekteve.

000/lekë

DRT	GJENDJA 01.01.2021		SHTIME Janar - Dhjetor 2021		PAKËSIMET						GJENDJA 31.12.2021		PROCES GJYQ	
					Arkëtuar 2021		Sistemime		Falur Ligji 33/2017					
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
Rajoni Verior	29.538	11.007.343	42.282	3.581.492	29.300	1.997.341	-	-	-	-	42.520	12.591.494	3.060	1.511.534

Gjendja e detyrimeve të papaguara në fund të vitit 2021 është 12,591,494 mijë lekë që i përkasin 42,520 subjekteve. Referuar arkëtimeve gjithsej të realizuara nga Rajoni Verior janë 1,997,341 mijë lekë në vitin 2021, që u përkasin 29,300 subjekteve.

000/lekë

DRT	GJENDJA 01.01.2022		SHTIME 01.01.2022-30.06.2022		PAKËSIMET						GJENDJA 30.06.2022		PROCES GJYQ	
					Arkëtuar 01.01.2022- 30.06.2022		Sistemime		Falur					
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
Rajoni Verior	42,520	12,591,494	10,071	2,005,066	28,775	1,306,032	-	-	-	-	23,816	13,290,528	3,099	1,057,473

Gjendja e detyrimeve të papaguara në fund të muajit Qershor 2022 për rajonin Verior është 13,290,528 mijë lekë, që i përkasin 23,816 subjekteve. Referuar arkëtimeve gjithsej të realizuara nga rajoni Verior deri në 30.06.2022 janë në shumën prej 1,306,032 mijë lekë që u përkasin 28,775 subjekteve. Trendi për detyrimet e rajonit Verior, për vitin 2020-2021 paraqitet me një rritje në masën 14.39 % në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020, ndërsa trendi për arkëtimet, për vitin 2020-2021 paraqitet me një rritje të ndjeshme: në masën 41.3 % në vitin 2021, krahasuar me vitin 2020. Trendi për detyrimet e rajonit Verior, për periudhën 30.06.2022-2021 paraqitet me një rritje në masën 5.55 % në 30.06.2022 krahasuar me vitin 2021, ndërsa trendi për arkëtimet, për periudhën 30.06.2022-2021 paraqitet me një ulje të ndjeshme: në masën 34 % në 30.06.2022, krahasuar me vitin 2021.

Detyrimet e papaguara tatimore të raportuara nga Drejtoria Rajonale Tatimore për periudhën 01.01.2020 deri më 30.06.2022, është përfshirë dhe vlera e cila faktikisht nuk është kthyer në detyrim dhe që i përket çështjeve që janë në proces gjyqësor sipas raportimeve të mësipërme.

2. Të dhënat progresive të muajit Dhjetor 2020-2022 dhe 30.06.2022

000/lekë

DRT	GJENDJA 01.12.2020		SHTIME DHJETOR		PAKËSIMET				GJENDJA 31.12.2020		PROCES GJYQ.	
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtime Dhjetor		Sistemime		Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
Rajoni Verior	26,570	10,989,657	4,304	187,482	1,336	169,796	-	-	29,538	11,007,343	3,048	808,527

Të dhënat progresive të rajonit Verior për muajin dhjetor 2020: borxhi në muajin dhjetor 2020 është shtuar me 187,482 mijë lekë që u përket 4,304 subjekteve. Referuar arkëtimeve janë në vlerën 169,796 mijë lekë që u përkasin 1,336 subjekteve.

000/lekë

DRT	GJENDJA 01.12.2021		SHTIME		PAKËSIMET				GJENDJA 31.12.2021		PROCES GJYQ.	
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtime		Sistemime		Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
Rajoni Verior	41,932	12,484,500	2,010	228,580	1,422	121,586	-	-	42,520	12,591,494	3,060	1,511,534

Të dhënat progresive të muajit Dhjetor 2021 për rajonin verior: borxhi në muajin dhjetor 2021 është shtuar me 228,580 mijë lekë që u përket 2,010 subjekteve. Referuar arkëtimeve janë në vlerën 121,586 mijë lekë që u përkasin 1,422 subjekteve.

000/lekë

DRT	GJENDJA 01.06.2022		SHTIME		PAKËSIMET				GJENDJA 30.06.2022		PROCES GJYQ.	
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Arkëtime		Sistemime		Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
Rajoni Verior	26,639	13,197,957	180	256,388	3,003	163,817			23,816	13,290,528	3,099	1,057,473

Të dhënat progresive të muajit Qershor 2022 për rajonin verior: borxhi në muajin qershor 2022 është shtuar me 256,388 mijë lekë që u përket 180 subjekteve. Referuar arkëtimeve janë në vlerën 163,817 mijë lekë që u përket 3,003 subjekteve.

3. Detyrimi sipas llojit të Tatimit 2020-2021-30.06.2022

000/lekë

LLOJ I TATIMIT RAJ VERIOR	GJENDJA 31.12.2020		PROCES GJYQ.	
	Numër	Vlera	Numër	Vlera
Tat Fitimi	18,476	2,349,301	354	284,361
TVSH	18,185	4,805,208	1,129	314,548
Sig.Shoq	123,151	2,090,200	1,172	168,691
TAP	11,626	201,513	209	16,452
Të tjera	46,657	1,561,121	184	24,475

Në stokun e borxhit të Rajonit Verior të ndarë sipas llojit të tatimit për vitin 2020 pa proceset gjyqësore, TVSH zë peshën më të madhe me 43.7 %, e ndjekur nga Tatim fitimi me 21.3%, Sigurimet shoqërore dhe Shëndetësore me 19%, Të tjera me 14.2% dhe zëri TAP me 1.8%.

000/lekë

LLOJ I TATIMIT RAJ VERIOR	GJENDJA 31.10.2021		PROCES GJYQ.	
	Numër	Vlera	Numër	Vlera
Tat Fitimi	7,301	3,015,802	354	504,172
TVSH	17,212	5,632,477	1,141	523,554
Sig.Shoq	121,697	2,229,414	1,154	295,470
TAP	15,233	135,826	209	28,912
DIVA	955	33,451	-	-
Tatimi në burim	26,827	126,946	104	126,644
Të tjera	19,230	1,417,578	98	32,782

Në stokun e borxhit të Rajonit Verior të ndarë sipas llojit të tatimit për vitin 2021 pa proceset gjyqësore, TVSH zë peshën më të madhe me 44.7%, e ndjekur nga Tatim fitimi me 24% Sigurimet shoqërore me 17.7%, Të tjera me 11.3%, Tatimi në burim me 1%, Tatimi mbi pagën me 1% dhe DIVA me 0.3%.

000/lekë

LLOJ I TATIMIT RAJ VERIOR	GJENDJA 30.06.2022		PROCES GJYQ.	
	Numër	Vlera	Numër	Vlera
Tat Fitimi	6,662	3,205,146	1,034	352,721
TVSH	18,312	5,985,531	1,297	442,288
Sig.Shoq	104,997	2,318,773	60	20,226
Tatimi mbi pagën	9,278	76,450	325	111,056
DIVA	1,527	45,091	57	19,649
Tatimi në burim	32,566	185,605	260	88,600
Të tjera	20,555	1,473,932	67	22,933

Në stokun e borxhit të Rajonit Verior të ndarë sipas llojit të tatimit deri në fund të muajit qershor 2022 pa proceset gjyqësore, TVSH zë peshën më të madhe me 45%, e ndjekur nga Tatim fitimi me 24.1%, Sigurimet shoqërore me 17.4%, Të tjera me 11.1%, Tatimi në burim me 1.4%, tatimi mbi pagën me 0.6% dhe DIVA me 0.4%. *Për periudhën objekt auditimi, TVSH zë pjesën më të madhe të stokut të borxhit.*

4. Masat shtrënguese Janar-Dhjetor 2020-2021-30.06.2022

000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE RAJONI VERIOR 2020	TE VENDOSURA		TE ARKETUARA	
		Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	5,459	7,403,444	32,639	479,942
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	17,671	12,304,944	3,901	279,547
3	Urdhër ekzekutime	12,804	943,246	3,438	43,370
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	12,904	3,975,288	400	3,977
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	13,104	9,080,331	121	1,558
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	12,776	2,131,504	153	1,198
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguruese	331	8,158,237	-	-
8	Urdhër sekuestrimi	-	-	-	-
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	-	-	-
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	197	47,095	102	7,542
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	503	102,354	-	-
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	367	8,109,003	82	48,088
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	145	2,212,862	12	8,778
14	Konfiskim i 50% te xhiros ditore	2	564	2	564
	Totali	76,263	54,468,872	40,850	874,564

000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE RAJONI VERIOR 2021	TE VENDOSURA		TE ARKETUARA	
		Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	1,378	5,032,394	88	21,099
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	1,284	5,455,337	98	435,925
3	Urdhër ekzekutime	200	70,559	65	682,132
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	1,202	1,989,297	-	-
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	910	1,750,638	-	-
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	760	1,369,644	-	-
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguruese	1,040	1,980,298	11	2,391
8	Urdhër sekuestrimi	-	-	-	-
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	194	520,931	109	29,716
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	-	-	-	-
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	41	112,563	-	-
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	1,187	3,000,185	127	653,686
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	738	2,466,438	4	1,709
14	Konfiskim i 50% te xhiros ditore	649	587,703	182	73,974
	Totali	9,583	24,335,987	691	1,904,158

000/lekë

Nr.	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE RAJONI VERIOR KORRIK 2022	TE VENDOSURA		TE ARKETUARA	
	Llojet	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Njoftim dhe kërkesë për të paguar	495	3,162,547	33	97,512
2	Urdhër bllokim të llogarive bankare	325	2,604,225	27	18,960
3	Urdhër ekzekutime	136	80,762	-	-
4	Njoftim i përgjithshëm për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	370	5,408,249	-	-
5	Njoftim tatimpaguesit për vendosjen e barrës hipotekore dhe siguruese	370	5,408,249	-	-
6	Njoftim për vendosjen e barrës hipotekore	370	5,408,249	-	-
7	Njoftim për vendosjen e barrës siguruese	370	5,408,249	-	-
8	Urdhër sekuestrimi	-	-	-	-
9	Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë	-	-	-	-
10	Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98	-	-	-	-
11	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	-	-	-	-
12	Kërkesë për pezullim të aktivitetit në Doganë	355	5,358,318	33	38,496
13	Njoftim për vendosjen e masës së sigurimit tatimor në QKB	298	5,110,518	2	794
14	Konfiskim I 50% te xhiros ditore	112	77,930	130	66,978
	Totali	3,243	38,056,035	468	305,762

Mungesa e efektivitetit të masave shtrënguese të ndërmarra për arkëtimin e borxhit të tatimpaguesve si dhe moszbatimi i tyre në mënyrë shteruese ka shkaktuar që stoku i borxhit të vijojë me rritje.

5. Mosha e Borxhit 2020-2021-30.06.2022

000/lekë

MOSHA 2020 RAJ Verior	DETYRIMET E BORXHIT											
	TAP		TATIM FITIMI		TVSH		SIGURIME SHOQ-SHËNDET		TË TJERA		TOTALI	
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
< 3 muaj	2,173	15,575	801	408,710	1,430	286,223	11,831	244,794	354	22,470	16,589	977,772
3 – 6 muaj	1,040	12,988	703	282,817	1,170	363,074	7,300	108,046	530	9,895	10,743	776,820
6-12 muaj	1,383	16,656	2,486	132,035	1,690	113,641	10,764	220,794	4,532	168,509	20,855	651,635
1-2 vjet	3,016	67,655	3,806	271,300	4,736	520,328	29,552	447,240	7,269	287,446	48,379	1,593,969
2-5 vjet	4,014	88,639	4,933	714,119	7,468	1,320,730	36,397	703,324	13,542	488,544	66,354	3,315,356
mbi 5 vjet			5,747	540,320	1,691	2,201,212	27,307	366,002	20,430	584,257	55,175	3,691,791
TOTALI	11,626	201,513	18,476	2,349,301	18,185	4,805,208	123,151	2,090,200	46,657	1,561,121	218,095	11,007,343

Në 31.12.2020 borxhi i ndarë sipas moshës rezulton si në vijim:

Mosha e Borxhit (31.12.2020)	% ndaj totalit të Stokut të Borxhit
Borxhi deri në 3 muaj	8,9 % ndaj totalit të stokut
Borxhi nga 3 - 6 muaj	7,1 % ndaj totalit të stokut
Borxhi nga 6-12 muaj	5,9 % ndaj totalit të stokut
Borxhi nga 1-2 vjet	14,5 % ndaj totalit të stokut
Borxhi nga 2-5 vjet	30,1 % ndaj totalit të stokut
Borxhi mbi 5 vite	33,5 % ndaj totalit të stokut

000/lekë

MOSHA E BORXHIT 31.12.2021 RAJONI VERIOR	DETYRIMET E BORXHIT											
	TAP		TATIM FITIMI		TVSH		SIGURIME SHOQ SHENDET		TE TJERA		TOTALI	
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
< 3 muaj	25	178	64	46,365	773	102,762	5,577	145,088	2,348	26,146	8,787	320,539
3 – 6 muaj	11	95	73	66,770	530	93,719	4,954	160,830	1,842	15,867	7,410	337,281
6-12 muaj	91	1,465	487	389,208	1,101	523,711	8,906	182,098	4,264	51,496	14,849	1,147,978
1-2 vjet	2,021	1,138	622	388,799	2,278	626,528	19,763	297,979	5,300	48,437	29,984	1,362,881

2-5 vjet	4,192	2,884	1,968	511,570	5,292	845,645	39,837	601,952	15,021	200,103	66,310	2,162,154
mbi 5 vjet	8,893	130,066	4,087	1,613,090	7,238	3,440,112	42,660	841,467	18,237	1,235,926	81,115	7,260,661
TOTALI	15,232	135,826	7,301	3,015,802	17,212	5,632,477	121,697	2,229,414	47,012	1,577,975	208,455	12,591,494

Në 31.12.2021 borxhi i ndarë sipas moshës rezulton si në vijim:

Mosha e Borxhit (31.12.2021)	% ndaj totalit të Stokut të Borxhit
Borxhi deri në 3 muaj	2,5 % ndaj totalit të stokut
Borxhi nga 3 - 6 muaj	2,7 % ndaj totalit të stokut
Borxhi nga 6-12 muaj	9,1 % ndaj totalit të stokut
Borxhi nga 1-2 vjet	10,8 % ndaj totalit të stokut
Borxhi nga 2-5 vjet	17,2 % ndaj totalit të stokut
Borxhi mbi 5 vite	57,7 % ndaj totalit të stokut

000/lekë

MOSHA E BORXHIT 30.06.2022 RAJONI VERIOR	DETYRIMET E BORXHIT											
	TAP		TATIM FITIMI		TVSH		SIGURIME SHOQ SHENDET		TE TJERA		TOTALI	
	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
< 3 muaj	72	211	552	89,959	868	220,387	2,663	146,179	4,865	53,072	9,020	509,808
3 – 6 muaj	2	1	298	127,946	615	148,678	4,841	90,263	2,160	14,461	7,916	381,349
6-12 muaj	29	193	232	79,151	1,081	213,084	8,630	227,963	3,084	31,907	13,056	552,298
1-2 vjet	119	1,590	566	704,034	2,252	1,045,201	14,561	276,917	6,934	70,758	24,432	2,098,500
2-5 vjet	715	4,494	1,769	349,164	5,799	681,029	37,547	654,027	15,456	180,874	61,286	1,869,588
mbi 5 vjet	8,341	69,961	3,245	1,854,892	7,697	3,677,152	36,755	923,424	22,149	1,353,556	78,187	7,878,985
TOTALI	9,278	76,450	6,662	3,205,146	18,312	5,985,531	104,997	2,318,773	54,648	1,704,628	193,897	13,290,528

Në 30.06.2022 borxhi i ndarë sipas moshës rezulton si në vijim:

Mosha e Borxhit (30.06.2022)	% ndaj totalit të Stokut të Borxhit
Borxhi deri në 3 muaj	3,9 % ndaj totalit të stokut
Borxhi nga 3 - 6 muaj	2,9 % ndaj totalit të stokut
Borxhi nga 6-12 muaj	4,2 % ndaj totalit të stokut
Borxhi nga 1-2 vjet	15,8 % ndaj totalit të stokut
Borxhi nga 2-5 vjet	14,1 % ndaj totalit të stokut
Borxhi mbi 5 vite	59,1 % ndaj totalit të stokut

Gjendja e detyrimeve tatimore të papaguara në afat (borxhit) në fund të periudhës përbëhet kryesisht nga detyrimet tatimore të lindura mbi 5 vjet të cilat zënë një peshë prej 59.1% të totalit të borxhit në fund të muajit qershor 2022. Borxhi nga 2-5 vite përbën 14.1 % të stokut të tij ndërsa borxhi nga 1 deri në 2 vite zë 15.8 %.

6. Borxhi i ndarë sipas detyrim-gjobë-interes 2020-2021-30.06.2022

000/lekë

BORXHI 2020 RAJ. VERIOR	DETYRIM	GJOBË	INTERES	TOTALI
TAP	71,891	106,266	23,356	201,513
Tatim Fitim	1,489,631	712,802	146,868	2,349,301
TVSH	2,521,098	1,599,693	684,417	4,805,208
Sig shoq/shëndet	1,542,457	415,164	132,579	2,090,200
Të tjera	470,367	1,084,043	6,711	1,561,121
TOTALI	6,095,444	3,917,968	993,931	11,007,343

Borxhi tatimor i rajonit verior në total prej 11,007,343 mijë lekë në datën 31.12.2020 përbëhet nga:

- Principali/detyrimi në shumën prej 6,095,444 mijë lekë;
- Gjobë në shumën prej 3,917,968 mijë lekë;

- Kamat vonesa në shumën prej 993,931 mijë lekë.

000/lekë				
BORXHI 2021 RAJ. VERIOR	DETYRIM	GJOBË	INTERES	TOTALI
TAP	2,011,389	839,834	164,579	3,015,802
Tatim Fitim	3,134,747	1,792,102	705,628	5,632,477
TVSH	1,664,188	446,345	118,880	2,229,414
Sig shoq/shëndet	70,000	33,128	32,698	135,826
DIVA	28,714	4,107	630	33,451
Tatim burim	67,705	55,739	3,501	126,946
Të tjera	388,740	1,001,018	27,820	1,417,578
TOTALI	7,365,484	4,172,274	1,053,737	12,591,494

Borxhi tatimor i rajonit verior në total prej 12,591,494 mijë lekë në datën 31.12.2021 përbëhet nga:

- Principali/detyrimi në shumën prej 7,365,484 mijë lekë;
- Gjobë në shumën prej 4,172,274 mijë lekë;
- Kamat vonesa në shumën prej 1,053,737 mijë lekë.

000/lekë				
BORXHI 30.06.2022 RAJ. VERIOR	DETYRIM	GJOBË	INTERES	TOTALI
TAP	37,886	19,308	19,256	76,450
Tatim Fitim	2,153,654	882,799	168,693	3,205,146
TVSH	3,390,209	1,881,019	714,303	5,985,531
Sig shoq/shëndet	1,712,689	466,817	139,267	2,318,773
Të tjera	465,175	1,225,579	13,874	1,704,628
TOTALI	7,759,613	4,475,522	1,055,393	13,290,528

Borxhi tatimor i rajonit verior në total prej 13,290,528 mijë lekë në datën 30.06.2022 përbëhet nga:

- Principali/detyrimi në shumën prej 7,759,613 mijë lekë;
- Gjobë në shumën prej 4,475,522 mijë lekë;
- Kamat vonesa në shumën prej 1,055,393 mijë lekë.

7. Borxhit sipas statusit aktiv-pasiv 2020-2021-30.06.2022

000/lekë						
STATUSI SUBJEKT 2020	AKTIV		JOAKTIV		TATIMPAGUESIT TOTAL	
	NR.	VLERA	NR.	VLERA	NR.	VLERA
RAJONI VERIOR	18,404	3,761,151	11,134	7,246,194	29,538	11,007,343

Për vitin 2020 borxhi i rajonit verior sipas statusit të subjekteve rezulton: në statusin e subjekteve aktiv në vlerën 3,761,151 mijë lekë ose në 34.2 % të totalit të tij. Kjo vlerë u takon 18,404 subjekteve nga 29,538 në total ose 62.3% të numrit të subjekteve. Në statusin e subjekteve pasiv në vlerën 7,246,194 mijë lekë ose në 65.8 % të totalit të tij. Kjo vlerë u takon 11,134 subjekteve ose 37.7% e numrit total të subjekteve debitorë.

000/lekë						
STATUSI SUBJEKT 2021	AKTIV		JOAKTIV		TATIMPAGUESIT TOTAL	
	NR.	VLERA	NR.	VLERA	NR.	VLERA
RAJONI VERIOR	23,253	4,137,783	19,267	8,453,711	42,520	12,591,494

Për vitin 2021 borxhi i rajonit verior sipas statusit të subjekteve rezulton: në statusin e subjekteve aktiv në vlerën 4,137,783 mijë lekë ose në 32.8 % të totalit të tij. Kjo vlerë u takon 23,253 subjekteve nga 42,520 në total ose 54.7% të numrit të subjekteve. Në statusin e subjekteve pasiv në vlerën 8,453,711 mijë lekë ose në 67.2 % të totalit të tij. Kjo vlerë u takon 19,267 subjekteve ose 45.3 % e numrit total të subjekteve debitorë.

000/lekë						
STATUSI SUBJEKT 30.06.2022	AKTIV		JOAKTIV		TATIMPAGUESIT TOTAL	
	NR.	VLERA	NR.	VLERA	NR.	VLERA

RAJONI VERIOR	7,935	3,797,456	15,881	9,493,072	23,816	13,290,528
---------------	-------	-----------	--------	-----------	--------	------------

Për periudhën 30.06.2022 borxhi i rajonit verior sipas statusit të subjekteve rezulton: në statusin e subjekteve aktiv në vlerën 3,797,456 mijë lekë ose në 28.6 % të totalit të tij. Kjo vlerë u takon 7,935 subjekteve nga 23,816 në total ose 33.3% të numrit të subjekteve. Në statusin e subjekteve pasiv në vlerën 9,493,072 mijë lekë ose në 71.4 % të totalit të tij. Kjo vlerë u takon 15,881 subjekteve ose 66.7% e numrit total të subjekteve debitorë.

8. Detyrime të mbajtura jashtë sistemit

Detyrimet e akcizës të mbajtura jashtë sistemit C@TS për DRT Shkodër rezultojnë në vlerën 20,004,043 lekë, të regjistruara në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, detyrime që datojnë prej vitit 2008. Aktualisht nuk janë kryer veprime për mbledhjen e këtyre detyrimeve tatimore për shkak të mungesës së dokumentacioneve, të dhënave të plota dhe pamundësisë për regjistrim në sistem.

Sipas informacionit të paraqitur nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, detyrimet jashtë sistemit për Rajonin Verior rezultojnë si në vijim:

DRT	Vlera e detyrimit jashtë sistemi
Shkodër	20,004,043
Kukës	42,613,632
Dibër	48,918,116
Lezhë	1,676,075

9. Borxhi i regjistruar sipas llojit të pronësisë 2020-2021-30.06.2022

Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Rajoni Verior, nuk disponon të dhëna për vitin 2020 për borxhin e regjistruar sipas pronësisë.

Për periudhën 2021 dhe 30.06.2022, paraqitet si në vijim:

NR.	DRT 2021	000/lekë			
		Buxhetor		Privat	
		Nr. subjekte	Vlerë borxhi	Nr. subjekte	Vlerë borxhi
1	Rajoni VERIOR	209	526,537	42,311	12,064,957

Sa më sipër borxhi paraqitet i ndarë në lloj dhe pronësi, subjekte private dhe buxhetorë përfshirë dhe SHA me kapital shtetëror, ku peshën kryesore e zë borxhi privat në masën prej 95,8 % të totalit të borxhit.

NR.	DRT 30.06.2022	000/lekë			
		Buxhetor		Privat	
		Nr. subjekte	Vlerë borxhi	Nr. subjekte	Vlerë borxhi
1	Rajoni VERIOR	227	560,138	23,589	12,730,390

Sa më sipër borxhi paraqitet i ndarë në lloj dhe pronësi, subjekte private dhe buxhetorë përfshirë dhe SHA me kapital shtetëror, ku peshën kryesore e zë borxhi privat në masën prej 95,8 % të totalit të borxhit.

10. Trendi i borxhit

Vitet	Gjendja e Borxhit Tatimor Rajoni Verior		Rritja në %
	Nr. Subjektesh	Vlerë (000/lekë)	
31.12.2020	29,538	11,007,343	
31.12.2021	42,520	12,591,494	14,39%
30.06.2020	23,816	13,290,528	5,55%

Për sa i përket trendit të borxhit të Rajonit Verior për vitet 2020-2021 ka një rritje prej 14.39% ndërsa krahasuar periudha 30.06.2022 me vitin 2021 rritja e borxhit rezulton në norma më të ulta prej 5.55%. Trendi i borxhit është në rritje.

11. Subjektet aktive dhe pasive

000/lekë

VITI	Subjekte aktive	Vlera e borxhit për subjektet aktive	Subjekte pasive	Vlera e borxhit për subjektet pasive	Borxhi deri në fund të vitit	
					Nr.	Vlerë Borxhi
31.12.2020	18,404	3,761,151	11,134	7,246,194	29,538	11,007,343
31.12.2021	23,253	4,137,783	19,267	8,453,711	42,520	12,591,494
RRITJE	26,3%	10%	73%	16,7%	44%	14,39%

VITI	Subjekte aktive	Vlera e borxhit për subjektet aktive	Subjekte pasive	Vlera e borxhit për subjektet pasive	Borxhi deri në fund të vitit	
					Nr.	Vlerë Borxhi
31.12.2021	23,253	4,137,783	19,267	8,453,711	42,520	12,591,494
30.06.2020	7,935	3,797,456	15,881	9,493,072	23,816	13,290,528
ULJE/RRITJE	*ulje 65,9%	*ulje 8,2%	*ulje 17,6%	*rritje 13,3%	*ulje 35,6%	5,55%

Për sa i përket trendit të detyrimeve të subjekteve aktivë dhe pasive të Rajonit Verior konstatohet se trendi i detyrimit të subjekteve aktivë rezulton me një ulje të lehtë prej 8.2% ndërsa i subjekteve pasivë me një rritje prej 13.3%.

12. Mosha e Borxhit

000/lekë

MOSHA E BORXHIT Rajoni Verior	31.12.2020	31.12.2021	Ndryshimi	
	Vlera	Vlera	Ulje	Rritje
Borxhi deri ne 3 muaj	977,772	320,539	67,2%	
Borxhi nga 3 - 6 muaj	776,820	337,281	56,6%	
Borxhi nga 6-12 muaj	651,635	1,147,978		76,2%
Borxhi nga 1-2 vjet	1,593,969	1,362,881		14,5%
Borxhi nga 2-5 vjet	3,315,356	2,162,154	34,8%	
Borxhi mbi 5 vjet	3,691,791	7,260,661		96,7%
TOTALI	11,007,343	12,591,494		14,39%

000/lekë

MOSHA E BORXHIT Rajoni Verior	31.12.2021	30.06.2022	Ndryshimi	
	Vlera	Vlera	Ulje	Rritje
Borxhi deri ne 3 muaj	320,539	509,808		59%
Borxhi nga 3 - 6 muaj	337,281	381,349		13%
Borxhi nga 6-12 muaj	1,147,978	552,298	51,9%	
Borxhi nga 1-2 vjet	1,362,881	2,098,500		54%
Borxhi nga 2-5 vjet	2,162,154	1,869,588	13,5%	
Borxhi mbi 5 vjet	7,260,661	7,878,985		8,51%
TOTALI	12,591,494	13,290,528		5,55%

Për sa më sipër paraqiten në % ndryshimet e borxhit kategorizuar sipas moshës për Rajonit Verior për periudhën objekt auditimi.

13. Efektiviteti i masave shtrënguese ndër vite

000/lekë

VITI	Vlerë e Vendosur	Vlerë e Arkëtuar	Diferencë e pa-arkëtuar	% e arkëtimit kundrejt masave
31.12.2020	54,468,872	874,564	53,594,326	1,6%
31.12.2021	24,335,987	1,904,158	22,431,829	7,8%
30.06.2022	38,056,035	305,762	37,750,273	0,8%

Konstatohet se % e arkëtimit kundrejt masave shtrënguese rezulton në nivel shumë të ulët krahasuar me detyrimin dhe vlerën e vendosur në masë, rezultat i masave jo të plota dhe shteruese kundrejt debitorëve dhe mungesës së efektivitetit të tyre.

Debitorët me vlerat më të larta të detyrimeve

000/lekë		
NIPT	SUBJEKTI	Vlera e Detyrimit 30.06.2022
X	K	1,788,017
X	FI	800,018
X	K	776,562
X	K	748,810
X	EG	699,673
X	E	203,461
X	V	202,208
X	S	184,655
X	G	173,309
X	UK	140,539
X	MD	114,287
X	KFV	110,923
X	T	104,684
X	ML	103,082
Total		6,150,229

Nga auditimi konstatohet se 14 debitorë përbëjnë 46% të totalit të detyrimit. Në lidhje me masat shtrënguese të këtyre debitorëve situata rezulton sipas ankesit II.2.4.1.

Në lidhje me debitorin “KV” konstatohet se është vendosur urdhër bllokim nr.5524/2 datë 24.07.2020 për detyrimet jashtë marrëveshjes, pasi subjekti ka qenë edhe në proces gjyqësor dhe në aktmarrëveshje për likudim detyrimi, sipas shkresës nr.5840/1 prot. datë 22.10.2021. Gjithashtu është kërkuar informacion Drejtorisë Rajonale të Transportit Rrugor Shkodër me shkresën nr.676 prot. datë 06.06.2022, në lidhje me mjetet në pronësi, për të cilën nuk është kthyer përgjigje.

Nga ana e DRT Shkodër nuk është ezauruar në asnjë rast asnjë prej masave e tjera shtrënguese si në vijim:

LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE
Urdhër Sekuestrim
Njoftim transferimi detyrimi tatimor palës së tretë
Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta në zbatim të nenit 98
Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit

Nga Drejtoria e Mbledhjes së detyrimeve të papaguara pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër nuk është marrë në konsideratë Neni 88 kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar” 97, 98 dhe neni 99 “Përgjegjësia e ortakut, aksionarit dhe administratorit” i Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar. Për zbatimin e masave shtrënguese dhe vendosjen e barrëve sigurose i janë drejtuar DRSHTRR/DPSHTRR dhe Bankave të Nivelit të Dytë. Drejtoria e mbledhjes së detyrimeve tatimore të papaguara Shkodër, nuk ka kërkuar informacion në të gjitha zyrat që regjistrojnë pasuri të luajtshme sipas përcaktimeve të Nenit 91, pika 91.2.5 dhe pika 91.2.8 të Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr. 24, datë 02.09.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Kjo ka shkatuar që pasuri të tjera të luajtshme të tatimpaguesve debitorë të mos jenë identifikuar dhe rrjedhimisht vijuar në fazat e tjera të mbledhjes me forcë. Detyrimet me vjetërsi mbi 2 vjet zënë një pjesë të konsiderueshme të totalit (73.2%) duke treguar për një pamundësi të

arkëtueshmërisë së tyre në Buxhetin e Shtetit. Konstatohen boshllëqe në politikat ekzistuese për shuarjen e borxhit të pa mbledhshëm.

Subjekte që rezultojnë debitorë në TF

DRT Shkodër

Nisur nga deklarata e TF 2019 si dhe të dhënave të përpunuara nga sistemi C@ts, rezultojnë debitorë në mos likuidimin e TF të vet deklaruar për DRT Shkodër, si në vijim:

SUBJEKTI	DETYRIMI PRINCIPAL	INTERESA	GJOBA	DETYRIMI TOTAL
Aktivë 84	21,417,724	627,160	4,806,377	26,851,261
Kërkesë për çregjistrim 7	258,742	337	83,566	342,645
Pasivë 64	2,886,049	3,636	1,731,478	4,621,163
TOTAL 155	24,562,515	631,133	6,621,421	31,815,069

Për sa më sipër konstatohen 155 subjekte të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2019 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 31,815,069 lekë, vlerë e cila duhet të ishte e arkëtuar brenda 31.03.2020. Nisur nga deklarata e TF 2020 si dhe të dhënave të përpunuara nga sistemi C@ts, rezultojnë debitorë në mos likuidimin e TF të vet deklaruar për DRT Shkodër, si në vijim:

SUBJEKTI	DETYRIMI PRINCIPAL	INTERESA	GJOBA	DETYRIMI TOTAL
Aktivë 97	18,912,420	163,762	4,726,171	23,802,353
Kërkesë për çregjistrim 5	130,059	188	50,762	181,009
Pasivë 59	4,155,438	92,567	1,594,169	5,842,174
TOTAL 161	23,197,917	256,517	6,371,102	29,825,536

Për sa më sipër konstatohen 161 subjekte të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2020 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 29,825,536 lekë, vlerë e cila duhet të ishte e arkëtuar brenda 31.03.2021.

Nisur nga deklarata e TF 2021 si dhe të dhënave të përpunuara nga sistemi C@ts, rezultojnë debitorë në moslikuidimin e TF të vetdeklaruar për DRT Shkodër, si në vijim:

SUBJEKTI	DETYRIMI PRINCIPAL	INTERESA	GJOBA	DETYRIMI TOTAL
Aktivë 136	17,962,135	365,291	5,078,251	23,405,677
Kërkesë për c' regjistrim 4	-	-	69,624	69,624
Pasivë 54	3,306,805	-	1,149,136	4,455,941
TOTAL 194	21,268,940	365,291	6,297,011	27,931,242

Për sa më sipër konstatohen 194 subjekte të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2021 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 27,931,242 lekë, vlerë e cila duhet të ishte e arkëtuar brenda 31.03.2022.

Për Drejtoritë e tjera tatimore, pjesë e Rajonit Verior situata paraqitet si në vijim:

-Për DRT Lezhë, periudha objekt auditimi konstatohen 692 subjekte që kanë kryer deklarimin e TF për periudhën 2019-2021 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 687,455,299 lekë.

-Për DRT Dibër, periudha objekt auditimi konstatohen 441 subjekte që kanë kryer deklarimin e TF për periudhën 2019-2021 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 165,775,953 lekë.

-Për DRT Kukës, periudha objekt auditimi konstatohen 178 subjekte që kanë kryer deklarimin e TF për periudhën 2019-2021 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 6,650,335 lekë.

Për sa më sipër këto rezultojnë detyrime të pa mbledhura për Rajonin Verior, periudha objekt auditimi.

Akt-marrëveshjet 01.01.2020-31.07.2020

Në lidhje me akt-marrëveshjet e lidhura nga DRT Shkodër, grupi auditimit ka kërkuar informacion me email-in e datës 19.09.2022, kërkesë të përsëritur me email-in e datës 22.11.2022, për periudhën 01.01.2020 deri në gusht 2020, periudhë kur Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara ka kaluar Rajon Verior (ristrukturim).

Nga email-i kthim përgjigje i datës 22.11.2022, dërguar nga Drejtori aktual i kësaj Drejtorie sqarohet si në vijim: *Në përgjigje të kërkesës suaj, informacioni për regjistrin e akt-marrëveshjeve të lidhura nga DRT Shkodër për periudhën janar-korrik 2020, sqarojmë që në momentin e marrjes në dorëzim të detyrës dhe krijimit të Rajonit Verior dhe deri tani, nuk kemi marrë informacion për marrëveshjet në lidhje me këtë drejtori.*

Gjatë takimit përfundimtar me subjektin në lidhje me problematikat e konstatuara gjatë fazës së auditimit në terren, nga ish Drejtori i kësaj Drejtorie u sqarua se regjistri ishte dërguar elektronikisht më datë 27.10.2022 Drejtorit aktual të Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, në vijim të kërkesave nga grupi auditimit. Në konkluzion ky regjistër u vu në dispozicion elektronikisht me email-in e datës 01.12.2022, ku për shkak të kufizimit të kohës kur u vu në dispozicion, nuk u testua me dokumentacion fizik dhe nuk disponohen të dhëna të tjera në lidhje me anulimin, arsyet e anulimit, debitorë që nuk kanë paguar asnjë kësht pas lidhjes së akt marrëveshjes, etj. Për periudhën 01.01.2020-31.07.2020, rezultojnë të lidhura 58 akt marrëveshje me detyrimin total si në vijim:

Nr.	Det.Total (për të cilin lidhet A-M)	Detyrimet sipas llojit të tatimit (për të cilin lidhet A-M)				
		TVSH	TF	Sig.Shog & Shënd.	TAP	Të tjera
58	83,808,598	17,926,370	38,619,424	15,727,888	267,954	10,687,549

Drejtorja e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara Rajoni Verior për periudhën objekt auditimi është menaxhuar nga:

- znj. T.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Detyrimeve Tatimore të Papaguara Rajoni Verior për periudhën 01.08.2020-30.06.2022.
- znj. A.U. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të zbatimit në terren të masave shtrënguese të Drejtorisë së Detyrimeve Tatimore të Papaguara për periudhën 02.11.2020-30.06.2022 (periudha maj-dhjetor leje lindje).
- z. A.Sh. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit, Analizës për Masat Shtrënguese, për periudhën 04.02.2021-30.06.2022.
- z. M.B. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Procedurave Ligjore të Mbledhjes me forcë të Drejtorisë së Detyrimeve Tatimore të Papaguara për periudhën 28.02.2021-30.06.2022.
- z. Ll.N. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit, Analizës për Masat Shtrënguese, për periudhën 24.07.2020 deri më 13.10.2020.
- Inspektorët e Drejtorisë së Detyrimeve Tatimore të Papaguara.

Konkluzion: Grupi i auditimit vlerëson se niveli i borxhi të ri, deri në 2 vite është konsiderueshëm i ulët në krahasim me nivelin e borxhit të vjetër (mbi 2 vite), dhe viti 2020 ka qenë një periudhë e vështirë nga pandemia Covid-19. Vlerësohet marrja e masave në lidhje me komunikimet me Ministrin e Linjës për detyrimet e papaguara për ndërmarrjet shtetërore dhe entet publike. Po kështu edhe shkresat për detyrim paraqitje për takim kundrejt palëve të treta në funksion të nenit 98 “E

drejta për të kërkuar detyrimet nga palët e treta”, masa këto të marra gjatë periudhës mars 2021-qershor 2022, dërguar nga Sektori i Procedurave Ligjore.

Megjithatë kërkohet një vëmendje e shtuar nga ana e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, për ezaurimin e të gjitha masave shtrënguese në fuqi dhe një vëmendje e shtuar nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve në lidhje me shmangien e ristrukturimeve, lëvizjeve të shpeshta të punonjësve dhe vakancave për një kohë të gjatë.

Titulli i gjetjes 1: **E ardhur e munguar në buxhetin e shtetit në vlerën 949,453 mijë lekë nga mos pagesa e tatimit mbi fitimin në periudhën 2019-2021.**

Situata: Nga analizimi i të dhënave u konstatua se për periudhën objekt auditimi, rezultojnë 1,821 subjekte të cilët kanë kryer deklarimin e TF 2019-2021 dhe nuk kanë kryer pagesën e këtij detyrimi në vlerën 949,453 mijë lekë, konkretisht 510 subjekte për DR T Shkodër në vlerën 89,572 mijë lekë, 692 subjekte për DRT Lezhë në vlerën 687,455 mijë lekë, 441 subjekte për DRT Dibër në vlerën 165,776 mijë lekë dhe 178 subjekte për DRT Kukës në vlerën 6,650 mijë lekë, në kundërshtim me nenin 71,74,76,114 të Ligjit nr. 8438 datë 19.05.2008, i ndryshuar. Për periudhën objekt auditimi rezulton detyrim i pa mbledhur nga Drejtoria Rajonale Shkodër.

Kriteri: Ligji 9920, datë 19.05.2008, i ndryshuar, “Për Procedurat Tatimore në RSH”, neni 71, 74, 76 dhe 114.

Efekti: Ligji 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat Neni 30. Mos realizimin e të ardhurave nga Tatim Fitimi në vlerën 949,453 mijë lekë, me pasojë mungesën e të ardhurave tatimore për tatim fitimin në buxhetin e shtetit.

Shkaku: Mos kryerja e pagesës së tatim fitimit nga subjektet tatimore në kohë sipas përcaktimeve ligjore dhe mos marrja e masave nga Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara Rajoni Verior me qëllim arkëtimin.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi: Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Rajoni Verior, të marrë masa të menjëhershme dhe të ndjekë rrugët ligjore për arkëtimin e detyrimeve të tatim fitimit për subjektet të cilat nuk kanë kryer pagesën e këtij tatimi.

Titulli i gjetjes 2: **Mos mbulimi i borxhit tatimor me të gjitha masat shtrëngues të përcaktuara në legjislacionin në fuqi.**

Situata: Gjendja e detyrimeve të papaguara në fund të muajit Qershor 2022 për rajonin Verior rezulton 13,290,528 mijë lekë, që i përkasin 23,816 debitorëve, nga vlera 11,007,343 mijë lekë që paraqitej në fund të muajit dhjetor 2020. Trendi për detyrimet për periudhën janar 2020-qershor 2022 paraqitet me një rritje të ndjeshme, situatë e ndikuar nga mungesa e efektivitetit të masave shtrënguese të ndërmarra për arkëtimin e borxhit, moszbatimi i tyre në mënyrë shteruese, ristrukturimi i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara në Rajon Verior dhe periudha e vështirë shkaktuar nga pandemia e Covid-19 gjatë vitit 2020.

Nga analizimi i të dhënave të detyrimeve tatimore të papaguara rezulton se nuk janë marrë të gjitha masat shtrënguese të përcaktuara në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Rezulton se nuk është marrë asnjë masë “Njoftim transferimi detyrimi palës së tretë”, “Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta dhe “Njoftim për transferimin e detyrimit, ortakut, aksionarit, administratorit”, veprime këto në kundërshtim me pikat 88, 97, 98, 99 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Kriteri:	Neni 88, 97, 98, 99, Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
Shkaku:	Mosveprim nga ana e strukturave të menaxhimit të borxhit, për ezaurimin e plotë të masave shtrënguese në rikuperimin e borxhit tatimor.
Ndikimi/Efekti:	Si pasojë e mos mbulimit të borxhit tatimor me të gjitha masat shtrënguese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, rritet risku i mos arkëtimit të detyrimeve të papaguara.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandim:	Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Rajoni Verior, të marrë masat e nevojshme për të siguruar mbulimin e debitorëve, me të gjitha masat shtrënguese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi me qëllim uljen e riskut të mos arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara.

III.2.5. Mbi vlerësimin e përputhshmërisë ligjore, të veprimtarisë së Drejtorisë së Shërbimit të Tatimpaguesve

Në zbatim të kësaj pike të programit të auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Ndarja e detyrave në punonjës.

-Klasifikimi i subjekteve (aktiv/pasiv/ të regjistruar/të çregjistruar/ të pezulluar etj.) për periudhën objekt auditimi.

-Vërtetimet që janë lëshuar për subjektet në lidhje me detyrimet.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Drejtoria e Shërbimit të Tatimpaguesve në DRT është e organizuar dhe funksionon në zbatim të “Rregullores së funksionimit të Drejtorive Tatimore Rajonale” miratuar me Urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 të Këshillit të Ministrave. Drejtoria e Shërbimit ndaj Tatimpaguesve, Shkodër në zbatim të detyrave funksionale për vitet 2020 deri 2022 (*periudha nën juridiksion auditimi*) është fokusuar kryesisht në përpunimin e kërkesave për vërtetime, dhënien e asistencës, dhënien e fjalëkalimeve, dërgimin e njoftimeve subjekteve të ndryshme, edukimin dhe informimin e subjekteve me bazën ligjore.

Sipas të dhënave të ofruara nga DSHT, në zbatim të neneve 5, 6, 7, dhe 8 të rregullores së brendshme për funksionimin e Zbatimit të Rregullores për ofrimin e asistencës dhe shërbimeve për Tatimpaguesit e regjistruar dhe individët nga funksioni i shërbimit të tatimpaguesve në DRT, Sektori i Shërbimit dhe Asistencës ka qenë i fokusuar kryesisht në:

Informimin e shpejtë dhe të saktë të tatimpaguesve, administrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme teknike brenda një afati kohor të arsyeshëm.

Shërbimi dhe asistenca në këtë drejtori është dhënë kryesisht nëpërmjet emali-it zyrtar, në adresën e dsht_shkodër@tatime.gov.al, nëpërmjet telefonit, si dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me

tatimpaguesit në ambientet e Drejtorisë Shërbimit, janë bërë nëpërmjet sqarimeve verbale apo shpërndarjes së broshurave informuese mbi mënyrën e deklarimit, përpilimit të librave të shitblerjes etj., si dhe janë dhënë sqarime të nevojshme në lidhje me paqartësitë e tatimpaguesve rreth situatave të tyre financiare në sistemin tatimor.

Struktura. Struktura e DSHT ka funksionuar me Urdhrin nr.126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit deri në 27.02.2019, Urdhrit nr.49, datë 27.02.2019 “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 126” datë 2.08.2016 të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të administratës tatimore qendrore”, Urdhrit nr.86, datë 03.05.2019 “Për Miratimin e Strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, të ndryshuar si dhe me Urdhrin nr. 33 datë 12.02.2019. Rregullorja e brendshme e miratuar me Urdhër.19, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave “Për miratimin e rregullores së brendshme për funksionimin e Administratës Tatimore Qendrore” përcakton rregullat dhe detyrat për organizimin, funksionimin dhe marrëdhëniet, ndërmjet njësive të brendshme administrative dhe nëpunësve që ushtrojnë aktivitet në DPT dhe DRT.

Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve në Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër ka të miratuar në strukturë aktualisht 10 punonjës: 1 Drejtor Drejtorie, 2 përgjegjës sektori, 7 specialistë.

Ndarja e detyrave:

Inspektorët kanë ndarjen e detyrave specifike ku përfshihen:

Regjistrimi i subjekteve

Ndryshimi i përgjegjësive tatimore.

Ndryshimi i përgjithshëm

Ndjekja e procedurave të çregjistrimit

Ndjekja e regjistrave të subjekteve dhe përgatitja e raporteve të ndryshëm

Analizat vjetore

Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve në Shkodër ka zhvilluar analizat vjetore për vitet 2020 deri 2022. Nga auditimi i dokumentacionit përkatës u konstatua si në vijim:

Analiza vjetore e vitit 2020 është bërë me shkresën nr.154/1prot datë 11/01/202.

Analiza vjetore e vitit 2021 është bërë me shkresën nr.307prot datë 17.01.2021.

Nga analizimi i veprimtarisë së kësaj Drejtorie për vitet 2020 deri në vitin 2022 (periudha e juridiksionit të auditimit) u konstatua si në vijim:

Nga ana e grupit auditues është kërkuar informacion administrativ ligjor nga Drejtorja e Shërbimit të Tatimpaguesve në lidhje me shërbimet dhe veprimtarinë e kësaj Drejtorie për periudhën në juridiksion auditimi dhe u auditua edhe përputhshmëria ligjore e veprimeve administrative ligjore të kryer nga ana e kësaj drejtorie bazuar në të dhënat që u gjeneruan nga sistemi C@Ats. Gjithashtu janë marrë të dhëna informuese mbi veprimtarinë e kryer nga Drejtorja e Shërbimit Tatimpagues për vitin 2020, 2021 dhe 2022. Sa më poshtë dhe llojet e komunikimit të kryera për periudhën në juridiksion auditimi nga Drejtorja e Shërbimit Tatimpagues në DRT Shkodër.

Nr.	Lloji i Komunikimit	Viti 2020	Viti 2021	Janar- Qershor 2022
1	Vërtetime elektronike	3,372	1,603	896
2	Vërtetime manuale	1,149	1,563	401
3	ResatPasswordi	455	521	215
4	Vert.perkontribut.individ. te punonjes. (FORM. E-sig 03/A	342	537	78
5	Vert. perpag. e detyr. Tatimore. (FORM. 4)	36	57	37
6	Vërtetim statusi me kthim pergjigje	56	47	13
7	Vert.perkontrib e sigurimet. (FORM.E-SIG 02/A)	6	9	1
8	Vert. xhir.per 3 vitet e fund,per tender.(FORM.6)	18	3	3
9	Numri i njoftimeve i dërguar tatimpaguesve	16,835	28,448	7,284
10	Numri total i taksapaguesve i asistuar (ballë për ballë)	24,550	22,558	8,879
11	Numri i seminareve edukues të realizuar biznesi I ri	12	12	6

12	Numri I thirrjeve hyrëse	6,287	4,372	2,459
13	Pyetje e përgjithshme	1,028	28,448	1,598
14	Asistence ne e albania	1,720	1,344	624
15	Asistence ne sportel	14,047	14,813	5,448
	TOTALI	53,095	104,335	27,942

Burimi DRT Shkodër

Në lidhje me auditimin e vërtetimeve për detyrime të dhëna nga Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues për periudhën 2020 deri 2022 nuk u konstatuan problematika. Gjithashtu gjatë veprimtarisë së aktivitetit të Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues DRT Shkodër nga grupi auditues u administrua edhe veprimtaria shkresore me Institucione të tjera publike të detajuara sa më poshtë vijon për vitin 2020 deri më qershor 2022.

Nr.	Lloji i Komunikimit	Viti 2020	Viti 2021	Janar- Qershor 2022
1	Shkresa te ardhura nga DR Policisë se Shtetit	517	23	1
2	Shkresa te ardhura nga Përmbartime Shkodër dhe Puke	264	192	141
3	Shkresa te ardhura nga prokuroria	88	87	85
4	Shkresa te ardhura nga ILDKP dhe Komisioni i pavarur i kualifikimit	15	8	6
5	Shkresa nga Gjykata, Bashkia Shkodër, Malësi e Madhe,	34	114	105
6	Shkresa nga Tatimpaguesit	315	294	166
7	Shkresa nga individët	435	542	226
	TOTALI	1668	1260	730

Burimi DRT Shkodër

Gjithashtu gjatë veprimtarisë së aktivitetit të Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues DRT Shkodër nga grupi auditues u administrua edhe aktiviteti pranë subjekteve në terren që lidhet me vizita dhe trajnime të detajuara sa më poshtë vijon për vitin 2020 deri më qershor 2022.

Nr.	Vizita dhe Trajnime	2020	2021	Janar-Qershor 2022
1	Vizita këshilluese biznesit te ri	253	275	272
2	Verifikime për çregjistrim	304	418	161
3	Kaluar Drejtorisë se Hetimit	1	6	1
4	Vizita informuese për fiskalizimin	0	3325	438
5	Vizita ne kuadër te planit operacional	425	0	0
6	Telefonuar	6,287	4,372	4,077
1	Dërguar letër te personalizuar subjekte p	284	0	0
2	Dërguar letra te personalizuara individëve te punësuar .	574	0	0
3	Dërguar letër informuese per fiskalizimin	0	5045	0
4	Dërguar leter informuese individeve te dy punësuar		1828	0
1	Trajnuar per Fiskalizimin, online	511	779	Subjekte nga te gjitha DRT
2	Nr. i trajnimeve	2	çdo dite	2 trajnime ne jave

Burimi DRT Shkodër

Gjithashtu gjatë veprimtarisë së aktivitetit të Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues DRT Shkodër nga grupi auditues u administrua edhe aktiviteti i DRT Shkodër ne lidhje me numrin e ndryshimeve të statusit të shoqërive tregtare, ndryshime te përgjegjësive tatimore, çregjistrime të kryera, ndryshime pa adresim, regjistrime, për OJF, ENTE Publike, Fermerë dhe Ambulante të detajuara sa më poshtë vijon për vitin 2020 deri më qershor 2022.

NDRYSHIMET\DRT	2020		2021		2022		TOTALI	
Ndryshime te pergjithshme	Numri	Kryer	Numri	Kryer	Numri	Kryer	Numri	Kryer
Kalimi ne pasiv me çështje	226	226	26	26	14	14	266	266
Riaktivizimi	39	39	46	46	16	16	101	101
Aplikim për çregjistrim	285	285	28	28	17	17	330	330
Tërheqje nga çregjistrimi	19	19	23	23	14	14	56	56
Ndryshime te kategorisë se sigurimeve	369	369	339	339	145	145	853	
Ndryshim kodi NACE	1	1	0	0	0	0	1	1
Ndryshim i pergjegjesive tatimore								
Tatimi ne Burim	249	249	279	279	101	101	629	629
Tatimi mbi Fitimin	55	55	86	86	16	16	157	157
Tatimi i Thjeshtuar mbi fitimin	3	3	0	0	0	0	3	3
TVSH	115	115	451	451	250	250	816	816

Sigurimet shoqërore	6	6	42	42	0	0	48	48
Taksa nacionale	2	2	1	1	0	0	3	3
Cregjistrimi								
Çregjistrime të përfunduara në sistem	123	123	247	247	79	79	449	449
Ndryshime pa ceshtje							0	0
Emërtimi, administratori, adresa, nr tel,	92	92	94	94	63	63	249	249
Regjistrime								
Ambulant	1	1	3	3	1	1	5	5
Fermerë	429	429	809	809	822	822	2060	2060
OJF	14	14	23	23	10	10	47	47
Ente Publike					0	0	0	0
Kërkesë për status	22	22	10	10	0	0	32	32

Burimi DRT Shkodër

Gjatë veprimtarisë së aktivitetit të Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues DRT Shkodër nga grupi auditues u administrua edhe aktiviteti i ndryshimit të llojit të Tatimit si dhe TVSH-se të detajuara sa më poshtë vijon për vitin 2020 deri më qershor 2022.

Lloji	2020		2021		2022		TOTALI	
Heqje	Numri	Kryer	Numri	Kryer	Numri	Kryer	Numri	Kryer
Tatimi në Burim	15	15	12	12	4	4	31	31
Tatimi mbi Fitimin			1	1			1	1
Tatimi i Thjeshtuar mbi fitimin							0	0
TVSH (Nga Apelimi)	2	2	193	193	2	2	197	197

Burimi DRT Shkodër

Gjatë veprimtarisë së aktivitetit të Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues DRT Shkodër nga grupi auditues u administrua edhe të dhëna statistikore të aktiveve që lidhen me ecurinë e statusit të subjekteve tatimpagues për vitin 2020 deri më qershor 2022.

Subjekte tregtare e shërbimesh	Subjekte Aktivë me Date 01.01.2020	Regjistrime të reja 2020	Pezullime 2020	Aplikim për çregjistrim 2020	Situata e Aktiveve më datë 31.12.2020
BM	781	37	91	7	842
BV +TVSH	1,508	124	259	56	1,607
BV	3,525	429	347	292	3,464
Ente OJF	379	11	6	5	363
Fermer	4,305	449	0	27	4,737
Total	10,498	1,050	703	387	11,013

Burimi DRT Shkodër

Subjekte tregtare e shërbimesh	Subjekte Aktivë me Date 01.01.2021	Regjistrime të reja 2021	Pezullime 2021	Aplikim për çregjistrim 2021	Situata e Aktiveve më datë 31.12.2021
BM	842	41	80	10	950
BV +TVSH	1,607	72	73	21	388
BV	3,464	659	788	392	4,630
Ente OJF	363	23	14		294
Fermer	4,737	810	0	15	5,510
Total	11,013	1,605	955	438	11,772

Burimi DRT Shkodër

Subjekte tregtare e shërbimesh	Subjekte Aktivë me Date 01.01.2022	Regjistrime të reja 2022	Pezullime 2022	Aplikim për c 'regjistrim 2022	Situata e Aktiveve më datë 31.06.2022
BM	950	12	44	4	1,000

BV +TVSH	388	26	19	5	439
BV	4,630	417	254	118	4,808
Ente OJF	294	10	15		300
Fermer	5,510	818	0	15	6,348
Total	11,772	1,283	332	142	12,895

Burimi DRT Shkodër

Gjithashtu gjatë veprimtarisë së aktivitetit të Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues DRT Shkodër nga grupi auditues u administrua edhe të dhëna statistikore të ndryshimet të përgjegjësisë të TVSH dhe Tatim Fitimit sipas subjekteve që lidhen me ecurinë e statusit të subjekteve tatimpagues për vitin 2020 deri më qershor 2022.

Subjekte tregtare e shërbimesh	Subj. Aktivë me 01.01.2020	Ndryshime	Ndryshimi
BM	842	61	
BV +TVSH	1,607	99	Tatim Fitimi
BV	3,464	-61	TVSH
Ente	363	-16	
Fermer	4,737	432	
Total	11,013		

Burimi DRT Shkodër

Subjekte tregtare e shërbimesh	Subj. Aktivë me 01.01.2021	Ndryshime	Ndryshimi
BM	950	108	
BV +TVSH	388	-1219	Tvsh dhe tatim fitim
BV	4,630	1166	
Ente	294	-69	
Fermer	5,510	773	
Total	11,772		

Burimi DRT Shkodër

Subjekte tregtarë e shërbimesh	Subj. Aktive me 01.08.2022	Ndryshime	Ndryshimi
BM	1,000	50	
BV +TVSH	439	51	Tatim Fitimi dhe Tvsh
BV	4,808	178	
Ente	300	6	
Fermer	6,348	838	
Total	12,895	1,123	

Burimi DRT Shkodër

Konstatohet se për veprimet e mësipërme Drejtoria e Shërbimit tatimpagues ka bashkëlidhur praktikat me dokumentacionin e nevojshëm si: kërkesë, shkresa përcjellëse nga Drejtoria e Kontrollit, Sektorit të Vlerësimit dhe Monitorimit nga Zyra. Gjithashtu gjatë veprimtarisë së aktivitetit të Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues DRT Shkodër nga grupi auditues u administrua edhe veprimtaria administrative shkresore në lidhje me planet mujore të punës si dhe me analiza mujore të kryera përgjatë çdo viti për vitin 2020 deri më qershor 2022.

Konstatohet se për veprimet e mësipërme Drejtoria e Shërbimit tatimpagues ka bashkëlidhur praktikat me dokumentacionin e nevojshëm si: kërkesë, shkresa përcjellëse nga Drejtoria e Kontrollit, Sektorit të Vlerësimit dhe Monitorimit nga Zyra. Gjithashtu gjatë veprimtarisë së aktivitetit të Drejtorisë së Shërbimit Tatimpagues DRT Shkodër nga grupi auditues u administrua edhe veprimtaria administrative shkresore në lidhje me transferimet e subjekteve tregtare nga DRT

Shkodër drejt DRT të tjera dhe zhvendosja e selisë së aktivitetit pranë DRT Shkodër të ardhur nga DRT të tjera për vitin për vitin 2020, 2021 deri më qershor 2022.

Trajtuar sa më poshtë edhe tabela e të dhënave:

Transferime dhe Ardhje ne DRT SHKODER				
VITI 2020				
Transferuar drejt DRT-ve	20	6BM	13BV	1OJF
Ardhur ne DRT-Shkodër	23	13 BM	10BV	1OJF
VITI 2021				
Transferuar drejt DRT-ve	24	9BM	15BV	
Ardhur ne DRT-Shkodër	23	6BM	17BV	
VITI 2022				
Transferuar drejt DRT-ve	11	2BM	9BV	
Ardhur ne DRT-Shkodër	8	1BM	7BV	

Burimi DRT Shkodër

Konkluzion: Në përfundim konstatohet se nga Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues pranë DRT Shkodër për periudhën nën auditim është kryer një veprimtari administrative në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

-është kryer një komunikim i gjerë si në formë elektronike dhe manuale tek kontribuesit tatimore individualë dhe pranë shoqërive tregtare, komunikime të tjera dërguar subjekteve tatimpagues dhe asistencë e kryer në një numër prej 185,372 komunikime.

me institucionet publike si policia e Shtetit, Shërbimi Përmbarrimor, Prokuroria dhe Gjykata, ILDKP-ja, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, shkresa individësh etj. me një numër total komunikimi prej 3658 raste.

-janë kryer vizita dhe trajnime për qëllime të ndryshme kryesisht fiskalizimi i ri, vizita në kuadër të planeve operacionale etj., prej 29,555 raste.

-është kryer veprimtari e ndryshme administrative në një numër veprimesh dhe komunikimesh në 5481 raste; për ndryshimin e përgjegjësisë tatimore për 99 61 raste pakësimi për heqje nga përgjegjësia, 61 raste shtesa të regjistrimit të biznesit të madh si dhe 432 raste shtesa të regjistrimit të biznesit fermer.

-rezultojnë veprime administrative të kryera në përputhje me planet e punës të përpiluara për përkatës si dhe analiza mujore të kryera nga Drejtoria e Shërbimit Tatimpagues Shkodër.

-veprime të kryera për çregjistrimin e subjekteve tatimpagues etj.

-nga administrimi i të dhënave të përpunuara nga DRT Shërbimit Tatimpagues Shkodër u konstatua se janë kryer 1050 regjistrime të reja për të gjitha kategoritë e bizneseve operuese, 703 pezullime aktiviteti dhe 387 çregjistrime aktiviteti me një situatë totale aktive prej 11013 subjekte operues.

-janë kryer 1065 regjistrime të reja, 905 pezullime aktiviteti dhe 438 çregjistrime aktiviteti me një situatë totale aktive prej 11772 subjekte.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.10, datë 13.05.2022, protokolluar me nr. 3313/3, datë 02.12.2022 “Mbi shërbimin ndaj tatimpaguesit”.

II.2.6. Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informimi/komunikimi, si dhe Monitorimi.

A. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit

Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Mjedisi i kontrollit vlerësohet bazuar në komponentët si më poshtë.

1. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike;

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër nuk ka një Kod Etike të miratuar. DRT Shkodër bazohet në Ligjin 153/2013 “Për nëpunësin civil”, Ligjin 9131 datë 09.08.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit, për procedurën për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara. Është hartuar regjistër risku në përputhje me nenin 12 të Ligjit nr.10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar dhe nenin 30 të Rregullores për Funksionimin e Drejtorive Rajonale Tatimore, miratuar me Urdhrin nr.19, datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave.

2. Politika menaxheriale dhe stili punës;

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër nuk ka një plan strategjik i cili përmban objektivat afatmesëm dhe vjetore prioritare të institucionit duke qenë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

3. Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

Deri në vitin 2020 Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër ka funksionuar mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr.126, datë 02.08.2016. Prej vitit 2020 e në vijim Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër funksionon mbi bazën e strukturës së re, që përfshin ristrukturimin e Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, në Rajon Qendror. Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër funksionon në bazë të rregullores së brendshme të miratuar me Urdhrin Nr. 19, Datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, rregullore e cila nuk është përditësuar në përputhje me ndryshimet.

4. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Referuar Ligjit për Statusin e Shërbimit Civil, Ligjit të Procedurave Tatimore, Kodit të Punës, akteve të tjera nënligjore, rregullores së funksionimit të administratës tatimore qendrore, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.19, datë 22.02.2017, është detyrë e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në DPT të ndjekë, zbatojë dhe sigurojë procedura për rekrutim, largim nga puna, zhvillimin profesional dhe motivimin e burimeve njerëzore të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim arritjen e objektivave të institucionit.

B. Menaxhimi i riskut.

Nga auditimi konstatohet se Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër nuk ka hartuar një strategji për menaxhimin e riskut, por ka në fuqi një regjistër risku në format elektronik për përdorim të

brendshëm, kjo dhe nga fakti se çdo dokumentacion me karakter strategjik përgatitet nga DPT, duke përfshirë dhe njësitë e saj të varësisë.

C. Aktivitetet e kontrollit.

Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër për periudhën objekt auditimi e ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit, e cila duhet të përgatitet nga menaxherët për proceset kryesore të punës së njësisë dhe është përgjegjësi e NZ për garantimin e gjurmës së auditimit për të gjitha proceset që ndodhin në njësi.

D. Informimi dhe komunikimi

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet punonjësve të shoqërisë si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht kryhet kryesisht me anë të postës elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik. Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër nuk ka një faqe web por ka një nën seksion tek faqja web e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

E. Monitorimi

Në DRT Shkodër është ngritur një sistem monitorimi, i pasqyruar në ndarjen e detyrave midis hallkave, ku janë specifikuar përgjegjësitë e drejtuesve për mbikëqyrjen e zyrave që mbulojnë. Nivelet më të ulëta drejtuese në bazë të ligjit dhe strukturës, raportojnë tek niveli më i lartë. Titullari i njësisë informohet vazhdimisht nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve, evidencave të ndryshme, raporteve dhe analizave vjetore.

III.2.7. Mbi përgatitjen e Pasqyrave Financiare dhe raportimin financiar, për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për vitin 2021, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.

Në përputhje me kërkesat e Udhëzimit MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit Shkodër me shkresën nr. 876, datë 22.02.2022.

Titullari i DRT Shkodër, që është njëkohësisht NA i institucionit rezulton të ketë nënshkruar pasqyrat financiare të vitit 2021 dhe shkresën përcjellëse për Degën e Thesarit të Rrethit, për DPT dhe për Degën e Statistikës së Rrethit Shkodër.

Për pasqyrat financiare të vitit 2021 nuk janë respektuar kërkesat e përcaktuara në pikën 117 të UMFE nr. 8, datë 09.03.2018 ku shprehimisht citohet: *Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur, brenda muajit mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet bërë duke dërguar një kopje në Degën e Thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikës së rrethit.*

Nga DRT Shkodër pasqyrat financiare janë dërguar në të tre institucionet brenda një dite, pra me shkresën përcjellëse nr. 876 prot., datë 22.02.2022.

Hartimi i pasqyrave financiare, është bazuar në legjislacionit në fuqi; ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimi MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” me ndryshime, Udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, etj.

Drejtori Rajonal i Tatimeve, ka nxjerrë Urdhrin nr. 29, datë 03.12.2021 “Mbi ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave pasurisë së institucionit për vitin 2021”, protokolluar me nr. 7712, datë 03.12.2021, për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 i përbërë nga 3 anëtarë: A.L. Kryetar, U.A. dhe E.K. anëtarë.

Sipas Urdhrit nr. 29, datë 03.12.2021, ky inventarizim ka afat përfundimi datën 24.12.2021 duke hartuar njëkohësisht dhe proces verbalin.

Me shkresën nr. 7712/1 prot., datë 24.12.2021 është përgatitur relacioni mbi kryerjen e inventarizimit.

Nga auditimi i dokumentacionit shoqërues i dosjes së inventarizimit, konstatohet se:

-Komisioni i inventarizimit përpara fillimit të inventarit nuk ka mbajtur procesverbal me magazinierin, në të cilin fiksohen numri i fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve të bëra gjatë vitit duke vepruar jo në përputhje me përcaktimet në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pika 83 “Përgjegjësitë për inventarizimin”, ku citohet se: *“Para fillimit të inventarit fiksohet numri rendor i fletë hyrjes dhe fletë daljeve nëpërmjet një procesverbali të mbajtur midis përgjegjësit material dhe komisionit të inventarizimit dhe bëhet mbyllja dhe dylllosja e magazinës. Hapja dhe mbyllja bëhet në prani të komisionit dhe përgjegjësit material.*

Referuar relacionit nr. 7712/1 prot., datë 24.12.2021, komisioni i inventarizimit ka informuar Drejtorin Rajonal dhe Drejtorinë e Funksioneve Mbështetëse mbi përfundimin e procesit të inventarizimit të mjeteve kryesore, materialeve, shtypshkrimeve dhe gjendjes në magazinë.

Komisioni ka vlerësuar paraprakisht se janë të papërdorshme nga inventari ekonomik 18 artikuj në vlerë 3,209,268 lekë (ku 12 prej tyre janë kondicioner dhe rezultojnë në vlerën 2,332,557 lekë), shoqëruar me gjendjen fizike, çmimin dhe vlerën.

-Komisioni i inventarizimit në përfundim të procesit nuk ka mbajtur procesverbal ku të pasqyrojë të dhënat e inventarizimit, krahasimin e gjendjes fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit, por rezultatet i ka pasqyruar vetëm në relacionin përmbledhës, duke vepruar jo në përputhje me përcaktimet në Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, pika 85 Komisioni i inventarizimit ka përgjegjësinë për: *“a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të njësisë publike dhe pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili ruhet gjatë periudhës së inventarizimit b. Të bëjë krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të librave që mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale e që janë të përputhura me sektorin e financës, të llogaritë kompensimet e lejueshme, duke marrë edhe mendimin e specialistëve përkatës dhe, për diferencat që mund të dalin pas kompensimeve, të hartojë procesverbalet”.*

-Nga strukturat drejtuese të institucionit nuk është vijuar me procesin e vlerësimit të aktiveve të parashikuara të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit dhe nga nëpunësi autorizues nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit, jo në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, ndryshuar sipas pikës 95 “Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi” ku citohet: *“Është një proces që kryhet gjatë ose pas*

procesit të inventarizimit. Mbi bazën e të dhënave kontabël për vitin e vënies në punë, kohën e përdorimit, vlerën fillestare, vlerën e mbetur, vlerën e rivënies dhe mbajtjes në punë, vlerësimin kosto-përfitim, bëhet vlerësimi i aktiveve afatgjata dhe afatshkurtra materiale; pikës 96 ku citohet “Procesi i vlerësimit të aktiveve realizohet nga komisioni i vlerësimit, ndërsa procesi i dhënies në përdorim/tjetërsimit apo nxjerrjes jashtë përdorimit kryhet nga komisioni i nxjerrjes së aktiveve nga përdorimi në njësi. Këto dy komisione ngrihen me urdhër të titullarit të njësisë publike me propozim të nëpunësit autorizues. Nëpunësi Autorizues ngarkohet me ndjekjen dhe monitorimin e realizimit të procesit”.

-Mallrat e konfiskuara dhe të rezultuara nga auditimi i kaluar të pa dorëzuara pranë Drejtorisë së Rezervave Rajonale Materiale të Shtetit konstatohet se janë dorëzuar pranë DPRMSH Pukë, sipas përcaktimeve të pikës 16, nenit 2 dhe pikës c të nenit 4 të ligjit nr. 9900, datë 10.04.2008 “Për rezervat materiale të shtetit” dhe pikës b të nenit 2 të VKM nr. 1128, datë 05.08.2008 “Për krijimin dhe administrimin e mallrave rezervë material shtetërore”.

-Për periudhën objekt auditimi nuk konstatohen të jenë asgjësuar vlera materiale.

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2021, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre rezultojnë se: Aktiviteti neto janë të barabarta me diferencën midis aktiveve dhe pasiveve, për vlerën 52,441,032 lekë.

Aktivitet afatshkurtra

Aktivitet afatshkurta më datë 31.12.2021 paraqiten në vlerën 35,240,965 lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 1,740,874 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 628,992 lekë, nga llogaria “Inventar i imët” në vlerën 285,488 lekë dhe llogaria kontabël 35 “Mallra” në vlerën 826,394 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 106,317 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit”.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debiti të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 33,500,091 lekë dhe përbëhet nga llogaria 468 dhe 4342:

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2021 është në vlerën 20,004,043 lekë. Sipas listës së vënë në dispozicion vlera rezultojnë 19,740,701 lekë. Diferenca prej 263,342 lekë përfaqëson detyrimin për kthim pagese për 2 punonjës, lënë nga KLSH në auditimin e kaluar. “...Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm” kuadron me llogarinë 4341 “Operacione me shtetin detyrime” në pasiv të bilancit.

Llogaria 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 13,496,948 lekë. Kjo llogari kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin” (Të drejta) në aktiv të bilancit, ka si kundër parti në pasiv të bilancit: llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”; 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”; 42 “Detyrime ndaj personelit”; 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”; 435&436 “Sigurime Shoqërore & Shëndetësore”. Llogaria 4342, operacione me shtetin (të drejta) kreditohet për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor, për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me buxhetin e vitit ushtrimor raportues..”.

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 0 lekë, vlerë e cila është pasqyruar në pasiv të bilancit dhe rakordon me llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

II Aktivet Afatgjata

Aktivët Afatgjata jo materiale (AAJM)

Llogaritë e Klasës 20 “Aktivët Afatgjata Jo materiale”, përbëhen nga llogaria 201 “prime të emisionit dhe rimbursimit të huave”, llogaria 202 “Studime dhe kërkime”, llogaria 203 “koncesione, patenta, licenca të ngjashme” të cilat si për vitin 2020 ashtu dhe për vitin 2021 janë në vlerën 0 lekë.

Aktivët e afatgjata materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivët Afatgjata Materiale”, për vlerën kontabël sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, paraqiten në shumën 50,700,158 lekë. Në vitin paraardhës 2020, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 53,734,786 lekë.

Nga auditimi rezulton se në pasqyrat financiare të DRT Shkodër për vitin 2021, sipërfaqet e evidentuara të tokave dhe trojeve, zëri “*Toka, Troje, Terrene*” (llogaria 210) nuk rezultojnë të regjistruara në AQT, (janë evidentuar për vlerën 0 lekë), pasi rezulton se DRT Shkodër zotëron vetëm ndërtesa, në administrim të DPT.

Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” për vlerën kontabël sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, paraqiten në shumën 36,320,319 lekë, në vitin paraardhës 2020, vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 38,231,914 lekë, pakësuar për amortizimin e llogaritur prej 5% në vlerën 1,911,595 lekë.

Ndërsa për vlerën historike viti ushtrimor 2021 paraqitet në shumën 115,935,844 lekë.

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” për vlerën kontabël sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, paraqiten në shumën 2,021,414 lekë. Në vitin paraardhës 2020, paraqitet në shumën 2,120,112 lekë. Amortizimi është llogaritur në masën 20% mbi vlerën e mbetur, në përputhje me kërkesat e UMFE nr.8, datë 09.03.2018.

Llogaria 215 “Mjete transporti” për vlerën kontabël sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, paraqiten në shumën 5,611,686 lekë. Në vitin paraardhës 2020, paraqitet në shumën 7,014,608 lekë pakësuar për amortizimin e llogaritur në vlerën 1,402,952 lekë dhe kalim inventari në vlerën 6,746,739 lekë. Për çdo pajisje është llogaritur amortizim në masën 20% mbi vlerën e mbetur, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018. Llogaria 215 është e zbërthyer në mënyrë analitike dhe e rakorduar me inventarët e kryer.

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” për vlerën kontabël sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, paraqiten në shumën 6,746,739 lekë.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivët Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e DRT Shkodër më 31.12.2021, detyrime ndaj personelit, detyrime ndaj shtetit për tatim taksa, sigurime shoqërore, sigurime shëndetësore, kreditorë të ndryshëm, operacione me shtetin.

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura pranë DRT Shkodër, paraqitet në vlerën 5,802,651 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Llogaria 431 “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”, paraqitet në vlerën 565,469 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

Llogaria 435 “Sigurime shoqërore” dhe **Llogaria 436** “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar dhe janë përkatësisht në vlerat 1,760,316 lekë dhe 244,130 lekë.

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” në shumën 5,123,482 lekë.

Llogari 4341 “Të tjera operacione me shtetin (detyrime)” në shumën 20,004,043 lekë.

Llogari 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” në shumën 8,372,566 lekë përfaqëson detyrimet e konstatuara për paga, sigurime shoqërore e shëndetësore dhe detyrimet për shpenzime udhëtim e dieta, detyrimet për energji elektrike/ujë/shërbim postar/tel, të muajit dhjetor 2021, likuiduar në janar të vitit 2022. Vlera e llogaria 7206 është e kuadruar me vlerën e llogarive të klasës 4 në Formatin nr. 1 të bilancit (401-408+42+431+435+436).

Pasqyra e Performancës financiare (F2)

Të ardhurat dhe shpenzimet, e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të DRT Shkodër më datë 31.12.2021 janë të kuadruara me Degën e Thesarit.

Të ardhurat e kuadruara me akt rakordimet e mbajtura midis DRT Shkodër dhe Bashkisë, Prefekturës, Prokurorisë, Gjykatave, që operojnë në juridiksionin e DRT Shkodër rezultojnë 7,827,650 lekë, me një diferencë prej 5,000 lekë.

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ me kosto historike” është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.8.2 “Rregullat për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (me koston historike të tyre)” dhe pikës 3.8.3 “Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (me vlerën neto të tyre)”.

Pasqyra statistikore nr. 8 “Numri i punonjësve dhe Fondi i pagave”.

Fondi i pagave referuar akt rakordimit me degën e thesarit, përfaqëson pagat e punonjësve për periudhën dhjetor 2020-nëntor 2021, ndërkohë që të dhënat e bilancit 2021 pasqyrojnë konstatimin e pagave bruto/borderotë e muajve janar-dhjetor 2021, duke qenë se Bilanci hartohet mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara për periudhën raportuese, ndërsa akt rakordimi me degën e thesarit paraqet shpenzimet faktike të kryera gjatë vitit ushtrimor.

Titulli i Gjetjes 1: Mangësi në kryerjen e procedurës së inventarizimit.

Situata:

Nga auditimi mbi zbatimin e dispozitave ligjore për inventarizimin e pronës shtetërore si dhe rregullshmërinë e procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit/asgjësimin e aktiveve, konstatohet se:

Për vitin 2021, Drejtori Rajonal i Tatimeve, ka nxjerrë Urdhrin nr. 29 datë 03.12.2021 “Mbi ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale të DRT Shkodër”, protokolluar me nr. 7712 datë 03.12.2021, për periudhën 01.01.2021-31.12.2021 i përbërë nga 3 anëtarë.

Komisioni i inventarizimit përpara fillimit të inventarit nuk ka mbajtur procesverbal me magazinierin, në të cilin fiksohen numri i fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve të bëra gjatë vitit duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 83 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.

Komisioni i inventarizimit në përfundim të procesit nuk ka mbajtur procesverbal ku të pasqyrohet dhe të krahasohet gjendja fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit, por një pjesë e rezultateve kryesisht inventarizimi i pajisjeve të zyrave janë pasqyruar në formë tabelore, me shënime, duke vepruar në kundërshtim me përcaktimet e pikës 85 të

	Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011.
	Nga strukturat drejtuese të institucionit nuk është vijuar me procesin e vlerësimit të aktiveve të parashikuara të përdorshme nga komisioni i inventarizimit dhe nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit, veprim ky në kundërshtim në me pikën 95 të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011.
	Si rezultat procesi i inventarizimit nuk është kryer i plotë dhe në përputhje me procedurat ligjore.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 83, 85, 95.
Shkaku:	Mosveprim nga ana e komisionit të inventarizimit, referuar Udhëzimit nr. 30/2011.
Ndikimi/Efekti:	Institucioni përballet me riskun potencial të mos menaxhimit administrimit dhe humbjeve të vlerave materiale.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Drejtorja Rajonale Tatimore Shkodër të marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike, si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin e vlerave materiale, për të parandaluar shpërdorimin dhe humbjen e tyre.

II.2.8. Mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë në ekzekutimin e buxhetit vjetor, për periudhën nën auditim.

Për auditimin e këtij drejtimi të Programit të Auditimit, grupi i auditimit ka marrë në shqyrtim çështjet e mëposhtme:

- Plani i buxhetit mbi shpenzimet e DRT Shkodër;
- Realizimi i planit të buxhetit sipas zërave të buxhetit, si dhe respektimi i këtij plani;
- Rakordimi dhe raportimi i shpenzimeve faktike, për periudhën nën auditim;
- Përputhshmëria e dhe rregullshmëria e veprimeve të kryera, dokumentimi i shpenzimeve;
- Realizimi i prokurimeve, likuidimi i kontratave.

Kriteret e vlerësimit:

- Udhëzimet e MFE, Udhëzimet e DPT, në lidhje me planifikimin, zbatimin dhe raportimin e buxhetit nga njësitë e varësisë;
- Ligji për prokurimet publike dhe VKM mbi miratimin e procedurave të prokurimit publik;
- VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit” me ndryshime;
- VKM nr.187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”.
- Rregullore e Brendshme e DRT-ve, miratuar me Urdhër nr. 192, datë 12.08.2020.

Plani i buxhetit për Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkodër, për periudhën objekt auditimi është alokuar sipas shkresave përcjellëse të DPT, respektivisht për periudhën objekt auditimi, duke reflektuar dhe ndryshimet gjatë vitit paraqitet:

Realizimi i buxhetit, sipas periudhave.

Nr.	Viti buxhetor	Plan buxheti	Fakt buxheti	Diferenca (Fakt/Plan)	Realizimi në %
1	2020	117,112,000	106,172,290	-10,939,710	90.6
2	2021	109,944,280	108,197,747	-1,746,533	98.4
3	2022	106,555,050	54,884,993	-51,670,057	51.5

Nga të dhënat e mësipërme, evidentohet se plani i buxhetit për shpenzimet, është relizuar në nivele të kënaqshme, në masën 98.4 %, duke marrë në analizë vitin 2021, për shkak se viti 2020, përkon me situatën pandemike Covit-2019, ndërsa fakti i vitit 2022, i referohet vetëm 6-mujorit të parë të vitit 2022, i cili është objekt auditimi.

Realizimi i shpenzimeve sipas zërave dhe nën zërave, për periudhën objekt auditimi paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Referuar të dhënave evidentohet se peshën specifike më të lartë kundrejt totalit të shpenzimeve e zënë shpenzimet për “paga dhe sigurime” me 82.4 % në viti 2020, me 82.5 % në vitin 2021 dhe në masën 94.7 % në 6 mujorin e parë të vitit 2022.

Shpenzimet sipas zërave të buxhetit dhe nën zërave

Llogaritë	Përshkrimi	Nën llogaritë	Realizimi		
			2020	2021	6 M/I-2022
600	Paga		87,652,812	89,255,759	44,553,944
	Shpenzime personeli	600.1	86,220,820	81,820,046	42,698,118
	Paga personal i përkohshëm	600.2	1,431,992	7,435,713	1,855,826
601	Sigurime		14,380,454	14,907,756	7,452,929
	Shoqërore	601.01	12,916,509	13,389,819	6,694,684
	Shëndetësore	601.11	1,463,945	1,517,937	758,245
602	Shpenzime operative		4,027,024	3,957,121	1,923,070
	Materiale të përgjithshme zyre	602.0	141,600	119,887	
	Shërbime nga të tretë	602.2	1,976,867	2,249,879	1,216,118
	Shpenzime transporti	602.3	779,002	774,659	392,832
	Shpenzime udhëtimi	602.4	758,440	223,380	175,570
	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	602.5	199,740	400,000	
		602.6			
	Shpenzime për detyrime legale	602.7	100,200	24,716	
	Shpenzime të tjera operative	602.9	71,175	164,600	138,550
604	Transferata			32,831	
	Transferime te organet e pushtetit vendor (renta)	604.0		32,831	
606	Shperblime		112,000	44,280	
	Të tjera transferata tek individët	606.1099	112,000	44,280	
466	Mjete në ruajtje				955050
	Totali		106,172,290	108,197,747	54,884,993

Nga ana e DRT Shkodër, sipas shkresave të mëposhtme, është dërguar në DPT, raporti mbi realizimi i shpenzimeve:

- Raportimi i shpenzimeve për vitin 2020 me shkresën nr. 120, datë 08.01.2021, të DRT Shkodër;

- Raportimi i shpenzimeve për vitin 2021 me shkresën nr. 382, datë 25.01.2022, të DRT Shkodër;
- Raportimi i shpenzimeve për periudhën Janar-Qershor 2022, me shkresën nr. 3055, datë 10.08.2022, të DRT Shkodër.

Nga auditimi mbi përputhshmërinë e shpenzimeve të kryera, referuar dokumentacionit të bankës për periudhat (Mars, Qershor, Shtator dhe Dhjetor të vitit 2020 dhe 2021 dhe muajt Mars dhe Qershor të vitit 2022) ka rezultuar:

- Në funksion të auditimit të respektimit të dispozitave ligjore për pagat e punonjësve, shpërblimet, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, etj., grupi i auditimit auditori në bazë risku praktikat dokumentare që shoqëronin shpenzimet e kryera. Shpenzimet për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore si dhe tatimi mbi të ardhurat personale ishin përlllogaritur drejtë dhe në përputhje me VKM nr.187, datë 08.03.2017, *“Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”* lidhja 1; lidhja 2 dhe lidhja 6/8. Bashkëlidhur urdhër shpenzimit ndodhen listë prezencat, raportet mjekësore dhe llogaritjet e vjetërsisë së punës, të cilat përputhen me llogaritjen e pagës bruto dhe neto. Nga ana e strukturave përgjegjëse në DRT është hartuar regjistri themeltar i punonjësve dhe libri i personelit, ndërkohë që për vendimet e emërimit, transferimit, ndryshimit të kategorisë dhe largimit nga detyra janë të pasqyruara në format Excel. Tabela e vjetërsisë në punë të punonjësve rishikohet për çdo muaj.
- Nga auditimi i shpenzimeve të kryera llogaria 602, është përdorur kryesisht për likuidim të faturave të ujit, energjisë elektrike, shërbime telefonike, posta dhe shërbimi korrier, blerje dokumentacioni etj., pagesa e të cilave është kryer pa vonesa (brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të faturës) dhe në përputhje me faturën bashkëlidhur.
- Përsa ju përket shpenzimeve për udhëtim e dieta brenda vendit, kryerja e tyre ishte në përputhje me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 *“Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”* me ndryshime. Bashkëngjitur urdhër shpenzimeve ishte, Urdhër shërbimi, Përlllogaritja e shpenzimeve; Fatura e hotelit, etj. Këto shpenzime kryheshin kryesisht nga inspektorët e kontrollit në terren (Hetimi Tatimor), Rajoni i veriut, i cili mbulon disa qarqe si (Shkodër; Kukës; Peshkopi dhe Lezhë).

Konkluzion: Nga auditimi bazuar në analizën e riskut dhe përcaktimin e kampionit, për shpenzimet operative (shpenzimet për udhëtim e dieta; shpenzimet për karburant, si dhe shpenzime për blerje mallra, shërbime etj.), është konstatuar se kryerja e tyre është e mbështetur në dokumentacionin autorizues dhe justifikues, bashkëngjitur urdhër shpenzimeve. Të gjitha urdhër shpenzimet rezultojnë të firmosura dhe vulosura nga kontabilisti i DRT Shkodër në cilësinë e nëpunësit zbatues, urdhëruesi/Titullari i DRT-së në cilësinë e nëpunësit autorizues dhe aprovuar nga nëpunësi i thesarit.

Mbi auditimin e procedurave të prokurimit publik.

Për auditimin e kësaj nën çështje, nga grupi i auditimit së pari, u shqyrtuan regjistri i parashikimit të prokurimeve publike dhe regjistri i realizimit të prokurimeve, të cilët janë hartuar dhe janë përcjellë me shkresat përkatëse në institucionin qendror *“Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve”*.

AK, Drejtoria Rajonale Shkodër, ka vepruar në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Mbi miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 4 “Regjistri i parashikimeve të prokurimit publik” dhe neni 7 “Raportimi i realizimeve të prokurimit publik”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, neni 3 “Regjistri i parashikimeve të procedurave të prokurimit publik” dhe neni 4 “Regjistri i realizimit të procedurave të prokurimit”. Regjistrat e realizimit (Tabelat anekse nr. II.2.7).

Përsa i përket zbatimit të ligjit mbi prokurimet publike, nga DRT Shkodër gjatë periudhës objekt auditimi, janë zhvilluar procedura prokurimi me vlerë mbi 100,000 lekë, objekt i trajtimit të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (aktualisht i shfuqizuar), ligjit nr. 162/2020, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 (aktualisht i shfuqizuar) dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Mbi miratimin e rregullave të prokurimit publik” vetëm për pjesë këmbimi automjete, siguracion makinash, mirëmbajtje objekti, ndërsa të gjitha blerjet e kryera, sipas të dhënave analitike në tabelat anekse nr. 1, 2 dhe 3, janë nën vlerën 100,000 lekë. Për blerjet nën këtë vlerë, nuk zhvillohen procedura prokurimi.

Nga auditimi i procedurave të mësipërme nuk kanë rezultuar mangësi, nga shqyrtimi i dokumentacionit bashkëngjitur urdhër shpenzimeve ka rezultuar se për çdo procedurë të kryer ishte bashkëngjitur dokumentacioni i duhur justifikues.

Për sa më sipër, është mbajtur Akt Konstatimi nr.1, datë 02.12.2022, protokolluar me nr. 3313/5, datë 02.12.2022.

Për ndryshimin dhe përmirësimin e gjendjes në të ardhmen rekomandojmë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e procedurave të kontrollit, nga 30 dosje kontrolli tatimor të audituara, në 15 prej tyre, janë evidentuar mangësitë si më poshtë:

- Nuk janë analizuar në mënyrën e duhur llogaritë vjetore të subjekteve, referuar periudhave objekt të kontrollit mbi tatim fitimin, në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor dhe Programit të Kontrollit;
- Nuk është kryer një analizë mbi Aktivitet Afatgjatë Materiale (AAM) dhe shpenzimet e amortizimit;
- Nuk është kryer në mënyrën e duhur analiza e shpenzimeve, kryesisht shpenzime të tjera, pasi nuk është përcaktuar në mënyrë të detajuar llojet e shpenzimeve me zëra dhe nën zëra, me qëllim identifikimin e shpenzimeve të cilat nuk i shërbejnë objektit të veprimtarisë së subjektit (shpenzime të panjohura);
- Në disa raste, edhe pse në raportet përfundimtare të kontrollit, nga inspektorët e kontrollit është cilësuar se kanë kryer analizën e blerjeve dhe shitjeve, realisht nuk është kryer një analizë e tillë, përveç se nga ana e tyre, janë pasqyruar çmime për njësi të disa artikujve kryesorë vetëm në blerje, gjë e cila është një e dhënë e pamjaftueshme për të kryer një analizë mbi marzhin e fitimit;
- Në disa raste, në RPK, ka trajtime të tej zgjatura të çështjeve të parëndësishme si dhe pasaktësi në trajtimin e çështjeve të rëndësishme në lidhje me pasqyrimin e situatës financiare të subjekteve;
- Në disa raste nga inspektorët e kontrollit nuk është analizuar gjendja e lartë e llogarive klientë dhe furnitorë, të cilat paraqiten në vlera të larta krahasuar me çeljen e vitit (viti i mëparshëm

ushtrimor), si dhe nuk është kryer një analizë mbi analitikun e këtyre llogarive, kryqëzimin e tyre (të ardhura të arkëtueshme/klientë-detyrime afatshkurta/furnitorë);

- Nuk është kryer një analizë mbi aktivitetin e subjektit referuar faktit se, në disa raste subjektet kanë zhvilluar veprimtari në më shumë se një aktivitet, (import eksporte, prodhim/shitje më pakicë dhe shumicë/shërbime, etj.;
- Në disa raste nga inspektorët e kontrollit, jepen pohime mbi gjenden e llogarive, pozicionin e tyre, kryerjen e analizave të ndryshme, ndërkohë që nuk ka asnjë gjurmë në RPK dhe dosjen e kontrollit, mbi kryerjen e këtyre procedurave;

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Ligjit nr. 9920/2008 "Për procedurat Tatimore në RSH" me ndryshime, Kreu X "Kontrolli tatimor", neni 80; me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, Kapitulli VII "Kryerja e kontrollit tatimor"; me kërkesat e Programit të Kontrollit, si dhe Ligjin nr. 10296 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", neni 4, pika 19 "Gjurma e auditimit".

Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3/1, faqe 21-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, në cilësinë e Titullarit, duhet të nxjerrë përgjegjësitë si dhe të marrë masa të menjëhershme, për forcimin e kontroleve të cilësisë, mbi kontrollet e ushtruara nga inspektorët e kontrollit tatimor në vend, nga ana e Përgjegjësit të Sektorit të Kontrollit Tatimor në Vend dhe Drejtori i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor.

Menjëherë dhe vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor në vend, në kontrollet e ushtruara, në **6 raste**, në subjektet tatimpagues "SH-A" SHPK, "D.G." SHPK, "M" SHPK, "A-D" SHPK dhe "A.B.07" nuk janë analizuar në mënyrën e duhur llogaritë "Detyrime afat shkurtra" (detyrime ndaj ortakut) dhe Detyrime afatgjata" (hua).

1. Nga shqyrtimi i kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues "SH-A" SHPK, ka rezultuar se sipas pasqyrave të pozicionit financiar për periudhën 2015-2018, subjekti paraqitet me detyrime afatshkurtra dhe afatgjata kundrejt institucioneve financiare apo dhe të tretë (hua). Detyrimet afatgjata "Hua" të krijuara në vitin 2015 në shumën 11,200,000 lekë, janë rritur në vitin 2016 në shumën 31,180,000 lekë dhe rezultojnë në këtë vlerë edhe për vitin 2017 dhe 2018. Nga ana e inspektorit të kontrollit në RPK, nuk është cilësuar dhe analizuar burimi i këtyre të ardhurave dhe të dhëna të tjera, pasi dhe në shënimet shpjeguese të PF, të vitit 2017 nuk është analizuar dhe shpjeguar kjo shumë, nuk janë cilësuar institucionet financiare (banka etj.), apo huadhënës, kontratat e kredisë apo huadhënies, aktet noteriale, termat e referencës së kredive, plani i amortizimit etj.

2. Nga shqyrtimi i kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues "D.G." SHPK, ka rezultuar se, nuk është analizuar llogaria e pasivit "Detyrime afatshkurtra", "Të pagueshme ndaj njësive ekonomike brenda grupit" e cila për vitin 2020, paraqitet në vlerën 14,992,619 lekë.

3. Nga shqyrtimi i kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues "M" SHPK, ka rezultuar se nga analiza e detyrimeve në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, është shtuar në vlerën 39,842,446 vlera e detyrimeve të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit, të cilat përfaqësojnë mjete monetare të injektuara në shoqëri nga pronari. Nga ana e inspektorit të kontrollit nuk është analizuar ky ndryshim shtesë në këtë llogari, burimi i financimit, etj.

4. Nga shqyrtimi i kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues "A-D" SHPK, ka rezultuar se nga kontrolli i llogarive të pasivit paraqitet gjendje e lartë e injektimit të likuiditeteve në shoqëri nga ana e ortakut, të cilat nuk janë analizuar nga inspektori i kontrollit. Këto detyrime paraqiten

në shumën 47,300,000 lekë për vitin 2016; 53,200,000 lekë për vitin 2017 dhe 54,400,000 lekë për vitin 2018. Nga ana e inspektorit të kontrollit në RPK, nuk është cilësuar dhe analizuar burimi i këtyre të ardhurave dhe të dhëna të tjera.

5. Nga shqyrtimi i kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues “A.B.07” SHPK, ka rezultuar se nuk është analizuar llogaria e ortakut “Të pagueshme ndaj njërive ekonomike brenda grupit/ortaku” për gjithë periudhën e kontrollur nga viti 2016 deri në vitin 2020.

6. Nga shqyrtimi i kontrollit të ushtruar në subjektin tatimpagues “M” SHPK, ka rezultuar se nga kontrolli i llogarive të pasivit ka rezultuar nuk është analizuar llogaria "Dhënie huaje" në shumën 64,528,949 lekë. Në të njëjtën periudhë subjekti tatimpagues M, në vitin 2014, paraqitet me detyrime afatgjata kundrejt bankës (hua/kredi) në shumën 63,063,000 lekë. Në lidhje me këto të drejta dhe detyrime, nuk është kryer asnjë analizë.

Mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor, kërkesat e Programit të kontrollit tatimor, si dhe me Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF nr. 16, datë 16.02.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5 “Raportimi i aktivitetit të dyshimtë (RAD)”, pika 1 dhe 2.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3/1, faqe 21-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, në cilësinë e Titullarit, duhet të nxjerrë përgjegjësitë për të gjitha rastet e evidentuara, si dhe në vijimësi të kërkojë që nga ana e inspektorëve të kontrollit tatimor në vend, të analizohen dhe të jepet informacion mbi cilësimin e institucioneve financiare (banka etj.), apo huadhënës; kontratat e kredive apo huadhënies; aktet noteriale; termat e referencës së kredive; plani i amortizimit etj., si dhe të deklarohet burimi i krijimit të të ardhurave të “ortakut” të injektuara si likuiditet apo çdo formë tjetër në shoqëri.

Menjëherë dhe vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga ana e Sektorit Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit ka munguar monitorimi dhe vlerësimi i treguesve me risk që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës, për problematikat si më poshtë:

- Ky sektor nuk disponon plane të plota mujore dhe vjetore ku të përcaktohen objektivat, ndarjet e detyrave për inspektorët në mënyrë që të monitorohen subjektet në mënyrë të vazhdueshme, duke mos vepruar në përputhje me kërkesat e pikave 5, 8 dhe 9 të Manualit të Kontrollit nga Zyra;

- Në lidhje me ndarjen e NIPT-eve, në organizimin dhe monitorimin e inspektorëve nuk janë zbatuar kërkesat dhe përcaktimet e pikave 5, 8 dhe 9 të Manualit të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, ku paraqitet një ndarje në nipte sipas rendit kronologjik të tyre, në mënyrë rastësore e të barabartë nëpërmjet inspektorëve, i cili nuk përmban kriteret e përcaktuara në manual si më sipër cituar.

- Struktura aktuale e sektorit paraqitet me 2 vakanca, përkatësisht në pozicionin e inspektorëve të kontrollit. Deri në muajin qershor të vitit 2022 ajo paraqitej me 1 vakancë; në fund të vitit 2021 ajo paraqitej me 1 vakancë (1 inspektor i dytë); dhe në fund të vitit 2020 me 3 vakanca (3 inspektorë të parë). Nga auditimi u konstatuan se si rezultat i ristrukturimit, vakancave dhe angazhimeve të shpeshta të stafit në pozicione apo detyra të tjera brenda DRT Shkodër, është impaktuar edhe roli kryesor i inspektorëve në Sektorin e Kontrollit nga Zyra.

- Nga një zgjedhje me një numër të kufizuar subjektesh (vetëm 50 subjekte) që përbëjnë 36% në vitin 2020, 39% në vitin 2021 dhe 37% në periudhën e audituar për vitin 2022 të totalit të tepricës kreditore të TVSH-së për të gjithë subjektet e DRT Shkodër, konstatohen teprica kreditore me tendenca rritjeje, veçanërisht në subjektet aktivitet i së cilave është tregtia apo shërbimet, në të

cilat risku i evazionit për shkak të mos deklarimit të shitjeve apo dorëzimi i faturave fiktive në blerje është më i lartë. Pavarësisht se këto subjekte duhet të ishin objekt monitorimi dhe verifikimi nga ana e inspektorëve, rezulton se nga këto subjekte janë kaluar për kontroll vetëm 19 prej tyre, pra nuk rezultojnë të jenë marë masa veprimi konkrete nëpërmjet kërimit të informacionit për verifikimin e situatës së rritjes së vazhdueshme të tepricës së TVSH-së. Gjithashtu, rezultojnë 14 nga 50 subjekte të mara nën shqyrtim (23% në vitin 2020, 20% në vitin 2021 dhe 29% në periudhën e audituar për vitin 2022 të totalit të tepricës kreditore të tatim fitimit), ku janë kaluar për kontroll vetëm 7 prej tyre, nga të cilët vetëm 2 janë subjekte që kanë paraqitur tendenca rritjeje të tepricës, duke ndikuar kështu në reduktimin e performancës për deklarimet tatimore të tatimpaguesve.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.3.2/2, faqe 68-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit

3.1 Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër dhe Përgjegjësi i Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të vlerësojnë problematikat e mësipërme me qëllim hartimin e planeve mujore dhe vjetore të punës; ndarjen e nipteve sipas kuadrit rregullator në fuqi dhe intensifikimin e punës në drejtim të analizimit të subjekteve me teprica kreditore me tendencë rritjeje, edhe nëpërmjet kombinimit me kontrollin në vend, duke vlerësuar treguesit me risk që ndikojnë në mbarëvajtjen e punës; çështje këto që garantojnë se detyrat e ngarkuara të jenë të matshme për secilin pozicion të Drejtorisë së Kontrollit.

Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2023

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se pas riorganizimit në strukturat tatimore, ndjekja e akt marrëveshjeve ka mbetur nën kompetencën e Drejtorisë së Kontrollit pranë DRT-ve përkatëse. Gjatë vitit 2021 nga ana e DPT është kryer rishikimi i Manualit të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, ku është hequr kapitulli që më parë parashikonte procedurat që do të ndiqen për zbatimin e marrëveshjeve me këste. Si rezultat, këto procedura nuk janë përfshirë në asnjë prej akteve nënligjore sipas së cilave funksionojnë Drejtoritë e Kontrollit (ndër të tjera edhe DRT Shkodër) dhe si rezultat, procesi që do të ndiqet për akt marrëveshjet me këste rezulton i pa rregulluar dhe i pa mbuluar me akte administrative, manuale apo udhëzime të DPT, duke cenuar kështu veprimtarinë e këtyre strukturave përgjegjëse për monitorimin e tyre.

-Nga auditimi u konstatuan mangësi në drejtim të administrimit të informacionit mbi akt marrëveshjet nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra, për shkak të mos rakordimit të totalit të vlerës së akt marrëveshjes me pagesat e kryera dhe vlerës së mbetur pa paguar; një pjesë e informacionit lidhur me pagesat e kryera për marrëveshjet e anuluar u plotësua gjatë auditimit; mungesa e historikut të subjekteve para ndryshimit të përgjegjësisë për monitorimin e tyre, etj.; të cilat e kanë kufizuar auditimin në lidhje me vlerësimin e ndjekjes së ecurisë së akt-marrëveshjeve nga ana e Drejtorisë së Kontrollit dhe marrjen e masave në kohë në lidhje me zgjidhjen e tyre për mosplotësim të kushteve.

-Nga auditimi konstatohet se për periudhën objekt auditimi janë anuluar 24 akt marrëveshje të lidhura me subjektet (37% e totalit të akt marrëveshjeve të lidhura), nga ku 8 raste rezultojnë me 100% detyrim i papaguar në raport me vlerën për të cilën është lidhur akt marrëveshja; 14 raste me mbi 50% dhe vetëm 2 raste me më pak se 50%. Në total vlera e detyrimit për të cilin është lidhur akt marrëveshja e anuluar paraqitet në vlerën 168,241 mijë lekë (52 % e totalit të vlerës së akt marrëveshjeve të lidhura). Nga total detyrimi për të cilën është lidhur AM rezultojnë të jenë likuiduar 34,192 mijë lekë, ose vetëm 20% e vlerës. Nga ana e Sektorit të Kontrollit nga Zyra në DRT Shkodër, nuk është kryer ose nuk ka qenë efektive analiza për të vlerësuar riskun lidhur me përmbushjen e kushteve të marrëveshjes, duke mos respektuar pikën 2 dhe 3 të Nenit 18 të Rregullores së Funksionimit të DRT-ve.

-Nga auditimi u konstatua se nga Drejtoria e Kontrollit nuk ishte trashëguar historiku i mëparshëm për këto akt marrëveshje për periudhën kur monitorimi i tyre kishte qenë nën mbikëqyrjen e Drejtorive të Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara, duke reflektuar kështu mangësitë në drejtim të dorëzimit të punës dhe materialeve përkatëse pas rishpërndarjes së përgjegjësi, një situatë që cenon efektivitetin e vendimmarrjes së strukturave të cilat nuk kanë vepruar duke vlerësuar dhe analizuar edhe historikun e mëparshëm të këtyre subjekteve sikundër përcakton udhëzimi nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar pika 78 e tij; rregullorja e funksionimit të DRT, neni 18 pika 2 ; udhëzuesi i përgjithshëm i procedurave të mbledhjes me forcë datë 15.03.2018 pika 10. Nga regjistri i vendosur në dispozicion, rezultojnë akt marrëveshje të përsëritura, për të cilët nuk është kaluar në masa të tjera shtrënguese, situatë kjo e cila përbën në nga indikatorët matës për efektivitetin e analizës së kryer nga struktura përgjegjëse pranë DRT Shkodër, për përmbushjen e kushteve sipas përcaktimeve të kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.3.2/2, faqe 68-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4.1 Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër të përcjellë pranë DPT, propozimin për parashikimin e procedurës së marrëveshjeve me këste të detyrimeve tatimore në aktet nënligjore miratuar prej saj, ose reflektimin e kësaj çështjeje në një dokument/manual të vetë institucionit, për t’u zbatuar nga strukturat përkatëse të kontrollit, si dhe të marrë masat për kryerjen e analizave efektive përpara lidhjes së Akt-Marrëveshjeve duke shqyrtuar historikun dhe aftësinë paguese të tatimpaguesit; apo edhe gjatë zbatimit, me qëllim përmbushjen e kushteve dhe uljen e riskut të anulimit, apo përsëritjen e tyre për të mos kaluar në masa të tjera shtrënguese.

Brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2023

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se si pasojë e moskryerjes në kohë dhe me efektivitetin e kërkuar të detyrave funksionale, mungesës së planeve mujore të punës, e analizave nga përgjegjësi i sektorit dhe drejtori, kanë rezultuar mangësi në administrimin dhe monitorimin e situatave financiare të tatimpaguesve, konkretisht:

- Janë konstatuar 161 subjekte të cilat kanë plotësuar rubrikat e të ardhurave tatimore të deklaratës me të vlera më të ulëta apo të larta me diferencë në vlerë absolute prej 110,297,6837 lekë krahasuar me të ardhurat ushtrimore, në mënyrë të paargumentuar dhe të pa verifikuar nga administrata tatimore, nga të cilat për vitin 2020 në 83 raste me një diferencë në vlerë absolute (+/-) prej 39,966 mijë lekë, dhe për vitin 2021 për 78 raste në diferencën 70,331 mijë lekë.

- Janë konstatuar 257 subjekte të cilat kanë plotësuar rubrikat e shpenzimeve tatimore të deklaratës me të vlera më të ulëta apo më të larta prej 185,518,678 lekë krahasuar me shpenzimet ushtrimore, në mënyrë të paargumentuar dhe të pa verifikuar nga administrata tatimore, nga të cilat për vitin 2020 në 134 raste me një diferencë në vlerë absolute (+/-) prej 53,775 mijë lekë, dhe për vitin 2021 për 123 raste në diferencën 131,743 mijë lekë.

- Pavarësisht se monitorimi dhe mbikëqyrja e veprimtarisë ekonomike të tatimpaguesit është detyrë e themelore e administratës tatimore, janë konstatuar 60 tatimpagues me mbi mesatarisht 5 punonjës të cilët rezultojnë pa përgjegjësi tatimore të TVSH-së, ku pavarësisht qarkullimit të deklaruar prej administratës tatimore duhet të ndërmerreshin verifikimet përkatëse nëpërmjet evidentimit dhe analizave të thelluara të kostove duke verifikuar kështu dhe burimet e financimit të këtyre tatimpaguesve për përballimin e tyre. Mungesa e veprimeve konkrete nga ana e administratës së DRT Shkodër ka bërë që procesi i monitorimit të përgjegjësi tatimore të paraqitet me mangësi dhe parregullsi me efekte të rëndësishme në strukturën e të ardhurave, risk

të lart për fshehje të xhiros reale dhe mos regjistrim në regjimin e TVSH-së si dhe krijojnë devijime nga parimet e miradministrit tatimor dhe konkurrencës së drejtë.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.3.2/2, faqe 68-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5.1 Rekomandimi: Sektori i Kontrollit Tatimor nga Zyra dhe Monitorimit në DRT Shkodër, të marrë masat për dokumentimin e kryerjes së verifikimeve përkatëse për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, sipas qarkullimit vjetor dhe shkallës së tatimit objekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me qarkullim që ka qenë në fuqi për atë kategori tatimpaguesish, duke verifikuar mospërputhjet midis deklaratës së qarkullimit sipas kasës dhe të ardhurave sipas TTHF; si dhe të propozojë sipas rastit ndryshimin e përgjegjësiave tatimore për tatimpaguesit të cilët plotësojnë kushtet për kalimin në përgjegjësinë tatimore të TVSH-së dhe Tatimit mbi Fitimin, apo kryerjen e kontrolleve të thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra.

Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2023

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatuan 30 subjekte biznesi i madh, të cilët kanë deklaruar humbje tatimore për 3 vite të njëpasnjëshme për të cilat nga ana e Sektorit të Kontrollit Tatimor dhe Monitorimit nga Zyra, nuk dokumentohet puna për kryerjen e një analize të hollësishme sipas inspektorëve për evidentimin e këtyre subjekteve, arsyet dhe argumentimin e humbjes, vlerësim në rritje të të ardhurave apo ulje të shpenzimeve, sipas informacioneve me shkrim që duhet të kishin kërkuar tatimpaguesve apo letër kujtesave, shkresa për kalimin/propozimin e kontrolleve në Drejtorinë e Kontrollit, kërkim në gjykatë të procedurës së falimentit, etj., veçanërisht për bizneset e BM kategoria e të cilave cilësohet si me një risk më të madh. Nga këto subjekte, 11 prej tyre rezultojnë me humbje 3 vite rresht në vlerë mbi 1,000,000 lekë.

Gjithashtu, u konstatuan 55 subjekte BV të cilët kanë deklaruar humbje tatimore për 3 vite të njëpasnjëshme, nga të cilat 11 tatimpagues që kanë deklaruar për 3 vite rresht humbje mbi 500,000 lekë, për të cilat u evidentua e njëjta problematikë në monitorimin dhe analizën si për BM trajtuar më sipër.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.3.2/2, faqe 68-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit

6.1 Rekomandimi: DRT Shkodër, nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të kryejë një analizë të thelluar të situatës së tatimpaguesve BM dhe BV të cilët rezultojnë me humbje respektivisht mbi 500,000 lekë për tre vite të njëpasnjëshme, si dhe të propozojë kryerjen e kontrolleve të thelluara në vend/vizitave fiskale për rastet e vlerësuara me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, duke kryer njoftimet përkatëse në gjykatë për fillimin e procedurave të likuidimit.

Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2023

7. Gjetje nga auditimi: Gjatë auditimit u konstatua se Urdhri nr. 2, datë 21.07.2021 “Për transferim të përkohshëm ndërmjet sektorëve” i Drejtorit Rajonal të DRT Shkodër, nuk është kryer në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Konstatohet në përmbajtjen e dokumentit është urdhëruar transferimi i përkohshëm i nëpunësit të DRT Shkodër z. L. Ç. nga Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, në Sektorin e Kontrollit në Vend pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, duke mos cituar periudhën kohore gjatë të cilës do të jetë i vlefshëm ky transferim, si dhe duke mos trajtuar edhe bazën ligjore në të cilin është mbështetur ky urdhër, veprime këto në kundërshtim përcaktimet ligjore të Seksionit 3 “Ligjshmëria, pavlefshmëria dhe korrigjimi i aktit administrative” konkretisht neni 107 “Ligjshmëria e aktit administrativ” neni 108 ‘Akti

administrativ absolutisht i pavlefshëm”, neni 109 “Paligjshmëria e aktit administrativ” të ligjit nr. 44/20151 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”. Sipas shkresës nr. 3802/1, prot. DRT Shkodër datë 15.03.2020 me Urdhrin nr. 6, datë 15.03.2022 të drejtorit të DRT Shkodër “Për rikthim nga transferimi i përkohshëm ndërmjet sektorëve” (pra rreth 8 muaj pas shkresës së mëparshme) është urdhëruar rikthimi i nëpunësit të DRT Shkodër z. L. Ç. me të gjitha funksionet pranë Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit. Si rezultat, për një periudhë rreth 8 mujore punonjësi ka ushtruar kompetencat e një pozicioni, komandimi për të cilin është kryer në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.3.2/2, faqe 68-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit

7.1 Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Rajonale Shkodër në bashkërendim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve të marrë masa të menjëhershme me qëllim eliminimin e veprimeve administrative që bien në kundërshtim të hapur me pikat 3, 5, 10, 11, 18, 20 të nenit 4 të përcaktuar në Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore si dhe përcaktimet ligjore të Seksionit 3, neni 107, 108, 109 dhe 114 të ligjit nr. 44/20151 “Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë”, duke evidentuar rast pas rasti në bashkëpunim me strukturat në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, pasojat ekonomike administrative ligjore me efekte në të ardhurat tatimore në Buxhetin e Shtetit që kanë lindur si pasojë e veprimeve të kryera pas nxjerrjes së aktit administrativ të kundërligjshëm sipas Urdhrit nr. 2, datë 21.07.2021 “Për transferim të përkohshëm ndërmjet sektorëve” gjatë periudhës dhe fushës materiale që ka mbuluar akti administrativ.

Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2023

8. Gjetje nga auditimi: Gjendja e detyrimeve të papaguara në fund të muajit Qershor 2022 për Rajonin Verior rezulton 13,290,528 mijë lekë dhe ju përket 23,816 debitorëve, nga vlera 11,007,343 mijë lekë që paraqitej në fund të muajit dhjetor 2020. Trendi i detyrimeve për periudhën janar 2020-qershor 2022 paraqitet me një rritje të ndjeshme, i ndikuar nga mungesa e efektivitetit të masave shtrënguese të ndërmarra për arkëtimin e borxhit, moszbatimi i tyre në mënyrë shteruese, ristrukturimi i Drejtorisë së Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara në Rajon Verior dhe periudha e vështirë shkaktuar nga pandemia e Covid-19 gjatë vitit 2020.

Nga analizimi i të dhënave të detyrimeve tatimore të papaguara rezulton se nuk janë marrë të gjitha masat shtrënguese, konkretisht: nuk është marrë asnjë masë “Njoftim transferimi detyrimi palës së tretë”, “Njoftim dhe kërkesë për të paguar nga palët e treta dhe “Njoftim për transferimin e detyrimit, ortakut, aksionarit, administratorit”, veprime këto në kundërshtim me pikat 88, 97, 98, 99 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 110-123, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8.1. Rekomandim: Drejtoria e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara, Rajoni Verior, të marrë masat e nevojshme për të siguruar mbulimin e debitorëve, me të gjitha masat shtrënguese të përcaktuara në legjislacionin në fuqi me qëllim uljen e riskut të mos arkëtimit të detyrimeve tatimore të papaguara.

Menjëherë dhe vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi kryerjen e inventarizimit e pronës shtetërore si dhe rregullshmërinë e procedurave për nxjerrjen jashtë përdorimit/asgjësimin e aktiveve, është konstatuar se për vitin 2021, “Komisioni i inventarizimit” përpara fillimit të inventarit nuk ka mbajtur procesverbal me magazinierin, në të cilin fiksohen numri i fletëhyrjeve dhe fletëdaljeve të

bëra gjatë vitit; në përfundim të procesit nuk ka mbajtur procesverbal ku të pasqyrohet dhe të krahasohet gjendja fizike dhe cilësore të aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit, por një pjesë e rezultateve kryesisht inventarizimi i pajisjeve të zyrave janë pasqyruar në formë tabelore, me shënime, si dhe nga strukturat drejtuese të institucionit nuk është vijuar me procesin e vlerësimit të aktiveve të parashikuara të papërdorshme nga komisioni i inventarizimit dhe nuk është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje jashtë përdorimit, veprime në kundërshtim në me pikat 83, 85 dhe 95 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011.

Për rrjedhojë të mosveprimeve të mësipërme procesi i inventarizimit nuk është kryer i plotë dhe në përputhje me procedurat ligjore.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.7, faqe 130-135, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër të marrë masa për kryerjen e procesit të inventarizimit në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi me qëllim rritjen e cilësisë dhe besueshmërisë së informacionit që gjenerohet nga pasqyrat financiare krahasuar me gjendjen fizike, si edhe shmangien e risqeve potenciale që lidhen me menaxhimin e vlerave materiale, për të parandaluar shpërdorimin dhe humbjen e tyre.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i ushtruar në DRT Shkodër, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, sipas shkresës nr. 250/6 prot. KLSH datë 19.04.2021 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me lëndë “Dërgohet Raporti Përfundimtar i Auditimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm” niveli i zbatimit të rekomandimeve të dhëna rezulton si më poshtë:

Masa organizative:

Në auditimin e mëparshëm janë rekomanduar 8 (tetë) masa organizative nga të cilat janë pranuar 7 (shtatë) masa dhe realizuar 6 (gjashtë) prej tyre. Nuk është pranuar Rekomandimi nr. 1.1, e cila është adresuar DPT për zbatim me shkresën nr. 3933 datë 21.05.2020. Niveli i zbatimit 85.7 %.

Masa shpërblim dëmi:

Në auditimin e mëparshëm janë rekomanduar 3 (tre) masa shpërblim dëmi në shumën totale 1,444,208 lekë, nga të cilat janë pranuar dy (dy) masa në shumën 1,292,979 lekë, si dhe nuk është pranuar 1 (një) masë shpërblim dëmi në shumën 151,229 lekë, që i përket Rekomandimit nr. 3.1. Niveli i zbatimit paraqitet në masën 66.6 %. Nga dy masat shpërblim dëmi të pranuar, është arkëtuar deri në përfundim të auditimit shuma 546,747 lekë, ose 37.8 % ndaj totalit.

Masa për eliminimin e efekteve negative në buxhetin e shtetit:

Në auditimin e mëparshëm janë rekomanduar 12 (dymbëdhjetë) “Masa për eliminimin e efekteve negative”, nga të cilët janë zbatuar plotësisht 11 prej tyre, ose në masën 92 %, si dhe është zbatuar pjesërisht 1 rekomandim (Rekomandimi nr. 4.1).

Masa disiplinore:

Në auditimin e mëparshëm janë rekomanduar 5 (pesë) masa disiplinore me shkresën nr.55/10 prot., datë 13.05.2020 “Dërgim i Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet”, ri kërkuar përsëri me shkresën nr. 250/6 prot. KLSH datë 19.04.2021 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit, për të cilat nuk është zbatuar asnjë rekomandim i KLSH-së dhe nuk ka një qëndrim administrativ ligjor nga Drejtorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër (sipas periudhave përkatëse në këtë detyrë). Nga auditimi rezulton se, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, nuk është dërguar shkresë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me qëllim ngritjen e

Komisionit Disiplinor për dokumentimin e shkeljeve të konstatuara nga KLSH, si dhe referimin e shkeljes disiplinore përkatëse të rekomanduar.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.1, faqe 14-18, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

10.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, në lidhje me rekomandimet e pa realizuara të rishqyrtojë dhe të analizojë situatën, duke marrë masa të menjëhershme për nxjerrjen e shkaqeve dhe përgjegjësi konkrete, të mos veprimeve nga ana e titullarëve të DRT Shkodër, për mos zbatimin e rekomandimeve (Masa organizative, rekomandimi nr. 1.1; Masa shpërblim dëmi, rekomandimi nr. 3.1 dhe Masat disiplinore, për 5 punonjës të DRT Shkodër), si dhe të fillojë procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit, përcjellë nga KLSH me shkresën nr. 250/6, datë 19.04.2021 të Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit me lëndë “Dërgohet raporti përfundimtar i auditimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm”.

B. TË ARDHURA TË MUNGUARA NË BUXHETIN E SHTETIT:

Nga auditimi i kryer mbi zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend dhe vlerësimit tatimor nga zyra, sipas auditimit të kryer nga KLSH, nga përlllogaritjet paraprake, kanë rezultuar të ardhura të munguara në shumën totale 1,196,591,489 lekë, nga e cila detyrimet **TVSH dhe Tatim Fitimi në shumën 960,335,382 lekë dhe penalitete në shumën 236,256,107 lekë, për të cilat kërkohet të kryen rivlerësimet përkatëse.**

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nga inspektorët e kontrollit tatimor në vend, nuk është evidentuar dhe trajtuar në raportet e kontrollit tatimor, fakti që nga ana e subjekteve tatimpaguese, nuk është përlllogaritur saktë amortizimi i Aktiveve Afatgjata Materiale (AAM), pasqyrimi i amortizimit si shpenzim në Pasqyrën e Performancës Financiare, si dhe mos paraqitja e tyre me vlerën neto kontabël në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 22 “Amortizimi”; Manualin e Procedurave të Kontrollit Tatimor, si dhe kërkesat e programeve të kontrollit, mbi analizimin e AAM-ve. Për diferencat e evidentuara në përlllogaritjen e shpenzimeve të amortizimit, për **gjashtë raste** është kryer ri karakterizim i situatës dhe përlllogaritjet e detyrimeve në shumën 24,705,227 lekë, në zbatim të Ligjit 9920 datë 18.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, germa “b”, neni 72, germa “a” dhe neni 115, pika 1 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3/1, faqe 21-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

1.1. Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht në vlerën prej **24,705,227 lekë, nga e cila penalitetet në shumën 4,113,880 lekë.**

Brenda 3 (tre) muajve

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, në **pesë raste** janë evidentuar mospërputhje në deklarimin e blerjeve mallra e lëndë të parë gjatë vitit (shtesa gjatë vitit), e cila ka ndikuar në përlogaritjen e KMSH sipas Formularit nr. 5, Pasqyrën e Performancës Financiare dhe FDP e tatim fitimit, ku për të gjitha rastet e mospërputhjeve, diferenca e konstatuar ka shërbyer si bazë e tatueshme për të kryer ri karakterizimin dhe përlogaritjen e detyrimeve tatimore, referuar Ligjit nr.9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”, germa (b) si dhe bazuar në nenin 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit” është kryer rivlerësimi sipas të cilit janë përlogaritur detyrimet dhe gjobat e mësipërme në zbatim të nenit 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, pika 1.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3/1, faqe 21-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

2.1. Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht **në shumën 2,950,345 lekë, nga e cila penalitetet në shumën 529,779 lekë.**

Brenda 3 (tre) muajve

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se në **dy raste**, bazuar në të dhënat mbi gjendjen e inventarëve sipas Raportit Përfundimtar të Kontrollit dhe të dhënave në C@ts, kanë rezultuar diferenca në inventar. Konkretisht:

- Për subjektin tatimpagues "A.PH." në datë 31.12.2019 gjendja e inventarit në C@ts paraqitet në shumën 114,575,466 lekë, ndërsa gjendja e inventarit në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (2019) paraqitet në shumën 137,524,665 lekë, duke rezultuar me një diferencë në vlerën 22,949,199 lekë. Diferenca në gjendjen e inventarit, ka shërbyer si bazë e tatueshme për ri karakterizimin e situatës dhe përlogaritjen e detyrimeve në shumën 9,791,276 lekë.

- Për subjektin tatimpagues "A-2011" SHPK, në datë 31.12.2018 gjendja e inventarit në C@ts paraqitet në shumën 48,768,761 lekë, ndërsa gjendja e inventarit në Pasqyrën e Pozicionit Financiar (2018) paraqitet në shumën 47,441,195 lekë, duke rezultuar me një diferencë në vlerën 1,327,566 lekë. Diferenca në gjendjen e inventarit ka shërbyer si bazë e tatueshme për ri karakterizimin e situatës dhe përlogaritjen e detyrimeve në shumën 566,406 lekë.

Ri karakterizimi është kryer bazuar në Ligjin nr. 9920/2008 me ndryshime neni 71 dhe 72, për shkelje referuar nenit 115, pika 1 të këtij ligji.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3/1, faqe 21-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3.1. Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht **në shumën 10,357,682 lekë, nga e cila penalitetet në shumën 1,860,814 lekë.**

Brenda 3 (tre) muajve

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor në vend, nuk janë analizuar në mënyrën e duhur shpenzimet për efekt të kreditimit të TVSH (shpenzimet e panjohura).

- Në kontrollin e ushtruar në subjektin tatimpagues "A.B.07" SHPK, përlogaritja e shpenzimeve të karburantit për shkak të njohjes së shpenzimeve për efekt të kreditimit të TVSH, nga inspektori i kontrollit, nuk është kryer në mënyrën e duhur, pasi sipas Udhëzimit nr. 6/2015 normativa për inertet është 33 % dhe për betonin është 14 %. Nga përlogaritja referuar normativave dhe peshës specifike të dy produkteve, përqindja që duhej aplikuar është 23.2 %. Si rezultat i mos aplikimit të përqindjes së duhur kundrejt shitjeve (beton dhe inerte), është kryer ri karakterizimi i situatës dhe janë kryer përlogaritjet e detyrimeve në shumën 1,400,317 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me udhëzimin nr.6/2015, neni 55 “Kufizime të zbritjes së TVSH për disa furnizime”. Nga rivlerësimi i bërë në zbatim të Ligjit 9920/2008 neni 68 “Vlerësimi tatimor” dhe neni 115 “Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore”, pika 3, bazuar në përlogaritjet e mësipërme detyrimi total rezulton në shumën 1,400,317 lekë.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3/1, faqe 21-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

4.1. Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht **në shumën 1,400,317 lekë, nga e cila penalitetet në shumën 233,386 lekë.**

Brenda 3 (tre) muajve

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, në kontrollin e ushtruar në subjektin tatimpagues "S.A." SHPK, nga inspektori i kontrollit tatimor, nuk është analizuar fakti që në Pasqyrën e flukseve monetare, nuk është paraqitur në vitin ushtrimor 2019 shuma 18,334,540 lekë dhe në vitin ushtrimor 2020 shuma 24,732,964 lekë, si hua të arkëtuara në seksionin e flukseve monetare nga/përdoruar në aktivitetin e financimit. Mosparaqitja e këtyre shumave ka impaktuar mjetet monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare në fund të periudhave ushtrimore, vlerë e cila duhet të jetë e barabartë me mjetet monetare në aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar. Për rrjedhojë aktivet janë paraqitur me pak për shumat respektive 18,334,540 lekë në vitin 2019 dhe 24,732,964 për vitin 2020, Këto diferenca kanë shërbyer për ri karakterizimin e situatës referuar Ligjit 9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71 “E drejta për të përdorur mënyra alternative vlerësimi”, germa (b); nenin 72 “Baza e mënyrave alternative të vlerësimit” dhe përlogaritjen e detyrimeve në shumën 4,522,422 lekë, bazuar në nenin 115 “Plotësim i pasaktë i deklaratës tatimore”, pika 1.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3/1, faqe 21-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

5.1. Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorin e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjes përkatëse të kontrolluar prej tij, nga auditimi i të cilës janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave

të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht **në shumën 4,522,422 lekë, nga e cila penalitetet në shumën 812,478 lekë.**

Brenda 3 (tre) muajve

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se në **tre raste**, në kontrollin e ushtruara në subjektet tatimpaguese "P.GJ." SHPK, "G-2012" SHPK dhe "A-2011" SHPK, nga inspektorët e kontrollit tatimor, nuk janë analizuar llogaritë "Të drejta të arkëtueshme/Klientë" dhe "Detyrime afatshkurtra/Furnitorë", në kundërshtim me kërkesat e Manualit të Kontrollit Tatimor dhe programeve të kontrollit.

- Nga analiza furnitorë-klientë, për subjektin "L.G." PF është evidentuar se, subjekti "P.GJ." me NIPT-X, rezulton se ka kryer blerje tek subjekti "L.G." në shumën 2,147,015 lekë, të cilën e ka paraqitur si detyrim afatshkurtër "furnitorë" ndërsa subjekti "L.G." nuk e ka përfshirë në analizën e llogarisë "klientë" dhe në të drejtat e arkëtueshme, për shkak se transaksionet janë kryer me pagesa cash/kasë fiskale dhe të regjistruara në librat e shitjes. Nga analiza e llogarisë analitike të "Furnitorëve" të subjektit "P.GJ." rezulton se ka detyrime kundrejt subjektit "L.G." në shumën 2,147,015 lekë, duke rënduar në këtë mënyrë pasivin e bilancit. Sa më sipër është kryer ri karakterizimi i situatës dhe përlllogaritjet e detyrimeve të subjektit **"P.GJ." SHPK, në shumën 916,023 lekë.**

- Nga analiza furnitorë-klientë me subjektin "A" SHPK, ka rezultuar se, subjekti "G-2012" paraqet në vitin 2014 në "Të drejta të arkëtueshme/klientë" në shumën 274,979,591 lekë, ndërsa në Pasqyrat Financiare të subjektit "A" SHPK, në llogarinë "Të pagueshme/ furnitorë" paraqitet në shumën 232,187,646 lekë, me një diferencë në shumën 42,791,945 lekë, të cilat përfaqësojnë shitje të deklaruara të "G-2012" kundrejt subjektit "A" SHPK, shtuar këtij faktin që dy shoqëritë kanë të njëjtin pronar.

Aktivi (Të drejta të arkëtueshme) "G-2012"	274,979,591 lekë
--	------------------

Pasivi (Të pagueshme/Furnitor) "A"	232,187,646 lekë
------------------------------------	------------------

Diferenca	42,791,945 lekë
-----------	-----------------

Për shitjet (të ardhura) e padeklaruara në shumën 42,791,945 lekë, është kryer ri karakterizimi dhe janë përlllogaritur detyrimet e subjektit **"G-2012" SHPK në shumën 18,257,184 lekë.**

- Nga auditimi i subjektit "P.GJ.", rezulton se ka kryer blerje tek subjekti "A-2011" SHPK në shumën 1,130,314 lekë, të cilën e ka paraqitur si detyrim afatshkurtër "furnitorë" ndërsa subjekti "A-2011" SHPK nuk e ka përfshirë në analizën e llogarisë klientë dhe në të drejtat e arkëtueshme, të cilat për vitin 2019 paraqiten në vlerën 325,600 lekë.

Klient "P.GJ." SHPK	0 lekë
---------------------	--------

Furnitor "A-2011" SHPK	1,130,314 lekë
------------------------	----------------

Për shitjet (të ardhura) e padeklaruara në shumën 1,130,314 lekë, është kryer ri karakterizimi dhe janë përlllogaritur detyrimet e subjektit **"A-2011" SHPK në shumën 482,248 lekë.**

Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3/1, faqe 21-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

6.1. Rekomandim: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 "Ri kontrolli tatimor" të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht **në shumën 19,655,455 lekë, nga e cila penalitetet në shumën 3,531,209 lekë.**

Brenda 3 (tre) muajve

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, inspektori i kontrollit tatimor nuk ka analizuar detyrimet afatshkurtra “Furnitorë”, të subjektit tatimpagues “A.B.07”, të cilat në shumicën e rasteve rezultojnë të pa ndryshuara nga viti në vit. Më i dukshëm ky fenomen rezulton në 13 raste të furnitorëve, që zënë mbi 90 % të totalit të detyrimeve afatshkurtra. Nga analiza e historikut të këtyre furnitorëve rezulton se, tatimpaguesi “A.B.07”, ka detyrime permanente, të pandryshuara në 4 (katër) vite ushtrimore, të analizuara, ndaj 13 subjekteve, të cilat kanë tejkaluar afatin e detyrimeve afatshkurtra, referuar SNK 1 “Detyrimet afatshkurtra”, paragrafi 69.

Sipas kryqëzimit të të dhënave të deklaruar (të mundshme për tre rastet e mëposhtme) në C@TS, (Libra blerje/ “A.B.07” dhe Libra Shitje/ “A-2006”, si dhe Libra blerje “A.B.07” në raport me subjektet “F.I.” dhe “B.E.”) nuk ka asnjë blerje të deklaruar tek këta subjekte/furnitorë.

Në lidhje me tre subjektet “A-2006”, “F.I.” dhe “B.E”, subjekti “A.B.07”, nuk ka deklaruar asnjë faturë blerje në librat e saj, për rrjedhojë është kryer ri karakterizimi i situatës dhe është përlogaritur detyrimet e subjektit në shumën 21,678,982 lekë.

Subjekti tatimpagues “A.B.07”, nuk ka dokumentuar TVSH në blerje, për faktin se nuk ka dokumentacion “Faturë blerje të regjistruar në librat e blerjes”, sipas verifikimeve në C@ts, për rrjedhojë është në shkelje të Udhëzimit nr. 6, neni 54 “Kriteret formale për ushtrimin e së drejtës së zbritjes së TVSH-së” pika 1.

Gjithashtu, veprimet e mësipërme, të cilat rezultojnë me dhënien e informacioneve joreale, deklarimeve të pavërteta, përbëjnë evazion fiskal referuar Ligjit 9920/2008 me ndryshime, neni 116 “Evazion fiskal”. Deklarimi i pasaktë i detyrimeve afatshkurtra në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar dhe i pasqyrimin të shpenzimeve të pa justifikuar me dokumentacion (blerje materiale, lëndë të para, etj.) në Pasqyrën e Performancës Financiare, ndikon drejtpërsëdrejti në llogarinë “Fitim apo humbje nga veprimtaria e shfrytëzimit” (të ardhura-shpenzime) dhe për pasojë në përlogaritjen dhe deklarimin e TF.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3/1, faqe 21-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

7.1. Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht **në shumën 21,678,982 lekë, nga e cila penalitetet në shumën 10,839,491 lekë.**

Brenda 3 (tre) muajve

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se sipas të dhënave të pasqyrave të pozicionit financiar për periudhën 2015-2018, të subjektit “SH-A” SHPK, detyrimet afatgjata “Hua” të krijuara në vitin 2015 në shumën 11,200,000 lekë, në vitin 2016 janë rritur në shumën 31,180,000 lekë dhe rezultojnë në këtë vlerë edhe për vitin 2017 dhe 2018. Në lidhje me këto detyrime evidentohet fakti se rezultojnë të pandryshuara në tre periudha ushtrimore, si dhe duke analizuar shpenzimet (kostot) e kësaj kredie/huaje rezulton se ato paraqiten në shumën 0 lekë për të gjithë periudhën e kontrolluar.

Nga ana e inspektorit të kontrollit në RPK, nuk është cilësuar dhe analizuar burimi i këtyre të ardhurave dhe të dhëna të tjera, pasi dhe në shënimet shpjeguese të PF, të vitit 2017 nuk është

analizuar dhe shpjeguar kjo shumë, por është cituar vetëm se: “Shuma prej 31,180,000 lekë është hua e marrë me akte noteriale dhe kaluar me bankë”.

Në asnjë prej rasteve të mësipërme të huamarrjes nuk janë cilësuar institucionet financiare (banka etj.), apo huadhënës, kontratat e kredisë apo huadhënies, aktet noteriale, termat e referencës së kredive, plani i amortizimit etj., në kundërshtim me kërkesat e programit të kontrollit. Gjithashtu, këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9917, datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit” i ndryshuar, neni 18.1 si dhe UMF nr. 16, datë 16.02.2009 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave”, neni 5 “Raportimi i aktivitetit të dyshimtë (RAD)”, pika 1 dhe 2. Nga grupi i auditimit, referuar situatës së paraqitur më lart, e cila nuk është në kushtet e përcaktuara në nenin 131 “Mos shlyerja e kredisë” të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar, pasi subjekti jo vetëm që nuk ka zvogëluar, por ka zmadhuar kapitalin nga viti në vit, si dhe paraqitet me një rezultat financiar pozitiv (fitim), për gjatë gjithë periudhës (2015-2018), është kryer ri karakterizimi dhe janë përllogaritur detyrimet e subjektit në shumën 791,526 lekë.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3/1, faqe 21-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

8.1. Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht **në shumën 791,526 lekë, nga e cila penalitetet në shumën 142,202 lekë.**

Brenda 3 (tre) muajve

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se, nga ana e inspektorit të kontrollit tatimor në vend, nuk është evidentuar fakti se subjekti tatimpagues “S.A.” SHPK nuk ka pasqyruar në Pasqyrën e Performancës Financiare shpenzimet për paga të kryera për vitin 2020. Në vitin paraardhës kanë rezultuar në shumën 672,000 lekë. Nga verifikimi në C@ts i listë pagesave të vitit 2020, rezulton se shpenzimet për paga janë në shumën 815,000 lekë. Për këto shpenzime të pa përfshira në PASH dhe FDP e tatim fitimit është kryer ri karakterizimi si më poshtë, bazuar në Ligjin nr. 9920/2008 “Për procedurat tatimore në RSH” me ndryshime, neni 71 dhe 72, si dhe janë përllogaritur detyrimet e subjektit në shumën 347,720 lekë.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.3/1, faqe 21-67, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

9.1. Rekomandimi: Titullari i DRT Shkodër, të nxjerrë përgjegjësitë për inspektorët e kontrollit tatimor në vend, referuar dosjeve përkatëse të kontrolluara prej tyre, nga auditimi i të cilave janë konstatuar mangësi dhe parregullsi në procedurat e kontrollit, me efekte negative në të ardhurat tatimore, si dhe në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurale, të kryejë ri kontroll tatimor, sipas përcaktimeve të nenit 85 “Ri kontrolli tatimor” të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, të evidentuara paraprakisht **në shumën 347,720 lekë, nga e cila penalitetet në shumën 62,390 lekë.**

Brenda 3 (tre) muajve

10.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DRT Shkodër për periudhën objekt auditimi nuk ka saktësuar nëpërmjet kontrollit tatimor, vlerësimet nga zyra për tatimpaguesit sipas kasës, me qarkullimin në deklaratat e TFTH-së dhe TVSH-së, sipas përcaktimeve procedurale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:

a. Nga analiza e diferencave në qarkullim midis xhiros së korrektuar të kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TTHF, për bizneset e vogla pa TVSH, u konstatua se:

- Për vitin 2020 rezultuan 266 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTHF-së në vlerën 96,728,682 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 5,895,613 lekë.

- Për vitin 2021 rezultuan 181 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTHF-së në vlerën 129,575,024 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 7,897,597 lekë.

b. Nga analiza e diferencave në qarkullim midis xhiros së korrektuar të kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TVSH-së (FDP) për bizneset e vogla me TVSH, rezultuan si më poshtë:

- Për vitin 2020 rezultuan 570 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTHF-së në vlerën 629,720,428 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 268,670,221 lekë.

- Për vitin 2021 rezultuan 22 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTHF-së në vlerën 19,520,052 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 8,328,230 lekë.

c. Nga analiza e diferencave në qarkullim midis xhiros së korrektuar të kasës dhe të ardhurave në deklaratën e TVSH-së (FDP) për bizneset e mëdha me TVSH, rezultuan si më poshtë:

- Për vitin 2020 rezultoi 1 subjekt i cili kishte qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTHF-së në vlerën 434,630 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 185,435 lekë.

- Për vitin 2021 rezultuan 158 subjekte të cilat kishin qarkullim sipas kasës më të lartë sesa deklarata e TTHF-së në vlerën 715,207,142 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 305,143,127 lekë.

Sipas vlerësimit paraprak, rezultojnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit gjithsej në vlerën prej 596,120,224 lekë, nga e cila vlera e penalteteve rezulton në shumën 107,096,251 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 71, neni 115, UMF nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 71, pika 115, Rregulloren e Funkcionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin Nr.19 (Nr.1482/2., prot.) datë 22.02.2017 të Ministrit të Financave, Rregulloren e Funkcionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr.192, datë 12.08.2020 të Ministrit të Financave, Manualit të Kontrollit nga Zyra.

10.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se nga ana e DRT Shkodër rezultojnë mangësi në drejtim të përmbushjes së detyrimit për saktësimin nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit me diferenca të pajustificuara midis qarkullimit të deklaruar në formularin e deklarimit të pagesës të TVSH-së (FDP) dhe deklaratën e Tatimit mbi Fitimit, për periudhën objekt auditimi, në kundërshtim me përcaktimet ligjore e procedurale të cilat rregullojnë veprimtarinë e administratës tatimore dhe konkretisht:

- Për vitin 2020 rezultuan 32 subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të vogël se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën 27,612,829 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 6,732,008 lekë. Gjithashtu rezultuan 15

subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të madh se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën 514,038,736 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 93,991,983 lekë.

- Për vitin 2021 rezultuan 30 subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të vogël se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën 81,327,484 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 19,827,641 lekë. Gjithashtu rezultuan 17 subjekte të cilat kishin qarkullimin e deklaruar sipas deklaratës së TVSH-së më të madh se qarkullimi sipas deklaratës së TF, në vlerën 205,687,978 lekë duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 37,610,047 lekë.

Pra, rezultojnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit gjithsej në vlerën prej 158,161,678 lekë,

Sipas vlerësimit paraprak, rezultojnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit gjithsej në vlerën prej 158,161,678 lekë, si rezultat i diferencave në deklarime për efekt të TVSH-së dhe TF-së, nga e cila vlera e penaliteteve rezulton në shumën 28,414,608 lekë.

Gjatë auditimit u sistemuan nga ana e inspektorëve pas konstatimit të grupit diferencat për 13 raste në vlerë absolute për vitin 2020 në 4,297,692 lekë, dhe 2021 në 11,310,707 lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 60, neni 71, neni 71/1, neni 115, UMF nr.24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, pika 60, pika 71, pika 71/1, pika 115, Rregulloren e Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin Nr.19 datë 22.02.2017, të Ministrit të Financave, Rregulloren e Funksionimit të Drejtorive Rajonale Tatimore dalë me Urdhrin nr.192, datë 12.08.2020 të Ministrit të Financave, Manualit të Kontrollit nga Zyra.

10.3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u raportuan nga Sektori i Kontrollit nga Zyra problematika të shumta të lidhura me sistemet sipas së cilave bazohet aktiviteti i punonjësve të sektorit, të cilat kanë cenuar aktivitetin e punës së tyre, të tilla si: Inkorporimi i sistemit të ri fiskal CPCPM ka sjellë mungesë informacioni dhe keqfunksionime të sistemit si rezultat duke i dubluar të dhënat; Sistemi i kasave Nexus është jashtë funksionit për të kryer verifikime; Raportet e fundit nga AKSHI nuk pasqyrojnë vlerat e pajisjeve fiskale të çregjistruara; Duplikime në sistemin selfcare; Mangësi dhe mospërputhje me sistemin e vjetër; Mungesë aksesit në raportet e kasave; Mungesë aksesit për t'i eksportuar ne excel apo për të aksesuar raportet e shkarkuara nga ana e IT-së çdo muaj për kasat/pajisjet fiskale/ sigurimet/deklaratat e TVSH-ve apo te TTHF, TF, etj.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.3.2/2, faqe 68-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për diferencat e pajustificuara, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në zërat e Tatimit mbi Fitimin, Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin dhe TVSH-së, të përlllogaritura paraprakisht **në shumën 596,120,224 lekë, nga e cila penalitete në shumën 107,096,251 lekë**, si rezultat i diferencave me kasën për 1198 raste; dhe si rezultat i diferencave mes të ardhurave të TF dhe TVSH **në shumën 158,161,678 lekë, nga e cila penalitete në shumën 28,414,608 lekë**, për 94 raste, duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse si dhe kryerjen e propozimeve përkatëse Sektorit të Kontrollit Operacional në DRT Shkodër për kontrollin e thelluar në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

10.2. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër në bashkëpunim me DPT-në në cilësinë e institucionit epror përgjegjës, t'i drejtohen AKSHI-t me shkresë zyrtare për problematikën e hasura gjatë kryerjes së detyrave funksionale të punonjësve tilla si: normalizimin

e situatës së funksionimit të sistemit informatik tatimor dhe rikthimin e dokumentacionit dhe informacionit të fshirë në postën elektronike zyrtare të institucionit; përmirësimin e problematikave të lidhura me inkorporimin e sistemit të ri fiskal CPCM, zgjidhjen e mangësive dhe mospërputhjeve me sistemin e vjetër ku nevojitet mundësimi i aksesit në sistemin e vjetër të kasave Nexus për të kryer verifikime ; shqyrtimin e mundësisë për hapjen e akseseve për t'i eksportuar ne excel apo për të aksesuar raportet e shkarkuara nga ana e IT-së çdo muaj për kasat/pajisjet fiskale/ sigurimet/deklaratat e TVSH-ve apo te TTTF,TF; pasqyrimin e vlerave të pajisjeve fiskale të çregjistruara nga AKSHI, problemeve të regjistrimit të importeve në sistemin selfcare; dublikime, etj; në mënyrë që DRT Shkodër nëpërmjet Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të kryejë verifikimet përkatëse për diferencat e konstatuara nga grupi i auditimit.

Brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 2023

11.1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DRT Shkodër nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit me diferenca të pajustificuara në vlerën e importeve të deklaruar në tatime dhe të deklaruar në doganë konkretisht:

- Për vitin 2020 rezultuan 99 subjekte, deklarimet e importeve të të cilave paraqiten me një qarkullim vjetor të deklaruar në doganë me një diferencë prej 121,027,228 lekë më shumë se vlera e deklaruar në tatime, dhe diferencë TVSH prej 18,410,001 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 26,161,619 lekë. Gjithashtu u konstatuan 86 subjekte ku totali i qarkullimit të deklaruar në doganë për importet është më një diferencë prej 91,632,265 lekë më pak se vlera e deklaruar në tatime dhe TVSH me diferencë 12,817,339 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 19,561,957 lekë.

- Për vitin 2021 rezultuan 138 subjekte, deklarimet vjetore të importeve të të cilave paraqiten me një qarkullim vjetor të deklaruar në doganë me një diferencë prej 84,665,293 lekë më shumë se vlera e deklaruar në tatime, dhe TVSH me diferencë 21,882,211 lekë, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 20,273,253 lekë. Gjithashtu u konstatuan 111 subjekte ku qarkullimi vjetor i deklaruar në doganë i importeve është me një diferencë prej 196,042,887 lekë më pak se vlera e deklaruar në tatime, dhe TVSH me diferencë 25,710,812 duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 41,477,110 lekë.

Sipas vlerësimit paraprak, rezultojnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit gjithsej në vlerën prej 107,473,939 lekë, nga e cila penalitete ne shumën 33,468,787 lekë, si rezultat i diferencave të konstatuara në import.

Gjithashtu, për vitin 2022 (periudhë ende e pa mbyllur deklarimesh financiare) u konstatuan diferenca pozitive (rastet kur vlera e deklaruar sipas tatimeve është më e madhe se ajo sipas doganave) për 44 raste në vlerën e tatueshme prej 121,293,557 lekë, dhe në 23,595,020 TVSH lekë; dhe diferenca negative (rastet kur vlera e deklaruar sipas tatimeve është më e vogël se ajo sipas doganave) për 308 raste në vlerën e tatueshme prej 738,987,323 lekë, dhe në TVSH 162,603,126 lekë, objekt verifikimi nga DRT Shkodër në vijim.

11.2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se DRT Shkodër nuk ka përmbushur detyrimin për saktësimin nëpërmjet kontrollit tatimor apo vlerësimit nga zyra për tatimpaguesit me diferenca të pajustificuara në vlerën e eksporteve të deklaruar në tatime dhe të deklaruar në doganë konkretisht:

- Për vitin 2020 rezultuan 49 subjekte, deklarimet e eksporteve të të cilëve paraqiten me një qarkullim vjetor të deklaruar në doganë me një diferencë prej 195,732,207 lekë më shumë se vlera e deklaruar në tatime, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën

83,509,146 lekë. Gjithashtu u konstatuan 35 subjekte eksportet e të cilave kanë qarkullim vjetor të deklaruar në doganë më një diferencë prej 55,785,833 lekë më pak se vlera e deklaruar në tatime, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 10,200,440 lekë.

- Për vitin 2021 rezultuan 85 subjekte, deklarimet e eksporteve të të cilave paraqiten me një qarkullim vjetor të deklaruar në doganë me një diferencë prej 335,259,374 lekë më shumë se vlera e deklaruar në tatime, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 143,038,412 lekë. Gjithashtu u konstatuan 41 subjekte ku qarkullimi i deklaruar në doganë është më një diferencë prej 60,401,419 lekë më pak se vlera e deklaruar në tatime, duke sjellë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën 11,044,399 lekë.

Gjithashtu, për vitin 2022 (periudhë ende e pa mbyllur deklarimesh financiare) u konstatuan diferenca pozitive për 30 raste në vlerën e tatueshme prej 7,110,337 lekë, dhe diferenca negative për 72 raste në vlerën e tatueshme prej 211,164,827 lekë, objekt verifikimi nga DRT Shkodër në vijim.

Sipas vlerësimit paraprak, rezultojnë të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit gjithsej në vlerën prej 247,792,397 lekë, nga e cila penalitete në shumën 44,517,257 lekë, si rezultat i diferencave të konstatuara në eksport.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.3.2/2, faqe 68-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

11.1. Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor për diferencat e pajustificuara, për vlerësimin e të ardhurave tatimore të munguara në zërat e Tatimit mbi Fitimin dhe TVSH-së, të përlogaritura paraprakisht në shumën **107,473,939 lekë, nga e cila penalitete në shumën 33,468,787 lekë**, në importet për 334 raste dhe **247,792,397 lekë, nga e cila penalitete në shumën 44,517,257 lekë**, në eksporte për 210 raste duke kryer vlerësimet dhe rivlerësimet përkatëse.

11.2. Rekomandimi: Strukturat respektive të Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit të kryejnë propozimet përkatëse Sektorit të Kontrollit Operacional në DRT Shkodër për kontrollin e thelluara në vend ose vizitave fiskale për tatimpaguesit me risk të lartë apo pamundësi vlerësimi nga zyra, me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara në Buxhetin e Shtetit.

Brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2023

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i vlerësimeve të kërkesave të subjekteve në lidhje me uljen e kështjës të tatimit fitimit rezultuan veprime jo në përputhje me përcaktimet e pikës 5, neni 3 “Parapagimet” të Ligjit Nr.8438 datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimi Nr.5, datë 30.01.2006 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, pika 3.13. “Parapagimet”, çështja 3.13.3 dhe Manualin e Kontrollit nga Zyra, pika 11.4, si rezultat i së cilave rezultojnë efekte financiare në vlerën 633,574 lekë penalitete për efekt pagese tatim fitimi.

Më hollësisht trajtuar në pikën III.3.2/2, faqe 68-110, të Raportit Përfundimtar të Auditimit

12.1 Rekomandimi: Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër të marrë masat e duhura administrative konform legjislacionit tatimor, për efektet financiare në vlerën 633,574 lekë detyrime tatim fitimi, që kanë rezultuar si pasojë e mungesës së monitorimit korrekt të kërkesave në ulje të tatimit mbi fitimin, me qëllim arkëtimin e tyre në Buxhetin e Shtetit.

Brenda gjashtëmuajorit të parë të vitit 2023

C. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenin 59, pika 4, shkronja “a” dhe “b”, të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013, “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, që në vlerësim të shkeljeve, të konsideruara nga ana jonë, sipas pikës 1 shkronja “b” të nenit 57 të ligjit nr. 152/2013, të urdhërojë fillimin e procedurave përkatëse për shqyrtimin dhe dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës të atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, në proporcion me shkeljet e konstatuara sa më poshtë:

- I. Masa, referuar Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, neni 58, germa b “Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” dhe germa c “Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, për punonjësit e mëposhtëm:
 1. S.I., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Rajonale Tatimore, Shkodër;
 - *Për mangësitë e evidentuara në kontrollin e tatimor në vend, në cilësinë e Drejtorit e Drejtorisë Rajonale, referuar Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192 datë 12.08.2020, neni 4 “Drejtori i Drejtorisë Rajonale Tatimore”, pikat 3, 10, 11, 18.*
 - *Në cilësinë e Drejtorit të DRT Shkodër, për nxjerrjen nga ana e tij të Urdhrit nr.2, datë 21.07.2021 “Për transferim të përkohshëm ndërmjet sektorëve” të pa mbështetur në kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, i cili është zbatuar për rreth 8 muaj.*
 2. A.H., me detyrë ish. Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit Tatimor në Vend dhe aktualisht, Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit Tatimor;
 - *Në cilësinë e Drejtorit të Kontrollit Tatimor dhe Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit në Vend (sipas rasteve përkatëse) për mos kryerjen në mënyrën e duhur të vlerësimit të cilësisë së raporteve të kontrollit tatimor në vend, referuar Rregullores së Funksionimit të Administratës Tatimore dalë me Urdhrin nr. 192 datë 12.08.2020, neni 58 “Përgjegjësitë dhe detyrat e përgjegjës të sektorit të kontrollit në vend”, pikat 1, 2, 3, 4, 5, 7, 8 dhe*
 3. F.M., me detyrë Inspektor i Kontrollit Tatimor në Vend;
 4. R.O., me detyrë Inspektor i Kontrollit Tatimor në Vend;
 5. L.Ç., me detyrë Inspektor i Kontrollit Tatimor në Vend;
 6. A.K., me detyrë Inspektor i Kontrollit Tatimor në Vend;
 7. E.K., me detyrë Inspektor i Kontrollit Tatimor në Vend;
 - *Në cilësinë e inspektorit të kontrollit tatimor në vend, për shkeljet dhe mangësitë e evidentuara në zbatimin e procedurave të kontrollit tatimor në vend, referuar kërkesave të Manualit të Kontrollit Tatimor dhe Programeve të Kontrollit, në lidhje me trajtimin e çështjeve të kontrollit, kryerjes së analizave të dhura financiare, argumentimit dhe dokumentimit të tyre, si dhe mos vlerësim të saktë të situatës financiare të subjekteve tatimpaguese objekt kontrolli, referuar kërkesave të Manualit të Kontrollit Tatimor, kërkesave të Programit të Kontrollit Tatimor, si dhe legjislacionit tatimor, trajtuar në faqe 23-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*
 8. E.K., me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit.

- *Për mos ndjekjen e realizimit të detyrave dhe objektivave të sektorit reflektuar në diferencat e konstatuara të pa sistemuara dhe të pa shoqëruar me dokumentacionin justifikues në Sektorin e Kontrollit nga Zyra, trajtuar në faqe 68-110 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*
- 9. A.P.
- 10. E.K.
- 11. M.H.
- 12. Xh.U.
- *Me detyrë inspektorë pranë Sektorit të Kontrollit nga Zyra, për diferencat e pa justifikuara me dokumentacion mbështetës trajtuar në faqe 23-67 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.*

II. Nuk propozohen masa disiplinore:

- a. *Për punonjësit e Drejtorisë Rajonale Shkodër, Sektori i Kontrollit Tatimor në Vend dhe Sektori i Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit, të cilët kanë rezultuar me shkelje dhe mangësi në nivelin e materialitetit cilësor dhe sasior, nuk rekomandohen masa disiplinore, konkretisht:*
 - 1. P.D.;
 - 2. M.S.;
 - 3. G.B.;
 - 4. F.D.;
 - 5. H.R.;
 - 6. R.H.;
 - 7. M.B.;
 - 8. A.C.;
 - 9. Dh.D.;
 - 10. J.G.;
 - 11. R.R.;
 - 12. U.A.;
 - 13. S.M.
- b. *Për ish. punonjësit e cilësuar më poshtë, të Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit dhe Sektorit të Kontrollit Tatimor në vend, të cilët nuk janë aktualisht në sistemin tatimor, masat nuk mund të ezaurohen:*
 - 1. D.Gj., ish. inspektore në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit;
 - 2. K.P., ish. Inspektore në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit;
 - 3. Rr.L. ish. inspektore në Sektorin e Kontrollit nga Zyra dhe Monitorimit;
 - 4. B.L., ish. Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit Tatimor në Vend;
 - 5. A.M., ish. Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit Tatimor në Vend;
 - 6. A.K., ish. Inspektor i Kontrollit Tatimor në Vend.

D. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL

Për punonjësit e atakuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të cilët vlerësohen për masa disiplinore sa më sipër, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

- a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.
- b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “*Për Nëpunësin Civil*”, i ndryshuar.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT